



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS PENALE**



Programi i studimeve të Doktoraturës në Shkencat Juridike Penale

**DISERTACION
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”**

**KUADRI JURIDIKO-PENAL I TRAJTIMIT TË PEDOFILISË
NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR, ASPEKTE KRAHASORE
ME NORMATIVËN NDËRKOMBËTARE**

**KANDIDATI
ADRIATIK LLALLA**

**UDHËHEQËS SHKENCOR
PROF. DR. ALTIN SHEGANI**

TIRANË, 2017

© E drejta e autorit: Adriatik LLALLA

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit "Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratave", miratur në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me vendimin nr.20, datë 13.11.2008.

Lista e shkurtimeve

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KE	Këshilli i Evropës
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OMS/WHO	Organizata Botërore e Shëndetit
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KP	Kodi Penal
KPC	Kodi i Procedurës Civile
KPA	Kodi i Procedurave Administrative
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
NJDF	Njësia e të Drejtave të Fëmijëve
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
STF	Sekretariati Teknik për Fëmijët
MKR	Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qënieve Njerëzore

Përmbajtja

Hyrje	i
KAPITULLI I	1
Aspekte të përgjithshme të fenomenit të pedofilisë	1
1.1. Kuptimi i pedofilisë	1
1.1.1 Abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit	4
1.1.2. Liria seksuale, pjesë e të drejtës për jetë private.	8
1.1.3 Pedofilia në profilin psikologjik	9
1.2 Regjimi juridik i mbrojtjes së fëmijëve- Vështrim i përgjithshëm	13
1.2.1 Kuadri juridik ndërkombëtar	13
1.2.2. Kuadri juridik shqiptar.....	19
1.2.3. Strategjitë e miratuara.....	23
1.2.4. Institucionet që monitorojnë të drejtat e fëmijëve	26
KAPITULLI II	28
Format klasikë të inkriminimit të pedofilisë	28
2.1. Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur	28
2.1.1 Teknikat e inkriminimit të kësaj figure të veprës penale.....	32
2.1.2 Momenti i konsumimit	35
2.1.3 Rrethanat me rëndësi cilësimi ligjor.	41
2.1.4 Problematikat e shfaqura në praktikë lidhur me anën subjektive të kësaj figure të veprës penale.	54
2.1.5. Relacioni me heqjen e paligjshme të lirisë	59
2.1.6. Relacioni me figurën e veprës penale të “Fyerja”.	72
KAPITULLI III	75
Forma të tjera të inkriminimit të pedofilisë	75
3.1. Marrëdhënia seksuale në gjini	75
3.2. Vepra të turpshme	84
3.2.1. Rrethana me vlerë cilësimi ligjor.....	91
3.2.2. Veprat e turpshme dhe prishja e qetësisë publike.....	95
3.3. Figura e veprës penale të “Pornografia”	98
3.3.1 Disa aspekte historike dhe kuptimi i pornografisë	98
3.3.2. Kuptimi i termit “fëmijë”	103
3.3.3 Format e inkriminimit.....	105

3.3.3.1. Kriminalizimi i posedimit të materialeve pornografike me fëmijë, pa marrë parasysh qëllimin për t'i shpërndarë ato (Karakterit formal i veprës penale të pornografisë).....	105
3.3.3.2. Kriminalizimi i shkarkimeve dhe shikimeve nga interneti i imazheve pornografike me fëmijë dhe përdorimi i internetit për të shpërndarë pornografinë e fëmijëve.	109
3.3.3.3. Penalizimi i atyre që iu bëjnë të ditur të tjerëve se ku mund të gjejnë pornografinë e fëmijëve.....	114
3.3.3.4. Kriminalizimi i veprimeve të prindërve ose kujdestarëve të cilët pajtohen me pjesëmarrjen e fëmijës së tyre në pornografinë e fëmijëve.	114
3.3.3.5. Veprimet e joshjes, tërheqjes (Grooming) së të miturit për të realizuar raport seksual duhet të penalizohen.....	115
3.3.3.6. Përgjegjësia penale e fëmijëve të përfshirë në pornografi.....	116
3.3.3.7. Rëndimi i sanksioneve për shkelësit përsëritës, pjesëmarrësit në krimin e organizuar, si dhe faktorë të tjerë që mund të konsiderohen në caktimin e dënimit.....	116
KAPITULLI IV.....	119
Aspekte procedurale për mbrojtjen e të drejtave të miturit- viktimë të trafikimit, ose shfrytëzimit seksual, ose abuzimit seksual	119
4.1. Aktet juridike ndërkombëtare me fokus garantimin e të drejtave të miturit viktimë e krimeve me natyrë seksuale.	124
4.2. Aspektet procedurale të karakterit jo penal, që paraprijnë procedurën penale.	128
4.2.1 Identifikimi i viktimës, si aspekti themelor në zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e abuzuesit, ose shfrytëzuesit seksual të të miturit.....	128
4.2.1.1 Dallimet themelore ndërmjet termit “identifikim i të miturit –viktimë” dhe termit “kualifikim si vepër penale i abuzimit, ose shfrytëzimit seksual”....	131
4.2.1.2 Subjektet që realizojnë identifikimin e të miturit viktimë.....	132
4.2.1.3 Sistemi i indikatorëve për indentifikimin e të miturit viktimë	137
4.3. Caktimi i një kujdestari	138
4.4. Referimi, si pikënisje e procedimit penal.....	141
4.4.1. E drejta për akses në shërbimet mbështetëse të viktimës.....	143
4.5. Aspektet procedurale penale dhe të drejtat e të miturit viktimë e abuzimit ose shfrytëzimit seksual.....	144
4.5.1 Mosaplikimi i përgjegjësisë penale ndaj viktimave të shfrytëzimit seksual, si një aspekt themelor për mbrojtjen e të drejtave të miturit.	146
4.5.2 Të drejtat e viktimës së mitur në kuadër të procedimit penal.....	150
4.5.2.1 E drejta për informim i të miturit.....	150

4.5.2.2. E drejta për interpretim, sqarim dhe përkthim.....	154
4.5.2.3 Të drejtat e viktimës në rastin e vendimit për të mos proceduar.....	155
4.5.2.4 E drejta për siguri dhe mbrojtje i të miturit viktimë	158
4.5.2.5 Rehabilitimi i të miturit.	160
4.5.2.5.1 Dëmshpërblimi	162
4.5.2.5.2 Mekanizmat e shpërblimit	164
4.6. Të dhëna statistikore.....	168
4.6.1. Tendencat sipas veprave penale	168
Konkluzione dhe rekomandime	175
Biblografia	189

Hyrje

Objekt i këtij studimi është kuadri juridiko-penal i trajtimit të pedofilisë në legjislacionin shqiptar-aspekte krahasimore me normativën ndërkombëtare. Pedofilia është një fenomen, i cili paraqitet në disa dimensione, atë juridik, psikiatrik, sociologjik. Për shkak të pranisë së tij në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha shtetet, ai është shndërruar në një fenomen me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Si një dukuri e përfshirë në krimin e abuzimit seksual me të miturit, pedofilia është një fenomen i konstatuar në të gjitha vendet dhe kulturat botërore që nga lashtësia e deri më tani, por është e pamundur të përcaktohet në shifra.

Në këtë punim vëmendja do të përqëndrohet në analizimin e fenomenit të pedofilisë në dimensionin juridik, material- penal dhe procedural- penal.

Në kuptimin juridik pedofilia nënkupton abuzimin seksual, i cili përkufizohet si angazhim i një fëmije në aktivitete seksuale, të cilat ata nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj janë të paafte që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabutë e shoqërisë. Abuzimi seksual, përfshin një spektër aktivitetimesh duke filluar nga marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me dhunë (përdhunimi) deri tek mënyrat e abuzimeve seksuale më pak të dhunshme.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmije më të rritur, i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar. Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shteruese): përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme; shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme; shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike.

Konventa Lanzarote e përkufizon abuzimin seksual si: *“Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili, sipas dispozitave përkatëse të ligjit kombëtar, nuk e ka arritur moshën ligjore për aktivitete seksuale”*;

Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë ku:

- *përdoret shtrëngimi, forca ose kërcënimet; ose*
- *abuzimi bëhet nga një pozicion i njohur i besimit, autoritetit ose influencës mbi fëmijën, duke përfshirë dhe brenda familjes; ose*
- *abuzimi bëhet nga një situatë veçanërisht e cënueshme e fëmijës, përkatësisht për shkak të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike ose të një situatë të varësisë....”¹.*

Fenomeni i pedofilisë, abuzimit seksual është prezent edhe brenda rrethit të besimit, ku dhunimi seksual i fëmijëve bëhet nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar, të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes. Pavarësisht rëndësisë, e cila pasqyrohet në veçanti tek pasojat negative që sjell për fëmijët abuzimi seksual nga persona të rrethit të besimit, në

¹ Shih nenin 18 të Konventës Lanzarote ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

vendin tonë literatura, qoftë edhe në kuadrin e projekteve modeste studiuere të këtij fenomeni kanë qënë të pakta, për të mos thënë kanë munguar².

Mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit është një e drejtë themelore e të gjithë fëmijëve, prandaj institucionet shtetërore dhe ato publike, shoqëria civile, komunitetet dhe familja kanë detyrimin të krijojnë një mjedis që edukon, mbron dhe kujdeset për të gjithë fëmijët e një vendi.

Konventa Lanzarote³ është akti i parë ndërkombëtar që proklamon në mënyrë eksplicite çështjen e abuzimit seksual tek fëmijët brenda rrethit të besimit. Konventa përcakton qartë detyrimin e shteteve palë për të kriminalizuar abuzimin seksual me fëmijët në rrethin e besimit.

Në vendin tonë fenomeni i pedofilisë ka qënë prezent në të gjitha kohët, por legjislatori nuk e ka normuar si fenomen, pavarësisht sanksionimit penal të formave të inkriminimit të abuzimit seksual me të mitur. Nga analiza e legjislacionit penal që ka qënë në fuqi ndër vite në vendin tone, rezulton se aktivitetet e abuzimit seksual me të mitur ka qënë të inkriminuara. Në dekadat e fundit, për shkak të nevojës për të luftuar fenomenin e pedofilisë, i cili kishte karakter ndërkombëtar, janë miratuar një sërë aktesh juridike ndërkombëtare, me qëllim normimin e unifikuar të këtij fenomeni.

Përveç inkriminimit penal, në kuadër të efikasitetit të luftës ndaj pedofilisë është e nevojshme që të merren masa për parandalimin e këtij fenomeni. Gjithashtu, viktimës së mitur duhet t'i kushtohet një vëmendje e madhe, me qëllim garantimin e të drejtave të tij në procesin penal.

Metodologjia

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur disa metoda, të ndërthurura me njëra-tjetrën, si ajo e analizës, sintezës, observimit, konkretizimit, specifikimit, induksionit dhe deduksionit, si metoda themelore të metodës logjike, e cila gjithmonë është kuptuar si metodë e cila nxjerr të dhëna shkencore të përpunuara, të ndërtuara në konkluzione.

Metoda e analizimit të hollësishëm të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, i cili ka për objekt aspekte të ndryshme të fenomenit të pedofilisë, mbledhjes të dhënave përmes observimit, të vështrimit kritik të literaturës dhe jurisprudencës, është e pranishme në pjesën më të madhe të punimit. Kjo konsiderohet si një nga metodat më të rëndësishme të hulumtimit logjik shkencor, e cila gjithmonë është e pandarë me metodën e sintezës.

Gjithashtu, për të evidentuar idetë kryesore është përdorur metoda deduktive, që nënkupton metodën e përfundimeve, por duke u gërshetuar në shumë raste me atë induktive. Përsa i përket metodës deduktive, fillimisht trajtohen aspekte të veçanta të fenomenit të pedofilisë të parashikuara nga legjislacioni dhe të elaboruara nga teoria e së drejtës, nga praktika gjyqësore, për të arritur më pas në përfundime domethënëse të kërkimit shkencor duke evidentuar në çdo rast problemet e veçanta.

Metoda induktive zë një rol të konsiderueshëm të punimit. Metoda induktive nënkupton procesin e zbatimit të konkluzioneve sistematike ku në mbështetje të fakteve të ndara dhe të veçanta vjen deri konkluzioni për gjykim të përgjithshëm, nga vrojtimi i rasteve konkrete e të veçuara, si dhe të fakteve të tjera të kësaj natyre,

² Shih “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. Dhjetor 2015, Terre Des Hommes. Fq.10

³ Konventa Lanzarote ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

arrihet deri te konkluzionet e përgjithshme. Kryesisht, do të shihet analiza juridiko-proceduralo-penale e ndërlidhjes së elementëve material penal dhe procedural penal. Krahas analizimit të literaturës vendase dhe të huaj, është bërë krahasimi i legjislacionit vendas me standardet ndërkombëtare, duke nxjerrë në pah diferencat ndërmjet tyre.

Rasti studimor është një tjetër metodë që është përdorur gjatë punimit, kryesisht lidhur me aspektet materiale dhe procedurale penale përmes praktikës dhe vendimeve të Gjykatës së Lartë. Kjo metodë është përdorur edhe për të kryer një analizë krahasuese në lidhje me qëndrime të vendeve të ndryshme në situata të caktuara të lidhura me legjislacionet përkatëse.

Literatura, e shfrytëzuar për realizimin e këtij punimi është e shumëllojshme, si e vendit tonë, ashtu dhe e vendeve të tjera. Burimet e shfrytëzuara janë legjislacioni shqiptar, artikuj shkencorë, komentare, të brendshëm dhe të huaj, vendime të Gjykatës së Lartë, vendime të gjykatave në periudhat e marra në studim, legjislacioni i shteteve të huaja etj.

Kapitulli i parë ka në fokusin e tij trajtimin e aspekteve të përgjithshme të fenomenit të pedofilisë, fillesat e këtij fenomeni dhe qasjen e shoqërisë dhe organeve shtetërore ndaj tij. Ky fenomen është sa historik aq dhe aktual dhe ka qënë prezent që nga lashtësia. Termi “Pedofili” vjen nga greqishtja dhe do të thotë Pedio (marrëdhënie) dhe Filio (fëmijë). Pedofilia bën pjesë tek perversionet seksuale dhe nënkupton dëshirën seksuale për të kryer marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me fëmijë. Fenomeni i pedofilisë gjendet në të gjitha shoqëritë dhe shtetet e botës. Ajo i përfshin të dyja aspektet, si fantazinë ashtu dhe sjelljen. Ky fenomen është i pranishëm edhe në familje. Pedofilia përfshin edhe marrëdhëniet homoseksuale, në të cilat personi i rritur kryen aktin me të mitur, zakonisht në moshën para pubertetit, ose në pubertet të hershëm. Homoseksualizmi është çoroditje seksuale ku instinkti seksual orientohet drejt partnerit të së njëjtës gjini.

Gjithashtu, është trajtuar relacioni që ka fenomeni i pedofilisë me konceptin e dhunës seksuale dhe abuzimit seksual. Kuptimi i kësaj të fundit, tashmë me karakter ndërkombëtar dikton domosdoshmërinë e përcaktimit të definicionit se çfarë nënkuptohet me “dhunë”.

Në këtë kapitull i është kushtuar rëndësi trajtimit të fenomenit të pedofilisë dhe abuzimit seksual brenda rrethit të besimit, ku dhunimi seksual i fëmijëve bëhet nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar, të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes. Pavarësisht rëndësisë, e cila pasqyrohet në veçanti tek pasojat negative që sjell për fëmijët abuzimi seksual nga persona të rrethit të besimit, në vendin tonë literatura, qoftë edhe në kuadrin e projekteve modeste studiuuese të këtij fenomeni kanë qënë të pakta, për të mos thënë kanë munguar. Edhe pse relativisht i shpeshtë, fenomeni është shumë i vështirë për t’u identifikuar, analizuar dhe më pas adresuar nëpërmjet programeve dhe shërbimeve efektive.

Një aspekt tjetër, i cili është trajtuar ka qënë jeta seksuale e një personi si pjesë e jetës së tij private, e cila përbën një aspekt të rëndësishëm të të drejtave themelore të njeriut. Jeta private garanton një sferë brenda së cilës një person mund të krijojë marrëdhënie të llojeve të ndryshme, duke përfshirë edhe ato seksuale dhe si rrjedhojë jep zgjedhjen për të afirmuar e nënkuptuar se identiteti i jetës seksuale të një personi i përket mbrojtjes së dhënë nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë kapitull është trajtuar pedofilia në profilin psikologjik. Shkenca juridiko-penale gjithnjë e më shumë është fokusuar tek politika penale specifike për evidentim, parandalim, rehabilitim dhe ndëshkim të viktimizimit seksual të fëmijëve. Në Shqipëri, krimet seksuale e më tej krimet me sfond seksual po bëhen më të shpeshta e më të rënda me forma tragjike të viktimizimit. Ky lloj krimi karakterizohet nga elementë social dhe psikologjik.

Pedofilia është një status dhe jo një akt, kështu që pedofili mund të jetojë me pedofili dhe të mos veprojë si i tillë. Në bazë të hulumtimeve, rreth gjysma e të gjithë dhunuesve seksualë të fëmijëve nuk janë të tërhequr seksualisht nga viktimat e tyre. Aktivitetet seksuale përfshijnë të gjitha format e kontaktit me fëmijët, orale, gjenitale apo anale, por gjithashtu edhe abuzimet pa kontaktin e prekjes si psh. eksibicionizmi, vojerizmi apo përdorimi i fëmijës në prodhimin e pornografisë. Abuzimi seksual i fëmijëve mund të jetë në shumë forma: inçest, pornografi, prostitucion, trafikim, korrupsion dhe shfaqje të sulmeve seksuale.

Personat që vuajnë prej saj shfaqin ndër të tjera edhe dyzim dhe çrregullim të identitetit, çka duket është edhe arsyeja pse ata mund të jetojnë “normalisht” për periudha të ndryshme kohe apo të arrijnë të ruajnë sekretin. Organizata Botërore e Mjekësisë (OMS/WHO) e ka klasifikuar pedofilinë si sëmundje, e cila daton në vitin 1952.

Pedofilia ndryshe nga shumë diagnoza të tjera, nuk e shkarkon të akuzuarin nga përgjegjësitë penale. Organizata Botërore e Shëndetit dhe Shoqata e Mjekëve Psikiatër Amerikan, nëpërmjet metodës DSM kanë vlerësuar se shqetësime të orientimit të libidit nuk sjellin përjashtim të subjektit nga përgjegjësia penale.

Pas trajtimit të aspekteve të lartpërmendura, në këtë kapitull është trajtuar edhe regjimi juridik i mbrojtjes së fëmijëve, si një vështrim i përgjithshëm. Të drejtat e fëmijëve, përveçse në kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar duhen përfytyruar dhe realizuar si pjesë e platformave strategjike dhe dokumenteve të cilat kanë në qendër përfshirjen sociale në shoqëri.

Në kapitullin e dytë është trajtuar forma klasike e inkriminimit të pedofilisë, marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur, teknikat e inkriminimit të kësaj figurë të veprës penale, momenti i konsumimit të kësaj figurë, si dhe problematikat e shfaqura në praktikë lidhur me anën subjektive të kësaj figure të veprës penale.

Marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale me të mitur janë një nga krimet që kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore. Ato përfaqësojnë një nga format kryesore të abuzimit seksual ndaj të miturit. Mbrojtja e lirisë seksuale dhe zhvillimit seksual normal të personit të mitur përbën një nga aspektet kryesore të integritetit fizik dhe psikik të tij, si dhe një nga të drejtat dhe liritë themelore të të miturit. Prandaj kjo figurë e veprës penale paraqet rëndësi të madhe në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Objekti i këtij kapitulli është analiza restrospektive-historike e kësaj figure të veprës penale. Në veçanti janë analizuar parashikimet e bëra nga Kodi Penal i vitit 1952 dhe i vitit 1977. Në kuadër të analizës historike të kësaj figure të veprës penale theksojmë se teknikat e inkriminimit të saj janë të mbartura nga kodet penale, që kanë qënë në fuqi më përpara në Republikën e Shqipërisë.

Edhe pas vitit 1995, kjo dispozitë ka qënë objekt ndërhyrje nga ana e ligjvënësit, me qëllim që fusha e mbrojtjes të saj të zgjerohet.

Meqë Kodi Penal nuk ka dhënë përkufizimin e termit “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale”, në këtë punim janë bërë përpjekje për të dhënë një përkufizim. Për këtë qëllim, është analizuar doktrina e së drejtës penale në retrospektive. Kështu,

doktrina e së drejtës në Shqipëri, më përpara, e ka përcaktuar këtë term si bashkimin seksual normal midis një mashkulli dhe një femre. Një kuptim i tillë ka karakter kufizues. Megjithatë, edhe doktrina e së drejtës penale në Shqipëri, ka përqafuar tendencat me karakter ndërkombëtar, të cilat e trajtojnë marrëdhënien seksuale ose aktin seksual si penetrim sado i vogël, i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit, ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit. Gjithashtu, me marrëdhënie seksuale kuptohet jo vetëm bashkim formal të dy personave, të sekseve të ndryshëm apo të njëjtë por, edhe çdo lloj akti, i cili edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me kontaktin fizik direkt me subjektin pasiv (viktimën) ka për qëllim dhe është i përshtatshëm të vërë në rrezik të mirën parësore të individit, atë të lirisë seksuale, nëpërmjet eksitimit ose sadisfaksionit të instiktit seksual të personit abuzues.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij kapitulli ka qënë analiza e lidhur me përcaktimin e momentit në të cilin kjo figurë e veprës penale konsiderohet e konsumuar, sepse një gjë e tillë paraqet rëndësi të veçantë për të bërë dallimin e fazave të përgatitjes, tentativës dhe kryerjes, për përcaktimin e kompetencës territoriale, për aplikimin e normave penale në bazë të veprimit në kohë të ligjit penal, për afatet e parashkrimit në veprat penale të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Gjithashtu, janë trajtuar në mënyrë të hollësishme rrethanat me rëndësi për cilësimin ligjor të veprës penale.

Në këtë kapitull është analizuar përgjigja e pyetjes: A ka përgjegjësi penale, nëse mungon dijenia e subjektit aktiv për moshën, ose mosarritjen e pjekurisë seksuale të të dëmtuarit/ës, duke patur një përfytyrim të gabuar për to, apo nëse mungon dijenia se një akt i tillë seksual është i dënueshëm?

Një pjesë të rëndësishme të këtij kapitulli e zë analiza lidhur me relacionin e kësaj figure të veprës penale me figurat e veprave të tjera, si me heqjen e paligjshme të lirisë, relacioni me figurën e veprës penale të “Fyerjes” etj.

Pasojë direkte, madje parësore e kryerjes së marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale është cënimi, heqja e lirisë së personit të dëmtuar, sepse ajo përbën një nga elementët e anës objektive të figurës së “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”. Në figurat e krimeve seksuale heqja e paligjshme e lirisë së personit i paraprin dhe shoqëron kryerjen e aktit seksual. Nisur nga sa më sipër, disa shtete i trajtojnë krimet seksuale si vepra penale që çënojnë lirinë e personit duke i grupuar në të njëjtin seksion. Pavarësisht koneksitetit material ndërmjet tyre ekzistojnë dallime thelbësore, të cilat pasqyrohen në elementët e secilës prej tyre.

Duke konstatuar ngjashmërinë që ka rrëmbimi, ose mbajtja peng e personit me qëllim përfitimin, me heqjen e paligjshme të lirisë me qëllim për të kryer marrëdhënie seksuale me të mitur, është e rëndësishme të analizohen diferencat thelbësore ndërmjet këtyre figurave të veprës penale.

Krimi “Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur”, siç e theksuam më lart ka objekt juridik mbrojtjen e lirisë seksuale, por akti seksual dhe veprimet që e përbëjnë, apo shoqërojnë atë çënojnë edhe ndjenjën e dinjitetin personal. Kjo e fundit përbën objektin juridik të mbrojtjes të figurës së veprës penale të “Fyerja”. Pavarësisht koneksitetit natyror të tyre, ndërmjet krimit “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe kundërvajtjes penale të “Fyerja” ekzistojnë dallime thelbësore si nga objekti që ato prekin ashtu edhe nga ana subjektive.

Në kapitullin e tretë janë analizuar format e tjera të inkriminimit të pedofilisë, si: marrëdhënia seksuale në gjini; ngacmimi seksual; vepra të turpshme; prishja e qetësisë publike; figura e veprës penale e “Pornografisë”.

Një nga figurat e krimit seksual që legjislacioni penal ka parashikuar është edhe figura e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”. Kjo figurë, në aspektin historik, ka qënë e parashikuar edhe nga kodet penale të mëparshme si ai i vitit 1952, ashtu edhe ai vitit 1977.

Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në gjini në literaturën juridike, njihen me termin incest, i cili cënon normat morale. Lidhur me zbulimin e këtyre marrëdhënieve parashtrihen vështirësi të konsiderueshme dhe tregohen edhe pasojat lidhur me marrëdhëniet familjare gjatë procedurës së ndjekjes. Si rezultat i këtyre diskutimeve, disa shtete kanë hequr dorë nga ndëshkimi i këtyre marrëdhënieve (Franca, Portugalia, Belgjika). Mirëpo incesti mbetet ende i ndëshkueshëm për shumë shtete (Italia, Danimarka, Gjermania, Greqia etj.). E drejta penale bashkëkohore, marrëdhëniet seksuale në mes të anëtarëve të familjes i konsideron si shkelje të lirisë seksuale dhe moralit në përgjithësi.

Në vijim, është bërë një trajtim i hollësishëm në funksion të dhënies së përgjigjes për pyetjen: A konkuron figura e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” me figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini, ose kujdestari”?

Në doktrinën e së drejtës penale në Shqipëri, është mbajtur qëndrimi se për sa kohë që objekti i drejtpërdrejtë i këtyre figurave është i ndryshëm, atëherë duhet të pranojmë edhe konkurrimin ndërmjet tyre. Për të njëjtën arsye, figura e “marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, konkurren me të gjitha krimet e tjera seksuale. Sipas tyre krimi i marrëdhënieve seksuale në gjini konkuron në çdo rast me krimet e tjera seksuale.

Pavarësisht se nga pikëpamja formale, figurat kanë elementë të ndryshëm, ato nuk mund të konkurojnë ndërmjet tyre, sepse qëllimi i legjislacionit penal dhe detyrë e tij, është marrja në mbrojtje e të mirave juridike të parashikuara nga neni 1/b i Kodit Penal. Pra, t’i sigurojë një mbrojtje efektive marrëdhënieve juridike të vendosura nga veprimet ose mosveprimet kriminale të personave, duke caktuar dënim penal ndaj tyre. Për rrjedhojë nëse dy figura kanë të njëjtin objekt ato nuk mund të konkurrojnë, pasi secila nga ato e siguron mbrojtjen e marrëdhënies juridike përkatëse.

Siç rezulton, një nga kushtet që kërkohet lidhur me konkurimin fiktiv të specialitetit është që figurat duhet të kenë të njëjtin objekt grupor, ose me koneksitet derivativ ndërmjet tyre.

Si përfundim, theksojmë se për të shmangur të gjitha problematikat lidhur me konkurimin ndërmjet figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” dhe figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, është e nevojshme ndërhyrja legjislative duke e parashikuar si rrethanë cilësuese në njërin nga figurat e veprës penale, atë të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në gjini ose nën kujdestari me të miturit.

Analiza e bërë në këtë kapitull lidhur me konkurimin ndërmjet figurave të veprës penale “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”, është e vlefshme edhe në lidhje me konkurimin ndërmjet figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” dhe figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”.

Gjithashtu, është analizuar në mënyrë të hollësishme në tërësinë e elementeve të saj figura e veprës penale “Vepra të turpshme”. Parashikimi i figurës së veprës penale “Vepra të turpshme” nga Kodi Penal që hyri në fuqi në vitin 1995 është

vazhdim i traditës së kodeve penale të mëparshme të vitit 1952 dhe 1977, të cilët bënin të njëjtin parashikim.

Për shkak të rrezikshmërisë dhe përhapjes së madhe të saj, i është kushtuar vëmendje figurës së veprës penale të “Pornografisë”, e cila është parashikuar nga Kodi Penal që hyri në fuqi në vitin 1995, duke vazhduar traditën e kodeve penale të mëparshme, por duke sjellë risi në kuadër të teknikës së inkriminimit si qasje e zhvillimeve ndërkombëtare.

Në kapitullin e katërt trajtohet analiza juridike e pozitës së të dëmtuarit dhe të drejtat e tij gjatë procesit penal. Mbrojtja e të drejtave të të dëmtuarit, nuk ka patur vëmendje specifike nga legjislatori, sepse ky i fundit përqëndrohet në zbulimin, gjetjen, ndëshkimin e autorit të veprës penale. Një aspekt i tillë ka bërë që në doktrinë të theksohet se tipari diskrecionar karakterizon drejtësinë tonë penale, sepse i gjithë sistemi procedural penal, duke përfshirë edhe atë penal material ka në fokus atë të sipërcituar, duke mos i kushtuar rëndësi, në veçanti pasojave të veprës penale dhe pozitës së të dëmtuarit. Një qasje të tillë ka qënë prezente pothuajse në të gjitha shtetet.

Dekadat e fundit, për shkak të nevojës dhe domosdoshmërisë, organizmat ndërkombëtar janë investuar në krijimin e një kuadri ligjor, i cili të përmirësonte pozitën dhe të drejtat e të dëmtuarin nga vepra penale në përgjithësi dhe viktimës së mitur në veçanti. Vendi ynë ka treguar në përmanencë vullnetin që të përqafojë nismat ndërkombëtare duke ratifikuar me shpejtësi konventat ndërkombëtare me objekt pozitën e viktimës në procesin penal. Megjithatë, akoma është në fazën embrionale koncepti i “viktimologjisë” dhe nuk janë marrë të gjitha masat që këto konventa kërkojnë në këtë drejtim.

Meqë, Republika e Shqipërisë është angazhuar në mënyrë të veçantë, me parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i të miturve, duke shprehur vullnetin e tij në luftën kundër këtij fenomeni edhe nëpërmjet ratifikimit të disa konventave, të cilat zënë një vend të veçantë në hierarkinë e akteve ligjore, në këtë kapitull trajtohet e gjithë panorama e akteve juridike, të cilat rregullojnë pozitën e të dëmtuarit në procesin penal.

Trajtimi juridik është bërë duke ndarë në dy faza aspektet procedurale. Në fazën e parë janë trajtuar aspekte procedurale, të cilat nuk janë të natyrës procedurale penale në thelb, por me një kontribut të rëndësishëm në këtë të fundit. Identifikimi i të miturit, viktimë e abuzimit seksual, ose trafikimit, është një nga aspektet procedurale kryesore, i cili jep kontribut të rëndësishëm për zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e abuzuesit, ose shfrytëzuesit, si dhe bën të mundur mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë një angazhim serioz në arritjen e një procesi identifikimi sa më efektiv, i cili shprehet në miratimin nga Këshilli i Ministrave i vendimit nr.582, datë 27.07.2011 “Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit”.

Nëse në përfundim të procesit të identifikimit arrihet që të identifikohet një, ose disa të mitur, të cilat kanë qënë viktimat të trafikimit, shfrytëzimit, ose abuzimit seksual, hapi i parë që duhet të ndërmerret është caktimi i një kujdestari për ta shoqëruar të miturin përgjatë gjithë procesit, deri sa të gjendet dhe zbatohet një zgjidhje e qëndrueshme në interesat më të mirë të fëmijës.

Ky aspekt procedural paraqet rëndësi substanciale për mbrojtjen e të drejtave të miturit, aq sa është ngritur në standard me karakter ndërkombëtar, i parashikuar nga aktet ndërkombëtare dhe i detyrueshëm për t'u ndërmarrë nga të gjitha shtetet, të cilat kanë ratifikuar këto akte.

Në pjesën në vijim të këtij kapitulli është trajtuar aspekti procedural i referimit. Fëmijët viktime duhet t'u referohen pa vonesë shërbimeve të përshtatshme.

Një analizë e hollësishme i është bërë të drejtës për mbështetje, e cila është një e drejtë themelore. Mbështetja është thelbësore për shërimin e viktimave dhe qëllimi i kësaj të drejte është, të sigurojë që viktimat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të kenë akses në shërbimet e mbështetjes pa pagesë, duke përfshirë informacion dhe këshilla, mbështetje emocionale, psikologjike dhe ndihmë praktike.

Në pjesën e dytë të këtij kapitulli janë trajtuar të gjitha të drejtat e viktimës në procesin penal. Ratifikimi i një sërë konventash nga Republika e Shqipërisë, duke i bërë pjesë të sistemit juridik të brendshëm dhe të detyrueshëm për zbatim, kërkon që në legjilacionin procedural penal të reflektohen qasjet e tyre, të merren masat e duhura legjislative në funksion të realizimit të qëllimit të ekzistencës së tyre, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të viktimës në përgjithësi, dhe asaj të të miturit në veçanti. Fillimi i procedimit penal apo vazhdimi i tij për hetimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual nuk duhet të jetë i kondicionuar nga vullneti i të dëmtuarit të mitur.

Në pjesën e fundit të këtij kapitulli janë trajtuar të drejtat e viktimës së mitur në kuadër të procedimit penal, si informimi i të miturit; e drejta për interpretim, sqarim dhe përkthim; të drejtat e viktimës në rastin e vendimit për të mos proceduar; sigurimi, mbrojtja i të miturit viktimë, rehabilitimi i të mituri, dëmshpërblimi, mekanizmat e shpërblimit etj.

Në përfundim të punimit jepen në mënyrë të përmbledhur konkluzionet kryesore mbi problemin e pedofilisë dhe mbrojtjen e të drejtave të të miturve, zhvillimet pozitive dhe mangësitë e legjislacionit penal dhe zbatimit të tij në praktikë, si dhe rekomandime konkrete për përmirësime të mundshme në këtë fushë.

KAPITULLI I

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË FENOMENIT TË PEDOFILISË

1.1 Kuptimi i pedofilisë

Fenomeni i pedofilisë është sa historik aq dhe aktual dhe ka qënë prezent që nga lashtësia⁴. Termi “Pedofili” vjen nga greqishtja dhe do të thotë Pedio (marrëdhënie) dhe Filio (fëmijë). Pedofilia bën pjesë tek perversionet⁵ seksuale dhe nënkupton dëshirën seksuale për të kryer marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me fëmijë.

Fenomeni i pedofilisë gjendet në të gjitha shoqëritë dhe shtetet e botës. Ajo i përfshin të dyja aspektet, si fantazinë ashtu dhe sjelljen. Ky fenomen është i pranishëm edhe në familje. Në rastin kur viktimja është gjini e afërt me pedofilin, atëherë do të quhet *molestim intrafamiljar* ose ndryshe *incest*. Në rastin kur ai kryhet nga një person jashtë familjes quhet *molestim ektrafamiljar*⁶.

Pedofilia përfshin edhe marrëdhëniet homoseksuale, në të cilat personi i rritur kryen aktin me të mitur, zakonisht në moshën para pubertetit, ose në pubertet të hershëm. Homoseksualizmi është çoroditje seksuale ku instinkti seksual orientohet drejt partnerit të së njëjtës gjini. Fenomeni i pedofilisë përbën objekt studimi të shumë shkencave shoqërore, si psikiatrisë, sociologjisë dhe shkencave juridike.

Psikiatria i përkufizon pedofilët si persona mbi moshën 16 vjeç, për të cilët fëmijët femra apo meshkuj, përbëjnë objekt seksual të preferuar ose është objekti i vetëm seksual që identifikohet nga ata. Sipas kësaj, pedofilia është një orientim seksual i pandryshueshëm, i karakterizuar nga këmbëngulja dhe ndonjëherë tërheqja ekskluzive për fëmijët para pubertetit. Ky përkufizim pasqyron vetëm tërheqjen seksuale, sepse jo të gjithë pedofilët abuzojnë me fëmijët, shumë prej tyre janë në gjendje të kontrollojnë veprimet e tyre. Pedofilia është forma më radikale mes formave të ngacmimeve seksuale, si mania për t’u dukur (ai që tregon organet gjenitale), mazokizmi apo disa forma të ndryshme të seksualizmit të paarsyeshme dhe të pandalshme, të cilat përbëjnë një nga format e “varësisë seksuale”.

Pedofilët janë njerëz që abuzojnë seksualisht me fëmijët, pavarësisht nga gjinia e tyre. Pedofilët gjithashtu referohen edhe si ngacmues seksual të fëmijëve ku përfshihen të gjitha format e abuzimit seksual. Abuzimi seksual klasifikohet edhe si sugjerim seksual duke treguar pornografi, përkëdhelje, puthje, prekje, masturbim, seks oral dhe penetruar.

Psikiatria e konsideron, pedofilinë si një çrregullim mendor që ndeshet tek personat mbi 16 vjeç, të cilët karakterizohen nga një interes seksual parësor e ekskluziv ndaj fëmijëve të moshës së parapubertetit ose pubertetit të hershëm. Pra, objekti i synuar janë fëmijë përgjithësisht të moshës nën 11 vjeç, megjithëse kriteret

⁴ Platoni (shek. V – IV p. e s.) pohonte se krimi është shprehje e shpirtit të sëmurë dhe se për shkak të çrregullimeve shpirtërore shkaktohen instinkte të tilla, të cilat kërkojnë plotësimin e kënaqësive që çojnë deri në kriminalitet.

⁵ perversione - zakone të kundërligjshme, çoroditje

⁶ molestim intrafamiljar - abuzim seksual brenda familjes

specifikë për këtë çrregullim mund ta shtrijnë kufirin moshor për parapubertetin deri në moshën 13 vjeç.

Sipas standardeve ndërkombëtare të sëmundjeve, ku klasifikohen edhe çrregullimet mendore, një adoleshent që është 16 vjeç ose më i madh, i cili është të paktën pesë vite më i madh se fëmija ndaj të cilit ka tërheqje seksuale, mund të diagnostikohet si rast pedofilie. Pra, personi, kryesisht madhor në moshë, karakterizohet nga një tërheqje dhe interes seksual i tillë, që është i vazhdueshëm e i qëndrueshëm në kohë, për të paktën gjashtë muaj. Puna kërkimore, ka treguar që pedofilia mund të haset si te meshkujt, ashtu edhe tek femrat, por është më e theksuar tek meshkujt. Raste mund të gjenden edhe mes personave të afërt e familjarë të të miturit.

Duke qenë një çrregullim afektiv seksual, mund të kuptohet që kemi të bëjmë me rast pedofilie, kur personi, për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, fantazon dhe ndjen kënaqësi seksuale të orientuara ndaj të miturve, përjeton impulse seksuale në prani apo distancë të të miturve dhe/ose i materializon dëshirat seksuale nëpërmjet abuzimit seksual me të miturin. Por, nuk është kusht i domosdoshëm që personi me çrregullimin e pedofilisë të kryejë akte abuzimi seksual me të miturin dhe kështu personi, klasifikohet si pedofil edhe nëse ushqen fantazi dhe përjeton tërheqje seksuale ndaj të miturit. Në këtë klasifikim futen edhe persona të cilët mbledhin dhe shohin materiale pornografike me të miturit.

Si një dukuri e përfshirë në krimin e abuzimit seksual me të miturit, pedofilia është një fenomen që haset në të gjitha vendet dhe kulturat botërore, por është e pamundur të përcaktohet në shifra. Sipas një studimi (Seto MC, 2009) të bazuar në SHBA, pedofilia vlerësohet të jetë në më pak se 5% të popullsisë së meshkujve të rritur. Një studim tjetër (Cohen, 2002) vlerëson se raporti mes meshkujve dhe femrave me sjellje pedofilie është 10 me 1. Raportet botërore që vlerësojnë abuzimin seksual me të miturit japin shifra të ndryshme në vite të ndryshme, kjo për shkak të ndryshme si: numri i rasteve të denoncuara e të ndjekura penalisht, statistikave e sakta të referimit në qendra të përkujdesit shëndetësor e social, si dhe vetë ndërgjegjësimit dhe denoncimit të abuzimit nga vetë shoqëria. Raportet ndërkombëtare të përvitshme tregojnë për një numër të lartë kërkesë nga vendet perëndimore për materiale që ofrojnë shërbime e favore seksuale me/nga të mitur (duke përfshirë edhe pornografinë), si dhe raste të abuzimit me fëmijë të përfshirë në krimin e trafikimit njerëzor, por kjo nuk përjashton shoqëritë dhe kulturat lindore dhe hemisferin jugor. Pra, është një dukuri globale, e ushqyer nga një përqendrim i madh në kënaqësinë seksuale dhe mungesën e informacionit dhe ndërgjegjësimit të mjaftueshëm nga shoqëria.

Pedofilia është e lidhur me konceptin e dhunës seksuale dhe abuzimit seksual⁷. Kuptimi i kësaj të fundit, tashmë me karakter ndërkombëtar dikton domosdoshmërinë e përcaktimit të definicionit se çfarë nënkuptohet me “dhunë”. Dhuna⁸ konsiderohet si një dhunim (shkelje) i përgjithshëm i të drejtave të çdo qenieje njerëzore: i së drejtës së jetës, sigurisë, dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik e mendor dhe mund të marrë forma të ndryshme ose, më saktë, materializohet në forma të ndryshme, si agresion ose sulm fizik, abuzim seksual e përdhunim, kanosje dhe tronditje e thellë ose frikësim dhe duhet të konsiderohet nga e drejta penale, si vepër penale. Realizimi i këtyre akteve, në rastin e dhunës ndaj fëmijëve, bazohet në raportin ndërmjet një të rrituri dhe një fëmije, karakterizuar ky raport nga një asimetri njohjesh, eksperience si

⁷ Pedofilia dhe abuzimi seksual janë koncepte të lidhura sipas relacionit karteziar me njera-tjetren

⁸ Përkufizim nga Asambleja e Këshillit të Evropës

edhe force fizike, duke e vendosur automatikisht fëmijën në pozita vulnerabiliteti dhe në një ekspozim të vazhdueshëm rreziku fizik dhe psikik. Si rrjedhojë, ky fenomen ka karakter shumë kompleks dhe nuk konsiston vetëm në një akt të vetëm dhune fizike, ashtu sikurse rëndom konsiderohet.

Abuzimi seksual (pedofilia, në kuptimin juridik) përkufizohet si angazhim i një fëmijë në aktivitete seksuale, që fëmija nuk mund t'i kuptojë dhe për të cilat nuk ka zhvillimin e duhur. Aktivitetet seksuale mund përfshijnë të gjitha format e gojë-gjenitale, gjenitale, ose kontakti anal nga fëmija ose ndaj fëmijës, ose abuzimet jo prekëse, të tilla si ekzibicionizmi, voyeurism, ose duke përdorur fëmijën në prodhimin e pornografisë.⁹ Abuzimi seksual përfshin një spektër aktivitetesh duke filluar nga përdhunimi, deri tek mënyrat e abuzimeve seksuale më pak të dhunshme.

Dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik, psiko-emocional, abuzimin seksual, neglizhencën, apo shfrytëzimin e fëmijëve – duke shkaktuar në këtë mënyrë dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, pengesa në zhvillim, si dhe humbjen e dinjitetit.

Në veçanti, abuzimi seksual i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj edhe janë të paafte që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabutë e shoqërisë. Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur, i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar. Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të jenë rastet e përfshirjes së fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme, shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme, si shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike etj.

Përkufizimi i abuzimit seksual u formulua në deklaratën e Konsultimit për Parandalimin e Abuzimit ndaj Fëmijëve të OBSH-së në vitin 1999, sipas të cilës:¹⁰ *“Të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe emocional, abuzimi seksual, neglizhenca ose shfrytëzimi komercial i fëmijëve, që rezultojnë në dëmtime të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, rrezikojnë jetën e tyre, çënojnë zhvillimin ose dinjitetin e fëmijëve në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie ndaj fëmijëve, marrëdhënieje besimi, ose marrëdhënieje autoriteti”*¹¹.

“Abuzimi seksual i fëmijëve nënkupton përfshirjen e fëmijëve në aktivitete seksuale të cilat ato nuk i kuptojnë plotësisht, ose nuk janë të përgatitur apo të zhvilluar (të rritur) prandaj edhe janë të paafte që të japin miratimin/pëlqimin përkatës, ose aktivitete të cilat bien ndesh me ligjet dhe tabutë e shoqërisë. Dhuna seksuale ndaj fëmijëve evidentohet nga aktivitete të tilla mes fëmijës dhe një personi të rritur, ose një tjetër fëmijë më të rritur i cili ka marrëdhënie besimi, apo pushteti (autoriteti) me fëmijën e dhunuar. Aktivitete të tilla të lidhura me abuzimin seksual të fëmijëve mund të përfshijnë situatat e mëposhtme (listë e cila nuk është aspak shteruese): Përfshirja e fëmijëve në aktivitete seksuale të paligjshme; Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion, ose praktika të tjera të paligjshme; Shfrytëzimi i fëmijëve për performanca të ndryshme pornografike”.

⁹ Shih Kempe CH. Sexual abuse, another hidden pediatric problem: the 1977 C. Anderson Aldrich lecture. *Pediatrics*. 1978;62:382–389

¹⁰ Shih *Report of the consultation on child abuse prevention*, 29–31 March 1999. Geneva, World Health Organization, 1999 (document WHO/HSC/PVI/99.1).

¹¹ Shih Krug EG et al., eds. *World report on violence and health*. Geneva, World Health Organization, 2002.

Konventa Lanzarote e përkufizon abuzimin seksual si: “Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili, sipas dispozitave përkatëse të ligjit kombëtar, nuk e ka arritur moshën ligjore për aktivitete seksuale”;

Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë ku:

- *përdoret shtrëngimi, forca ose kërcënimet; ose*
- *abuzimi bëhet nga një pozicion i njohur i besimit, autoritetit ose influencës mbi fëmijën, duke përfshirë dhe brenda familjes; ose*
- *abuzimi bëhet nga një situatë veçanërisht e cënueshme e fëmijës, përkatësisht për shkak të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike ose të një situate të varësisë....”¹².*

Abuzimi seksual mund të dallohet nga “loja seksuale” duke përcaktuar nëse ekziston një asimetri zhvillimore mes pjesëmarrësve dhe duke vlerësuar natyrën shtrënguese të sjelljeve.¹³ Kështu, kur fëmijët e vegjël në të njëjtën fazë zhvillimore janë duke vëzhguar ose duke prekur organet gjenitale të njëri-tjetrit për shkak të interesit të përbashkët, pa detyrim apo ndërhyrje të tjetrit, kjo konsiderohet sjellje normale (jo abuzive). Megjithatë, një 6-vjeçar i cili përpigjet për të detyruar një 3-vjeçar për t’u angazhuar në marrëdhënie seksuale anale është duke shfaqur sjellje jonormale dhe organet shëndetësore dhe sistemet mbrojtëse të krijuara për mbarëvajtjen e të miturit duhet të kontaktohet dhe të ndërhyjë, megjithëse incidenti nuk mund të konsiderohet ligjërisht një sulm. Fëmijët ose të rinjtë që shfaqin sjellje të papërshtatshme seksuale mund të jenë duke reaguuar si pasojë e viktimizimit të tyre. Forma të ndryshme të abuzimit seksual janë:¹⁴

A - Format e rënda:

- a) Assault, duke përfshirë përdhunimin dhe marrëdhënie seksuale anormale
- b) Prekja ose përkëdhelje e një fëmijë
- c) Exhibitionism- Detyrimi një fëmijë për të ekspozuar pjesët e tij / saj intime të trupit
- d) Fotografimi i një fëmijë nudo

B - Forma të tjera:

- a) puthje me dhunë
- b) përparimet seksuale ndaj një fëmije gjatë udhëtimit
- c) përparimet seksuale ndaj një fëmije gjatë situatave të martesës
- d) exhibitionism- ekspozimi para një fëmije
- e) ekspozimi një fëmijë të materialeve pornografie

1.1.1 Abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit

Më lart theksuam se fenomeni i pedofilisë, abuzimit seksual është prezent edhe brenda rrethit të besimit, ku dhunimi seksual i fëmijëve bëhet nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar, të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu edhe personat brenda familjes. Pavarësisht rëndësisë, e cila pasqyrohet në veçanti tek pasojat negative që sjell për fëmijët abuzimi seksual nga persona të rrethit të besimit, në vendin tonë, literatura, qoftë edhe në kuadrin e projekteve modeste studiuuese të këtij fenomeni kanë qënë të pakta, për të mos thënë kanë munguar. Edhe

¹² Shih nenin 18 të Konventës Lanzarote ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

¹³ Shih Yates A. Differentiating hypererotic states in the evaluation of sexual abuse. *J Am Acad Child Adolesc Psychiatry.* 1991;30:792

¹⁴Shih Raman, Surekha. (1995). "Violation of Innocence: Child Sexual Abuse and the Law", The Lawyers Collective; (10 &11), October-November

pse relativisht i shpeshtë, ky fenomen është shumë i vështirë për t'u identifikuar, analizuar dhe më pas adresuar nëpërmjet programeve dhe shërbimeve efektive¹⁵.

Mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit është një e drejtë themelore e të gjithë fëmijëve, prandaj institucionet shtetërore dhe ato publike, shoqëria civile, komunitetet dhe familja kanë detyrimin të krijojnë një mjedis që edukon, mbron dhe kujdeset për të gjithë fëmijët e një vendi¹⁶.

Dhuna dhe abuzimi ndaj fëmijëve janë të pranishme në të gjitha vendet e botës dhe janë produkt kompleks i shumë faktorëve shoqërorë, kulturorë, ekonomikë dhe biologjikë. Për më tepër, dhuna dhe keqtrajtimi i fëmijëve përbën faktorin kryesor të pabarazive shëndetësore dhe padrejtësive shoqërore, ku grupet social-ekonomike vulnerabel janë edhe në risk më të lartë për të pësuar eksperiencë të tilla negative¹⁷.

Konventa e Lanzarotes¹⁸ është akti i parë ndërkombëtar që ligjeron në mënyrë eksplicite çështjen e abuzimit seksual tek fëmijët brenda rrethit të besimit. Konventa përcakton qartë detyrimin e shteteve palë për të kriminalizuar abuzimin seksual me fëmijët në rrethin e besimit. Kështu në nenin 18 të saj përcaktohet se: *“Çdo palë merr masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për t'u siguruar se sjelljet e mëposhtme, kur kryhen me qëllim, përcaktohen si masa penale, b. përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, në këto situata:– ...kur abuzohet me një pozicion të njohur që gëzon besim, autoritet ose ndikim mbi fëmijët, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes...”*¹⁹.

Abuzimi seksual në rrethin e besimit i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu personat brenda familjes, komshinjtë, persona të njohur në rrethin familjar, mësues, etj. Nga kjo pikëpamje, marrëdhënie të tilla në “rrethin e besimit” zakonisht ekzistojnë midis fëmijës dhe prindërve të tij, anëtarëve të tjerë të familjes, kujdestarëve ose prindërve adoptues, por ato mund të ekzistojnë gjithashtu edhe në lidhje me personat të cilët, kanë funksione prindërore ose të kujdesit, edukojnë fëmijën, ose ofrojnë kujdes emocional, shpirtëror, terapeutik ose mjekësor, ose, punësojnë ose kanë kontroll financiar mbi fëmijën, apo ushtrojnë kontroll mbi fëmijën²⁰.

Shumica e abuzuesve njihen me viktimën; afërsisht 30% e tyre janë të afërm: më shpesh vëllai, babai, xhaxhai ose kushëri; rreth 60% janë të njohur të tjerë, si “miq të familjes” fqinjë, kujdestarë, dhe vetëm 10% janë të panjohur²¹. Prandaj, abuzimi seksual i fëmijëve në rrethin e besimit konsiderohet mjaft i përhapur pavarësisht nga evidenca e kufizuar zyrtare si pasojë e vështirësive për matjen dhe raportimin e saj.

¹⁵ Këtu vlen të përmendim raportin studimor, financuar nga USAID “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri”, Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve, Dhjetor 2015, Terre Des Hommes.

¹⁶ Shih “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve, Dhjetor 2015, Terre Des Hommes. fq 10

¹⁷ Shih Sethi D., Bellis M. et al. *European report on preventing child maltreatment*. Geneva, *World Health Organization*, 2013

¹⁸ Konventa Lanzarote ratifikuar me ligjin nr 10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

¹⁹ Konventa e Lanzarotes, 2007. <http://femijet.gov.al/al/konventa-e-lanzarotes>

²⁰ Shih “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. Dhjetor 2015, Terre Des Hommes. Fq. 11.

²¹ Shih Julia Whealin, Ph.D. (2007-05-22). “*Child Sexual Abuse*”. National Center for Post Traumatic Stress Disorder, US Department of Veterans Affairs.

Një rishikim shkencor i studimeve epidemiologjike të realizuara në 21 vende, kryesisht shtete me të ardhura të mesme ose të larta, zbuloi se të paktën 7% e femrave (deri në 36% të tyre) dhe 3% e meshkujve (deri në 29% të tyre) raportojnë të kenë qenë viktime të abuzimit seksual gjatë fëmijërisë së tyre. Sipas këtyre studimeve, 14% deri në 56% e vajzave dhe 25% e djemve të dhunuar seksualisht ishin viktime të abuzimit nga ana e familjarëve (“të gjakut”), ose njerku/njerkës.

Turpi, fshehtësia dhe mohimi të lidhura me dhunën seksuale ndaj fëmijëve në mjedisin familjar formëzojnë një kulturë të heshtjes, ku fëmijët nuk mund të flasin rreth abuzimeve seksuale të pësuar dhe ku prindërit nuk flasin rreth rrezikut që i kanoset fëmijëve të tyre, ose nuk dinë si të veprojnë në rastet kur dyshojnë që fëmijët e tyre mund të jenë viktime të abuzimit seksual në kontekstin apo në mjedisin familjar.²² Shumica e fëmijëve nuk e raportojnë dhunën seksuale të pësuar në mjedisin familjar sepse ndjehen të frikësuar për pasojat ndaj tyre ose familjarëve të tyre, faktit që familjarët do të turpërohen prej tyre, refuzimin e mundshëm nga familjarët, si dhe faktin që mund të mos besohen për raportimin e tyre.²³

Edhe të rriturit jo abuzues mund të mos raportojnë dhunën seksuale të ushtruar ndaj fëmijëve të tyre në mjedisin familjar. Në komunitete dhe familje me norma të ngurta patriarkale që lidhen edhe me “nderin” familjar, djemtë që raportojnë eksperiencën të dhunës seksuale mund të shihen si të dobët dhe jo-burrërorë, ndërsa vajzat mund të fajësohen për akte të tilla dhe shpesh mund të rrihen, madje edhe të vriten^{24, 25}. Si djemtë ashtu edhe vajzat janë njëllëj vulnerabël ndaj dhunës seksuale, por krahasimi i të dhënave të studimeve ndërkombëtare dëshmon se niveli i abuzimit seksual ndaj vajzave është më i lartë në krahasim me djemtë^{26, 27}.

Në të vërtetë, në marrëdhënie të tilla, një i rritur mund të përfitojë nga ndryshimi i moshës dhe marrëdhënia e pushtetit që ka mbi fëmijën, për ta detyruar, bindur ose shtyrë fëmijën të marrë pjesë në aktivitete për të cilat viktime, për shkak të moshës nuk është plotësisht i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e tyre. Duke përdorur të njëjtin mekanizëm psikologjik nënshttrimi, abuzuesit përdorin kërcënimin dhe e bëjnë fëmijën të ndihet fajtor, që në vetvete e pengon fëmijën të mbrohet dhe të kërkojë ndihmë.

Lidhur me abuzimin seksual brenda rrethit të besimit, Kodi Penal parashikon dënime penale në rastet e abuzimit seksual *duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës*²⁸ apo me *persona në gjini ose nën kujdestari*²⁹.

Megjithatë vihet re se legjislacioni penal ende nuk merr parasysh të gjithë dimensionin e marrëdhënies së besimit siç përcaktohet nga Konventa Lanzarote. Një gjë e tillë është theksuar edhe në raportin e parë të Monitorimit të Zbatimit të Konventës së Lanzarotës (Lanzarote Committee), “*..një pjesë e shteteve anëtare kanë*

²²Shih Finkelhor D (1994). The International Epidemiology of Child Sexual Abuse. Child Abuse & Neglect, 18(5): 409–417

²³Shih World report on violence against children. (2006)

²⁴Shih United Nations Secretary-General’s Study on Violence against Children (2005). Regional Desk Review: South Asia. Available at: www.violencestudy.org/r27

²⁵Shih Haj-Yahi MM, Tamish S (2001). The Rates of Child Sexual Abuse and Its Psychological Consequences as Revealed by a Study among Palestinian University Students. Child Abuse & Neglect, 25(10): 1303–1327

²⁶Shih Finkelhor D (1994). The International Epidemiology of Child Sexual Abuse. Child Abuse & Neglect, 18(5): 409–417

²⁷Shih Andrews G et al. (2004). Child Sexual Abuse. In: Ezzati Metal. (2004). Comparative Quantification of Health Risks: Global and Regional Burden of Disease Attributable to Selected Major Risk Factors, Vol. 2. Geneva, World Health Organization, pp.1851–1940.

²⁸ Shih nenin 105 të Kodit Penal

²⁹ Shih nenin 106 të Kodit Penal

*futur në legjislacionin e tyre dënimin penal për abuzimin seksual të fëmijëve në kontekstin e abuzimit me pozitën, statusin ose marrëdhënien, por vetëm një prej tyre ka përdorur terminologjinë e përcaktuar në Konventën Lanzarotës për përcaktimin e krimit si abuzim në një pozitë besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes*³⁰.

Monitorimi i zbatimit të Konventës së Lanzarotes tregon se përcaktimi më i saktë i krimit të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit, duke e përafëruar atë me përcaktimin e Konventës së Lanzarotës është i domosdoshëm. Gjithashtu, ky përcaktim duhet të përfshijë të gjithë personat e mundshëm që mund të abuzojnë me pozitën e tyre të besimit, autoritetit ose të ndikimit (si p.sh rrethi shoqëror i anëtarëve të familjes, një fqinj, etj.)³¹.

Ndryshimet e bëra në Kodin Penal me ligjin nr.144/2013, datë 20.5.2013, ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale. Këto ndryshime e sjellin legjislacionin penal shqiptar në standardin e legjislacionit ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e Këshillit të Evropës (Lanzarote) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”.

Në këtë frymë është miratuar ngritja e Seksionit për të Miturit pranë institucionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet Ligjit nr.155/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i cili pritet të ndikojë pozitivisht në garantimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, pasi tashmë edhe vendi ynë ka një zyrë të veçantë pranë Avokatit të Popullit, që do të mund të presë ankesat për të drejtat e fëmijëve dhe të bëjë monitorim të pavarur mbi shkeljet e këtyre të drejtave.

Edhe pse Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Lanzarotës, si dhe atë të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, legjislacioni shqiptar ka ende sfida sa i përket çështjes së mbrojtjes së fëmijës dhe në veçanti mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi seksual. Pa dyshim, njohuria për fenomenin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve vjen në rritje dhe bashkë me rritjen e të kuptuarit të përbashkët mbi karakteristikat dhe tipologjinë e fenomenit, lind edhe nevoja për rishikime të vazhdueshme të legjislacionit³².

Gjithashtu raporti i sipërpërmendur evidenton nevojën për një analizë më të thelluar të kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, e cila duhet të evidentojë mangësitë dhe nevojën për përmirësime ligjore, si dhe të përbëjë një bazë të vlefshme për hartimin e ligjeve dhe akteve nën ligjore të reja, politikave dhe ndërhyrjeve për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual.

Nga raportet dhe analizat e bëra deri tani³³, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri ka shumë mangësi, sidomos sa i përket nivelit të kapaciteteve të profesionistëve për t’ju përgjigjur nevojave komplekse të fëmijëve të abuzuar dhe

³⁰Shih Lanzarote Committee of the Parties to the Council of Europe Convention on the protection of children against sexual exploitation and sexual abuse (T-ES) 1st implementation report “Protection of children against sexual abuse in the circle of trust the framework”, Adopted by the Lanzarote Committee on 4 December 2015.

³¹ Shih “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. Dhjetor 2015, Terre Des Hommes. Fq. 15.

³² Shih “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. Dhjetor 2015, Terre Des Hommes. Fq.15.

³³ Shih Filippou, F. Child Protection System Under Construction. Terre des hommes Mission in Albania, 2015.

familjeve të tyre, mungesës së buxhetit dhe mungesës së shërbimeve mbështetëse rehabilituese dhe ri-integruese për fëmijën dhe familjen. Një situatë e tillë nuk është e justifikueshme, qoftë edhe formalisht për shkak të angazhimeve të marra përsipër në kuadër të parashikimeve të bëra nga neni 14/1 i Konventës së Lanzarotës, i cili përcakton se: *“Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të ndihmuar viktimat, në kuadrin afatshkurtër dhe afatgjatë, për rimëkëmbjen e tyre fizike dhe psiko-sociale. Masat e marra në përputhje me këtë paragraf duhet të marrin parasysh pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijëve”*³⁴.

Nga ana tjetër, sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri i mungojnë shërbimet e emergjencës 24 orë (përveç një qendre në Tiranë), si edhe shërbimet e specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe autorët e krimit, të cilat do mundësonin ofrimin e ndërhyrjes së menjëhershme dhe trajtimit afatgjatë të fëmijës dhe familjes³⁵.

1.1.2. Liria seksuale, pjesë e të drejtës për jetë private.

Jeta seksuale e një personi është pjesë e jetës së tij private, e cila përbën një aspekt të rëndësishëm të të drejtave themelore të njeriut. Jeta private garanton një sferë brenda së cilës një person mund të krijojë marrëdhënie të llojeve të ndryshme duke përfshirë edhe ato seksuale dhe si rrjedhojë jep zgjedhjen për të afirmuar e nënkuptuar se identiteti i jetës seksuale të një personi i përket mbrojtjes së dhënë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut³⁶.

GJEDNJ ka krijuar një jurisprudencë të konsoliduar në lidhje me përfshirjen e jetës seksuale në objektin e nenit 8 të Konventës³⁷. Në jurisprudencën e saj, Gjykata³⁸, u shpreh se jeta seksuale e një personi përfshihet në konceptin e jetës private. Ajo e gjeti shkelje të nenit 8-të të Konventës, në rastin kur ligji i brendshëm i shtetit parashikonte ndalimin e kryerjes së marrëdhënieve homoseksuale me të rinj nën 21 vjeç. Mbrojtja e jetës seksuale përbën një detyrim të rëndësishëm pozitiv për shtetet. Ato duhet të parashikojnë dhe të marrin masa për të ndaluar çdo ndërhyrje të pavullnetshme në jetën seksuale të personit.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore në nivel evropian. Edhe pse ajo bën disa referenca të drejtpërdrejta tek fëmijët, disa nga nenet e saj janë përdorur në mënyrë efektive nga Gjykata për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijës në Evropë. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e vë theksin si në kërkesën për të mbrojtur interesat e fëmijës ashtu dhe në rolin e familjeve për kujdesin e fëmijëve.

³⁴Shih nenin 14 të Konventës Lanzarote ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

³⁵ Shih “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve, Dhjetor 2015, Terre Des Hommes. Fq. 16.

³⁶Shih nenin 8 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

³⁷ GJEDNJ duke pasur parasysh të dhënat shkencore, praktikën ndërkombëtare, nevojën për drejtësi koherente, por edhe disavantazhet për personat në fjalë, vendosi se neni 8-të mbulonte dhe të drejtën e individëve për ndryshimin e identitetit seksual dhe detyrimin e shteteve që ta njohin këtë ndryshim. Shtetet duhet të respektojnë të drejtën për vetëpërcaktim seksual të transeksualëve. Çështjet në lidhje me refuzimin për të lejuar një transeksual që të përftojë ndryshimin e emrit me dokumenta zyrtare për të reflektuar përkatësitë e reja gjinore janë trajtuar si çështje që kanë lidhje me respektimin e jetës private sipas Nenit 8, paragrafi 1.

³⁸Shih vendimin mbi çështjen Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 22.10.1981, A. 7525/76.

KEDNJ-ja gjithashtu detyron shtetet anëtare të parandalojnë dhunën ndaj fëmijëve si dhe u kërkon atyre që në radhë të parë të marrin masa parandaluese për mbrojtjen e integritetit fizik dhe seksual të fëmijës; së dyti, autoritetet kompetente në nivel kombëtar pritet që në mënyrë efektive të hetojnë çfarëdo pretendimi të keqtrajtimit në sferën e familjes ose brenda institucioneve të kujdestarisë dhe së fundi të ndjekë penalisht dhe të ndëshkojë abuzuesit. Mund të identifikohen tri llojet e detyrimeve të shtetit në rastet e kujdesit për fëmijët:

- a. detyrimet për të mos ndërhyrë në ushtrimin e të drejtave të mbrojtura nga Konventa, përkatësisht jetës familjare apo për të mos keqtrajtuar një fëmijë.
- b. detyrimet pozitive për të miratuar legjislacionin që parandalon individët e tjerë për të ndërhyrë në të drejtat e mbrojtur nga Konventa;
- c. detyrimet procedurale lidhur me procesin e vendimmarrjes dhe një proces të rregullt ligjor.

Në çdo rast, parimi që duhet të mbizotërojë është ai i interesit më të lartë të fëmijës. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut ofron një larmishmëri rastesh në lidhje me respektimin e të drejtave në çështje që implikojnë të mitur. Ajo që vlen të theksohet është qasja që gërsheton nevojën për të garantuar gjithmonë të drejtat e fëmijës në lidhje me informacionin, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në procedurat administrative dhe gjyqësore, duke i njohur atyre këto të drejta në të gjitha fazat e procedimit, por duke pasur në vëmendje se duhet të respektohet dhe të mbrohet jeta private, interesat, nevojat e veçanta, dinjiteti individual i fëmijës.

1.1.3. Pedofilia në profilin psikologjik

Shkenca juridiko-penale gjithnjë e më shumë është fokusuar tek politika penale specifike për evidentim, parandalim, rehabilitim dhe ndëshkim të viktimizimit seksual të fëmijëve. Në Shqipëri, krimet seksuale e më tej krimet me sfond seksual, po bëhen më të shpeshta e më të rënda me forma tragjike të viktimizimit. Ky lloj krimi karakterizohet nga elementë social dhe psikologjik.

Abuzuesit seksual gjithnjë e më shpesh vijnë me profil kriminal si përsëritës, me karrierë të gjatë viktimizimesh. Pedofilia është një status dhe jo një akt, kështu që pedofili mund të jetojë me pedofili dhe të mos veprojë si i tillë. Në bazë të hulumtimeve, rreth gjysma e të gjithë dhunuesve seksual të fëmijëve nuk janë të tërhequr seksualisht nga viktimat e tyre.³⁹ Aktivitetet seksuale përfshijnë të gjitha format e kontaktit me fëmijët, orale, gjenitale apo anale, por gjithashtu edhe abuzimet pa kontaktin e prekjes si psh. eksibicionizmi, vojerizmi apo përdorimi i fëmijës në prodhimin e pornografisë.⁴⁰ Abuzimi seksual i fëmijëve mund të jetë në shumë forma: inçest, pornografi, prostitucion, trafikim, korrupsion dhe shfaqje të sulmeve seksuale.

Personat që vuajnë prej saj shfaqin ndër të tjera edhe dyzim dhe çrregullim të identitetit, çka duket është edhe arsyeja pse ata mund të jetojnë “normalisht” për periudha të ndryshme kohe apo të arrijnë të ruajnë sekretin. Organizata Botërore e Mjekësisë (OMS/WHO) e ka klasifikuar pedofilinë si sëmundje, e cila daton në vitin 1952.⁴¹

Pedofilia ndryshe nga shumë diagnoza të tjera, nuk e shkarkon të akuzuarin nga përgjegjësitë penale. Organizata Botërore e Shëndetit dhe Shoqata e Mjekëve

³⁹ Shih Margo Kaplan by New York Times; http://www.nytimes.com/2014/10/06/opinion/pedophilia-a-disorder-not-a-crime.html?_r=0; October 2014

⁴⁰Shih Kempe CH. Sexual abuse, another hidden pediatric problem: the 1977 C. Anderson Aldrich lecture. *Pediatrics*. 1978;62:382–389

⁴¹“Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders”

Psikiatër Amerikan, nëpërmjet metodës DSM kanë vlerësuar se: “shqetësime të orientimit të libidit nuk sjellin përjashtim të subjektit nga përgjegjësia penale”.

Në Shqipëri duhet që këto raste të diagnostikohen, jo për t'i shmangur këta persona nga përgjegjësia penale, por për të përshtatur si duhet Kodin Penal dhe dënimet që duhet t'u jepen atyre, përfshi këtu edhe dënime plotësuese, ku ligji të shohë jo vetëm dënimin e pedofililit, por edhe mundësitë që ai të trajtohet, gjë që edhe pse nuk do ta shëronte atë, mund të kufizonte aftësinë e tij për të vepruar sërish.

Pedofilia është një çrregullim mendor, në një drejtim seksual. Pedofilët mund të zgjedhin të jenë aktivë apo inaktivë. Ata nuk janë mostra ashtu sikurse shpesh herë i quajmë, pasi ka shumë pedofilë që kanë vendosur ta refuzojnë drejtimin e tyre seksual ashtu sikurse shumë pedofilë rrëfejnë eksperiencat e tyre të refuzimit për të shërbyer si udhërrëfyes apo ndihmë për shumë pedofilë të tjerë që përballen me vështirësitë e tyre, pa patur mundësinë e trajtimit dhe kurimit.⁴²

Vendi ynë duhet që të krijojë mekanizmat e duhura për të trajtuar personat që vuajnë nga pedofilia, ashtu sikurse i shërben kësaj kauze projekti “Dunkelfeld” në Gjermani, i cili i shërben kompanive mediatike për të publikuar shërbime kurative personave që vetëquhen pedofilë, por ndjejnë nevojën për ndihmë.

Në Mbretërinë e Bashkuar, NSPCC (National Society for the Prevention of Cruelty to Children) u ka vënë në dispozicion një shërbim telefonik në të cilin personat abuzues mund të telefonojnë në momentin kur kanë frikë që mund të kryejnë sërish një krim seksual kundrejt një fëmije, për të marrë këshilla apo asistencë të menjëhershme. Shërbimi parashikon informimin e menjëhershëm të policisë dhe shërbimeve sociale për telefonatën në mënyrë që t'i garantojnë mbrojtje fëmijës përpara se të jetë i përfshirë. Në Danimarkë (brydcirklen.dk), është krijuar posaçërisht një website që i referohet të rriturve që pranojnë që kanë një interes seksual ndaj fëmijëve duke përshkruar sjelljet e ndryshme dhe duke i ftuar të gjejnë ndihmë psikologjike, duke telefonuar një linjë telefonike të dedikuar përpara se të kryejnë abuzime.

Në SHBA, organizata B4UACT24 (Before You Act) promovon shërbimet e ndihmës dhe asistencës për subjektet (të rritur dhe adoleshentë), që pranojnë të qënurit seksualisht të tërhequr nga fëmijët. Shqipëria është një vend i vogël, i cili aktualisht nuk ka krijuar mekanizmat për të parandaluar pedofilinë. Shumë individë të dhunuar për shkak të këtij mentaliteti hermetik nuk kanë guxuar të denoncojnë dhunimin e tyre nga frika e paragjyqimit apo nga fakti që shteti ynë nuk është në gjendje t'iu ofrojë atyre mbrojtjen e duhur. Në Shqipëri nuk ekzistojnë qendra rehabilitimi të specializuara për personat e dhunuar apo për pedofilët.

Kriteri psikiatrik DSM, parashikon disa lloje pedofilish, duke përfshirë këtu, tipin ekskluziv (i tërhequr nga fëmijët); tipin e diferencuar (person i tërhequr edhe nga njerëzit e rritur); apo llojin e padiferencuar (të tërhequr vetëm për njërin nga të dy sekset).

Tërheqja për fëmijët meshkuj rezulton më rezistente nga ngacmuesit e fëmijëve. Vlera e recitivitetit në subjektet e tërhequra nga fëmijët meshkuj është dyfish në raport me tërheqjen ndaj fëmijëve femra. Lloji i pedofilisë me tip të padiferencuar rezulton të jetë më i rëndë në raport me tipin e diferencuar pasi është një lloj pedofilie e limituar drejt inçestit.⁴³ Fëmijët e abuzuar seksualisht vuajnë më shumë sesa nga një dhunim i patolerueshëm i integritetit të tyre fizik. Shëndeti i tyre mendor preket dhe lidhjet e tyre të besimit me të rriturit shkatërrohen.⁴⁴ Nuk

⁴²<http://www.virped.org/index.php/who-we-are>

⁴³<https://it.wikipedia.org/wiki/Pedofilia>

⁴⁴Shih Protecting children from sexual violence. www.coe.int/children2010; fq.7.

konsiderohen pedofilë personat që tërhiqen seksualisht nga fëmijë, të cilët janë rreth 12 vjeç apo më të rritur, por që kanë arritur zhvillimin pubertal. Tërheqja nga adoleshentët (pubertet) përkufizohet me termat efebofilia dhe ninfofilia ndryshe edhe “Sindromi i Lolitës”.

Pedofili në incest është edhe një tip pedofili që është i kufizuar tek incesti (interes i treguar vetëm ndaj fëmijëve, bijve të tij ose motrave apo vëllezërve të subjektit pedofil). Ky profil pedofili përkon me veprime që shënojnë më shumë se një vepër penale.

Pedofili latent, është i fshehtë, i heshtur, i cili kategorizohet nga një pasion për fëmijët, që qëndron në nivel fantazie erotike që mund të konkretizohet nga veprim ose mosveprim.

Pedofili attiva, konsiderohet nga një hap më tej i pedofilisë latente. Në këtë tipologji kemi të bëjmë me raste të dhunimeve psikike e fizike ose dëmtim të fëmijës.

Pedofili killer, vrasës që manifeston një aspekt sadist në të cilin kënaqësia maksimale arrihet me vrasjen e viktimës.

Një nga tipat e pedofilëve janë edhe pedofilët online, të cilët diferencohen nga pedofilat e tjerë duke përfshirë në këtë identikit individë të seksit mashkull, racë e bardhë, që i takojnë niveleve të ndryshme socialo-ekonomike. Moshë e tyre përfshihet nga 18 deri në 25 vjeç (pra, më të rinj sesa pedofilët “tradicionalë”), të cilët zakonisht nuk kanë kryer krime seksuale të mëparshme. Ata që tentojnë të joshin në internet kërkojnë të shmangin marrëdhënie të drejtpërdrejta, duke shpenzuar shumicën e kohës së tyre në internet, në kërkim të kontakteve sociale apo seksuale duke synuar një kënaqësi seksuale të menjëhershme, janë të shoqërueshëm dhe në gjendje për të hyrë emocionalisht në sintoni me viktimën dhe janë manjakërisht të angazhuar në aktivitete seksuale.⁴⁵ Hulumtimet e fundit kanë ndihmuar për të përcaktuar dy profile të veçanta, ata që thjesht mbajnë dhe shkëmbejnë materiale pornografike të fëmijëve dhe ata të cilët, me anë të këtyre materialeve përpiqen të përfshijnë direkt fëmijët dhe adoleshentët në akte seksuale.

Brenda profilit të dytë, përfshihen dy nëngrupe, pedofilët me fantazi të nxitur, të motivuar për të angazhuar adoleshentët në seks virtual, pa asnjë kërkesë për takim të drejtpërdrejtë dhe me kontakt të nxitur, të motivuar për t'u angazhuar në marrëdhënie seksuale me adoleshentë jashtë rrjetit. Sipas një studimi nga Universiteti i Lancashire (2003), ka pesë faza joshjeje në internet, formimi i miqësisë, formimi i marrëdhënieve të besimit, vlerësimi i rrezikut për t'u zbuluar, faza e raportit ekskluziv, faza seksuale e vërtetë reale.

Hulumtimet shkencore tregojnë se rreth 20% e fëmijëve në Evropë janë viktima të ndonjë forme të dhunës seksuale. Është vlerësuar se në 70% deri në 85% të rasteve, autori i krimit është i njohur për viktimën. Sipas një raporti të FBI-së në korrik të 2000, është vlerësuar 4% përfaqësimi nga femra të rritura, ndërsa pjesa më e madhe e pedofilëve i përkasin seksit mashkull. Fëmijët apo adoleshentët që shfaqin sjellje seksuale të papërshtatshme, mund të jenë duke reaguar ndaj viktimizimit të tyre. Diagnoza e abuzimit seksual dhe mbrojtja e fëmijëve nga dëmtimet e mëtejshme varet pjesërisht nga aftësia e pediatrit për ta konsideruar abuzimin si mundësi. Abuzimi seksual paraqitet në shumë mënyra dhe fëmijët, të cilët janë të abuzuar seksualisht përgjithësisht detyrohen në fshehtësi. Një nivel i lartë mosbesimi mund të jetë i nevojshëm për të njohur problemin.⁴⁶

⁴⁵Shih <https://it.wikipedia.org/wiki/Pedofilia>

⁴⁶Shih Krugman RD. Recognition of sexual abuse in children. *Pediatr Rev.* 1986;8:25–30

Duhet të jemi të vetëdijshëm se abuzimi seksual shpesh ndodh në kontekstin e problemeve të tjera familjare, duke përfshirë abuzimin fizik, keqtrajtimin emocional, abuzimin me substanca dhe dhuna në familje. Nëse këto probleme janë dyshuese, referimi për një vlerësim më të kuptueshëm është i domosdoshëm. Në raste të vështira pediatrik mund të bëjnë konsultime me një specialist për abuzimet e fëmijëve të rajonit apo qendra për vlerësime të dobishme. Pas ekzaminimit mjeku mund të ofrojë shpjegimin e përshtatshëm dhe heqjen e dyshimeve tek fëmija dhe familja.

Një numër në rritje e rasteve të pretenduara si abuzime seksuale, përfshijnë prindërit që janë në proces ndarjeje apo divorci dhe të cilët pretendojnë që fëmijët e tyre kanë qenë abuzuar seksualisht nga prindi tjetër gjatë vizitës së kujdestarisë. Megjithëse këto raste janë përgjithësisht më të vështira dhe i humbin më shumë kohë pediaterve, sistemeve me shërbime mbrojtjeje për fëmijët dhe agjencive të zbatimit të ligjit, ata nuk mund të anashkalojnë sepse një mosmarrëveshje kujdestarie ekziston. Akuzat e abuzimit që ndodhin në kontekstin e procedurave të shkurorëzimit ose duhet të raportohen në agjencitë e shërbimeve mbrojtëse të fëmijëve ose duhen ndjekur nga afër. Në të dyja procedurat si penale ashtu edhe civile, mjekët duhet të dëshmojnë gjetjet e tyre “në një shkallë të arsyeshme të sigurisë mjekësore”⁴⁷.

Rreth 10-30% e fëmijëve janë viktimat të ngacmimeve seksuale deri në 18 vjeç. Tërheqja e pedofililit mund të drejtohet si ndaj fëmijëve meshkuj, si ndaj fëmijëve femra, por duket që këto të fundit janë viktimat më frekvente (88%). Pasojat e abuzimit seksual mund t’i ndjekin fëmijët edhe përgjatë rritjes dhe personi shpesh e përshkruan jetën duke jetuar në një trishtim të fshehur dhe dhimbje.

Pedofilët kanë tendencë të modifikojnë aktivitetet sociale dhe në punë duke zgjedhur një stil jete dhe profesione në kontakt me minorenët, në mënyrë të veçantë zënë pozicione që iu lejojnë të arrijnë përfitime nga besimi i fëmijëve dhe prindërve. Në veçanti, një pedofil adapton jetën profesionale në bazë të nevojave të veta seksuale.

Pjesa më e madhe e burrave që ngacmojnë seksualisht djemtë (70%) kanë prevalencë heteroseksuale. Sipas disa studimeve, fëmijët kanë probleme psikologjike madhore kur abuzimet kryhen nga figura prindërore (miq të familjes, priftërinj apo figura të tjera religjioze, trajner) apo kur këto akte kryhen me dhunë apo kontakt gjenital.⁴⁸

Rreth 60% e abuzimeve ndaj minorenëve vjen në familje. Në Francë dhe Angli minorenët viktimat të abuzimeve seksuale janë të panumërt, edhe pse një pjesë e mirë e abuzimeve seksuale nuk deklarohen. Sipas prof. Mastronardi rreth 0.07% e rasteve të pedofilisë në Itali i takojnë klerikëve, kjo përqindje e priftërinjve italianë të dënuar për pedofili deri në 50 vjet, ndërsa në shoqërinë civile ekzistojnë 21.000 raste pedofilie çdo viti, pra 1 në 400 minorenë.

Pedofilia është një fenomen që ka lënë gjurmë edhe në religjion. Kisha Katolike ka një histori 2,000 vjeçare të abuzimit seksual.⁴⁹ Deklarata, lexuar nga Kryepeshkopi Silvano Tomasi, vëzhguesi i përhershëm i Vatikanit në OKB, mbrojti studimet e tij duke pretenduar se “hulumtimi në dispozicion” tregoi se vetëm 1,5% - 5% e klerit katolik ishin përfshirë në abuzimin seksual ndaj fëmijëve. Ai gjithashtu citoi statistika nga gazeta Christian Scientist Monitor për të treguar që shumica e kishave amerikane, u goditën nga akuzat për abuzim seksual ndaj fëmijëve ndërsa

⁴⁷ Shih McCann J, Voris J. Perianal injuries resulting from sexual abuse: a longitudinal study. *Pediatrics*. 1993;91:390–397

⁴⁸ Shih *American Journal of Psychology e il Journal of Psychiatric Practice*

⁴⁹ Sex, Priests and Secret Codes; Thomas Doyle, Richard Sipes and Patrick Wall; 2006

abuzimi seksual ndaj protestantëve dhe komuniteteve hebre ishte i zakonshëm.⁵⁰ Nga të gjithë priftërinjtë të përfshirë në abuzime 80 apo 90 përqind i përkasin këtij minoriteti, i cili është seksualisht i angazhuar me meshkujt adoleshentë rreth 11 deri në 17 vjeç. Selia e Shenjtë nisur nga kundër-sulmet ndaj një përfaqësuesi ndërkombëtar të Humanizmit dhe Bashkimit Etikë, Keith Porteous Wood, e akuzoi atë për mbulimin e keqpërdorimit të fëmijëve, duke qenë në kundërshtim me disa nene në bazë të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.⁵¹

1.2 Regjimi juridik i mbrojtjes së fëmijëve- Vështrim i përgjithshëm

1.2.1 Kuadri juridik ndërkombëtar

Shqipëria ka patur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përsa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shprehje e qartë e angazhimit të Shqipërisë, është ratifikimi apo aderimi në pothuaj të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Gjithashtu, Shqipëria ka aderuar në dy protokollat opsionale të Konventës për të Drejtat e Fëmijës: Protokollin Opsional “Mbi shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijë dhe Pornografinë”⁵²; Protokollin Opsional “Mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura”⁵³.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila pas ratifikimit në bazë të Kushtetutës së RSH-së, është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm, përbën bazën për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave të parashikuara në të. Gjithashtu, kjo është bërë në kuadrin e një reforme të përgjithshme të politikave sociale për të krijuar një mjedis mbrojtës për fëmijët, që nënkupton mjedisin familjar, institucionet, sistemet dhe shoqërinë që rrethojnë fëmijën.

Kuadri ligjor për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është përmirësuar vazhdimisht, si dhe janë hartuar politika sociale duke u përafruar me standardet ndërkombëtare. Objektivi i rëndësishëm mbetet marrja e masave të nevojshme për zbatimin në praktikë të akteve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare, si dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian.

Republika e Shqipërisë është shtet palë me të drejta dhe detyrime në një sërë aktesh ndërkombëtare:

- **Konventa e Hagës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”**⁵⁴. Kjo Konventë ka si qëllim që të merren masat mbrojtëse për të siguruar që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore, të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare; të krijohet një sistem bashkëpunimi midis shteteve kontraktuese, për të siguruar që këto masa të respektohen dhe në këtë mënyrë të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve; si dhe të sigurohet

⁵⁰<http://www.theguardian.com/world/2009/sep/28/sex-abuse-religion-vatican>

⁵¹<http://www.theguardian.com/world/2009/sep/28/sex-abuse-religion-vatican>

⁵²Protokollin Opsional “Mbi shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijë dhe Pornografinë”, miratuar me ligjin nr.9834, datë 22.11.2007

⁵³Protokollin Opsional “Mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura, miratuar me ligjin nr.9833, datë 21.12.2007

⁵⁴Konventa e Hagës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin për Birësimet jashtë vendit” ratifikuar me ligjin nr. 8624, datë 15/06/2000

njohja në shtetet kontraktuese e birësimeve të bëra në përputhje me këtë Konventë.

- **Konventa nr.182 “Për Format më të këqija të punës së fëmijëve” dhe Rekomandimi nr.190 “Format më të këqija të punës së fëmijëve”**⁵⁵. Konventa u kërkon shteteve ratifikuese të marrin masa të efektshme dhe të menjëhershme për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve, si një çështje e ngutshme. Ajo përcakton format më të këqija të punës së fëmijëve, si:
 - a) të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, të tilla si, shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi i skllavërues dhe bujkrobëria, puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimin pa dëshirë ose i detyruar për përdorim në konflikte të armatosura,
 - b) përdorimin, gjetjen ose dhënien e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;
 - c) përdorimin, gjetjen ose dhënien e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike, sikundër janë përkufizuar në traktatet përkatëse ndërkombëtare;
 - d) punën, e cila nga natyra e saj ose nga rrethanat në të cilat kryhet, mund të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.
- **Karta Sociale Europiane**⁵⁶ është një nga traktatet bazë të Këshillit të Evropës. Të drejtat themelore të përcaktuara në të janë: strehimi, shëndetësia, arsimi, punësimi, mbrojtja sociale dhe ligjore, lëvizja e lirë e personave dhe jo-diskriminimi. Karta parashikon se fëmijët, të rinjtë dhe gratë e punësuara në periudhën e shtatzënisë, kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Ajo e vë theksin në mënyrë të veçantë tek parimi i barazisë, duke sanksionuar të drejtën e të gjithë punëtorëve për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë në çështjet e punësimit dhe punës pa dallim mbi bazë seksi.
- **Konventa Europiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”**, Strasburg⁵⁷. Lidhur me këtë konventë duhet theksuar se në kuptim të paragrafit të parë të nenit 18 të Konventës, RSH-së deklaroi se rezervon të drejtën të përcaktojë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, se termi “person i varur” nënkupton “fëmijët e mitur, bashkëshorten dhe prindërit e paaftë për punë, që kanë qenë plotësisht ose pjesërisht në ngarkim të të vdekurit, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit”.
- **Konventa Europiane “Mbi marrëdhëniet me fëmijët”**⁵⁸, angazhon shtetet palë të saj në marrjen e masave për përcaktimin e parimeve të përgjithshme për t'u zbatuar me lidhje në vendimet mbi marrëdhëniet me fëmijët, rregullimin e garancive të përshtatshme për të siguruar ushtrimin e rregullt të marrëdhënieve dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të afatit të marrëdhënies, si dhe vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore, organeve gjyqësore dhe organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet

⁵⁵Konventa nr.182 “Për Format më të këqija të punës së fëmijëve” dhe Rekomandimi nr.190, “Format më të këqija të punës së fëmijëve”, ratifikuar me ligjin nr. 8774, datë 23.4.2001

⁵⁶“Karta Sociale Europiane”, ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002

⁵⁷Konventa Europiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, ratifikuar me ligjin nr.9265, datë 29.7.2004

⁵⁸ Konventa Europiane “Mbi marrëdhëniet me fëmijët”, ratifikuar me ligjin nr. 9359, datë 24.3.2005

ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.

- **Konventa Europiane “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve” e nënshkruar në Hagë**⁵⁹. Kjo konventë përbën një instrument bashkëpunimi mes shteteve pjesëmarrëse, për të marrë masa për të miturit deri në 16 vjeç. Ajo synon kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen, apo mbahen “pa të drejtë” drejt vendit të tyre. Sipas përkufizimit, “mbajtja e padrejtë” i referohet shkeljes së të drejtave nga të caktuarit si “kujdestar”, qoftë individ apo institucion shtetëror. Në shumicën e rasteve, kjo konventë përdoret për të zgjidhur mosmarrëveshjet mbi kujdestarinë e fëmijëve të çiftit të divorcuara, kur nëna dhe babai kanë shtetësi të ndryshme.
- **Konventa e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”**⁶⁰. Kjo Konventë zbatohet për fëmijët nga momenti i lindjes deri në moshën 18 vjeç. Nga këndvështrimi i të drejtave të fëmijëve, Konventa përfaqëson një instrument të rëndësishëm në mbrojtje të fëmijëve dhe pasurisë së tyre, duke përcaktuar sipas kriterëve autoritetin kompetent për të marrë masa mbrojtëse për fëmijët ose pasurinë e tyre, ligjin e zbatueshëm, si dhe njohjen dhe zbatimin e këtyre masave në shtetet e tjera palë të Konventës. Përfaqëson një akt të rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, e fokusuar në rregullimin e situatave ndërkombëtare lidhur me përgjegjësinë prindërore. Sipas Konventës, termi “përgjegjësi prindërore” nënkupton autoritetin prindëror ose çdo marrëdhënie të ngjashme të autoritetit që përcakton të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e prindërve, kujdestarëve ose përfaqësuesve të tjerë ligjorë në lidhje me fëmijën ose pasurinë e tij.
- **Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimave të trafikimit”**⁶¹. Kjo marrëveshje ka si qëllim nxitjen e bashkëpunimit për të luftuar trafikimin dhe çdo formë të shfrytëzimit të fëmijëve. Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, shprehet solidariteti dhe përkushtimin për të luftuar trafikimin e fëmijëve dhe çdo formë të shfrytëzimit të fëmijëve; duke marrë në konsideratë, që fëmijët e pashoqëruar, në parim janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj trafikimit dhe kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë; duke kërkuar, në bazë të reciprocitetit dhe të një fryme bashkëpunimi të ndërsjellë, të merren me fenomenin e trafikimit të fëmijëve; duke konsideruar prioritet mbrojtjen e viktimave fëmijë të trafikimit, krijimin e kuadrit të duhur ligjor për zbatimin e procedurave dhe strukturave të posaçme për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve të trafikuar.

⁵⁹Konventa Europiane “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, aderuar me ligjin nr.9446, datë 24.11.2005.

⁶⁰Konventa e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, aderuar me ligjin nr.9443, datë 16.11.2005.

⁶¹“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimave të trafikimit”, ratifikuar me ligjin nr. 9544, datë 29.05.2006.

- **Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijët”⁶²**, synon të angazhojë shtetet palë që të garantojnë të paktën mbulimin plotësisht nga ligji i tij penal, të veprimeve dhe aktiviteteve, që kanë të bëjnë me shitjen, përdorimin për prostitucion dhe pornografi të fëmijëve, pavarësisht se këto vepra penale janë kryer brenda apo jashtë vendit nga një individ apo grup individësh të organizuar. Gjithashtu, në dispozita parashikohet se këto vepra penale konsiderohen se përfshihen në veprat penale të ekstradueshme në të gjitha marrëveshjet e ekstradimit që ekzistojnë ndërmjet Shteteve Palë, dhe përfshihen si vepra penale të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që lidhet më vonë ndërmjet tyre.
- **Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi implikimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura”⁶³**. Nga këndvështrimi i të drejtave të fëmijëve, instrumenti ka efekt të drejtpërdrejtë në aspektet e mbrojtjes së fëmijëve nga rekrutimi nëpërmjet forcës ose detyrimit të tyre për t’u përdorur në konflikte të armatosura, nëpërmjet detyrimit të shteteve palë të marrin masa për të siguruar që anëtarët e forcave të armatosura të kenë mbushur moshën 18 vjeç. Protokolli me qëllim zbatimin efektiv të tij, detyron shtetet palë që në momentin e ratifikimit të depozitojnë një deklaratë detyruese të anëtarësimit në këtë protokoll, e cila përcakton moshën minimale në të cilën ai lejon rekrutimin vullnetar në forcat kombëtare të armatosura.
- **Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës “Për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”⁶⁴**. Në bazë të kësaj marrëveshje, RSH-së do të ripranojë, fëmijë të mitur e të pamartuar, pavarësisht vendlindjes ose kombësisë, nëse nuk kanë leje qëndrimi të pavarur në Islandë.
- **Konventa e Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”⁶⁵**. Kjo Konventë synon garantimin e të drejtave të fëmijëve duke pasur parasysh që çdo fëmijë ka të drejtë për masa të tilla mbrojtëse siç i kërkon statusi i tij /e saj, si i/e mitur, nga ana e familjes së tij ose të saj, nga shoqëria dhe shteti; duke konstatuar se shfrytëzimi seksual i fëmijëve, në veçanti pornografia dhe prostitucioni i fëmijëve në të gjitha format e abuzimit seksual me fëmijët, duke përfshirë dhe aktet, që kryhen jashtë shtetit, janë shkatërruese për shëndetin e fëmijës dhe zhvillimin e tij psikosocial; duke konstatuar se shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual i fëmijëve janë rritur në përmasa shqetësuese, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në veçanti në lidhje me përdorimin në rritje si nga fëmijët, dhe nga personat të cilët kanë kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) dhe që parandalimi kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve kërkon bashkëpunim ndërkombëtar.

⁶²Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijët”, aderuar me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007.

⁶³Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi implikimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura”, aderuar me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007.

⁶⁴Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”, ratifikuar me ligjin nr. 10 015, datë 6.11.2008.

⁶⁵Konventa e Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”, ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 9.02.2009.

- **Konventa Europiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore”⁶⁶.** Ky instrument, ndonëse nuk lidhet drejtpërdrejtë me të drejtat e grave dhe fëmijëve, garanton për këto dy kategori subjektsh, si për të gjithë individët, njohjen dhe respektimin e të drejtave themelore me karakter ekonomik, politik, shoqëror dhe kulturor.
- **Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”⁶⁷.** Qëllimi i kësaj konvente është që të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese, që në favor të mbrojtjes së interesave më të mira të fëmijëve, të marrin masa për të promovuar të drejtat e tyre, t’u japin atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor.
- **Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”⁶⁸.** Nga këndvështrimi i të drejtave të grave dhe fëmijëve, instrumenti ndikon drejtpërdrejtë në mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga trafikimi, duke përcaktuar masa për parandalimin, zbulimin, hetimin, ndëshkimin e rasteve të trafikimit, si dhe mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktime të trafikimit.
- **Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qënieve Njerëzore⁶⁹.** Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi midis aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore; përcakton përgjegjësitë që palët e përfshira kanë në identifikimin, referimin, akomodimin, asistencën dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit. Thelbi i marrëveshjes është ngritja e një rrjeti kombëtar funksionues midis disa agjensive shtetërore dhe jo shtetërore; konkretisht policia, shërbimi social, shërbimi diplomatik dhe konsullor, si dhe qendrat pritëse dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit, për të mundësuar identifikimin, sigurimin, referimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit në vend.
- **Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”⁷⁰.** Konventa ka efekt të drejtpërdrejtë në aspektet e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe fëmijëve për parandalimin e dhunës ndaj tyre, nëpërmjet marrjes së masave konkrete në favor të tyre. Qëllimi i kësaj konvente është që të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese në favor të mbrojtjes së grave dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Palët i shmangen përfshirjes në akte dhune kundër grave dhe fëmijëve dhe garantojnë

⁶⁶Konventa Europiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore”, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

⁶⁷Ligji nr.10 425, datë 2.6.2011 për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”.

⁶⁸Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006

⁶⁹Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qënieve Njerëzore⁶⁹ e nënshkruar korrik 2005.

⁷⁰Ligji nr.104/2012 për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

që autoritetet shtetërore, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe aktorë të tjerë që veprojnë në emër të shtetit, të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.

- **Konventa e Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”⁷¹**. Kjo Konventë përcakton disa rregulla dhe standarde në lidhje me statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesë, me qëllim për të përmirësuar statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesë, duke zvogëluar dallimet ndërmjet statusit të tyre ligjor dhe atij të fëmijëve të lindur në martesë, si dhe harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në këtë fushë. Sipas Konventës, amësia e çdo fëmije të lindur jashtë martesë do të bazohet vetëm në faktin e lindjes së fëmijës, ndërsa atësia e fëmijëve të lindur jashtë martesë mund të përcaktohet nëpërmjet njohjes vullnetare ose me vendim gjyqësor. Babai dhe nëna e një fëmije të lindur jashtë martesë kanë të njëjtin detyrim për t’u kujdesur për fëmijën, sikur të ishte lindur në martesë. Edhe kur detyrimi ligjor për t’u kujdesur për një fëmijë të lindur në martesë bie mbi anëtarë të caktuar të familjes së babait ose nënës, ky detyrim do të zbatohet në interes të fëmijës së lindur jashtë martesë.
- **Konventa e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”⁷²**. Konventa garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të grave, pjestare të familjes, duke përcaktuar rregullat dhe kriteret për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve që përmbajnë detyrim ushqimor apo forma të tjera të mbështetjes financiare, në një shtet tjetër. Kjo Konventë përcakton rregullat, kushtet dhe procedurat për marrjen e vendimeve, si dhe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të marra nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar, në lidhje me detyrimin për ushqim dhe forma të tjera të mbështetjes financiare ndaj fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, në një shtet tjetër anëtar të Konventës. Objekti i kësaj Konvente është garantimi i rivendosjes efektive ndërkombëtare të detyrimeve ushqimore dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e familjes, veçanërisht nëpërmjet: 1) krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të shteteve kontraktuese; 2) vënies në dispozicion të kërkesave për marrjen e vendimeve për detyrime ushqimore; 3) parashikimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve për detyrime ushqimore; dhe 4) kërkimit të masave efektive për zbatimin e shpejtë të vendimeve për detyrimin ushqimor.
- **Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës dhe procedurat e komunikimit”⁷³**. Ky protokoll do të forcojë dhe do të plotësojë mekanizmat kombëtare dhe rajonalë që lejojnë fëmijët të paraqesin ankesa për shkeljet e të drejtave të tyre. Shtetet palë duhet të zhvillojnë mekanizma të përshtatshëm kombëtarë të të drejtave të njeriut dhe institucione të tjera të specializuara, të ngarkuara për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duke forcuar garancitë për parandalimin e manipulimit të fëmijës nga ata që veprojnë në emër të tij ose të saj dhe mund të refuzojë të shqyrtojë ndonjë komunikim që e konsideron të mos jetë në interesat më të mira të fëmijës.

⁷¹Ligji nr.10 424, datë 2.6.2011, për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”.

⁷² Ligji nr. 63/2012, për ratifikimin e Konventës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”

⁷³ Ligji 86/2013 për ratifikimin e Protokollit Opsional mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Procedurat e Komunikimit.

1.2.2. Kuadri juridik shqiptar⁷⁴

- **Kushtetura e RSH-së⁷⁵**, ka parashikuar dispozita të veçanta në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve. Si pjesë e lirive dhe të drejtave të njeriut, Kushtetuta i njeh fëmijëve liritë dhe të drejtat vetjake (mbrojtja e jetës), politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në këtë kuadër brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, shteti nëpërmjet nismave të tij ligjore siguron plotësimin e nevojave të fëmijëve për mirëqenie, mirërritje, arsimim, punësim, si dhe zhvillimin intelektual të tij. Në kuadër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, shteti ka detyrimin të garantojë procedura lehtësuese gjatë gjyqimit të fëmijëve në proceset gjyqësore, si dhe të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.⁷⁶ Në dispozitat e mëposhtme kushtetuese, me termin “kushdo/çdo person” përfshihen edhe fëmijët, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të cilëve duhet të përbëjë prioritet dhe angazhim maksimal politik dhe shoqëror në krahasim me nismat e ndërmarra për grupmoshat e tjera të shoqërisë. Në Kushtetutë parashikohet shprehimisht se, askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.⁷⁷ Dispozitat kushtetuese garantojnë një sërë të drejtash për individin (përfshirë edhe fëmijën gjatë procesit penal).
- **Kodi i Familjes⁷⁸**, trajton gjerësisht dhe hollësisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në këtë Kod përfshihen parimet e përgjithshme të Konventave, akteve dhe instrumentave ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe veçanërisht dispozita të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Ky Kod i kushton kujdes të veçantë trajtimit dhe kujdesit të të miturve si dhe detyrimeve të prindërve, ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për administrimin e pasurive që vijnë nga puna e të miturve, lejimit të punës së të miturve, kujdesi kur ata punojnë. Kodi përcakton gjithashtu detyrimet institucionale të shtetit ndaj fëmijëve jashtë kujdesit prindëror, si edhe mënyrën e zbatimit të tyre.
- **Kodi Penal i RSH-së⁷⁹**, ka parashikuar vepra të reja penale të cilat kryhen kundër fëmijëve/të miturve, si dhe ashpërsimin e dënimit të dhënë ndaj personave të cilët me vendim të formës së prerë shpallen fajtor për një vepër penale të kryer kundër fëmijëve.
- **Kodi i Procedurës Penale⁸⁰**, parashikon se gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit.
- **Kodi Civil i RSH-së⁸¹**, parashikon mbrojtjen juridike të fëmijëve dhe njohjen e të drejtave të tyre civile.

⁷⁴Aktet ligjore janë paraqitur sipas rrjedhës kronologjike të miratimit të tyre.

⁷⁵Kushtetura e RSH, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998.

⁷⁶Neni 54 i Kushtetutës R.SH

⁷⁷Neni 25 i Kushtetutës R.SH

⁷⁸Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003, i ndryshuar

⁷⁹Kodi Penal i RSH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar

⁸⁰Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar

⁸¹Kodi Civil i RSH, miratuar me ligjin 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar

- **Kodi i Punës i RSH- së**⁸², i kushton një kapitull të veçantë mbrojtjes të të miturve, ku trajtohet moshë minimale e punës, kohëzgjatja e punës, punët e lehta dhe të vështira, kontrolli mjekësor etj.
- **Ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”**. Ky është një hap i rëndësishëm me fokus përmirësimin e kuadrit ligjor. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.
- **Ligji nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”** përcakton kriteret për të përfituar nga statusi i jetimit. Garanton angazhimin e mekanizmave shtetëror për të realizuar të drejtat e këtyre fëmijëve, si fëmijë që mund të preken lehtësisht nga abuzimet.
- **Ligji nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”**, parashikon se RSH-së, u njeh të drejtën për azil a mbrojtje të përkohshme të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, qofshin këta refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Gjithashtu, ligji rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit në RSh-së, si dhe të drejtat e detyrat e refugjatëve dhe të personave nën mbrojtje të përkohshme.
- **Ligji nr.8528 datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gj”**, ka si qëllim mbrojtjen e të drejtës së fëmijës për t’u ushqyer me gj. Nëpërmjet masave të veçanta, nxitet ushqyerja me qumështin e gjirit si një element i pazëvendësueshëm që ndikon drejtpërdrejt në mbijetesën dhe në zhvillimin e plotë dhe të mirë të fëmijës së porsalindur.
- **Ligji nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH-së”**, garanton të drejtën e parashikuar në Kushtetutë, për arsimim dhe formim profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimimit profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim.
- **Ligji nr.8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”**, parashikon se veprimtaria e shërbimeve për kujdesin ndaj shëndetit riprodhues përfshin: a) kujdesin para, gjatë dhe pas lindjes; b) kujdesin për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës 0-6 vjeç; c) kujdesin për shëndetin e adoleshentëve;
- **Ligji nr.9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në RSH-së”**, parashikon procedurat për realizimin e të drejtave për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor e shoqëror, strehimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfituar azil në RSH-së.
- **Ligji nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”**, rregullon masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes, duke parashikuar edhe rastet kur personi i mbrojtur është i mitur.

⁸²Kodi i Punës i RSH, miratuar me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar

- **Ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”**, parashikohen masa për të siguruar ndihmë dhe shërbime shoqërore individëve dhe grupeve në nevojë, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, duke përfshirë edhe fëmijët.
- **Ligji nr.9381, datë 28.4.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”**, parashikon ndër të tjera se të drejtën e paraqitjes së kërkesës për përfitimin dhe të kompensimin për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi për personin e mitur këtë të drejtë e ushtron kujdestari ligjor.
- **Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”⁸³**, rriten dhe forcohen më shumë kompetencat e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Parashikohet shprehimisht se në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i të miturit nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur.⁸⁴
- **Ligji nr.9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”**, ka për qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit. Ky ligj parashikon ndërmarrjen e masave për ndalimin e përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit.
- **Ligji nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”**, ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre. Ky ligj përcakton një sërë masash kufizuese për personat nën 18 vjeç.
- **Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”**, parashikon masat ligjore kundër dhunës dhe krijimin e një mekanizmi apo rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje, në veçanti për të parandaluar dhunën dhe keqtrajtimin e fëmijëve. Synon parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj, përcakton për herë të parë masa mbrojtjeje për viktimën nëpërmjet dy instrumenteve kryesore, “Urdhrit të Mbrojtjes” dhe “Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes”, të cilët lëshohen nga gjykata, i cili parashikon edhe mundësinë e largimit të autorit të supozuar të aktit ose të viktimës nga mjedisi i tij/saj familjar.
- **Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”⁸⁵**, siguron kushtet e përshtatshme për respektimin e të drejtës së fëmijës për t’u rritur në ambient familjar. Ky ligj përcakton procedurat e realizimit të birësimit, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komitetit Shqiptar të Birësimeve, me qëllim që fëmijët që janë të privuar nga mjedisi familjar, t’i sigurohet një familje alternative, me të drejta dhe detyrime të njëjta me prindërit biologjikë.

⁸³Ndryshuar me ligjin nr.8600, datë 10.4.2000.

⁸⁴Në ligjin nr.9398, datë 12.05.2005.

⁸⁵Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”.

- **Ligji nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e shtetit”**, parashikon masat që ndërmerr policia e shtetit për garantimin e të drejtave të shtetasve. Në masat që ndërmerr policia e shtetit për ruajtjen e rendit parashikohet se, nëse cënimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një personi të mitur nën 14 vjeç, përveç masave të marra ndaj tij, punonjësi i Policisë njofton prindin ose kujdestarin e të miturit nën 14 vjeç për ndërprerjen e veprimeve të paligjshme të të miturit. Gjithashtu, në kontrollet që kryhen nga punonjësit e policisë parashikohet se për kontrollin e të miturve kërkohet edhe prania e prindit ose e kujdestarit. Ligji parashikon se punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e Policisë ose në organin urdhërdhënës, për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent.
- **Ligji nr.9888, datë 10.3.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”** (të ndryshuar), parashikon se në institucionet e paraburgimit ndalohet mbajtja e të miturve në një dhomë me të rriturit, ose vendosja e të miturve vajza me të mitur djem në një dhomë. Gjithashtu, në ndryshimet e këtij ligji parashikohet se të miturit vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke u krijuar mundësinë e një trajtimi të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.
- **Ligjin nr.9952, datë 14.7.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”**, parashikohen rregullat për parandalimin dhe kontrollin në marrjen e masave për HIV/AIDS-in, kujdesin, trajtimin dhe mbështetjen për personat që jetojnë me HIV/AIDS. Ligji jep përkufizimet e braktisjes nga prindërit e fëmijës së mitur, të infektuar me HIV, të braktisjes ⁸⁶nga kujdestari ligjor i fëmijës, nën kujdestari, të infektuar me HIV.
- **Ligji nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”**, përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjera të ligjshme të tij. Në këtë ligj është parashikuar dhënia e ndihmës juridike të miturve në konflikt me ligjin.
- **Ligjin nr.10 060, datë 26.1.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”**, në dispozitën e përkufizimeve jepet termi “të mitur të pashoqëruar”.
- **Ligji nr.10139, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”**, ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe promovimin e jetesës së shëndetshme të popullatës. Në ligj janë parashikuar dispozita në mbrojtje të shëndetit të fëmijës.
- **Ligji nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”**, përcakton kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, si dhe organizimin e funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në RSh-së. Ky ligj rregullon në mënyrë më të plotë dhe të detajuar të drejtën për t’u regjistruar në momentin e lindjes, e drejtë nga e cila burojnë të drejtat të tjera si, e drejta për arsim, për kujdes shëndetësor, etj.
- **Ligji nr.10347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”**. Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën. Ligji për herë të parë realizon vendosjen e një sistemi efektiv vëzhgimi dhe raportimi lidhur me

⁸⁶Në nenin 3 i Ligjit “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”.

realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor. Ligji parashikon mekanizmat institucionalë, të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe garant për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi. Parashikon ngritjen e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) brenda strukturës së njesisë administrative vendore, si e vetmja strukturë e specializuar në nivel vendor që koordinon parandalimin, mbrojtjen dhe referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në territorin e vet përmes qasjes shumë-sektoriale të menaxhimit të rastit. Ky ligj dhe aktet e tij normative, përcaktojnë se përgjegjësia e kujdesit dhe e mbrojtjes së fëmijës nuk është vetëm e NJMF-së, por e të gjithë aktorëve publikë dhe jo-publikë që kanë një rol në ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nivel vendor, rajonal dhe qendror.⁸⁷ Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual është një nga format e dhunës të përmendura në këtë ligj (neni 21 dhe 24). Ky ligj jep përkufizimet e prostitucionit të fëmijës, pornografisë dhe shitjes së fëmijëve, por ai nuk përkufizon se çfarë quhet dhunë seksuale dhe nuk parashikon masa mbrojtëse të veçanta për fëmijët e abuzuar seksualisht.

- ***Udhëzimi nr.10, datë 25.02.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”***, përcakton hapat e procesit për menaxhimin e rastit, që ndiqen nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës (PMF), ose nga çdo punonjës social pranë institucioneve të tjera që menaxhon një rast të mbrojtjes së fëmijës.

1.2.3. Strategjitë e miratuara

Të drejtat e fëmijëve, përveçse në kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar duhen konsideruar dhe realizuar si pjesë e platformave strategjike dhe dokumenteve të cilat kanë në qendër përfshirjen sociale në shoqëri, si

- Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve – Plani i saj i veprimit;
- Strategjia e Përfshirjes Sociale;
- Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2007-2013;
- Strategjia e Kujdestarisë së Përkohshme;
- Strategjia e trafikimit të qënieve njerëzore në përgjithësi dhe atë të fëmijëve në veçanti;
- Standardet e shërbimeve shoqërore dhe veçanërisht ato të fëmijëve;
- Plani i Veprimit për Strategjinë e Fëmijëve, 2012 -2015.
- ***Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve***, ndër të tjera synon:
 - Sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga mosha, gjinia, etnia, aftësia e kufizuar, statusi i lindjes etj.
 - Ngritjen e strukturave dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare e njerëzore, për të realizuar detyrimet që rrjedhin sidomos nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.
- ***Strategjia Kombëtare për Fëmijët***.

Strategjia Kombëtare për Fëmijë është pjesë integrale e Strategjisë Ndërsektoriale për përfshirjen sociale (2007-2013). Përfshirja sociale është në fokusin kësaj strategjie,

⁸⁷Ligjit nr. 10 347 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i miratuar në date 4.11.2010.

-Vazhdimësia e procesit që siguron respektimin e interesave të fëmijëve, të drejtën e informimit dhe të lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha çështjet që lidhen me ta në familje, në shkollë dhe në institucione të tjera.

-Ngritja e sistemit të institucioneve dhe marrja e masave të tjera të domosdoshme, për të mbrojtur fëmijët nga të gjithë format e dhunës, të shfrytëzimit dhe nga keqtrajtimet.

-Sigurimi i jetesës së fëmijëve në mjedis familjar dhe vetëm në pamundësi të kësaj, ofrimi i kujdesit alternativ, ku përparësi të ketë kujdestaria në familjet sociale.

-Përsosja e kuadrit ligjor në fushën e birësimeve, duke synuar birësim të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët.

- **Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**

-Ulja e numrit të fëmijëve të rrugës dhe ngritja e shërbimeve që i mbrojnë dhe zhvillojnë ata.

-Reduktimi i numrit të fëmijëve që punojnë dhe garantimi i sistemit të mbrojtjes së tyre.

-Ndërtimi i sistemit arsimor bashkëkohor, duke garantuar që të gjithë fëmijët të mësojnë në kushte të përshtatshme dhe të përfundojnë arsimin e detyruar.

-Rritje e kujdesit për t'u krijuar shanse të barabarta fëmijëve me aftësi të kufizuara.

-Përmirësimi i kujdesit dhe shërbimit shëndetësor për nënën dhe fëmijën, me synim arritjen e standardeve normale në këtë shërbim.

- **Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2007-2013**

- Asistence për familjet në varfëri. Zbutje të varfërisë.

-Shtrirja e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës, në të gjithë vendin.

-Përmirësimi i targetimit për skemën e ndihmës ekonomike.

-Përmirësimi i administrimit të subvencionit për energjinë.

-Hartimi dhe miratimi i standardeve të përkujdesit për fëmijë;

- **Strategjia e mbrojtjes sociale dhe plani i saj i veprimit (2008-2013)⁸⁸,**

VKM nr.80, datë 28.01.2008 janë dhe një sërë treguesish që shërbejnë për të vlerësuar politikën e mbrojtjes sociale. Strategjia parashikon politikën në mbrojtje të grupeve në nevojë dhe veçanërisht ndalet tek fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe ata me aftësi të kufizuara. Reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale të fëmijës.

- **Strategjia Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara dhe Planin e saj i Veprimit⁸⁹**

Parashikon masa të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara në lidhje me shprehjen e mendimit, arsimin, shërbimin shëndetësor dhe argëtimin. Megjithatë është e nevojshme që kjo strategji të ndalet veçanërisht në abuzimin, dhunën, neglizhimin apo shfrytëzimin duke përfshirë kështu edhe parimet e KDF-së.

- **Strategjia e kujdestarisë⁹⁰**

Strategjia për Shërbimin e Kujdestarisë (foster care) për fëmijët në nevojë parashikon kujdestarinë si shërbim alternativ, i cili bazohet në procesin e decentralizimit dhe ngritjen e shërbimeve komunitare, ku fëmija mbështetet dhe ndihmohet në një mjedis familjar, i cili garanton një cilësi më të lartë shërbimesh dhe të drejtat themelore që

⁸⁸Strategjia e mbrojtjes sociale dhe plani i saj i veprimit (2008-2013), miratuar me VKM nr.80, datë 28.01.2008

⁸⁹ Strategjia Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara dhe Planin e saj i Veprimit, miratuar me VKM nr. 8, datë 7.01.2005

⁹⁰Strategjia për Shërbimin e Kujdestarisë, miratuar me VKM nr. 1104, datë 30.7.2008.

burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Në dokument janë përcaktuar fazat për zbatimin e shërbimit të kujdestarisë si: përmirësimi i legjislacionit, ngritja e kapaciteteve të strukturave zbatuese, fushata publicitare, përzgjedhja e familjeve kujdestare, vlerësimi i fëmijëve, monitorimi etj.

Parimet:

-Të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të drejtën e rritjes me dashuri në një mjedis familjar të qëndrueshëm;

-Të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga abuzimi fizik, psikologjik apo seksual;

-Të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të drejtën e ofrimit të alternativave të ndryshme të kujdesit me bazë familjen në rastet e mungesës së asaj biologjike;

Synohet:

-Kuađer ligjor i përmirësuar dhe i plotësuar për të mundësuar zbatimin e shërbimit të kujdestarisë për fëmijë;

-Sensibilizimi i shoqërisë lidhur me shërbimin e kujdestarisë për fëmijë dhe përparësitë e tij;

-Ngritje kapacitetesh profesionale të të gjithë aktorëve që do të përfshihen në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë;

-Procedura dhe dokumentacion i gatshëm për të ofruar një shërbim cilësor të kujdestarisë për fëmijë;

• ***Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010⁹¹***

Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2008-2010) si dhe dokumenti plotësues i Strategjisë Kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktime të trafikimit, synojnë eliminimin e plotë të trafikimit dhe marrin në konsideratë gjithashtu rritjen e mundësive për arsimim, përfshirjen, regjistrimin në gjendjen civile, eliminimin e punës së fëmijëve si dhe ndërtimin e rrjeteve në luftën kundër shfrytëzimit. Në dokument trajtohen aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me hetimin dhe ndjekjen penale, mbrojtjen sociale dhe integrimin e viktimave të trafikimit, parandalimin e fenomenit si dhe çështje të koordinimit dhe bashkëveprimit. Prioritete të strategjisë, kanë qënë përfshirja e fëmijëve në shkolla, respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe grave, krijimi i mundësive për punësim, mbështetja e vazhdueshme kryesisht për grupet e rrezikuara, rehabilitimi dhe integrimi i viktimave të trafikimit, rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal etj

Parimet:

-Trajtim i viktimave bazuar në të drejtat e njeriut;

-Qeveria - Përgjegjësia kryesore

-Pjesëmarrja më e gjerë e shoqërisë civile,

-Ofrim i mbrojtjes dhe asistencës për të gjithë viktimat që mendohen se janë të tillë dhe nëse ato nuk kanë dëshirë të dëshmojnë;

-Identifikimi i rasteve të mundshme dhe atyre aktuale të trafikimit të fëmijëve;

-Sigurimi i marrjes së masave parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese;

-Ngritja e sistemeve të institucionalizuara efektive të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, që kanë për synim identifikimin e grupeve dhe individëve në rrezik, si edhe të miturit e trafikuar;

-Sigurimi i aksesit për arsimim dhe përgatitje aftësish për jetën.

-Evidentim i problemeve sociale negative

⁹¹ Strategjia e Trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2010, miratuar me VKM nr. 1083, datë 23.07. 2008

- Shfrytëzimi ekonomik dhe seksual
- Trafikimi i fëmijëve
- Dhunimi Fizik
- Rekrutimi i fëmijëve për trafikim e ka burimin të familjet me:
 - o Kujdes familjar të brishtë dhe prindër të divorcuar.
 - o Fëmijë të mbetur jetimë dhe pa kujdes.
 - o Shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike.
 - o Prindër të punësuar jashtë vendit.
 - o Fëmijë që kanë braktisur shkollën dhe janë marrë me lypje
 - o Fëmijë që merren me veprimtari të kundërligjshme në Shqipëri
- Ratifikimi i Protokollit të Palermos për Luftën kundër trafikimit të grave dhe fëmijëve, ka sjellë ndryshime në legjislacionin penal.
- Krimet e kryera kundër fëmijëve kanë një dënim më të madh.
- Është krijuar Qendra e Riedukimit për të mitur me vepra penale dhe me çrregullime në sjellje.

- **Plani i veprimit për fëmijë 2012-2015**⁹²synon arritjen e objektivave strategjike kryesore si parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga format më të këqija të punës.

Objektivi strategjik, “Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi” kushtëzohet nga objektivat:

- Rregjistrimi i të gjithë fëmijëve me shtetësi shqiptare, të lindur, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë;
- Ngritja dhe funksionimi i mekanizmave institucionale në nivel vendor për mbrojtjen e fëmijëve dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik;
- Zbatimi i programit Combi: “Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive”;
- Vendosja dhe konsolidimi i shërbimit psikologjik në të gjitha kopshtet, shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm;
- Internet i sigurtë për fëmijët.

1.2.4. Institucionet që monitorojnë të drejtat e fëmijëve

- **Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve**⁹³

Autoriteti më i lartë që vëzhgon zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe që garanton përfshirjen e politikave për respektimin e të drejtave të fëmijëve në politikat e zhvillimit.

- **Sekretariati Teknik për Fëmijët (STF)**⁹⁴

Strukturë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Misioni i STF është monitorimi dhe vlerësimi lidhur me ecurinë dhe çështjet kritike të vërejtura në respektimin e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në nevojë në veçanti si dhe raportimi e informimi i strukturave shtetërore dhe opinionit publik.

- **Njësia për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF)**

⁹² Plani i veprimit për fëmijë 2012-2015 – Organizata Botërore për mbrojtjen e fëmijëve.

⁹³ Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve, ngritur me Urdhër të Kryeministrit, nr. 24 datë 21.03.2007

⁹⁴ Ngritur me Urdhër të Kryeministrit, në nëntor 2006

Ngritur brenda strukturës administrative të qarkut dhe ka për detyrë të vëzhgojë situatën dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të politikave për të drejtat e fëmijëve në nivel rajonal. Këto njësi funksionojnë në qarqet e Kukësit, Korçës, Elbasanit etj.

- **Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF)**

Ngritur brenda strukturës administrative të shërbimeve sociale në bashki. Ajo ka për detyrë të identifikojë, vlerësojë rastet e fëmijëve në nevojë dhe të koordinojë aktivitetet për mbrojtjen e fëmijës.

- **Observatori për të Drejtat e Fëmijës**

Strukturë e shoqërisë civile, e cila synon të ngrejë mekanizmat për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal. Ato mbledhin informacion nga të gjitha institucionet shtetërore rajonale dhe që njëkohësisht ndihmojnë këto institucione me të dhëna të mbledhura nga studimet e ndryshme. Deri tani janë ngritur gjashtë observatorë përkatësisht në qarqet e Shkodrës, Kukësit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit dhe Korçës.

- **Institucioni i Avokatit të Popullit⁹⁵**

Mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

- **Linja Kombëtare e telefonit për fëmijët (116)**

Shërbimi më i ri komunitar për fëmijët, në ndihmë të realizimit të së drejtës së tyre për mbrojtje shoqërore është Linja Kombëtare e telefonit për fëmijët (116). “Linja Kombëtare e telefonit për fëmijët në Shqipëri” është një nismë e UNICEF-it në Shqipëri dhe Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA/DCI Shqipëri). Kjo linjë ka si qëllim këshillimin psiko-social për fëmijët nëpërmjet telefonit, referimin e çdo problemi të fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashki dhe OJF, si dhe dëgjimin e ankesave të çdo fëmije, i cili nuk ka mundësi t’i shprehë ato në një formë tjetër. Linja Kombëtare e telefonit për fëmijët ka vendosur në përdorim aktiv numrin 116. Ky numër është mundësuar nga AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare)⁹⁶. Numri 116 është një numër paneuropean dhe gëzon cilësitë e numrit të policisë apo urgjencës. Linja ofron shërbim falas për fëmijët në 24 orë në ditë, në 7 ditë të javës.

⁹⁵ Ligji përkatës nr.8454, datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” është plotësuar me ligjin nr. 8600, datë 10.04.2000, si dhe është ndryshuar edhe me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005.

⁹⁶ Miratuar me vendim nr.207/3, datë 25.02.2009

KAPITULLI II

FORMAT KLASIKE TË INKRIMINIMIT TË PEDOFILISË

2.1. Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur

Marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale me të mitur janë një nga krimet që kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore. Ato përfaqësojnë një nga format kryesore të abuzimit seksual ndaj të miturit. Mbrojtja e lirisë seksuale dhe zhvillimit seksual normal të personit të mitur përbën një nga aspektet kryesore të intergritetit fizik dhe psikik të tij, si dhe një nga të drejtat dhe liritë themelore të të miturit. Prandaj kjo figurë e veprës penale paraqet rëndësi të madhe në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në nenin 100 të Kodit Penal⁹⁷ parashikohet se: *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*

Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.

*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet”.*⁹⁸

Për të arritur në këtë parashikim të tanishëm kjo dispozitë ka qënë objekt ndërhyrje nga ana e ligjvënësit, me qëllim që fusha e mbrojtjes të saj të zgjerohej. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në momentin e hyrjes në fuqi në vitin 1995 bënte këtë sanksionim: *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale me të miturën, që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*

Kur marrëdhënia seksuale kryhet me dhunë ose kur i janë shkaktuar të dëmtuarës pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturës, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet”.*⁹⁹

Gjatë aplikimit në praktikë të kësaj figure të veprës penale, u konstatua se ajo nuk mund të zbatohet në rastin e marrëdhënieve homoseksuale me të mitur. Kështu, me qëllim që të sigurohet mbrojtja juridike penale e njëjtë ishte e nevojshme ndërhyrja legjislative¹⁰⁰. Një boshllëk i tillë ligjor u plotësua me ligjin nr.8733 datë 24.01.2001, i cili ndryshoi përmbajtjen e mësipëme, duke i dhënë trajtën që kjo

⁹⁷ Shih nenin 100 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995.

⁹⁸ Shih nenin 15 të ligjit nr 8733 datë 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë””

⁹⁹ Shih nenin 100 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995

¹⁰⁰ Shih Ismet Elezi “E drejta Penale (Pjesa e posacme)”, Tiranë 2013 , fq 113.

dispozitë ka aktualisht¹⁰¹. Kështu që, edhe në rastin e marrëdhënieve homoseksuale me të mitur kualifikimi ligjor duhet të bëhet sipas këtij neni. Ky qëndrim është i konsoliduar edhe nga praktika gjyqësore. Në këtë optikë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁰² ka vlerësuar se: “...Ky person i ka kërkuar atij që ta ndihmonte të ngrinte një send të rëndë, por që është refuzuar prej tij sepse nuk kishte dalluar asnjë send. Atëherë agresori i tij e ka urdhëruar që t'i afrohej dhe mbasi e ka kapur kundër dëshirës së tij e ka zhveshur në pjesën e poshtme të trupit dhe më pas ka kryer marrëdhënie homoseksuale me të. Mbasi ka përfunduar aktin i ka urinuar në fytyrë dhe e ka kërcënuar që të mos tregonte për ngjarjen dhe është larguar.

I mituri V. GJ pas dhunës seksuale është veshur dhe ka shkuar në shtëpinë e tij. Në shtëpi ka gjetur motrën e tij A. GJ, të cilës i ka treguar për ç'ka i kishte ndodhur. Më mbas është njoftuar nëna e të dëmtuarit, e cila ka konstatuar se i dëmtuari kishte dhimbje, hemorragji në pjesën e mbrapme duke e çuar për ndihmë mjekësore në spital. Nga kqyrja trupore mjekët kanë konstatuar se i mituri V. GJ kishte dëmtime në pjesën e mbrapme të ngjashme me ato të një kontakti seksual. Në lidhje me ngjarjen është njoftuar policia gjyqësore, e cila ka filluar çështjen penale.

Gjatë fazës së hetimit janë grumbulluar provat të cilat kanë shërbyer që nga ana e prokurorit ndaj të gjykuarit I.V të ngrihet akuza për veprën penale të kryerjes së marrëdhënieve homoseksuale me të mitur me dhunë, të parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal...”

Në kuadër të analizës historike të kësaj figure të veprës penale theksojmë se teknikat e inkriminimit të saj janë të mbartura nga Kodet Penale, që kanë qënë në fuqi më përpara në Republikën e Shqipërisë. Kështu, në Kodin Penal të vitit 1952¹⁰³ në kapitullin e katërt, seksioni i katër, parashikohen krimet seksuale, me objekt të drejtpërdrejtë sipas figurave të mëposhtme:

1. Marrëdhënie seksuale me të rritur me dhunë (neni 165)
2. Marrëdhënie seksuale me të mitur (neni 166)
3. Korruptimi i të miturit (Vepra të turpshme) (neni 167)
4. Marrëdhënie seksuale në gjini (neni 168)

Lidhur me figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale me të mitur” ky kod parashikonte se: “Marrëdhëniet seksuale me persona që nuk kaë arritur pjekurinë seksuale dënohen nga tre gjer ne pesëmbëdhjetë vjet.

*Kur veprat e mësipërme janë kryer me dhunë, ose nga një grup personash si dhe kur nga ato kanë rrjedhur pasoja të rënda për shëndetin e fëmijës dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet ”.*¹⁰⁴

Ndërsa, Kodi Penal i vitit 1977¹⁰⁵, në kreun e katërt me titull “Krimet kundër personave dhe familjes”, në seksionin e tretë të këtij kreu, kishte parashikuar krimet seksuale, duke kategorizuar mbrojtjen në këto figura të veprës penale:

1. Marrëdhënie seksuale me dhunë (neni 97)
2. Marrëdhënie seksuale me të mitura (neni 98)
3. Vepra të turpshme (neni 99)
4. Marrëdhënie seksuale në gjini (neni 100)

¹⁰¹ Shih nenin 15 të ligjit nr 8733 datë 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë””.

¹⁰² Shih vendimin nr 245 datë 26.09.2012 të Kolegjit Penale të Gjykatës së Lartë.

¹⁰³ Ky Kod Penal është miratuar me dekretin nr.1516 datë 07.08.1952

¹⁰⁴ Shih nenin 166 të Kodit Penal të miratuar me dekretin nr. 1516 datë 07.08.1952

¹⁰⁵ Ky kod është miratuar nga Kuvendi Popullor më 15.06.1977 dhe hyrë në fuqi më 01.10.1977.

Lidhur me figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale me të mitura” ky kod parashikonte se: *“Marrëdhëniet seksuale me një vajzë që nuk ka arritur moshën 14 vjeç ose pjekurinë seksuale dënohen gjer në pesëmbëdhjetë vjet burg.*

*Po këto vepra të kryera në bashkëpunim ose kur kanë shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin dënohen jo më pak se dhjetë vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vetëvrasjen ose vdekjen e të dëmtuarës edhe me vdekje”.*¹⁰⁶

Siç vihet re, nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme rezulton se parashikimi i Kodit Penal të vitit 1977, është pothuajse i njëjtë me parashikimin që bën Kodi Penal i vitit 1995.

Nga analiza e nenit 100 të Kodi Penal, rezulton se si bazë të përgjegjësisë penale për marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale me të mitur pranon dy kritere kryesore:

1. Moshën
2. Pjekurinë seksuale

Marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale me një fëmijë të mitur që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, formojnë krim sepse është çmuar se fëmija i mitur, në këtë moshë, nuk e ka arritur atë zhvillim të përgjithshëm, në të cilin të kuptojë karakterin e veprës dhe pasojat e saj, si dhe mund të kryejë normalisht marrëdhënie seksuale pa pasojë të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin normal seksual. Përcaktimi i saktë i moshës ka rëndësi ekzistenciale për kualifikimin e saktë ligjor¹⁰⁷. Nëse i referohemi vendimit nr.537, datë 28.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konstatojmë rëndësinë e madhe që ka përcaktimi i saktë i moshës për kualifikimin ligjor. Kështu, në këtë vendim theksohet se: *“Më datën 04.06.2006, i dëmtuari M. I, i mitur i datëlindjes 26.02.1993, ka qënë duke kaluar në afërsi të shtëpisë të të gjykuarit. Ky i fundit, kur e ka parë, i ka thenë se të dëmtuarin e kërkonte shoku i tij E. dhe, sa janë futur në oborrin e shtëpisë, i gjykuari forcërisht e ka futur në haurin që ndodhej aty dhe duke e kërcënuar, e forcërisht, i ka kërkuar që të kryente marrëdhënie seksuale. Ndeshur me kundërshtimin e të dëmtuarit, i gjykuari, po me dhunë e ka çveshur të dëmtuarin, është çveshur dhe vete e ka filluar ta puthë e fërkojë të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit. Pas kësaj, e ka kthyer përmbys mbi kashtën ku ishin dhe ka dashur të kryejë plotësisht aktin seksual, gjë që nuk arriti ta kryente se në këtë kohë në haur hyri H.P, që ka deklaruar se i pa të dy personat, doli jashtë, e pas pak doli nga aty duke qarë edhe i dëmtuari M. I.*

Gjatë hetimeve paraprake e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, i gjykuari ka mohuar të ketë kryer veprën për të cilën është akuzuar dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me veprën e turpshme. Gjykatat kanë analizuar gjërësisht provat e administruara, deklaratimet e dëshmitë e personave që kanë patur dijeni për ngjarjen e aktet e tjera dhe kanë arritur në përfundimin se i gjykuari ka konsumuar veprën penale të marrëdhënive homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç, parashikuar nga neni 101/2 i K.Penal, mbetur në tentativë (dhe jo për veprë të kryer plotësisht, siç është akuzuar e ka pretenduar në vazhdimësi organi i prokurorisë), dhe jo atë të veprave të turpshme siç, ka pretendime mbrojtja... ”. Në rastin konkret i dëmtuari, është i mitur i moshës 13 vjeç dhe kualifikimi ligjor është i gabuar, sepse duhet të ishte bërë sipas neneve 100/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Veç kriterit moshë, pranohet si kriter tjetër për të miturën, ai i arritjes së pjekurisë seksuale. Ky kriter vlen për ato raste kur vajza, ndonëse e ka mbushur

¹⁰⁶ Shih nenin 98 të Kodit Penal të miratuar nga Kuvendi Popullor më 15.06.1977 dhe hyrë në fuqi më 01.10.1977

¹⁰⁷ Shih vendimin nr.537, datë 28.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

moshën katërmbëdhjetë vjeç, nuk ka arritur pjekurinë seksuale dhe me të kryhen marrëdhënie seksuale. Pra, kryerja e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale me një vajzë që ndonëse ka mbushur moshën 14 vjeç, por nuk ka arritur pjekurinë seksuale, qoftë edhe me pëlqimin e saj, formon krimin e parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal.

Edhe pse përcaktimi me ligj i moshës 14 vjeç për konsensusin për marrëdhënie seksuale është një hap pozitiv në mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi seksual, kjo moshë bie në kundërshtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe ligjin shqiptar, e cila përcakton se “fëmijë është çdo person deri në moshën 18 vjeç”. Gjithashtu këto nene kriminalizojnë aktin e penetrimit seksual, por nuk përcaktojnë qartë veprime të tjera me natyrë seksuale që mund të ndërmerren kundrejt fëmijës. Neni 108, dënon kryerjen e akteve të turpshme në prezencë të fëmijës nën moshën 14 vjeç, por nuk jep një përkufizim të akteve të turpshme. Për më tepër fëmijët mbi moshën 14 vjeç nuk janë të mbrojtur nga ky nen.

Kjo mangësi në legjislacionin shqiptar është evidentuar edhe nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës sipas të cilit “Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës është thellësisht i shqetësuar për gjendjen e legjislacionit shqiptar, i cili nuk mbron të gjithë fëmijët deri në moshën 18-vjeçare nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, për mungesën e masave efektive për parandalimin dhe luftimin e tij, si dhe mungesën e shërbimeve për t’i ofruar fëmijëve mbështetje psiko-sociale, rehabilitim dhe ri-integrim”.¹⁰⁸

Me pjekuri seksuale kuptohet aftësia për plotësimin fiziologjik të të gjithave funksioneve seksuale pa pasoja të dëmshme për shëndetin, nga kryerja e marrëdhënieve seksuale deri në lindjen e fëmijës. Pjekuria seksuale vërtetohet nga ekspertët.

Me pranimin e këtyre dy kriterëve, janë vënë në një mbrojtje të posaçme nga Kodi Penal, ato marrëdhënie shoqërore të rëndësishme që sigurojnë lirinë seksuale dhe zhvillimin normal seksual të fëmijës së mitur, jetës dhe shëndetit të tij, duke përbërë edhe objektin juridik të kësaj figure të veprës penale. Këto kriterë kanë vlerë cilësuese për këtë figurë të veprës penale. Lidhur me to, Gjykata e Lartë¹⁰⁹ ka theksuar se: “Në asnjë prej deklarimeve të bëra gjatë procedimit penal nuk është pretenduar për padijeninë objektive të tij lidhur me moshën e të dëmtuarës, gjë e cila mund të vinte në dyshim ekzistencën e anës subjektive dhe shkallën e fajësisë në kryerjen e kësaj vepre penale. Ndërkohë e dëmtuara K. nuk kishte arritur moshën 14 vjeç, e konfirmuar nga deklaratimet e saj në procesin e sigurimit të provës, kur ka kryer marrëdhënie seksuale me të pandehurin E.B në një hotel të qytetit Igalos, në Malin e Zi, përveçse kur ka kryer marrëdhënie edhe me parë.

Pretendimet e të pandehurit se ai ka ardhur nga Belgjika për në Shqipëri me kërkesën e të dëmtuarës, se çdo veprim i tij është kryer me pëlqimin e saj dhe se ajo kishte arritur pjekurinë seksuale, me të drejtë nuk janë pranuar nga gjykata e apelit, pasi ato nuk e përjashtojnë të pandehurin nga përgjegjësia penale, lidhur me akuzën e ngritur ndaj tij.

Neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” në paragrafin e parë parashikon “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç ose

¹⁰⁸ Shih “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. Dhjetor 2015, Terre Des Hommes. Fq.16.

¹⁰⁹ Shih vendimin nr.15, datë 04.02. 2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”

Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, për t’u konsideruar e konsumuar ana objektive e kësaj veprë penale kërkohet ekzistenca e pavarur e dy rrethanave: kryerja e marrëdhënieve seksuale me fëmijë të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç dhe kryerja e marrëdhënieve seksuale me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale...”

Funksioni mbrojtës i figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” drejtpërdrejt implikon edhe objektin e caktuar të mbrojtjes si i tillë, i përfshirë në nocionin e së mirës juridike¹¹⁰, në marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur lirinë seksuale dhe zhvillimin normal seksual të fëmijës së mitur, jetës dhe shëndetit të tij.

Objekti i mbrojtjes është nocion abstrakt, gjenerik, i cili përfshin idenë e të mirës juridike, vlerës, ose interesit që mbrohet me inkriminimin konkret. Sipas kuptimit formal-material, vepra penale është sjellja e njeriut, e cila është e ndaluar me ligj, sepse çënon vlerat dhe të mirat individuale dhe shoqërore.

Nocioni i të mirës juridike mund të përkufizohet në kuptimin formal dhe material. Në kuptimin formal, i cili përbën dhe objektin juridik, me të mirë juridike kuptohet ai interes, vlerë ose e mirë që drejtpërdrejt mbrohet me normën penale juridike. Në kuptimin material, e mirë juridike lidhet me atë se çfarë i paraprin ndalimit juridiko penal duke u paraqitur kriter vlerësues i ligjvënësisë në vënien e tij. Objekti juridik njihet me termin objekt i mbrojtjes. Çdo veprë penale ka objektin e vet të mbrojtjes, aq sa nuk mund të ekzistojë një veprë pa objekt mbrojtje.

Në dallim nga objekti i mbrojtjes, objekti material ose siç quhet objekti i veprimit është pjesë e botës së jashtme, shkelja ose kërcënimi i të cilit paraqitet si pasojë e veprës penale. Objekti i veprimit material, është formë e materilizuar e objektit juridik që paraqitet objekti i mbrojtjes, i kushtëzuar nga natyra materiale e figurës së veprës penale.

Në kuadër të koncepteve të mësipërme, theksojmë se objekti juridik i figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur lirinë seksuale dhe zhvillimin normal seksual të fëmijës së mitur, jetës dhe shëndetit të tij.

2.1.1 Teknikat e inkriminimit të kësaj figure të veprës penale

Krimi kryhet me veprime aktive që konsistojnë në kryerjen e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale me fëmijën që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale. Pra, teknika e inkriminimit kërkon që subjekti aktiv me veprime aktive të kryejë marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të dëmtuarin.

Kodi Penal nuk ka dhënë përkufizimin e termit “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale”. Ndërsa doktrina e së drejtës në Shqipëri, më përpara, e ka përcaktuar këtë term si bashkimin seksual normal midis një mashkulli dhe një femre¹¹¹. Një kuptim i tillë ka karakter kufizues. Mëgjithatë edhe doktrina e së drejtës penale në Shqipëri, ka përqafuar tendencat me karakter ndërkombëtar, të cilat e trajtojnë marrëdhënien seksuale ose aktin seksual si penetrim sado i vogël i organit seksual në

¹¹⁰Shih Vllado Kambovski “E drejta Penale”, Pjesa e Përgjithshme, Botim i dytë, SHB “Furkan ISM” Shkup 2007, fq.147.

¹¹¹ Shih Ismet Elezi “E drejta Penale (Pjesa e posacme)”, Tiranë 2009, fq.114.

cilëndo pjesë të trupit të personit, ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit. Gjithashtu, me marrëdhënie seksuale kuptohet jo vetëm bashkim formal i dy personave, të sekseve të ndryshëm apo të njëjtë por, edhe çdo lloj akti, i cili edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me kontaktin fizik direkt me subjektin pasiv (viktimën) ka për qëllim dhe është i përshtatshëm të vërë në rrezik të mirën parësore të individit, atë të lirisë seksuale, nëpërmjet eksitimit ose sadisfaksionit të instiktit seksual të personit abuzues.

Në nocionin “akt seksual” përfshihen të gjitha ato akte të adresuara drejt zonave erogjene dhe që janë të përshtatshme për të cënuar apo kompromentuar vendosmërinë e lirë të seksualitetit të viktimës dhe që rezultojnë të afta për të hyrë në sferën seksuale të viktimës, me mjete që lidhen me shtrëngim, presion apo abuzim të kushteve të inferioritetit fizik apo psikik.

Në të gjitha këto raste, do të përfshihen çdo lloj prekje, kapje, shtypje mbi zonat intime të viktimës, të ndjeshme dhe të afta për të shkaktuar ndjesi seksuale qoftë edhe në mënyrë jo të plotë dhe/ose për një periudhë kohore të shkurtër, duke qenë i parëndësishëm fakti nëse viktimja e ka arritur këtë kënaqësi erotike. Vlen të theksohet se jurisprudenca¹¹² në Shqipëri ka qënë e hapur ndaj këtyre nocioneve dhe tendencave të reja.

Disa shtete në legjislacionin penal kanë dhënë përkufizimin e termit “Marrëdhënie seksuale” dhe të termave të tjerë që lidhen me aktin seksual¹¹³. Kështu për shembull, Kodi Penal¹¹⁴ i Kosovës jep të njëjtin përkufizim si më sipër.

¹¹² Shih vendimin nr.582, datë 25.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹¹³ Kështu psh Kodi Penal i Kosovës në nenin 228 parashikon se: “Përkufizimet lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual, shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:

1. Shprehja “pëlqim” nënkupton pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjet për të kryer aktin seksual. Nuk ekziston pëlqimi nëse:

1.1. personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë;

1.2. pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës;

1.3. pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin siç është paraparë në nenin 230 paragrafi 3. të këtij Kodi; ose

1.4. personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera.

2. Asgjë nga paragrafi 1. i këtij neni nuk duhet të interpretohet si kufizim i rrethanave në të cilat nuk ekziston pëlqimi.

3. Shprehja “akt seksual” nënkupton penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit.

4. Shprehja “detyrim i personit tjetër në kryerjen e aktit seksual” nënkupton kryerjen e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryesi ose cytja e personit tjetër në kryerjen e aktit seksual me kryesin apo me personin e tretë ose cytja e personit të tretë për kryerjen e aktit seksual në personin tjetër.

5. Shprehja “pjesë intime” nënkupton gjinjte e një femre, penisi, vagina dhe/apo anusi.

6. Shprehja “prekje” nënkupton kontakt direkt ose indirekt, pa penetrim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë send.

7. Shprehja “pornografi me fëmijët” nënkupton çfarëdo pamje vizuele apo shfaqje ose pasqyrim vizuel, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyrë elektronike, mekanike apo me mjete tjera, që paraqet ose pasqyron:

7.1. gjenitalet (vagina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale;

një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;

7.3. një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose

7.4. pamje realiste të një fëmije joekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar.

Në konceptin e marrëdhënies seksuale futet edhe akti seksual oral. Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe praktika gjyqësore. Kështu në vendimin nr.181, datë 16.02.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka theksuar se “...I pandehuri H.Q ka qënë banor i qytetit të Korçës dhe ka patur marrëdhënie shoqërore me dëshmitarin S.Q, i cili është babai i të dëmtuarës shtetasës së mitur A.Q. Marrëdhëniet shoqërore midis tyre janë krijuar pasi ata kanë banuar në një lagje. Në dt.06.01.2008,i pandehuri ka shkuar për një vizitë në shtëpinë e dëshmitarit S.Q, i cili i ka kërkuar që i pandehuri ta ndihmonte për t’u punësuar në Tiranë. Gjatë kësaj vizite dëshmitarja A.Q ka shprehur dëshirën që të shkonte në Tiranë për të parë qytetin për shkak se nuk kishte qënë ndonjëherë. Kjo dëshirë e dëshmitares është pranuar dhe nga babai i saj dëshmitari S.Q, gjithashtu dhe i pandehuri ka qënë dakort që A të qëndronte në shtëpinë e tij që kishte marrë me qera në Tiranë në rrugën “Jordan Misja” në të cilën jetonte i vetëm.

A.Q për herë të parë ka shkuar në Tiranë në Janar të vitit 2008 dhe pasi ka qëndruar disa ditë në shtëpinë e të pandehurit është kthyer në qytetin e Korçës. Dëshmitarja A.Q ka shkuar përsëri në Tiranë këtë herë e shoqëruar nga shoqja e saj dëshmitarja J.O dhe kanë qëndruar përsëri në shtëpinë e të pandehurit.

Në dt.09.02.2008 dëshmitaret A dhe J.O kanë konsumuar pije alkolike së bashku me të pandehurin H.Q në shtëpinë e tij dhe më pas i pandehuri ka kryer marrëdhënie seksuale duke bërë seks oral me dëshmitaren A.Q ne prezencë të dëshmitares tjetër J.O. Dëshmitarja J e ka fiksuar faktin e mësipërm duke e fotografuar aktin seksual me telefonin e saj celular Nokia N.70, i sekuestruar si provë materiale.

Në dt.09.02.2008 kur është kryer marrëdhënia seksuale e dëmtuara A.Q referuar certifikatës së lindjes, rezulton se nuk kishte mbushur 14 vjeç.

Ekzistenca e faktit të mësipërm u vërtetua me keto prova te marra dhe të verifikuara në hetimin gjyqësor.

Në këto kushte, Gjykata bazuar ne nenin 375 te K.Pr.Penale, çmon se faktit penal duhet t’i jepet një përcaktim i ndryshëm juridik nga ai që i ka dhënë prokurori sepse në rastin konkret i pandehuri H.Q duke kryer një herë marrëdhënie seksuale (seks oral) me shtetasen A.Q ka konsumuar në mënyrë të plotë elementët e figurës së veprës penale “Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100.1 i K.Penal, për rrjedhojë duhet ndryshuar akuza nga paragrafi i dytë i nenit 100 te K.Penal ne paragrafin e parë të ketij neni...”.

Për kryerjen e marrëdhënieve nuk kërkohet përdorimi i dhunës. Për konsumimin e këtij krimi mjafton kryerja e bashkimit seksual. E dëmtuara nuk është në gjendje të kuptojë karakterin e veprës dhe pasojat e saj, për shkak të moshës dhe të zhvillimit të saj psikik. Marrëdhëniet seksuale me një vajzë të vogël, pa përdorur dhunë psikike ose fizike formojnë krim, sepse autori i krimit në këtë rast shfrytëzon gjendjen e pambrojtur dhe faktin se e dëmtura nuk kupton karakterin e veprimeve që kryen dhe pasojave të veprës.

Në vendimin nr.821, datë 25.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹⁵ është theksuar se “...Më datë 31.01.2007, rreth orës 13.30, në vendin e quajtur Kombinat, tek ish reparti Tekstil, në ambientet e banesës së tij, i pandehuri B.Gj, ka kryer marrëdhënie seksuale me shtetasen E.S, e cila nuk ka mbushur moshën 14 vjeçe.

Sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr.167, datë 31.01.2007, rezulton se shtetësja E.S është e defloruar e freskët dhe ka arritur pjekurinë seksuale. Vetë e

¹¹⁴ Shih nenin 228 të Kodit Penal të Kosovës nr 04/L-082 të vitit 2012 botuar në fletorën zyrtare nr.19 datë 13.07.2012.

¹¹⁵ Shih vendimin nr.821 datë 25.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

dëmtuara ka deklaruar gjatë hetimeve paraprake se e ka kryer marrëdhënien seksuale me dëshirën e saj dhe ky fakt provohet dhe nga pohimi i të pandehurit B.Gj.

Ndonëse marrëdhënia seksuale është kryer me dëshirën e shtetases E.S kryerja e “Marrëdhënieve seksuale me fëmijë të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale dënohet nga legjislacioni ynë penal dhe pikërisht neni 100 paragrafi i parë i Kodit Penal, ku sipas këtij neni “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur që nuk ka arritur moshën 14 vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale dënohet me burgim nga 7(shtatë) gjer në 15(pesëmbëdhjetë) vjet”. Përsa më sipër gjykata krijon bindjen se i pandehuri B.Gj ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur” parashikuar nga neni 100 paragrafi i parë i Kodit Penal...”.

2.1.2 Momenti i konsumimit

Kryerja e marrëdhënies seksuale, si veprim që përbën veprë penale është një fakt njerëzor, i cili në aspektin e shtrirjes kohore ka fillimin dhe fundin e saj.¹¹⁶ Çështja e përcaktimit të kohës së kryerjes së figurës së veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” ka rëndësi të posaçme praktike për një sërë institutesh.¹¹⁷

Përcaktimi i momentit në të cilin kjo figurë e veprës penale konsiderohet e konsumuar paraqet rëndësi të veçantë për të bërë dallimin e fazave të përgatitjes, tentativës dhe kryerjes, për përcaktimin e kompetencës territoriale, për aplikimin e normave penale në bazë të veprimit në kohë të ligjit penal, për afatet e parashkrimit në veprat penale të qëndrueshme dhe të vazhdueshme¹¹⁸.

Kjo veprë penale mund të konsiderohet e kryer kur ajo ka prekur marrëdhënie juridike të rëndësishme të mbrojtura në mënyrë të posaçme nga ligji¹¹⁹. Në doktrinë ka tre teori për përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale, të cilat janë: -teoria e veprimit, e cila i referohet momentit në të cilën subjekti ka shfaqur veprimin kriminal apo momenti kur personi ka ndërmarrë veprimin apo mosveprimin; -teoria e pasojës, e cila i referohet momentit në të cilën ka ardhur pasoja; -teoria mikse, e cila konsideron si kohë të kryerjes së veprës penale si kohën e ndërmarrjes së veprimit apo mosveprimit ashtu dhe kohën e ardhjes së pasojës, duke iu referuar dispozitave më të favorshme për autorin e veprës penale. Sipas një mendimi mbizotërues në doktrinë vepra është e kryer kur me veprimin ose mosveprimin e saj janë realizuar të gjitha tiparet e veprës penale¹²⁰. Ndërsa koha e kryerjes së saj apo koha e realizimit të tipareve objektive dhe subjektive përcaktohet në bazë të teorisë së veprimit duke mos i dhënë asnjë rëndësi kohës se kur ka ardhur pasoja.

Në të drejtën penale shqiptare nuk ka asnjë dispozitë, e cila në mënyrë të shprehur përcakton qartë dhe saktë kohën e kryerjes së veprës penale në dallim nga

¹¹⁶Mantovani, Diritto penale, Parte generale, 2001, fq. 443. Sipas këtij autori, vepra penale siç do gjë tjetër njerëzore lind, jeton dhe vdes. Kështu, nëse do të konsideroj dinamika e ecurisë së saj, ajo që realisht shfaqet në botën e jashtme, realizohet duke kaluar në një sërë fazash, që përbëjnë edhe iter crimins.

¹¹⁷ Shih Dorina Hoxha “Ndikimi i elementit kohë në veprës penale” , botimet Jozef 2015, fq 18.

¹¹⁸ Po aty

¹¹⁹ Shih Skënder Kaçupi, Fazat e kryerjes së veprës penale, Disertacion, 1990, fq. 63.

¹²⁰ Shih Villado Kambovski, E drejta penale. Pjesa e përgjithshme, Furkan, 2010, fq. 346.

disa të drejta të tjera të cilat e parashikojnë shprehimisht duke evituar dilema të ndryshme¹²¹.

Për të përcaktuar qartë kohën e kryerjes së veprës penale duhet të bëhet dallimi dhe të përcaktohet faza që në doktrinën e huaj njihet gjerësisht dhe me të drejtë si konsumimi i veprës penale.

Konsumimi apo vepra penale e përfunduar shpreh realizimin e të gjithë elementëve përbërës, objektivë dhe subjektivë të veprës penale: me fjalë të tjera, ecuria kohore e veprës penale dhe e elementëve të saj shfaqet në kohë dhe konsiderohet e konsumuar, kur përkon me figurën konkrete të parashikuar në pjesën e posaçme¹²². Pra, vepra penale do të quhet e konsumuar kur veprimi apo mosveprimi i kundërligjshëm, shoqërisht i rrezikshëm dhe me faj përkon tërësisht me llojin e figurës së veprës penale të parashikuar nga ligjvënësi¹²³. Me fjalë të tjera, kjo fazë përbën edhe fazën përfundimtare të veprës penale¹²⁴.

Mbi këtë arsytim të pranuar nga doktrina e huaj, e konsoliduar, me konsumim të veprës penale duhet të kuptohet “Përqasja e plotë e sjelljes së personit me figurën e parashikuar shprehimisht në ligj si vepër penale¹²⁵, duke pranuar (ato që ndodhin post factum i d.m.th pas kësaj) vetëm ato pasoja juridike të njohura dhe të parashikuar shprehimisht nga ligji dhe në çdo rast duke mos pranuar asnjë fazë plotësuese të *iter criminis*, tej momentit ku realizohet plotësisht figura e veprës penale. Pra, duhet të përcaktohen qartë ato elementë të parëndësishëm si idejimi, përgatitja dhe ato që janë determinante në përcaktimin e përgjegjësisë penale¹²⁶.

Një pjesë e konsiderueshme e doktrinës konsideron të pamjaftueshëm faktin që të merret parasysh një kriter i vetëm konsumativ, pasi nuk është në gjendje të justifikojë momente të ndryshme, në të cilat ka ndodhur plotësisht vepra penale dhe mënyra e zhvillimit të elementëve të veprave penale të ndryshme dallon nga një vepër penale tek tjera. Prandaj, edhe doktrina gjermane ka bërë një dallim mes konsumimit formal (Vollendung) dhe atij material (Beendigung). Kështu për shembull, në rastin e sëmundjeve profesionale shfaqja e qelizës së parë vdekjeprurëse paraqet vetëm konsumimin formal të dëmtimit, ndërsa pjekuria e plotë e sëmundjes do të çonte në konsumimin material. Në logjikën e kësaj ndarje, në doktrinën italiane¹²⁷ dallohen dy faza mes tyre të përsosmërisë dhe të konsumimit. Konsumimi ndodh kur vepra penale arrin në pasojat më të rënda të mundshme (Beendigung). Kështu që përsosmëria ka të bëjë me ekzistencën e veprës penale, konsumimi me përfundimin e saj duke mbyllur *iter criminis* dhe duke hapur fazën e *post factum*. Përsosmëria dhe konsumimi i veprës penale janë dy faza, të cilat nuk mund të analizohen gjithmonë të ndara mes tyre pasi ato edhe mund të përputhen në një vepër penale. Në fakt, përsosmëria dhe konsumimi mund të përputhen (p.sh. në plagosjen e rëndë vetëm me një të shtënë të

¹²¹Në të drejtën penale të Kosovës, Kodi Penal parashikon në nenin 9 se vepra penale konsiderohet e kryer në kohën kur personi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë, pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja. Dispozitë kjo shumë domethënëse, për të mënjeluar çdo parashikim të ndryshëm mes praktikës dhe doktrinës.

¹²² Shih Fiandaca-Musco, Diritto penale, Parte generale, fq. 333.

¹²³ Shih Antolisei, Manuale di diritto penale, Parte generale, fq. 231.

¹²⁴ Shih Fiandaca-Musco, Diritto penale, Parte generale, fq. 405.

¹²⁵ Shih Dorina Hoxha “Ndikimi i elementit kohë në veprës penale”, botimet Jozef 2015, fq. 18.

¹²⁶ Shih Kodi Penal shqiptar në asnjë rast nuk i referohet fazës së konsumimit të veprës penale, siç ndodh në të drejtën italiane ku afati i parashkrimit fillon jo nga koha e kryerjes së veprës penale por nga ajo e konsumimit³². Por trajtimi i kësaj faze mendoj se ka rëndësi praktike për ta dalluar nga fazat e tjera të *iter criminis*. Edhe pse Kodi Penal shqiptar në asnjë rast nuk i referohet fazës së konsumimit të veprës penale, ajo ka një rëndësi dhe ka marrë një profil të veçantë edhe në praktikën gjyqësore.

¹²⁷ Shih Mantovani, Diritto penale, Parte generale, fq. 444.

armës së zjarrit), por jo gjithmonë “si në rastin e veprës penale të plagosjes nga shumë të shtëna me armë zjarri, ku vepra penale përsoset me një të shtënë por që konsumohet me të shtënën e fundit¹²⁸.”

Pra, siç rezulton figura veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” konsiderohet e konsumuar në momentin kur realizohet në të gjithë elementët përbërës, objektivë dhe subjektivë të veprës penale, duke u kondicionuar nga natyra e kësaj vepre penale, nëse ajo është formale, materiale, e qëndrueshme, vazhduese.

Doktrina e të drejtës penale duke marrë në konsideratë faktin nëse pasoja kriminale ka rëndësi cilësuese duke kondicionuar ekzistencën e figurës së veprës penale, këto të fundit, ndahen në materiale dhe formale¹²⁹.

Me figurë formale të veprës penale kuptohen ato figura, për ekzistencën e të cilave nuk është e domosdoshme ardhja e pasojave shoqërisht të rrezikshme, por mjafton vetëm kryerja e veprimit ose mosveprimit që vepra të konsiderohet e konsumuar (kryer) ¹³⁰. Këto janë vepra të rrezikimit abstrakt, për një pasojë të supozuar, tek të cilat vijnë pasoja. Por ato janë të natyrës juridike, pra është vetë ligji që me kryerjen e veprimit ose mosveprimit e konsideron të cënuar marrëdhënien juridike të vendosur për të mbrojtur të mira juridike të caktuara, p.sh. dinjitetin e personit, paprekshmërinë seksuale etj. ¹³¹ Këto vepra konsiderohen si vepra të veprimit.

Ndërsa, me vepra penale materiale kuptohen ato, të cilat quhen të konsumuara kur kanë shkaktuar pasojën e caktuar me ligj ¹³². Këto njihen edhe si “vepra të pasojës”. Që të quhet e kryer, pasoja, në këto lloj figurash përfshin vetëm ato ndryshime të objektit të veprimit, që përfshihen në përsëkrimin ligjor të veprës, dhe jo çdo pasojë që mund të vijë nga veprimet ose mosveprimet e personit ¹³³.

Përsa më sipër, theksojmë se figura e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” është vepër penale formale, sepse për ekzistencën e të cilave nuk është e domosdoshme ardhja e pasojave shoqërisht të rrezikshme. Për efekt të konsumimit të kësaj vepre mjafton kryerja e aktit seksual.

Gjithashtu, kjo figurë e veprës penale është vepër penale e qëndrueshme. Nëse një figurë është permanente ose jo, kjo varet nga natyra e saj e cila rezulton nga interpretimi i normës juridike që e parashikon atë. Me vepra penale të qëndrueshme kuptohen ato që çënojnë marrëdhënien juridiko-penale për një kohë të caktuar në mënyrë të pandërprerë, dmth. që qëndrojnë në gjëndje latente ¹³⁴. Në këtë lloj vepre penale pasojat dhe konsumimi apo kryerja e veprës penale vijnë ngadalë, zgjasin për një periudhë të caktuar kohe. ¹³⁵ Në veprën penale të qëndrueshme veprimi dhe pasoja paraqiten si një e tërë, e dëshiruar nga subjekti për të zgjatur në kohë veprimin e kundërligjshëm. Struktura e veprës penale të qëndrueshme është për natyrën juridike

¹²⁸ Shih Pagliaro, Principi di diritto penale. Parte generale, Milano, 1998, fq. 491.

¹²⁹I cit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.14, dt. 17 Prill 2007.

¹³⁰Shih “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i Gjykatës së Lartë të RPSSH dhe Universiteti i Tiranës, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, f. 83.

¹³¹Kuptohet se nëse nuk do të vinte asnjë lloj pasoje nuk do të kishim vepër penale.

¹³²Vep. e cit. I. Elezi dhe të tjerë, “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë, 2006, f. 54.

¹³³Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 173.

¹³⁴Shih Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i përditësuar, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007; fq 113.

¹³⁵ Shih Mantovani, Ibidem, fq. 445.

të kësaj veprë penale e vetme dhe nuk është e mundur që të ndahet në disa vepra penale, duke qënë një i vetëm objekti juridik i cënuar gjatë kohës së cënimit nga veprimi apo mosveprimi, në mënyrë të tillë që bëjnë që rastet e shuarjes së dënimit dhe institucione të tjera të veprojnë në momentin kur ka përfunduar gjendja e kundërligjshmërisë¹³⁶. Dy janë elementët përbërës: a) cënimi i marrëdhënies juridiko-penale nga veprimi i autorit të ketë karakter të vazhdueshëm, që nuk konsumohet në moment, por që zgjat në kohë; b) cënimi i marrëdhënies juridiko-penale bëhet nga një veprim i qëndrueshëm dhe i vullnetshëm i autorit, për të cilën ai në kushtet që ndodhet mund të pushojë cënimin e marrëdhënies juridiko-penale. Nga këto dy elementë vepra penale e qëndrueshme mund të kryhet në dy faza: -faza e kryerjes së veprimit - faza e mbajtjes së kësaj gjendjeje të kundërligjshme, që zgjat në kohë. Gjatë kryerjes së aktit seksual cënimi i marrëdhënies juridike-penale ka karakter të vazhdueshëm dhe veprimi është i qëndrueshëm.

Pyetja që lind është: Për efekt të aplikimit të përgjegjësisë penale, kur do të konsiderohet e konsumuar marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale? A konsiderohet e konsumuar kjo figurë nëse subjekti aktiv ka filluar penetrimin, por akti nuk ka vazhduar për shkaqe të pavaruara, ose të varuara nga vullneti i tij?

Karakter i formal dhe i qëndrueshëm i kësaj figure të veprës penale i japin karakter të ndërlikuar përcaktimit të momentit të konsumimit të saj. Në veprën penale të qëndrueshme përsosmëria arrihet, jo në momentin që cënohet objekti juridik, por në momentin që realizohet minimumi i nevojshëm të mbajtjes së veprimit, i nevojshëm për ekzistencën e veprës penale. Përsosmëria e veprës penale ndodh kur ekzistojnë të gjithë elementët objektivë dhe subjektivë të parashikuar nga figura e veprës penale, në përmbajtjen më minimale. Kryerja e veprës penale është kur është ndërmarrë veprimi apo shfaqet në botën e jashtme sjellja e personit, edhe pse pasoja juridike vjen më vonë. Pra, figura e veprës penale “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” konsiderohet e konsumuar në momentin që realizohet minimumi i nevojshëm të mbajtjes së veprimit, i nevojshëm për ekzistencën e veprës penale. Mjafton që akti seksual të fillojë që vepra të konsiderohet e konsumuar.

Kodi jonë Penal, nuk parashikon në mënyrë eksplicite momentin e konsumimit të kësaj figure të veprës penale. Ndërsa në kodet e disa vendeve të tjera, për shembull ai i Kosovës, moment i konsumimit rezulton nga përkufizimi që bëjnë për termin “marrëdhënie seksuale. Siç theksuam më sipër, Kodi Penal i Kosovës e përcakton marrëdhënien seksuale penetrimit sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrimit sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit.

Si përfundim themi se vepra konsiderohet e konsumuar në momentin që ndodh një penetrimit sado i vogël, ose një fillesë e aktit seksual.

Marrëdhëniet seksuale më një të mitur që nuk ka arritur moshën 14 vjeç ose pjekurinë seksuale formojnë krim të kryer edhe kur nuk kanë sjellë si pasojë prishjen e membranës së virgjërisë, por mjafton të jetë konsumuar akti seksual¹³⁷. Marrëdhënia seksuale konsiderohet e konsumuar edhe nëse ka ardhur ose jo pasoja e deflorimit, mjafton që autori të ketë bërë bashkimin seksual.

Duke zbatuar ato që u theksuan më sipër arrihet të bëhet një përcaktim i drejtë i fazave të veprimtarisë kriminale në krimin e marrëdhënies seksuale e sidomos dallimi ndërmjet veprimeve përgatitore nga tentativa.

¹³⁶ Shih Dorina Hoxha “Ndikimi i elementit kohë në veprës penale”, botimet Jozef 2015, fq.134.

¹³⁷ Shih Ismet Elezi “E drejta Penale (Pjesa e posacme)”, Tiranë 2009 , fq.117.

Vepra penale, në karakterin e saj dinamik, përbëhet nga disa faza të cilat zhvillohen në kohë dhe përbëjnë atë që quhet *iter criminis*¹³⁸.

Përgatitja apo veprimet përgatitore konsistojnë në krijimin e kushteve për të kryer veprën penale, furnizimin ose gjetjen e mjeteve për kryerjen e veprës penale, mënjanimin e pengesave që paraqesin vështirësi për kryerjen e veprës penale, në arritjen e marrëveshjes, planifikimin apo organizimin me të tjerët me qëllim për të kryer veprën penale. Kjo është fazë e dytë në vazhden e kryerjes së veprës penale, e cila nuk është e domosdoshme të shprehet në çdo rast dhe sipas definicionit të mësipërm mund të shprehet në mënyra të ndryshme. Kjo fazë lehtëson kryerjen e veprës penale, i paraprin kryerjes së veprës penale dhe nuk është e dënueshme, por vetëm në raste të veçanta kur vetë ligji e parashikon si figurë konkrete të veprës penale. Përgatitja ekziston si për vepra penale materiale ashtu dhe formale.

Përgatitja për të kryer marrëdhënie seksuale nënkupton krijimin e kushteve të përshtatshme për kryerjen e krimit, si sigurimi i një dhome të veçuar, nxjerrja e të dëmtuarës jashtë qytetit, ose në një vend ku nuk ka njerëz, gjetja e narkotikëve për t'ia dhënë të dëmtuarës etj.

Faza që i paraprin përgatitjes, konsiderohet idejimi ose mendimi i sjelljes së vendimit për të kryer veprën penale¹³⁹, që zhvillohet në psikikën e autorit të kryerjes së veprës penale, e cila përmban një ose disa mundësi, se si do ta kryejë veprën penale, pasojat që mund të vijnë prej saj deri në vendimin përfundimtar të realizimit të tyre. Kjo fazë nuk është e dënueshme vetëm për faktin që personi ka vendosur të kryejë veprën penale. Ideja, lindja e mendimit dhe shfaqja e tij, vendimi, dëshira ose vullneti për të kryer veprën penale nuk hyn në sferën e të drejtës penale. Përndryshe, nëse do të lejohej që personi të ndëshkohej për dëshirën që ka për të kryer aktin seksual, apo për vendimin për ta kryer atë, atëherë e drejta penale do të njëssohej me moralin. Vendimi apo dëshira për të kryer veprën penale nuk duhet të ndëshkohet, pasi ato nuk shkaktojnë pasojat të dëmshme, nuk mund t'i dëmtojnë apo rrezikojnë të mirat e mbrojtura me të drejtën penale, përderisa ato nuk manifestohen në botën e jashtme¹⁴⁰. Kjo fazë ekziston vetëm në veprat penale të kryera me dashje.

Tentativë quhet veprimi i drejtpërdrejtë i personit për kryerjen e veprës penale, por vepra ndërpritet nuk përfundon për shkaqe të pavarura nga vullneti i personit¹⁴¹. Tentativa parashikohet si fazë paraprake vetëm për krime jo për kundërvajtje penale¹⁴². Tentativa ekziston vetëm për krimet e kryera me dashje direkte duke u nisur nga vetë tipari i përkufizimit të saj, që konsiston në veprim të drejtpërdrejtë. Në përcaktimin e përgjegjësisë penale tek tentativa analizohen dy kritere të rëndësishme siç janë, shkalla e afërsisë së ardhjes së pasojës dhe shkaqet për të cilat krimi mbeti në tentativë¹⁴³.

Tentativa dallon edhe nga përgatitja si faza të ndryshme paraprake¹⁴⁴. Tentativa dallon dhe nga vepra penale e plotë¹⁴⁵. Dallimi midis përgatitjes dhe

¹³⁸ Shih Dorina Hoxha "Ndikimi i elementit kohë në veprën penale", botimet Jozef 2015, fq.19.

¹³⁹ Shih Vllado Kambovski, E drejta penale. Pjesa e Përgjithshme, 2010, fq. 337.

¹⁴⁰ Shih Ismet Salihu, E drejta penale. Pjesa e Përgjithshme, 2010, fq. 338.

¹⁴¹ Neni 22-24 i Kodit Penal parashikon institutin e tentativës. Përkatesisht këto nene japin kuptimin e tentativës, përgjegjësinë për tentativën dhe heqjen dorë nga kryerja e veprës penale.

¹⁴² Neni 23 i Kodit Penal parashikon që: "Personi që tenton të kryejë një krim do të përgjigjet për të nisur nga kjo dispozite përgjegjësia penale për tentativën nuk ekziston kur kryhet një kundërvajtje.

¹⁴³ Neni 23, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

¹⁴⁴ Dallimi midis përgatitjes dhe tentativës qëndron në këto drejtime: a) Në vendin që zënë në procesin e anës objektive të veprës penale, përgatitja paraprin tentativën; b) Në mundësinë e ardhjes së pasojës kriminale, ku tek tentativa mund të vijë edhe ndonjë pasojë jo e dëshiruar nga subjekti; c) Në

tentativës qëndron në këto drejtime¹⁴⁶: a) në vendin që zënë në procesin e anës objektive të veprës penale, përgatitja paraprind të tentativës; b) në mundësinë e ardhjes së pasojës kriminale, ku tek tentativa mund të vijë edhe ndonjë pasojë jo e dëshiruar nga subjekti; c) në dënueshmërinë e tyre nga ligji penal; d) në anën subjektive; dh) në institutin e heqjes dorë; e) cënimi i marrëdhënies juridiko-penale.

Tentativa për të kryer marrëdhënie seksuale shprehet në kryerjen e veprimeve të drejtuara¹⁴⁷ direkt në realizimin e krimit si psh, kapja dhe shtrirja në tokë e së dëmtuarës si dhe çdo veprim tjetër i drejtuar direkt për kryerjen e marrëdhënies seksuale. Ky qëndrim është mbajtur edhe në vendimin nr.537, datë 28.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin theksohet se: “...Pas kësaj, e ka kthyer përmbys mbi kashtën ku ishin dhe ka dashur të kryejë plotësisht aktin seksual, gjë që nuk arriti ta kryente se në këtë kohë në haur hyri H.P, që ka deklaruar se i pa të dy personat, doli jashtë, e pas pak doli nga aty duke qarë edhe i dëmtuari.

Gjatë hetimeve paraprake e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, i gjykuari ka mohuar të ketë kryer veprën për të cilën është akuzuar dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me veprën e turpshme. Gjykatat kanë analizuar gjerësisht provat e administruara, deklaratimet e dëshmitë e personave që kanë patur dijeni për ngjarjen e aktet e tjera dhe kanë arritur në përfundimin se i gjykuari ka konsumuar veprën penale të marrëdhënies homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç, parashikuar nga neni 101/2 i K.Penal, mbetur në tentative (dhe jo për veprë të kryer plotësisht, siç është akuzuar e ka pretenduar në vazhdimësi organi i prokurorisë),

Në arritjen e përfundimeve të tyre, gjykatat kanë analizuar, krahas provave të tjera, proces verbalin e kqyrjes së personit datë 08.06.2006, ku eksperti mjeko-ligjor ka konstatuar dëmtime në bark e në këmbë të të dëmtuarit, konkluzionet në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.124, datë 06.06.2006, ku përshkruhen dëmtimet dhe theksohet se në anus i dëmtuari nuk ka dëmtime, si dhe aktin e ekspertimit biologjik të objekteve (teshave të të dëmtuarit) N-4606, datë 25.08.2006, ku janë konstatuar njolla gjaku e sperme...”. Megjithatë, në rastin konkret nuk janë sqaruar disa aspekte si prania e spermës në rrobat e të dëmtuarit, apo qëndrimi i shtetasit H.P pasi ka konstatuar të dy personat në haur. Prania e materialit biologjik spermë në rrobat e të dëmtuarit tregon që i gjykuari e ka realizuar epshin seksual. Mungesa e dëmtimeve në anus nuk duhet të anashkalojë provën e mësipërme. Gjithashtu, duke patur në vëmendje faktin që kjo figurë e veprës penale është e qëndrueshme, sipas përcaktimit të mësipërm për konsumimin e saj, ajo duhet të konsiderohet e konsumuar nëse është realizuar në përmbajtjen më minimale dhe jo plotësisht për shkak të pavarura nga ai.

Në vendimin¹⁴⁸ nr.122, datë 23.08.1966 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁴⁹ mbajti qëndrimin se bashkimi seksual konsiderohet i mbetur në fazën e tentativës kur autori mundohet të kapë të dëmtuarën, por nuk realizon qëllimin për shkak se kjo e fundit largohet. Gjykata arsyeton se: “Vepra kriminale e kryer nga i gjykuari nuk ka elementët e fyerjes, por të bashkimit seksual me dhunë. I gjykuari mbasi i ka propozuar të dëmtuarës për tu bashkuar seksualisht dhe nga ajo ka marrë përgjigje negative , i është vërsulur për të mposhtur vullnetin e saj me anë të dhunës, por ai nuk

dënueshmërinë e tyre nga ligji penal; d) Në anën subjektive; dh) Në institutin e heqjes dorë; e) Cënimi i marrëdhënies juridiko-penale.

¹⁴⁵Në veprën penale të plotë ka ardhur pasoja e dëshiruar.

¹⁴⁶ Shih Dorina Hoxha “Ndikimi i elementit kohë në veprën penale”, botimet Jozef 2015, fq.19.

¹⁴⁷ Shih vendimin nr.537, datë 28.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

¹⁴⁸ Në vendimin nr.122, datë 23.08.1966 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

¹⁴⁹ Gjatë këtij punimi në do të trajtojmë edhe praktikën e Gjykatës së Lartë për vitet 1945-1990 , sepse për shkak të ligjit material të ngjashëm, në kufijtë e njejtë, ajo paraqet një vlerë të shtuar për studimin.

ia ka arritur qëllimit se ka gjetur rezistencë të vendosur nga e dëmtuara e cila është larguar me vrap. Nuk ka qënë fjala vetëm për një propozim për bashkim seksual, por i gjykuari duke përdor forcën është përpjekur të imponojë vullnetin e tij me dhunë” .

Krimi i marrëdhënies seksuale me dhunë quhet i konsumuar kur autori ka arritur të bëjë bashkimin seksual me të dëmtuarin/ën, pavarësisht nëse është arritur deflorimi. Këtë qëndrim ka mbajtur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁵⁰ në vendimin e datës 13.12.1980 dhe e ka arsytuar si më poshte: “*Është vertetuar se i pandehuri e ka njohur të dëmtuarën në qytetin e Korçës. Ai e ka takuar atë disa herë gjatë viteve 1979-1980 dhe ka kërkuar që ajo të shkojë me të, por e dëmtuara nuk ka pranuar. Më datë 28.09.1980, i pandehuri përsëri e ka ndaluar në rrugë të dëmtuarën, i ka shfaqur asaj ndjenjat e dashurisë dhe ka kërkuar që të shkojë me të. E dëmtuara fillimisht nuk ka pranuar, por pas kërcënimit që i ka bërë ai, ajo ka shkuar me të. Pasi kanë dalë në kodrat e qytetit, i pandehuri kërkon që të kryejë aktin seksual, por e dëmtuara nuk ka pranuar. Atëherë i pandehuri ka përdorur dhunën e ka goditur atë disa herë me pëllëmbë, e ka shtrirë në tokë, i ka hequr veshjen e brendshme dhe me gjithë kundërshtimet e të dëmtuarës ka kryer aktin seksual. Gjykata me të drejtë ka pranuar se krimi i marrëdhënies seksuale me dhunë parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 97 është konsumuar, pavarësisht se e dëmtuara nuk ka arritur në deflorim. Që krimi i marrëdhënies seksuale me dhunë të quhet i kryer plotësisht mjafton që autori të këtë bërë bashkimin seksual me të dëmtuarën pavarësisht nëse ka ardhur ose jo pasojë të tilla siç janë deflorimi etj.”*

Gjykata e Lartë në vendimin e datës 24.04.1974¹⁵¹ ka mbajtur qëndrimin se kur tentativa për të kryer marrëdhënie seksuale me dhunë bëhet në dëm të një femre që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, vepra duhet cilësuar sipas paragrafit të dytë të nenit 160 të Kodit Penal. Këtë qëndrim e arsyeton se: “*Gjykatës i vihet në dukje si e metë se ajo ka pranuar akuzën kundër të gjykuarve për marrëdhënie seksuale me dhunë në dëm të dëmtuarës në bazë të paragrafit të dytë të nenit 160/2 të Kodit Penal, pa patur hetime të plota në këtë drejtim.*

Nga materialet e çështjes del që kjo e dëmtuar është e datëlindjes 1960, dmth në kohën e kryerjes së krimin nuk kishte mbushur moshën 14 vjeç. Gjykatës në këto rrethana i binte barrë të verifikonte këtë fakt dhe ta dërgonte për ekspertim gjinekologjik. Nëse ekspertimi do të vertetonte se ajo nuk ka arritur pjekurinë seksuale dhe se veç kësaj këtë e tregon edhe paraqitja e saj, gjykata ishte e detyruar që të bënte cilësimin ligjor të veprës nga paragrafi 2 i nenit 160 i Kodit Penal në paragrafin 2 të nenit 161 të Kodit Penal”.

2.1.3 Rrethanat me rëndësi cilësimi ligjor.

Krimi i “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” kryhet në rrethana cilësuese kur:

- a) Marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale janë kryer me dhunë. Një nga elementet që karakterizon figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, është se pavarësisht vullnetit reciprok, qoftë edhe nëse shoqërohet me afeksion të dyanshëm, të subjekteve që kryejnë marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale, kjo figurë konsiderohet e konsumuar, sepse fëmija i mitur, në këtë moshë, nuk e ka arritur atë zhvillim

¹⁵⁰ Shih vendimin e datës 13.12.1980 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Revista Drejtësia Popollore e nr.3,1980.

¹⁵¹ Shih vendimin e datës 24.04.1974 të Gjykatës së Lartë.

të përgjithshëm, në të cilin të kuptojë karakterin e veprimit dhe pasojat e saj, si dhe mund të kryejë normalisht marrëdhënie seksuale pa pasojë të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin normal seksual. Madje në rastet e ndodhjes së këtyre marrëdhënieve nuk i kushtohet rëndësi këtij elementi për efekt të aplikimit të përgjegjesisë penale, por është rrethanë që ndikon në caktimin e masës së dënimit. Prandaj, termi “pëlqim” nënkupton pajtim i vullnetshëm i personit, i cili ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç, ose pjekurinë seksuale për të kryer aktin seksual. Nuk ekziston pëlqimi nëse personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë; pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës; pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin; ose personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera.

Në kuptimin e dhunës futen para së gjithash dhuna fizike, e cila mund të shprehet në rrahje, goditje, plagosje e lehtë, plagosje e rëndë, shtytjes, lidhje etj. Lidhur me termin dhunë, Pleniumi i Gjykatës së Lartë në udhëzimin nr.1 datë,14.03.1979¹⁵² ka vlerësuar se: “*Rrahja, plagosja, heqja e lirisë, kapja për flokësh, shtrija në tokë, çdo përdorim tjetër i forcës fizike kundër të dëmtuarës për ta vënë atë në pamundësi që të kundërshtojë bashkimin seksual përbën dhunë fizikë*”.

Dhuna fizike, në çdo formë që të shfaqet, përdoret për të mposhtur kundërshtimin e të dëmtuarës për të thyer çdo qëndresë nga ana e saj. Dhuna përdoret sepse ka kundërshtim nga e dëmtuara. Ky është një element, i cili është mbajtur në vëmendje nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁵³, i cili thekson se: “*...I gjykuari, duke përfutuar nga marrëdhëniet familjare që kishin me njëri tjetrin, ka shkuar në banesë në dhomën e gjumit ku ndodhej e shtrirë e dëmtuara dhe aty ai ka mbyllur derën e dhomës dhe ka shkuar në krevatin ku ndodhej e shtrirë K. dhe duke përdorur forcën fizike e ka zhveshur atë, si dhe është zhveshur dhe vetë dhe pasi e ka qëlluar me grushta ka kryer marrëdhënie seksuale me të. Sipas të dëmtuarës, ajo e ka kundërshtuar duke bërë titur dhe vepruar me duar, por për shkak të fizikut të të gjykuarit nuk e ka ndaluar dot veprimin e tij. Pas këtij veprimi i gjykuari është larguar nga banesa, kurse e dëmtuara duke thënë se ishte e sëmure nuk është ngritur nga krevati dhe nuk ka treguar se çfarë i kishte ndodhur.*

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se në sjelljen e të gjykuarit, gjenden të konsumuar të katër këta elementë të figurës së veprës penale.

Kështu Kolegji vlerëson se në veprimet e të gjykuarit rezulton elementi “anë objektive” e figurës së veprës penale të “Marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të mitur”.

Në këto rrethana, me të drejtë Gjykata e Apelit Vlorë ka vlerësuar se nuk qëndron përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë se i gjykuari ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale, sipas paragrafit të parë të kësaj figure, por sipas paragrafit të dytë të nenit për të cilën është akuzuar nga organi i hetimit, pra nenit 100/2 i K.Penal...”.

¹⁵² Shih udhëzimin nr.1, datë 14.03.1979 të Pleniumit të Gjykatës së Lartë

¹⁵³ Shih vendimin nr.249, datë 03.10.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Pyetja që ngrihet në këtë rast është: Cili është kualifikimi ligjor nëse dhuna që perdoret nuk është rezultat i kundërshtimit nga ana e të dëmtuarës, por është në funksion të kënaqjes së epshit seksual?

Në përgjigjen e kësaj pyetje duhet të merret në konsideratë qëllimi i përdorimit të dhunës. Kështu, nëse ajo perdoret për të mposhtur kundërshtimin e të dëmtuarës për të thyer çdo qëndresë nga ana e saj është e qartë se kualifikimi do të bëhet sipas paragrafit të dytë të nenit 100 të Kodit Penal. Ndërsa, nëse ajo përbën një “teknikë” për kryerjen e marrëdhënies atëherë kualifikimi do të jetë sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e datës 04.10.1980¹⁵⁴ arsyeton se : *“I pandehuri për të hyrë në marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën e ka kapur atë, i ka vënë dorën në gojë që të mos dëgjohej e qara e saj, pastaj e ka kapur nga mesi me dorën tjetër dhe e ka rrëzuar në tokë dhe është shtrirë mbi trupin e saj dhe ka tentuar të kryejë marrëdhënie seksuale. Pra, siç shihet të gjitha këto veprime të pandehurit janë veprime dhunë..”*. Prandaj krimi i kryer duhet të cilësohet si marrëdhënie seksuale më dhunë”.

Nëse është përdorur dhunë apo jo për të kryer marrëdhënie seksuale, kjo është çështje fakti që zgjidhet në çdo rast konkret. Rëndësi të madhe paraqet akti i ekspertimit mjeko-ligjor. Ky i fundit është prova kryesore mbi bazën e të cilës gjykata formon bindjen e brendshme. Kështu, në vendimin nr.148, datë 30.05.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁵⁵ thekson se: *“Ky Kolegj vlerëson gjithashtu se edhe nga plotësimet e aktit të ekspertimit, të bëra nga njëri prej ekspertëve që kanë firmosur aktin fillestar, nuk rezulton që të jenë nxjerrë konkluzione që mbështesin akuzën. Sipas aktit të ekspertimit “...ka mungesë të shenjave të ushtrimit të dhunës në trupin e personit të dëmtuar, mungesë të shenjave të tjera të kryerjes së aktit seksual, si dhe mospërputhje të tjera...”*. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se *ekzistenca e provave dhe e dëshmimeve që ndodhen në dosjen hetimore dhe atë gjyqësore çojnë në përfundimin se pretendimet e prokurorisë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet nuk arritën të provohen në asnjë moment në mënyrë të plotë, të qartë dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshem e për rrjedhojë asnjë prej shkaqeve të paraqitura në rekurs prej Prokurorisë nuk e bëjnë të cënueshëm vendimin nr.622 datë 07.07.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë...”*.

Në vendimin nr.12, datë 31.03.1959, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁵⁶ ka mbajtur qëndimin se në bashkimet seksuale me personat që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale dhe kur janë të mitur, dhuna duhet të provohet. Kështu, ai arsyeton se: *“...nga të gjitha provat e administruara nuk rezulton se i gjykuari ka tentuar të çnderojë vajzën e mitur. I gjykuari gjatë hetimit ka pohuar se ai ka dashur të bashkohet seksualisht me të dëmtuarën, por ka ngelur në fazën e tentativës pasi u diktua nga nëna e vajzës. I gjykuari nga gjykatat më të ulta është dënuar sipas paragrafit të dytë të nenit 161 të kodit penal. Një vendim i tillë është i pabazuar. Gjykatat më të ulta në mënyrë të gabuar kanë arsyetuar se kryerja e aktit seksual me një person të mitur qoftë edhe pa dhunë duhet të konsiderohet si vepër e kryer me dhunë. Neni 161 i kodit penal në të dy paragrafet ka parasysh marrëdhënie seksuale me person që nuk kanë arritur*

¹⁵⁴ Shih vendimin e datës 04.10.1980 të Kolegjit të Gjykatës së Lartë, publikuar në Revistën Drejtësia Popullore, viti 1980.

¹⁵⁵ Shih vendimin nr.148, datë 30.05.2012 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

¹⁵⁶ Shih vendimin nr.12, datë 31.03.1959 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

pjekurinë seksuale pavarësisht nëse janë fëmijë të vegjël ose të mëdhenj. Në paragrafin e parë ky nen parashikon veprën e kryer pa dhunë ndërsa në paragrafin e dytë ai parashikon veprën e kryer me dhunë psikike ose fizike. Nga provat e administruara nuk rezulton të jetë përdorur dhunë fizike ose psikike. Moshë shumë e vogël e të dëmtuarës mund t'i vlejë gjykatës në caktimin e masës së dënimit dhe jo për ndryshim të kualifikimit ligjor...”

Elementi dhunë determinon cilësimin ligjor të veprës penale nga paragrafi i parë i nenit 100 të Kodit, në paragrafin e dytë të tij. Këtë element ka vlerësuar edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁵⁷, i cili thekson se: *Nga tërësia e provave të administruara në gjykim u provua se i pandehuri E.B ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet...nga deklaratimet e bëra nga shtetasja K. C. provohet se midis të pandehurit E.B dhe shtetasës K.C. ka ekzistuar një lidhje afektive; i pandehuri E.B ka kryer marrëdhënie seksuale me shtetasen K. C. në mënyrë të përsëritur deri në datën 03.09.2010; e dëmtuara K.C. është larguar nga banesa e saj për të shkuar për të bashkëjetuar me shtetasin E.B në Belgjikë, aty ku jetonte dhe punonte i pandehuri; i pandehuri E. B ka kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën K.C, në banesën e prindërve të saj, në datën 31.08.2010 kur kanë qëndruar në hotel në qytetin e Shkodrës; i pandehuri dhe e dëmtuara K.C kanë kaluar kufirin e Republikës së Shqipërisë jashtë pikës shtetërore për kalimin e kufirit. Gjithashtu, nga analiza në tërësi e provave të përshkruara rezulton se, marrëdhënia seksuale është kryer me dëshirën e të dëmtuarës si dhe në rrethanat kur e dëmtuara K.C ka arritur pjekurinë seksuale...i pandehuri E.B me veprimet e tij të kundraligjshme, duke kryer marrëdhënie seksuale me të miturën K.C, e datëlindjes 20/09/1996, pra nën 14 vjeç, duke konsumuar tërësisht elementët e figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale me të mitur” të parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal dhe për kryerjen e kësaj vepre penale i pandehuri E.B është fajtor dhe duhet të dënohet...”.*

Në kuptimin e dhunës futet si dhuna fizike edhe ajo psikike. Një nga format e dhunës psikike është kanosja, e cila në këtë rast shërben si mjet për kryerjen e krimit të marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale. Edhe në këtë rast kanosja duhet të plotësojë elementët e përcaktuara në nenin 84 të Kodit Penal. Kanosja mund t'i bëhet drejtpërdrejt të dëmtuarit për veten e tij ose për personat e tjerë. Në kuptimin e kanosjes nuk futet propozimi për t'u bashkuar seksualisht, ose shprehja e dashurisë apo e simpatisë. Kryerja e marrëdhënieve seksuale do të konsiderohet e kryer me dhunë edhe kur ato janë kryer duke përfutur nga pazotësia e së dëmtuarës për t'u mbrojtur. Me pazotësi për t'u mbrojtur kuptojmë një gjendje të tillë, në të cilën e dëmtuara objektivist e ka humbur ndërgjegjen e nuk ka mundësi të mbrohet dhe subjekti i krimit këtë gjendje e shfrytëzon për të kryer marrëdhënie seksuale. Kjo gjendje mund të jetë krijuar objektivist pa ndërhyrjen e autorit të krimit, por shfrytëzohet prej tij për të kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën, psh kur ajo është e sëmure, në gjumë etj. Pazotësia e të dëmtuarës për t'u mbrojtur mund të shkaktohet edhe nga vetë autori i veprës penale në mënyra të ndryshme, me anë të dehjes, me anë të përdorimit të narkotikëve etj. Për efekt të kualifikimit ligjor të veprës penale nuk ka rëndësi nëse pazotësia e së dëmtuarës është shkaktuar

¹⁵⁷ Shih vendimin nr.15, datë 04.02. 2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

objektivisht apo nga autori i krimit. Kjo rrethanë vlen të mbahet parasysht në caktimin e masës së dënimit nga gjykata.

Krimi i marrëdhënieve seksuale me persona që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç ose pjekurinë seksuale konkuron me krimet e tjera, siç është krimi i shpërdorimit të detyrës. Në rast se një mësues kryen marrëdhënie seksuale me një person që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç duke shpërdoruar detyrën ai do të përgjigjet penalisht për të dy krime për shpërdorimin e detyrës dhe për marrëdhënie seksuale me dhunë.

Në udhëzimin e Plenumit të Gjykatës së Lartë¹⁵⁸ parashikohet se: *“Në krimin e marrëdhënieve seksuale me dhunë nuk janë rrethana që ndikojnë në zbutjen e vendimit as dëshira për t’u martuar me viktimën, as moshja e vogël dhe as shtesa shoqërore: “pretendimi i këtij të fundit për tu zbatuar në favorin e tij neni 44 i kodit penal nuk është i bazuar. Fakti që i gjykuari ka deklaruar në gjyq se e dashuronte të dëmtuarën dhe se ishte gati të martohej me të nuk mund të justifikojë uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji. Është provuar se i gjykuari asnjëherë më parë nuk i ka shfaqur dashurinë të dëmtuarës. Ai i ka thënë të dëmtuarës se “ti je e imja sot” dhe në kundërshtim me vullnetin e saj ka tentuar të bashkohet seksualisht me të. Moshja e tij e re dhe shtesa e varfër nuk mund të konsiderohen rrethana të jashtëzakonshme”.*

Mungesa e shenjave të dhunës fizike nuk duhet të interpretohet si pëlqim nga ana e të miturit. Në vendimin nr.170, datë 08.10.1966 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁵⁹ ka arsyetuar se: *“Bashkimi seksual i kryer me dhunë kur autori i ka lidhur vetëm duart të dëmtuarës pavarësisht se në trupin e të dëmtuarës nuk konstatohen shenja dhune, leziona e të tjerë. Në këtë vendim gjykata thekson se : “ I gjykuari nuk ka përdorur dhunë ndaj të dëmtuarës përderisa në trupin e saj nuk janë konstatuar shenja dhune, qofshin këto edhe të vogla, gjykata më e ulët nuk ka pasur parasysht se përdorimi i dhunës nuk shoqërohet kurdoherë me leziona në trupin e të dëmtuarës, prandaj moskonstatimi i gërvishtjeve ose i shenjave të tjera në trupin e të dëmtuarës nuk mund të konsiderohen si provë që të vërtetojë së kundër saj nuk është përdorur dhunë. Në qoftë se e dëmtuara është bashkuar seksualisht me dëshirë me të gjykuarin atëherë nuk ka pasur arsye pse ai ta lidhte atë pikërisht në kohën kur do të kryente bashkimin seksual me të”.*

- b) Marrëdhëniet seksuale janë kryer në bashkëpunim. Kështu, ato janë kryer në bashkëpunim kur dy ose më shumë persona në marrëveshje midis tyre kryejnë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën. Për të patur këtë rrethanë duhet që dy ose më shumë persona të kryejnë marrëdhënie seksuale ose edhe sikur njëri prej tyre të kryejë marrëdhënien seksuale, kurse bashkëpunëtorët e tjerë mposhtin kundërshtimin e së dëmtuarës.

Në vendimin e datës 30.05.1975, Gjykata e Lartë¹⁶⁰, ka theksuar se kur vepra penale, marrëdhënia seksuale me dhunë, është kryer në bashkëpunim cilësohet sipas paragrafit të dytë të nenit 160/2 të Kodit Penal. Këtë e arsyeton si më poshtë: *“ është vërtetuar se më datë 07.07.1975 të gjykuarit kanë parë të dy të dëmtuarat duke ecur rrugës përpara tyre dhe kanë vendosur të kryejnë*

¹⁵⁸ Shih udhëzimin nr.183, datë 20.09.1966 Plenumi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Penal

¹⁵⁹ Shih vendimin nr.170, datë 08.10.1966 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

¹⁶⁰ Shih vendimin e datës 30.05.1975, Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Revista Drejtësia Popullore viti 1975.

marrëdhënie seksuale më dhunë me to. Megjithatë gjykata e ka cilësuar gabim veprën e tyre. Përderisa ajo është kryer në bashkëpunim duhej që të gjykuar të përgjigjeshin sipas paragrafit të 2 të nenit 160 të Kodit Penal dhe jo sipas paragrafit të parë.”

- c) Kanë shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin e të dëmtuarës. Kjo është çështje fakti dhe zgjidhet në çdo rast konkret nga gjykata, mbi bazën e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor. Si pasojë e rëndë për shëndetin mund të konsiderohet hemorragjia e madhe, infektimi me ndonjë sëmundje ngjitëse, një traumë psikike etj. Për të përcaktuar konceptin e pasojave të rënda për shëndetin mund t’i referohemi konceptit të plagosjes së rëndë, e cila parashikohet në nenin 88 të Kodit Penal, në të cilin përshkruhen rastet se kur dëmtimi i shëndetit konsiderohet i rëndë.
- d) Kanë sjellë si pasojë vetëvrasjen ose vdekjen e të dëmtuarës. Vdekja dhe vetëvrasja duhet të kenë lidhje shkaksore të drejtpërdrejtë me marrëdhëniet seksuale të kryera me dhunë. Kjo rrethanë cilësuese i jep kësaj figure natyrën e figurës së përbërë të veprës penale. Në mungesë të përcaktimeve të bëra nga Kodi Penal për veprën penale të përbërë, doktrina e së drejtës penale dhe jurisprudenca¹⁶¹ kanë bërë përpjekjet e tyre për të dhënë përkufizimin. Vepër penale e përbërë konsiderohen ato vepra që kryhen me anë të dy, ose me shumë veprimeve ose mosveprimeve dhe që secili prej tyre mund të përmbajë elementët e një figure të veprës penale të posaçme¹⁶². Bëhet fjalë për një unitet që ligji penal i bën dy ose më shumë figurave të veprës penale, në një figurë unike. Për rrjedhojë, figura e përbërë, ka si element përbërës të saj ose si rrethanë cilësuese, jo disa, por të gjithë elementët përbërës të figurave të tjera¹⁶³ që ajo i bashkon¹⁶⁴. Rasti kur elementët e dy ose më shumë figurave bashkohen (shkrihen) dhe përbëjnë një figurë të veprës penale, është për shembull figura e “vjedhjes me pasojë vdekjen”¹⁶⁵. Ndërsa në raste të tjera, figura të posaçme sanksionohen si rrethanë cilësuese e një figure tjetër. Kështu, vrasja e personit me dashje (neni 76) ose nga pakujdesia (neni 85), që parashikohen si figurë të posaçme krimi, përbëjnë rrethanë cilësuese të figurës “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”¹⁶⁶ (paragrafi i tretë i nenit 100), kur shkaktimi i vdekjes së të miturës ka ardhur si rrjedhojë e kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të.

¹⁶¹Jurisprudenca ka reflektuar përcaktimet e bëra nga doktrina e së drejtës, pasqyrë e kësaj është edhe vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 6, datë. 30.09. 2011, në të cilin vlerëson se: “Për të krijuar një tablo më të qartë se çfarë përfaqëson në vetvete vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K. Penal, është e domosdoshme që t’i referohemi doktrinës juridike në vite, e cila e ka përkufizuar atë si një vepër penale të përbërë nga dy vepra penale, që janë vepra penale e vjedhjes dhe vepra penale e vrasjes së personit, të cilat në kushtet e zakonshme qëndrojnë si vepra penale më vete, e para e parashikuar nga neni 134 e vijues i K.Penal dhe tjetra e parashikuar nga neni 76 e vijues i K. Penal”.

¹⁶²Shih Ismet Elezi, dhe të tjerë “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë, 2006, f. 53.

¹⁶³Elementët e figurës tjetër e humbasin autonominë e tyre dhe bëhen element përbërës ose rrethanë rënduese e figurës së përbërë.

¹⁶⁴Për më tepër shih artikullin e Alessandro Amaolo “Il reato complesso di cui all’art. 84 codice penale”, në adresën e internetit <http://www.overlex.com/leggiarticolo.asp?id=1957>, akses në dt. 04 Maj 2013.

¹⁶⁵Sipas nenit 141 të K.Penal, “vjedhja e pasurisë, kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga ...”

¹⁶⁶Sipas paragrafit të tretë të nenit 100 të K.Penal: “kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet ...”

Pra, që një figurë e veprës penale të konsiderohet e përbërë duhet të plotësohen në mënyrë komulative disa kushte si:

- a. Dispozita që parashikon veprën penale duhet të përshkruajë dy ose më shumë veprime ose mosveprime në kuptimin natyror¹⁶⁷. Vetëm ligji mund të sanksionojë figura të përbëra të veprës penale dhe të përcaktojë një dënim të vetëm për to.
- b. Të çënohen njëkohësisht dy ose më shumë marrëdhënie juridike të vendosura dhe të mbrojtura nga legjislacioni penal. Vepra penale e përbërë është gjithashtu vepër penale me dy, ose më shumë objekte.
- c. Veprimet ose mosveprimet që plotësojnë elementët e dy ose më shumë figurave të ndryshme, duhet të kryhen brenda një kohe të shkurtër dhe në funksion të njëra tjetrës, në kuptimin që veprimi kriminal i cili paraprin, shoqëron ose pason veprimin tjetër, është i domosdoshëm dhe shërben si mjet për kryerjen e tij¹⁶⁸. Pra, ekziston një lidhje organike dhe kohore ndërmjet tyre¹⁶⁹. Kështu, nëse një person në një moment kohe kryen marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur dhe me kalimin e një kohe të caktuar, pasi ka kryer marrëdhënien, e vret të dëmtuarin për arsye të ndryshme, jo në funksion të realizimit të marrëdhënies seksuale. Në këto kushte, personi ka konsumuar elementët e dy figurave të veprës penale, atë të “marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe të “vrasjes”, sipas konceptit të konkurrimit real ndërmjet tyre.

Uniteti i veprimit në kuptimi juridik duhet të dallohet nga uniteti i veprimit në kuptimin natyror. Ky i fundit ekziston kur më tepër veprime rezultojnë nga një proces i vetëm psikologjik, kur në mes tyre ekziston lidhshmëri natyrore kohore dhe hapësinore, si dhe mund të vlerësohen si një veprim i vetëm për shkak se shprehin qëndrim të vetëm të kryerësit dhe janë të drejtuara drejt qëllimit të vetëm.

Përshkrimi ligjor i veprës penale të përbërë përfshin dy veprime të ndryshme, që bashkë përbëjnë veprimin e kryerjes së veprës. Në varësi të kësaj, doktrina e së drejtës penale i ndan në dy lloje veprat penale të përbëra; veprat penale të përbëra të drejta dhe jo të drejta^{170,171}, ose po të përdorim terminologjinë e teorisë dhe praktikës gjyqësore italiane, vepra penale e përbërë në kuptimin e ngushtë (për të “drejtën”) dhe kuptimin e gjerë (jo e drejtë)¹⁷². Figura e përbërë e veprës penale, është e drejtë kur secili nga veprimet që përshkruan norma juridike penale, përmban elementët e një figurë të posaçme. Ndërsa, figura të përbëra jo të drejta, konsiderohen ato vepra të cilat vetëm njëra prej dy apo më shumë veprave është parashikuar si vepër e posaçme penale¹⁷³.

¹⁶⁷Për kuptimin e veprimit ose të mosveprimit në kuptimin natyror shiko më sipër gjatë këtij punimi, kur kemi trajtuar në mënyrë të detajuar kuptimin e veprimit dhe mosveprimit si element të figurës së veprës penale.

¹⁶⁸Shih Grigor Gjika “Bashkim krimesh dhe dënimesh”, Drejtësia Popullore, nr. 3, viti 1963, f. 27.

¹⁶⁹Shih Ismet Salihu “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i ripunuar, Botimet “Fama 2008”, Prishtinë, 2008, f. 363.

¹⁷⁰Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 172.

¹⁷¹Shih gjithashtu, Ismet Salihu “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i ripunuar, Botimet “Fama 2008”, Prishtinë, 2008, f. 364.

¹⁷²Për më tepër shih artikullin e avokat Alessandro Amaolo “Il reato complesso di cui all’art. 84 codice penale”, në adresën e internetit <http://www.overlex.com/leggiarticolo.asp?id=1957>, akses në dt. 04.05.2013.

¹⁷³Shih Ismet Salihu “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i ripunuar, Botimet “Fama 2008”, Prishtinë, 2008, f. 364.

Pra, kur një veprim edhe i vetëm përbën vepër penale, ndërsa veprimi tjetër nëse nuk shoqërohet nga ai, nuk është i tillë (vepër penale). Kështu, kryerja e marrëdhënieve seksuale me të rritur nuk përbën vepër penale, nëse nuk shoqërohet edhe me përdorimin e dhunës. Ndërsa kjo e fundit përbën vepër penale, edhe nëse kryhet më vete (rrahje ose vepra të tjera dhune).

Kështu, figura e veprës penale e marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale me të mitur me pasojë vdekjen është veper penale e përbërë e drejtë, sepse kryerja e marrëdhënieve me të mitur përbën vepër penale edhe nëse nuk shoqërohet me vdekjen e viktimës, ndërsa vdekja përbën vepër penale edhe nëse kryhet më vetë.

Lidhur me këtë rrethanë cilësuese rëndësi të veçantë merr qëndrimi psikik i subjektit aktiv lidhur me vdekjen e të miturit. Disa autorë mbajnë qëndrimin se pasojat si vdekja, apo vetëvrasja e të miturit në çdo rast vijnë nga pakujdesia¹⁷⁴, duke e trajtuar si vepër me dy forma faji¹⁷⁵. Megjithatë një qëndrim i tillë nuk është konsistent, sepse në këtë figurë të veprës penale dallojmë qëndrimin psikik që subjekti aktiv ka ndaj aktit seksual dhe ndaj pasojës së ardhur, vdekja, vetëvrasja, apo dëmtimi i rëndë i shëndetit. Një formë e tillë e qëndrimit psikik në doktrinën e së drejtës konsiderohet si forma e ndërlikuar e fajit.

Me formë të ndërlikuar faji duhet kuptuar qëndrimi psikik i ndryshëm i subjektit kundrejt pasojave shoqërisht të rrezikshme të afërta dhe të largëta. Ka disa vepra (veprime ose mosveprime) që kanë jo vetëm pasoja shoqërisht të rrezikshme të afërta, por edhe pasoja shoqërisht të rrezikshme të largëta. Në këtë formë faji personi parashikon se me veprimin e tij, do të vijë domosdoshmërisht ardhja e pasojës së afërt dhe vepron me dashje të drejtpërdrejtë për ardhjen e saj. Por, në vend të saj, vjen një pasojë tjetër, pasoja më e largët, të cilën ai nuk e ka dashur.

Që të jemi përpara formës së ndërlikuar të fajit, duhet që personi veprimet e tij t'i kryejë me dashje të drejtpërdrejtë, pra të dëshirojë ardhjen e pasojës së afërt aktin seksual. Ndërsa, pasoja e largët, ardhja e vdekjes të të miturit, vjen nga pakujdesia. Autori nuk e dëshiron ardhjen e saj, por ai e parashikon, ose nga tërësia e rrethanave ai duhet të parashikojë se mund të vijë edhe vdekja e të miturit. Por, nuk është e lehtë të ndahet nëse autori në këtë figurë, në lidhje me pasojën e largët, vepron me dashje indirekte, pasi e parashikon pasojën dhe me ndërjegje lejon ardhjen e saj, apo me pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar, pasi autori e parashikon dhe është i bindur se pasoja e largët vdekja e viktimës nuk do të vijë. Në fakt është e vështirë të pranohet se një person

¹⁷⁴ Shih Ismet Elezi "E drejta penale, pjesa e posaçme" Tiranë 2013, fq.116.

¹⁷⁵Në teorinë e të drejtës penale, njihen dhe trajtohen edhe ato të ashtuquajturat figura me dy forma faji. Me to kuptohen ato figura të cilat lejojnë qëndrime të ndryshme psikike të personit ndaj veprimit ose mosveprimit që kryen, ku veprimi kryhet me dashje, kurse pasojat vijnë vetëm nga pakujdesia. Si shembull tipik i kësaj figure merret "shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" (neni 290), ku shkelja e rregullave kryhet me dashje, ndërsa pasojat vijnë nga pakujdesia. Në mendimin tonë, përcaktimi i kësaj lloj figure nuk bazohet në ndonjë kriter të qartë. Në fakt, në shembullin që morëm më sipër jemi përpara rastit klasik të kryerjes së veprës me pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar. Në çdo rast që personi vepron në formën e vetëbesimit të tepruar, ai veprimet i kryen me dashje ndërsa pasojat vijnë nga pakujdesia. Për këtë arsye, arrijmë në konkluzionin se një dallim i tillë i figurës së veprës penale, nuk është i bazuar dhe për më tepër përveç vlerave teorike nuk ka ndonjë rëndësi për praktikën gjyqësore.

mund të ketë bindje që pasoja (vdekja e personit) nuk do të vijë, nëse kryen veprime të dhunshme për të kryer aktin seksual. Kështu theksojmë se nëse vdekja e të miturit shkaktohet me dashje, qoftë para, pas, apo gjatë aktit seksual, ose homoseksuale kualifikimi ligjor do të jetë vrasje e të miturit dhe marrëdhënie seksuale, apo seksuale me të mitur. Pyetja që lind në këtë rast është: Cili do të jetë kualifikimi ligjor në këto raste për figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”. A do të bëhet sipas paragrafit të parë, të dytë apo të tretë?

Mendojmë se kualifikimi ligjor do të bëhet sipas paragrafit të parë të nenit 100 të Kodit Penal, meqë pasoja e ardhur nuk plotëson elementët e paragrafit të tretë, por të një figure më vetë siç është ajo e vrasjes.

- e) Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet më shumë se një herë. Termi më shumë se një herë, nënkupton përsëritje, por nuk duhet të trajtohen si njëjtësi, sepse në kuptimin penal-juridik ato kanë diferenca të theksuara me njëra tjetrën. Termi “përsëritje” nënkupton kryerjen e veprës penale nga një person që ka kryer më parë një vepër tjetër penale, ndërsa autori konsiderohet përsëritës, “recidivist”.

Gjithashtu nocioni juridiko-penal i përsëritjes është i përafërt me nocionin e bashkimit të veprave penale, por me dallime formale ndërmjet tyre. Kjo i përgjigjet konceptit subjektiv për përsëritjen që e potencon rrezikun e subjektivit aktiv e gjitha kjo përballë konceptit objektiv për të cilën përsëritja sillet në kryerjen përsëri të veprës penale me gjykimin e mëparshëm për veprën e bërë¹⁷⁶.

Ndryshe nga Kodi Penal në fuqi, në Kodin Penal të vitit 1977, përsëritja parashikohej si rrethanë rënduese¹⁷⁷. Termi “përsëritje” është interpretuar edhe nga Gjykata e Lartë, në vendimin e saj unifikues nr.284, datë. 06.10.2000¹⁷⁸, në të cilin theksohet se: *“Sipas Kodit Penal të mësipërm (neni 31, germa “a” e Kodit Penal të vitit 1977) me përsëritje kuptoheshin rastet e kryerjes nga personi më parë të një ose më shumë veprave penale, qofshin këto të njëllojta apo të llojeve të ndryshme, pavarësisht se ai kishte qenë ose jo i dënuar më parë dhe kur kjo (përsëritja) nuk ishte element përbërës i veprës penale. Në këtë rast, kur dispozita përkatëse nuk e parashikonte përsëritjen si element përbërës të figurës së krimit, vepra cilësohej si e kryer në rrethana rënduese, ndërsa kur dispozita penale e parashikonte përsëritjen si rrethanë cilësuese, nuk zbatoheshin rrethanat rënduese.”*

Vepra e re mund të jetë e njëjtë, ose e ngjashme me veprën për të cilën autori më parë ka qenë i dënuar, ose çdo vepër tjetër. Pavarësisht se mund të bëhet fjalë për vepër me paramendim, ose për vepër nga pakujdesia, më e lehtë ose më e rëndë, vepër përgatitore e dënuar, tentativë ose vepër e kryer. Nuk ka rëndësi forma e pjesëmarrjes së autorit në kryerjen e veprës penale, nxitës, ekzekutor, bashkëpunëtor.¹⁷⁹

Doktrina e të drejtës penale e ndan përsëritjen në dy lloje, përsëritje e përgjithshme ose gjenerike dhe përsëritje e veçantë ose specifike. Me

¹⁷⁶Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 513.

¹⁷⁷ Shih nenin 31/a të Kodit Penal, miratuar nga Kuvendi Popullor më 15.06.1977 dhe hyrë në fuqi më 01.10.1977.

¹⁷⁸ Shih vendimin unifikues nr.284, datë 06.10.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁷⁹Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, fq.515.

përsëritje të përgjithshme kuptohen rastet kur autori ka kryer edhe më parë një a më shumë vepra penale, pavarësisht nga lloji, natyra apo forma e fajësisë së tyre dhe pavarësisht nëse është dënuar ose jo më parë për ndonjërin prej këtyre veprave, me kusht që as dënimi dhe as ndjekja penale të mos jenë parashkuar. Ndërsa, me përsëritje të veçantë kuptohen rastet kur autori ka kryer më parë një, ose disa vepra penale të të njëjtit lloj ose karakter, të kryera me dashje dhe të jetë dënuar të paktën për njërin prej tyre. Dallimi ndërmjet përsëritjes së përgjithshme dhe përsëritjes së veçantë ka rëndësi për përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të personit dhe për individualizimin e dënimit të tij, pasi, si rregull, përsëritësit specifik paraqesin rrezikshmëri shoqërore më të madhe se përsëritësit gjenerik¹⁸⁰.

Në Kodin Penal në fuqi bëhet dallimi ndërmjet termit “më shumë se një herë”, i cili nënkupton rastin kur personit ka kryer disa vepra penale dhe që për asnjërin prej tyre nuk është gjykuar dhe dënuar me vendim të formës së prerë, dhe termit “përsëritës”, që nënkupton rastin kur personi që kryen veprën penale pasi ka qenë dënuar më parë me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një tjetër veprë penale. Situata e parë përkufizohet si “*kryerja e veprës penale më shumë se një herë*” dhe parashikohet si rrethanë rënduese¹⁸¹. Situata e dytë parashikohet si rrethanë rënduese, duke u përkufizuar si: “*kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë*”¹⁸².

Shprehja “*kryerja e veprës më shumë se një herë*”, nënkupton kryerjen disa herë të figurës së përgjithshme, përfshirë format e cilësuar të saj, dhe jo kryerjen disa herë të figurave të ndryshme. Në literaturën juridike janë shfaqur mendime që në pikën “h” të shtohet togfjalëshi “ose kryerja e disa veprave penale”¹⁸³. Në fakt, nisur nga formulimi i ligjit, nga fakti që çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, si dhe nga parimi që “ligji penal duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtuar”¹⁸⁴ (*stricto sensu*) duhet të pranojmë se bëhet fjalë vetëm për rastin kur personi kryhen disa herë të njëjtën figurë të përgjithshme të veprës penale ose forma të cilësuar të saj. Një mendim i tillë është i vlefshëm vetëm në kuadër të rrethanave rënduese, dhe jo rrethanës cilësuese si element përbërës, i figurave konkrete të veprave penale, si p.sh. në figurat “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur, e kryer më shumë se një herë” (neni 100/2) etj. Në këto raste, kryerja e veprës më shumë se një herë duke qenë element përbërës i figurës konkrete, nuk mund të merret parasysh nga gjykata edhe si rrethanë rënduese. Nga interpretimi i këtyre dispozitave kuptohet që bëhet fjalë për kryerjen më shumë se një herë të figurës që parashikohet nga paragrafi i parë i nenit përkatës, dhe jo kryerja më shumë se një herë e figurave të cilësuar, që sanksionohet nga nene të

¹⁸⁰Shih Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i përditësuar, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007, f. 300.

¹⁸¹ Shih nenin 50/h të Kodit Penal

¹⁸² Shih nenin 50/ç të Kodit Penal

¹⁸³Shih Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i përditësuar, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007, f. 304.

¹⁸⁴Kjo është rrjedhojë e parimit të ligjshmërisë në të drejtën penale dhe e prezumimit të pafajësisë. Në legjislacione të tjera parashikohet shprehimisht, si p.sh. Kodi Penal Francez në nenin 111-4 të tij sanksionon se: “*legjislacioni penal duhet të interpretohet ngushtë*”. Shih versionin në anglisht, në adresën e internetit

http://www.legifrance.gouv.fr/content/download/1957/13715/.../Code_33.pdf%E2%80%8E, akses në datë 25 Mars 2013.

ndryshme. Për shembull, nuk mund të konsiderohet në rrethanë cilësuese si më shumë se një herë, kur autori kryen marrëdhënie seksuale me të mitur (neni 100) dhe pas disa kohësh, përsëri ai kryen marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (103).

Lidhur me kushtetutshmërinë e parashikimit të kryerjes së veprës më shumë se një herë, si rrethanë cilësuese e figurës së veprës penale, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.8, dt. 5 Mars 2005¹⁸⁵, vlerëson se: “...duke përdorur si metodë interpretimin e dispozitave të Kodit Penal, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e këtyre dispozitave, arrin në përfundimin se togfjalëshi “më shumë se një herë” parashikuar në nenin 278/4 të Kodit Penal, nuk vjen në kundërshtim me parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtën veprë penale...Nëse ligjvënësi një nga rrethanat e mësipërme e pikërisht atë “më shumë se një herë” e ka parashikuar në disa raste edhe si element të veprës penale duke e bërë këtë të fundit të cilësuar, nuk do të thotë se ka përzier në të dhe rrethanat e tjera rënduese, që kanë të bëjnë me dënimin e mëparshëm. Përkundrazi ligjvënësi nuk ka përfshirë si element të veprës penale kryerjen e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë, për të mos cenuar parimin ne bis in idem.”

Për efekt të cilësimit ligjor të veprës penale, nuk ka rëndësi nëse figura e veprës penale të “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur” kryhet ndaj të njëjtit të mitur, ose të miturve të ndryshëm. Kështu, lidhur me këtë në vendimin nr.15, datë 18.01.2012 i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë¹⁸⁶ theksohet se“...Në bazë të kësaj rrethane si i gjykuari, ashtu edhe e dëmtuara, kishin njohje dhe e dëmtuara shpesh herë shkonte në shtëpinë e të gjykuarit ku luante me fëmijët e tij. Në mesin e muajit korrik, në një datë të papërcaktuar, i gjykuari M.P i ka propozuar të dëmtuarës A.P. të vinte në shtëpinë e tij ku do t'i thoshte diçka. E dëmtuara ka pranuar dhe ka shkuar në banesë ku ndodheshin dhe fëmijët e të gjykuarit. Në vazhdim të asaj dite, në mesdite mbasi fëmijët e të gjykuarit kanë rënë për të fjetur, i gjykuari e ka ftuar të dëmtuarën që të shkonin tek shtëpia e tij e vjetër e pabanuar e cila ndodhej disa metra më larg. Aty ai ka propozuar që ata të kishin marrëdhënie intime me njëri-tjetrin kundrejt shpërblimit prej 200 lekësh. I gjykuari e ka zhveshur të dëmtuarën dhe ka filluar ta prekë në pjesë të ndryshme të trupit. Mbasi ka kryer këto veprime i gjykuari i ka dhënë 200 lekë, duke i kërkuar të dëmtuarës të mos e bisedonte me njeri tjetër. Të nesërmen e asaj dite, i gjykuari ka përsëritur të njëjtat veprime duke e ftuar përsëri në banesë, ku e ka zhveshur dhe më pas e ka prekur dhe puthur në pjesë të ndryshme të trupit duke paguar me të njëjtën shumë.

Në mesin e muajit gusht në një datë të papërcaktuar, i gjykuari M.P e ka thirrur përsëri të dëmtuarën A.P. dhe mbasi kanë shkuar në banesën e tij të vjetër ka kryer marrëdhënie seksuale. I gjykuari e ka kërcënuar se nëse tregonte ai do ta rrihte. Në ditët në vazhdim i gjykuari ka kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën e mitur në shtëpinë e tij të vjetër. Në një rast, marrëdhënia seksuale është kryer dhe në një apartament banimi në një pallat afër shkollës së mesme të qytetit të Laçit.

I gjykuari në datë 01.11.2005, pas një shkëputje kohe i ka dërguar të dëmtuarës vajzën e tij M.P, ku i kërkonte që të takoheshin dhe nëse nuk vinte

¹⁸⁵ Shih vendimin nr.8, datë 05.03. 2005 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸⁶Shih vendimin nr. 8, dt. 5 Mars 2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

do e kishte punën keq. E dëmtuara ka shkuar dhe e ka takuar duke e kundërshtuar për takimet e tjera duke mos e takuar më. Ndërkohë në datë 02.11.2005 ka bërë kallëzim kundër të gjykuarit për marrëdhënien seksuale me të.

Organi i akuzës, në bazë të kallëzimit, ka filluar procedimin penal në ngarkim të të gjykuarit, ku gjatë hetimit janë kqyrur dhe marrë me cilësinë e provës dëshmitë direkte dhe indirekte të dëshmitarëve, deklaratimet e të dëmtuarës, proces-verbalet e kqyrjes dhe administrimit të provës të disa sendeve të cilat përmbajnë njolla të ngjashme me ato të gjakut, akti i ekspertimit mjeko-ligjor (gjinekologjik), akti i ekspertimit biologjik;

Prokuroria në përfundim të hetimit e ka akuzuar të gjykuarin M.P për veprën penale të “kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të mitur”, e parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal..”.

Rrethana cilësuese, kryerja e veprës penale më shumë se një herë duhet të dallohet nga vepra penale vazhduese. Interpretimi i kësaj dispozite i referohet rastit kur i pandehuri ka kryer të njëjtën vepër penale më shumë se njëherë dhe dënohet bashkërisht për to, dmth, kur nuk është dënuar më parë për asnjërin prej tyre. Këto vepra penale edhe pse janë të njëjlojta apo dhe mund të jenë kryer në vazhdimësi me njëra tjetrën, nuk kryhen me një qëllim kriminal të vetëm, apo mendim unik kriminal. Mungesa e këtij elementi bën që, për këto vepra të operojë instituti i bashkimit të veprave penale ose si shumë rrethana të tjera, kryerja e veprës penale më shumë se njëherë të parashikohet si rrethanë cilësuese e figurës së veprës penale ose si rrethane rënduese. Vepra penale vazhduese është e papajtueshme me rrethanën tjetër rënduese parashikuar nga neni 50 pika ç)- kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë, pasi mes këtyre dy instituteve ka një raport kontradiktor: njëra *favor rei* për veprën penale vazhduese që i referohet mendimit unik kriminal; tjetra ndëshkim më të rreptë për përsëritësit apo recidivistët¹⁸⁷. Kjo zgjidhje mbështetet në nevojën e qëllimit të dënimit penal, atë të parandalimit të përgjithshëm.¹⁸⁸ Me vepër penale vazhduese kuptohet atëherë kur personi, me dy ose më shumë veprime të njëjlojta kryen të njëjtën vepër penale. Këto vepra shoqërisht të rrezikshme që përbëhen nga dy ose më shumë veprime të njëjlojta konsideroheshin krime vazhduese¹⁸⁹. Sipas kësaj të drejte, veprimet e veçanta të kryera nga autori nuk formojnë krime më vete, por konsiderohen pjesë përbërëse e një figure të vetme krimi. Një dallim i tillë është vlerësuar dhe zbatuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë^{190,191}, e cila faktin tipik të kryerjes së marrëdhënieve seksuale me dëshirë rregullisht me njëri-tjetrin ndërmjet subjektit aktiv dhe të miturës, e ka trajtuar si vepër penale vazhduese dhe ka bërë kualifikimin ligjor sipas nenin 100/1 i Kodit Penal.

¹⁸⁷ Shih Dorina Hoxha “Ndikimi i elementit kohë në veprës penale”, botimet Jozef 2015, fq 84

¹⁸⁸ Shih, Ronco, M, Ardizzone S., Codice Penale ipertestuale, Commentario anca dati di giurisprudenza, Seconda edizione, Utet giuridica 2007, fq. 564.

¹⁸⁹ Çela, Elezi, Peza, Gjika, E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme III, fq. 44.

¹⁹⁰ Shih vendimin nr.2301, datë 24.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁹¹ Fakti tipik është: Nga hetimet e mëtejshme rezultoi se shtetasja V Sh, e dtl. 12.04.2002 është larguar nga banesa e saj në datë 25.12.2014. Kjo shtetase deklaroi se me shtetasin D R njihet prej rreth një viti dhe në datën 25.12.2014 ata janë takuar tek Kisha Ortodokse Tiranë e më pas kanë shkuar së bashku te shtëpia e D-së. Ai e ka prezantuar me familjaret e tij duke u thënë se ajo ishte “nusja” e tij. Pas pesë ditësh ato kanë rënë të flinin së bashku dhe kanë kryer marrëdhënie seksuale me dëshirën e tyre. Pas këtij momenti ata kanë kryer marrëdhënie seksuale rregullisht me njëri-tjetrin. Momenti i fundit që kanë kryer marrëdhënie seksuale ka qënë rreth orës 04.00 e datës 23.01.2015”.

Me vepër penale vazhduese do të kuptohet, kryerja ose moskryerja e dy a më shumë veprimeve kriminale të njëlojta, me qëllim që të zbatohet një mendim i vetëm kriminal i autorit të tyre dhe përbëjnë një vepër penale të vetme.

Nga ky definicion për veprën penale vazhduese mund të konkludojmë që, për ekzistencën e saj kërkohet plotësimi i tre kushteve: 1) Veprimet ose mosveprimet të mos qëndrojnë si akt më vete; 2) Veprimet ose mosveprimet të jenë të njëlojta; 3) Mendimi unik kriminal. Të tre kriteret përmbushen në rastin e sipërcituar.

Pyetja që lind në këtë rast është: Cili do të jetë kualifikimi ligjor nëse subjekti aktiv e arrin kënaqësinë seksuale duke detyruar fëmijët e mitur nën moshën 14 vjeç të kryejnë marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin teksa ai vështron?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje duhet të trajtojmë dy probleme juridike, të cilat janë: A mund të futet në konceptin e marrëdhënies seksuale arritja e kënaqësisë seksuale duke vështruar të tjerët teksa kryejnë marrëdhënie seksuale? Nëse po, a mund të konsiderohet në rrethana cilësuese më shumë se njëherë?

Kodi Penal, siç e theksuam më sipër nuk ka dhënë përkufizimin e marrëdhënies seksuale, ai ka dhënë një përcaktim të përgjithshëm si “kryerja e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale”.

Tendenca konservatore e doktrinës të së drejtës në Shqipëri, më përpara, e ka përcaktuar marrëdhënien seksuale si bashkimin seksual normal midis një mashkulli dhe një femre¹⁹². Megjithatë edhe doktrina e së drejtës penale në Shqipëri, ka përqafuar tendencat me karakter ndërkombëtar, të cilat e trajtojnë marrëdhënien seksuale ose aktin seksual si penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit. Gjithashtu, me marrëdhënie seksuale kuptohet jo vetëm bashkim formal të dy personave, të sekseve të ndryshëm apo të njëjtë por, edhe çdo lloj akti, i cili edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me kontaktin fizik direkt me subjektin pasiv (viktimën) ka për qëllim dhe është i përshtatshëm të vërë në rrezik të mirën parësore të individit, atë të lirisë seksuale, nëpërmjet eksitimit ose sadisfaksionit të instiktit seksual të personit abuzues. Shumë shtete në Kodet Penale të tyre kanë dhënë përkufizimin e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale. Kështu mund të përmendim Kodin Penal të Kosovës, i cili në nenin 228 parashikon se: *“Përkufizimet lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual, shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:*

... 2.Asgjë nga paragrafi 1, i këtij neni nuk duhet të interpretohet si kufizim i rrethanave në të cilat nuk ekziston pëlqimi.

3. Shprehja “akt seksual” nënkupton penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit.

4. Shprehja “detyrim i personit tjetër në kryerjen e aktit seksual” nënkupton kryerjen e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryesi ose cytja e personit tjetër në kryerjen e aktit seksual me kryesin apo me personin e tretë ose cytja e personit të tretë për kryerjen e aktit seksual në personin tjetër.

Me anë të këtyre përkufizimeve Kodi Penal i Kosovës, i jep një ndihmesë të madhe organeve të drejtësisë në kualifikimet e sakta ligjore.

¹⁹² Shih Ismet Elezi “E drejta Penale (Pjesa e posacme)”, Tiranë 2009 , fq.114.

Sipas trajtesave të mësipërme konsiderohet marrëdhënie seksuale edhe rasti kur persona të tjerë detyrohen për të kryer marrëdhënie seksuale me njeri-tjetrin. Një përcaktim i tillë është i saktë dhe në këtë optikë duhet të përqasin interpretimin e tyre edhe organet e drejtësisë shqiptare.

Ndërsa, lidhur me pjesën e dytë të pyetjes theksojmë se subjekti aktiv e ka konsumuar figurën e veprës penale dy herë, sepse në marrëdhënie janë përfshirë dy të mitur, dhe për secilin prej tyre plotësohen elementet e figurës së veprës penale. Në këtë rast nuk plotësohen kriteret e rrethanës “*kryerje e veprës më shumë se një herë*”. Kjo e fundit nënkupton kryerjen disa herë të figurës së përgjithshme, përfshirë format e cilësuar të saj, dhe është qartësisht e dallueshme nga rrethana “në dëm të disa personave”. Elementi kohë është kriteri dallues i këtyre rrethanave. Nëse vepra kryhet ndaj disa personave në një kohë relativisht të afërt, si dhe në koneksitet me njera tjetrën në anën objektive, atëherë ndodhemi përpara rrethanës “në dëm të disa personave”.

Në nenin 100 të Kodit Penal nuk është parashikuar rrethana cilësuese “në dëm të disa personave”. Në mungesë të një parashikimi të tillë kualifikimi ligjor bëhet aq herë sa është numri i personave.

Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe në vendimin e datës 14.08.1969 nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili thekson se : “*Gjykata në vendimin e saj pranon se i gjykuari ka kryer marrëdhënie seksuale me dy vajza që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale. Në këto kushte ai duhej të përgjigjej dy herë në bazë të nenit 161 të Kodi Penal për shkak se vetë dispozita e përmendur nuk përmban në vetvete përsëritjen*”.¹⁹³

2.1.4 Problematikat e shfaqura në praktikë lidhur me anën subjektive të kësaj figure të veprës penale.

Figura e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, e cila karakterizon edhe anën subjektive të saj. Me këtë të fundit kuptohet përmbajtja e brendshme e saj, qëndrimi psikik që mban personi, kundrejt veprës së kryer prej tij¹⁹⁴. Në dallim nga ana objektive, vlerësimi për ekzistencën e saj, nuk është një çështje fakti. Ajo zbulohet e qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm se iniciohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive¹⁹⁵. Një qasje e tillë është bërë edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr.284, datë 06.10.2000, në të cilin thekson se: “*pavarësisht se është “mendim” ai “lexohet” nëpërmjet veprimeve konkrete që kryen i pandehuri për realizimin e veprës penale*”¹⁹⁶. Në këtë linjë mendimi arsyeton edhe Kolegji Penal i kësaj gjykate, në vendimin nr. 289, datë 07.11.2012, ku shprehet se: “*Interpretimi i një elementi të ndërgjegjes së individit që kryen një vepër penale është sa e vështirë ashtu edhe e rëndësishme për përcaktimin e fajësisë nëpërmjet kualifikimit ligjor. Natyrisht ky perceptim për gjykatën nuk duhet*

¹⁹³ Shih Udhëzime të Pleniumit të Gjykatës së Lartë, vitet 1965-1970, faqe 117.

¹⁹⁴ Shih “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i Gjykatës së Lartë të RPSSH dhe Universiteti i Tiranës, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, f. 143.

¹⁹⁵ Shih Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007, f. 136.

¹⁹⁶ Shih vendimin unifikues nr. 284, datë 06.10. 2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

bërë mbi baza subjektive, por në bazë të “leximit” të veprimeve konkrete dhe të vlerësimit në harmoni të të gjitha provave dhe të konkluzionit që del prej tyre.”¹⁹⁷

Elementë të anës subjektive të figurës së veprës penale janë fajti, motivet dhe qëllimet. Fajti është një element përbërës i domosdoshëm për çdo figurë të veprës penale. Pa faj, nuk mund të ketë vepër penale dhe as dënim (Nullum crimen, nulla poena sine culpa). Ndërsa, motivet dhe qëllimet, janë element plotësues, jo të domosdoshëm për të gjitha figurat e veprës penale.

Dashja është një nga format e fajtit. Kuptimi i saj, jepet në nenin 15 të Kodit Penal, sipas të cilit: *“Vepra penale kryhet me dashje, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre ose, megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre”*.

Në teorinë e të drejtës penale, nisur nga ky përkufizim, dallojnë dy forma të paraqitjes së dashjes: dashja e drejtpërdrejtë apo direkte dhe dashja indirekte¹⁹⁸ ose eventuale. Dashja e drejtpërdrejtë karakterizohet nga fakti që **personi është i vetëdijshëm se me veprimin ose mosveprimin e vet kryen veprën penale, e parashikon dhe dëshiron ardhjen e pasojave të dëmshme**. Nga ky përcaktim dalin në dritë dy momente: ai intelektual, dhe ai që lidhet me vullnetin *“volitiv”*. Momenti intelektual nënkupton vetëdijen e personit për karakterin e veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm, si dhe, parashikimin e ardhjes së domosdoshme të pasojave të dëmshme. Momenti *volitiv* nënkupton dëshirën e fajtorit për ardhjen e pasojës së dëmshme. Subjekti aktiv i figurës së veprës penale të *“Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”*, subjekti aktiv është i vetëdijshëm për karakterin e veprimit, parashikon, si dhe dëshiron ardhjen e pasojës, kryerjen e marrëdhënies seksuale me të mitur.

Në princip theksojmë se dashja direkte, përbën qëndrimin psikik të autorit ndaj tërësisë së elementëve të figurës së veprës penale, përfshirë këtu edhe cilësitë e subjektit pasiv, të dëmtuarës/it. Kështu, subjekti aktiv është i vetëdijshëm për karakterin e aktit seksual, parashikon dhe dëshiron kryerjen e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale me të mitur nën moshën 14 vjeç, ose që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale.

Në teknikën e inkriminimit legjislatori në nenin 100 të Kodit Penal, nuk ka përcaktuar në mënyrë eksplicite qëndrimin psikik që duhet të ketë subjekti aktiv ndaj cilësive të veçanta të të dëmtuarës, moshës, ose pjekurisë seksuale të saj. Ky qëndrim nuk është i njëjtë me qëndrimin që ka mbajtur ai në teknikat e inkriminimit të disa figurave të tjera të veprave penale. Për shembull, në nenin 79 të Kodit Penal parashikohet se: *“Vrasja me dashje e kryer ...b) ndaj personit me mangësi fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura”*. Termi *“të dukshme dhe të njohura”*, do të ishte i përshtatshëm për të pasqyruar edhe cilësitë e të miturit të moshës dhe papjekurisë seksuale, sepse subjekti aktiv duhet të ketë vetëdije që po kryen marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur, duke e dëshiruar një gjë të tillë. Një vetëdije e tillë prezumohet nëse moshja, apo papjekuria seksuale është e dukshme, ose e njohur.

¹⁹⁷ Shih vendimin nr. 289, datë 07.11. 2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁹⁸ Me dashje indirekte ose eventuale kuptohet ajo formë e dashjes ku personi i parashikon pasojat e veprës penale, por nuk i dëshiron ato, por me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre. Edhe në dashjen indirekte dallohen dy momente, ai intelektual dhe *volitiv*. Momenti intelektual ka të bëjë me aftësinë e personit për të kuptuar se veprimet ose mosveprimet e tij përbëjnë vepër penale dhe parashikon se nga këto veprime ose mosveprime mund të vijnë pasoja të dëmshme. Ndërsa momenti *volitiv* karakterizohet nga fakti se personi nuk i dëshiron pasojat që mund të vijnë nga sjelljet e tij, por me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre.

Pyetja që lind është: A ka përgjegjësi penale nëse mungon dijenia e subjektit aktiv për moshën, ose mosarritjen e pjekurisë seksuale e të dëmtuarit/ës, duke patur një përfytyrim të gabuar për to, apo nëse mungon dijenia se një akt i tillë seksual është i dënueshëm?

Për t'iu përgjigjur në mënyrë të saktë kësaj pyetje, duhet të kemi një kuptim të qartë mbi institutin e lajthimit, ose gabimit në kryerjen e veprës penale.

Lajthimi ose gabimi është përfytyrim i gabuar i realitetit i autorit për rrethanat e caktuara faktike dhe për vetë veprën si ndodhi reale ose për vlerësimin e lejueshmërisë së veprës. Kështu, i tillë është rasti kur subjekti aktiv nuk e di se personi me të cilën kryen marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale është i mitur që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, ose nuk ka arritur pjekurinë seksuale, nuk e di se marrëdhënia me të mitur me persona nën 14 vjeç është e ndaluar, sepse mund të vijë nga një shtet ku parashikohet moshë më e re për ndalimin e këtyre veprave. Në rastin e parë në vetëdijen e tij janë gabimisht prezente rrethanat faktike të veprës, kështu ai mendon se po bën diçka, ndërsa në fakt bën diçka krejtësisht tjetër. Në rastin e dytë autori ka përfytyrim të saktë dhe ajo që mendon përputhet tërësisht me atë që bën, por gabimisht e vlerëson lejueshmërinë e saj, nuk e di se veprimi i tij është i palejuar, i ndaluar.¹⁹⁹ Lajthimi, sipas kriterit të strukturës së nocionit të veprës penale ndahet në tre lloje:

1. Lajthimi në fakt për figurën e veprës penale, me të cilën kuptojmë mosnjohjen ose perceptimin e gabuar të autorit për ndonjë element të anës objektive të veprës penale ose të ndonjë elementi tjetër që rrit dënueshmërinë e veprës penale. Pra, përcaktohet si mangësi në momentin intelektual të dashjes që ka të bëjë me rrethanat e parashikuara si tipare konstituive të veprës penale konkrete. I tillë është rasti kur autori nuk është i vetëdijshëm për një rrethanë e cila duhet të jetë pjesë e tiparit ligjor²⁰⁰. Lajthimi është pjesa negative e dashjes që përjashton komponentin intelektual të saj. Përfytyrimi i gabuar e mohon dashjen në tërësi, autori nuk mund të jetë i vetëdijshëm për disa rrethana dhe të ketë përfytyrim të gabuar për disa të tjera, domethënë përjashtohet ndonjë kombinim midis elementëve të vetëdijshëm dhe të pavetëdijshëm të dashjes, qoftë edhe dashje e pjesshme, komponentët intelektual të së cilës do të mbulonin vetëm disa tipare të figurës së veprës.²⁰¹

Lajthimi në fakt për figurën e veprës penale është përfytyrim i gabuar i autorit për ndonjë tipar ligjor të veprës penale. Vetëm një lajthim i tillë është relevant dhe gjithmonë e përjashton dashjen, kurse nëse është i pashmangshëm, edhe fajin në tërësi. Për cilat rrethana autori mund të ketë përfytyrim të gabuar, “vendos” figura objektive e veprës penale konkrete që duhet të jetë e përfshirë në komponentin intelektual të dashjes.

2. Lajthimi në fakt për rrethanat që përjashtojnë kundërligjshmërinë. Ai ekziston kur autori gabimisht ka menduar se ekzistojnë rrethana, të cilat

¹⁹⁹ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.294.

²⁰⁰ Po aty.

²⁰¹ Lajthimin në fakt lidhur me figurën e veprës penale e tangon edhe pajkudësinë tek figurat e veprës penale si anë subjektive kërkojnë pakujdesinë, përjashtimi i dashjes nuk do të thotë se automaikisht mund të konstatohet faji nga pakujdesia. Pakujdesia si formë e fajit duhet të plotësohet në të kriteret e saj.

po të ekzistonin me të vertetë, vepra do të ishte e lejuar (mbrojtja e nevojshme, ose nevoja ekstreme).

3. Lajthimi juridik, përcaktohet si mungesë e vetëdijës për ndalesën e veprës penale tek autori i saj. Kur autori ka përfytyrim të gabuar për atë që bën, kemi të bëjmë me lajthim në fakt, kurse për ndalesën e asaj që bën kemi të bëjmë me lajthim juridik. Ai e di se çfarë bën, por nuk e di që është e ndaluar ose mendon se është e lejuar. Për shembull, një i huaj që vjen nga ndonjë shtet në të cilën lejohet kryerja e marrëdhënieve seksuale me të mitur mbi 12 vjeç e kryen këtë veprim në një shtet në të cilën ndalohet kryerja e një marrëdhënie të tillë. Lajthimi në kundërligjshmëri nuk ka të bëjë me vetë normën penale juridike, me ndalimin formal ose me dënueshmërinë e veprës, por me palejueshmërinë sociale të saj.

Duke vlerësuar klasifikimet e sipërcituara përgjigja e pyetjes së mësipërme duhet të jepet në varësi të llojit të lajthimit ose gabimit. Kështu, në rastin e gabimit në fakt përjashtohet ndonjë kombinim midis elementëve të vetëdijshëm dhe të pavetëdijshëm të dashjes, qoftë edhe dashje e pjesshme, komponenti intelektual i së cilës do të mbulonte vetëm disa tipare të figurës së veprës. Pra, përjashtohen në këtë mënyrë tre format e fajit, ato të dashjes direkte, indirekte dhe të pakujdesisë në formën e vetëbesimit të tepruar. Figura e veprës penale “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur” siç e theksuam më sipër kryehet me dashje të drejtpërdrejtë. Kështu që, në rastin e gabimit në fakt, kur subjekti aktiv nuk ka dijeni për moshën nën 14 vjeç, ai nuk mund të mbajë përgjegjësi penale, sepse mungojnë elementet e figurës së veprës penale, mungon ana subjektive e saj. Pra, theksojmë se nëse autori kryen marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale duke menduar se i dëmtuara/i është i rritur, ndërsa në fakt ai është i mitur me moshë nën 14 vjeç, ai nuk mund të ketë përgjegjësi penale për figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe praktika gjyqësore. Kështu në vendimin nr.1524, datë 07.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, theksohet se: *“Ana subjektive: I pandehuri të veprës me dashje, d.m.th. që i autori i veprës penale të jetë në dijeni të faktit se, e dëmtuara është nën moshën 14 vjeç dhe pavarësisht këtij fakti autori kryen marrëdhënie seksuale me të. Por, edhe nëse zhvillimi fizik i të dëmtuarës, i analizuar në harmoni me rrethanat e tjera në të cilat ka lindur dhe është zhvilluar njohja mes autorit të veprës penale dhe të dëmtuarës, mund të ngrejë dyshimin se, e dëmtuara nuk e ka mbushur moshën 14 vjeç, autori i veprës penale është i detyruar të informohet për moshën e të dëmtuarës.*

Informacioni mund të kërkohet me mjete dhe nga persona të ndryshëm, ku gjithashtu autori i veprës penale është i detyruar të pyesë vetë të dëmtuarën për moshën e saj.”²⁰²

Nëse cilësitë e të dëmtuarit të mitur janë të dukshme, atëherë nuk mund të pretendohet gabimi në fakt.

Lidhur me dijeninë e moshës të të miturit, në kodet penale të tyre shtetet kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Kështu, Kodi Penal italian në nenin 609 përcakton se: *“Kur veprat e parashikuara nga nenet 609 bis, 609 ter, 609 quater dhe 609 octies kryhen kundër personit nën moshën katërmëdhjetë vjeç, si dhe në rastin e krimit të përmendur në nenin 609 quinquies, fajtori nuk mund të pretendojë, si justifikim për*

²⁰² Shih vendimin nr.1524, datë 07.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

veten, mosdijeninë e moshës së viktimës”²⁰³. Pra, ligjvënësi italian përjashton aplikimin e rregullave të gabimit në fakt për këtë figurë të veprës penale.

Ndërsa Kodi Penal i Kosovës në nenin 229 të tij përcakton se: “1. *Për qëllime të këtij Kapitulli, lajthimi lidhur me moshën e viktimës, e cila është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nuk është lajthim në fakt sipas nenit 25 të këtij Kodi, nëse kryesi me vetëdije ka qenë i pakujdesshëm në vënien e vetës në lajthim të tillë. 2. Kryesi nuk është penalisht përgjegjës për shkak të lajthimit në fakt nga neni 25 i këtij Kodi nëse për arsye të justifikueshme nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se viktima ka qenë nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet*”²⁰⁴. Nga njëra anë Kodi Penal i Kosovës për efekt të aplikimit të përgjegjësisë penale e detyron autorin që të tregohet i kujdesshëm që me vetëdije të mos bjerë në një lajthim në fakt. Nga ana tjetër, në mënyrë eksplicite ky kod parashikon përjashtimin e përgjegjësisë penale në rastin e gabimit në fakt.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, siç vihet re duhet të përmirësohet në këtë drejtim, duke bërë parashikime strikte lidhur me gabimin në fakt për këtë figurë të veprës penale.

Në rastin e gabimit juridik, në të cilin autori ka përfytyrim të gabuar për ndalesën e asaj që bën, kemi të bëjmë me lajthim juridik. Ai e di se çfarë bën, por nuk e di që është e ndaluar ose mendon se është e lejuar. Për shembull, rasti i të huajit që vjen nga një shtet në të cilën lejohet kryerja e marrëdhënieve seksuale me të mitur mbi 12 vjeç e kryen këtë veprim në një shtet në të cilën ndalohet kryerja e një marrëdhënie të tillë. Në këtë rast aplikohen rregullat e përgjithshme të parashikuara në nenin 4 të Kodit Penal, në të cilin theksohet se: “*Mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme*”.²⁰⁵ Nëse njohja ka qenë objektivisht e paevitueshme është çështje kauzale.

Në vendimin nr.1524, datë 07.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë theksohet se: “*Ana subjektive: I pandehuri të veprës me dashje, d.m.th. që i autori i veprës penale të jetë në dijeni të faktit se, e dëmtuara është nën moshën 14 vjeç dhe pavarësisht këtij fakti autori kryen marrëdhënie seksuale me të. Por, edhe nëse zhvillimi fizik i të dëmtuarës, i analizuar në harmoni me rrethanat e tjera në të cilat ka lindur dhe është zhvilluar njohja mes autorit të veprës penale dhe të dëmtuarës, mund të ngrejë dyshimin se, e dëmtuara nuk e ka mbushur moshën 14 vjeç, autori i veprës penale është i detyruar të informohet për moshën e të dëmtuarës.*

Informacioni mund të kërkohej me mjete dhe nga persona të ndryshëm, ku gjithashtu autori i veprës penale është i detyruar të pyesë vetë të dëmtuarën për moshën e saj.

Ky detyrim buron nga neni 4 në lidhje me nenin 100/1 të KP, sipas të cilëve, personat nuk mund të pretendojnë përjashtimin nga përgjegjësia penale pasi, nuk janë njohur me ligjin, përveç kur mosnjohja është për shkaqe objektive”.²⁰⁶

Në rastin konkret gjykata ka gabuar në arsyestimin e saj duke analizuar gabimin juridik. Ajo nuk ka marrë në konsideratë dallimin ndërmjet gabimit në fakt dhe gabimit juridik. Sipas rrethanave të faktit rezulton se ajo duhet të arsyetonte gabimin në fakt.

Gabimi juridik, nuk mund të aplikohet në rastin e pretendimit se martesë në moshë të re, qoftë edhe nën 14 vjeç, është një traditë thelbësore e një komuniteti, e krijuar ndër shekuj. Në vendimin nr.2301, datë 24.06.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor

²⁰³ Shih nenin 609 të Kodit Penal Italian.

²⁰⁴ Shih Nenin 229 të Kodit Penal të Kosovës.

²⁰⁵ Shih nenin 4 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

²⁰⁶ Shih vendimin nr.1524, datë 07.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit pavarësisht ekzistencës së rrethanave faktike si më poshtë: “Unë shtetasen V.Sh kam rreth një muaj që e njoh. Që kur e njoha rashë në dashuri me të. Ajo më pranoi dhe të dy ramë dakord që ajo të vinte tek shtëpia ime të jetonim të dy së bashku si burrë dhe grua. Unë e kam pyetur për moshën dhe ajo më ka thënë se ishte 15 vjeçe. Unë e mora në shtëpi në muajin dhjetor 2014 dhe familja ime e pranoi. Unë nuk kam kryer marrëdhënie seksuale me të që në ditën e parë. Unë i kam kërkuar asaj të flinim bashkë, por fillimisht ajo nuk donte. Ajo më ka thënë se nuk kishte shkuar me njeri tjetër. Pas pesë ditëve ne vendosëm të kryenim marrëdhënie seksuale...pas kryerjes së aktit kam parë që V. nuk ishte e virgjër. Marrëdhënia e fundit seksuale me të ka qënë në datë 23.01.2015”. I pandehuri dhe avokati i tij kanë mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në gjykim duke pretenduar se martesat dhe marrëdhëniet seksuale në këtë moshë janë në mënyrën e jetesës së komunitetit të cilit i përket si i pandehuri dhe e dëmtuara”²⁰⁷.

2.1.5. Relacioni me heqjen e paligjshme të lirisë

Pasojë direkte, madje parësore, e kryerjes së marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale është cënimi, heqja e lirisë së personit të dëmtuar, sepse ajo përbën një nga elementët e anës objektive të figurës së “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”. Në figurat e krimeve seksuale heqja e paligjshme e lirisë së personit²⁰⁸ i paraprin dhe shoqëron kryerjen e aktit seksual. Nisur nga kjo, disa shtete i trajtojnë krimet seksuale si vepra penale që cënojnë lirinë e personit duke i grupuar në të njëjtin seksion²⁰⁹. Pavarësisht koneksitetit material ndërmjet tyre, ekzistojnë dallime thelbësore, të cilat pasqyrohen në elementët e secilës prej tyre:

1. Objekti. Heqja e paligjshme e lirisë ka si objekt juridik mbrojtjen e përgjithshme të lirisë së personit kundrejt çdo lloj privimi të saj, dhunimit dhe nënshtrimit të detyrueshëm fizik nga cilido, veprime këto që nuk janë të autorizuar apo lejuara nga ligji²¹⁰. Ndërsa, “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur” ka si objekt juridik mbrojtjen e lirisë seksuale dhe zhvillimin normal seksual të fëmijës së mitur, jetën dhe shëndetin e tij.
2. Veprimet a mosveprimet e autorit të kësaj vepre penale nuk janë të një natyre të përcaktuar shprehimisht prej saj. Heqja e paligjshme e lirisë mund të realizohet nëpërmjet veprimeve (aktive) duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në to: ushtrimi i dhunës mbi personin duke e rrëmbyer, mbajtur peng, e shoqëruar me bllokimin, prangosjen, etj., ose në forma të tilla si, injektimi i substancave narkotike që pamundësojnë reagimin dhe sjelljen normale të viktimës, dhunës psikike dhe kanosjeve nëpërmjet përdorimit dhe drejtimit të armëve ndaj viktimës. Nuk përjashtohen në heqjen e paligjshme të lirisë edhe përdorimi i formave të mashtrimit dhe gënjeshtëris me synim dhunimin e lirisë apo vetprivimin e viktimës nga liria personale për gjendjen e tij në situata të një sëmundje të

²⁰⁷ Shih vendimin nr.2301, datë 24.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁰⁸Në nenin 110 Kodi Penal parashikon se: “Heqja e paligjshme e lirisë së personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Kur kjo vepër shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet”.

²⁰⁹ Shih Kreun 3, seksionin 2 të Kodit Penal Italian.

²¹⁰ Shih vendimin unifikues nr.1, datë 25.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

pashërueshme, të rëndë, ngjitetë, etj., në situata të një rreziku (që në fakt nuk ekziston), vendosjen në gjendje sugjestionimi a supersticioziteti, etj. Kjo vepër mund të kryhet edhe nëpërmjet mosveprimeve kur, nëpërmjet tyre mund të shkaktohet dhe realizohet heqja e paligjshme e lirisë. Në këto raste, zbatimi i dispozitës shtrihet mbi ata persona (autorë) që kanë në ngarkim apo si detyrë të përcaktueshme mbrojtjen dhe garantimin e lirisë individuale të viktimës. Ndërsa, krimi i marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale kryhet me veprime aktive që konsistojnë në kryerjen e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale me fëmijën që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç, ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale. Pra, teknika e inkriminimit kërkon që subjekti aktiv me veprime aktive të kryejë marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të dëmtuarin. Akti seksual, si penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit, ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit, para së gjithash përfshin kontaktin fizik, i cili përveç rastit të ekzistencës së vullnetit, realizohet duke iu hequr liria e të dëmtuarit. Gjithashtu, me marrëdhënie seksuale kuptohet jo vetëm bashkim formal i dy personave, të sekseve të ndryshëm apo të njëjtë por, edhe çdo lloj akti, i cili edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me kontaktin fizik direkt me subjektin pasiv (viktimën) ka për qëllim dhe është i përshtatshëm të vërë në rrezik të mirën parësore të individit, atë të lirisë seksuale, nëpërmjet eksitimit ose sadisfaksionit të instiktit seksual të personit abuzues.

3. Heqja e paligjshme e lirisë, nga pikëpamja e anës subjektive realizohet për qëllime dhe motive që nuk janë nga ato të përfshira në nenin 109 të Kodit Penal²¹¹. Nga pikëpamja e anës objektive, heqja e paligjshme e lirisë (nënkuptohet, rrëmbimi dhe mbajtja peng), pavarësisht nga mënyra e kryerjes, do të kuptohet si privim i lirisë së lëvizjes së personit në hapësirë sipas rrethanave dhe çmimit subjektiv të tij²¹². Paprekshmëria e personit, liria e lëvizjes personale, për të mos u penguar a mbajtur fizikisht, por edhe psikologjikisht i lidhur nga një rrethanë e paligjshme dhe e dhunshme, është një e drejtë universale, natyrale, një nga liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta.

Përsa i përket përcaktimit të heqjes së paligjshme të lirisë, ardhjes së pasojës dhe shkallës së tyre, është e rëndësishme të vërtetohet një kohëzgjatje e matshme dhe e mjaftueshme e privimit të lirisë, e cila jo domosdoshmërisht duhet të jetë e gjatë. Nuk përbën heqje të paligjshme të lirisë vërtetimi i kësaj gjendje objektive në një çast të caktuar ose kalimtar, apo në kryerje e sipër të një veprimi të caktuar.

Gjithashtu, në kualifikimin e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, nuk ndikon shkalla relative apo absolute e heqjes së lirisë dhe as natyra e pengesave, bllokimit e përdorimit të mënyrave të tjera që bëjnë relativisht a plotësisht të përjashtuar ose të pamundur kapërcimin e tyre nga viktimat, apo mundësinë e vetlirimit të tij.

Vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe shpjegimet e parashtuara me sipër, quhet e kryer që në çastin kur

²¹¹I cili parashikon figurën e veprës penale të “Rrëmbimi, ose mbajtja peng e personit”.

²¹² Shih vendimin unifikues nr.1, datë 25.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

vërtetohet koha dhe vendi i realizimit të privimit dhe dhunimit të lirisë së personit.

Ndërsa figura e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” kryhet me dashje të drejtpërdrejtë. Subjekti aktiv është i vetëdijshëm për karakterin e aktit seksual, parashikon dhe dëshiron kryerjen e marrëdhënieve seksuale, ose homoseksuale me të mitur nën moshën 14 vjeç, ose që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale. Qëllimi i tij është kryerja e marrëdhënieve seksuale.

Siç vihet re, figurat e veprave penale të “Heqja e paligjshme e lirisë” dhe “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, kanë dallime thelbësore ndërmjet tyre.

Pyetja që lind është: A konkuron figura e veprës penale “Heqja e paligjshme e lirisë” me figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”?

Në funksion të përgjigjes së kësaj pyetjeje duhet të diferencojmë koneksitetin ndërmjet këtyre veprave penale. Kështu, heqja e paligjshme e lirisë së personit mund të paraprijë, të shoqërojë, ose pasojë aktin seksual. T’i trajtojmë këto raste:

- a. Në të parin, heqja e paligjshme e lirisë i paraprin aktit seksual. Për shembull, personi A duke qënë në dijeni të faktit se i mituri nën moshën 14 vjeç lë shkollën për të shkuar në shtëpinë e tij rreth orës 13:00, pret momentin që i mituri del nga oborri i shkollës, e merr me forcë dhe e fut në bagazhin e automjetit të tij. Më pas ai e dërgon në banesën e tij dhe kryen marrëdhënie seksuale më dhunë. Pas kryerjes së aktit seksual e lë të lirë të largohet. Në këtë rast dallohen dy episode. Në të parin, të miturit i hiqet liria në mënyrë të paligjshme duke e futur në bagazhin e automjetit. Në të dytin, konsumohet marrëdhënia seksuale. Është e qartë që në rastin konkret janë konsumuar të dy figurat e veprave penale të sipërpërmendura. Konkluzioni nëse ato konkurojnë me njëra-tjetrën do të arrihet pasi të analizohet koncepti i konkurimit fiktiv në formën e përthithjes, i cili si bazë të vlerësimit konkret të padrejtësisë materiale i dy ose më shumë veprave të kryera, konkludojmë se padrejtësia e njëres vepër e mbulon padrejtësinë e tjetrës, sipas rregullit *lex consumenc derogat, legi consumpetax*²¹³.

Në thelb të këtij koncepti qëndron eksperiencia e përgjithshme, sipas së cilës nëse kryerja e një vepre penale shoqërohet me realizimin e një vepre tjetër, kjo e dyta thithet nga e para sepse legjislatori kur përcakton dënimin për veprën më të rëndë, mban parasysh edhe veprën më pak të rëndë që përgjithësisht lidhet me të parën. Në këto raste zbatohet ajo normë që sanksionon dënimin më të rëndë. Ndërsa, kur nuk mund të përcaktohet se cili është dënimi më i rëndë, duhet t’i referohemi rëndësisë që paraqet marrëdhënia juridike e mbrojtur²¹⁴.

Sipas doktrinës së të drejtës penale një nga rastet e konkurimit fiktiv të përthithjes është konkurrimi ndërmjet veprës mjet dhe veprës qëllim. I tillë është rasti kur disa veprime në kuptimin natyror, formalisht plotësojnë

²¹³ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.411.

²¹⁴ Shih Nicola Corea “Le Sezioni Unite dicono no alla consumazione”, artikull në adresën e internetit <http://www.altalex.com/index.php?idnot=34106>, akses në datë 16 Prill 2013. Shih gjithashtu, Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 411.

elementët e dy ose më shumë figurave të veprave penale por, ndërmjet tyre ekziston një lidhshmëri kohore, hapësinore dhe qëllimore, sepse kryerja e njëres vepër shërben si mjet ose paraqitet si formë për realizimin e një vepre tjetër dhe autori i tyre synon apo dëshiron pasojat e vetëm njëres prej veprave. Vepra që shërben si mjet mund të kryhet përpara veprës tjetër me qëllim që të sigurohen kushtet për realizimin e saj, ose e shoqëron (inkluzicioni)²¹⁵ apo e pason atë (konsumcioni i veprës plotësuese të padenuar)²¹⁶, por gjithmonë në funksion të arritjes së rezultatit kriminal të synuar nëpërmjet veprës kryesore. Ekzistojnë këto kufizime në zbatimin e rregullit të thithjes:

- Një vepër që dënohet më rëndë, nuk mund të quhet si mjet për kryerjen e një vepre tjetër që dënohet më pak. Kështu, në udhëzimin nr.1, dt.26.11.1954 të Plenumit të Gjykatës së Lartë “Mbi bashkimin e krimeve dhe dënimeve” thuhet se: *“plagosja e rëndë nuk mund të konsiderohet si mjet për kryerjen e krimit të shtrëngimit për martesë, pasi plagosja e rëndë dënohet më shumë se vetë krimi i shtrëngimit për martesë”*²¹⁷. Të njëjtin qëndrim mban edhe teoria e të drejtës penale dhe praktika gjyqësore e vendeve të tjera²¹⁸.
- Të gjitha veprat duhet të çenojnë të njëjtin subjekt pasiv.
- Nuk ka konkurrim vetëm atëherë kur, teorikisht, vepra-qëllim nuk mund të arrihet në asnjë mënyrë tjetër pa veprën-mjet²¹⁹.

Duke marrë në konsideratë konceptin e konkurimit fiktiv në formën e përthithjes, në të cilin njëra vepër shërben si mjet, ndërsa tjetra si qëllim theksojmë se, në rastin kur heqja e paligjshme e lirisë shërben si mjet për realizimin e veprës qëllim, kryerjes së marrëdhënies seksuale, nuk kemi konkurim ndërmjet këtyre veprave, sepse plotësohen tre kushtet e sipërcituara. Kështu, heqja e paligjshme e lirisë dënohet me lehtë se marrëdhëniet seksuale, homoseksuale me të mitur. Të dy këto vepra kryhen ndaj të njëjtit subjekt pasiv. Heqja e paligjshme e lirisë është mjete i vetëm për realizimin e veprës qëllim.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.49, datë 18.02.2009²²⁰, në të cilin ka arsyetuar se: *“Është pranuar e provuar nga gjykatat se, në mbrëmjen e datës 27.04.2006, rreth mesnatës, e dëmtuara M.S po kthehej në shtëpinë e saj me një taksì. Aty e prisnin të gjykuarit B.R, E.M e K.S, të cilët, sapo ajo zbriti nga makina, forcërisht e futen në një furgon që kishin marrë, me të cilin shkuan deri tek banka e shtetit, ku hipen të katër në një veturë që e drejtonte i gjykuari B.R. Kur kanë shkuar tek fusha e aviacionit, ata i kërkuar të dëmtuarës për të kryer marrëdhënie seksuale e mbas refuzimit, në kundërshtim me vullnetin e saj, duke e kanosur se nuk kishte*

²¹⁵ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.412.

²¹⁶ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.413.

²¹⁷Shih “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i Gjykatës së Lartë të RPSSH dhe Universiteti i Tiranës, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, f. 321.

²¹⁸Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 413.

²¹⁹Vep e cit. Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i përditësuar, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007, f. 330. Shih gjithashtu Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 413.

²²⁰ Shih vendimin nr.49, datë 18.02.2009 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

se ku të shkonte pa kryer marrëdhënie, me dhunë kryen marrëdhënie seksuale njëri pas tjetrit në sediljen e pasme të makinës...

Por, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjen të drejtë pretendimin e bërë se në rastin në gjykim, të gjykuarit nuk duhej të deklaroheshin fajtorë edhe për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal, pasi kjo vepër nuk konkuron me veprën penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë.

Për akuzën e parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal, gjykata e rrethit edhe pse i ka deklaruar fajtorë të gjykuarit, nuk bën asnjë analizë se ku konsistojnë elementët e kësaj vepre, ndërsa gjykata e apelit në vendimin e saj, pa asnjë analizë, shprehet me vendim se “..edhe vepra e heqjes së paligjshme e lirisë është provuar me veprimet aktive të kryera nga të pandehurit”. Në këtë kontekst, gjykatat nuk kanë realizuar detyrimin ligjor për arsyetimin e vendimeve, sepse në çdo rast, për çdo akuzë, ata duhet të arsyetojnë ekzistencën apo jo të veprës penale.

Objekti i veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë, paprekshmërinë seksuale të femrës dhe shendetit, apo jetës së saj. Nga ana objektive, kjo vepër kryhet me përdorimin e dhunës fizike apo psikike. Dhuna është elementi kryesor përbërës i kësaj vepre penale dhe nënkupton përdorimin për të mposhtur kundërshtimin e të dëmtuarës. Me fjalën dhunë, sikurse kanë pranuar teoria dhe praktika e së drejtës penale për këtë vepër, duhet kuptuar dhuna fizike që mund të shfaqet me rrahje, plagosje, përdorimin e saj për të mposhtur me mjete të ndryshme kundërshtimet e të dëmtuarës, tërheqja e saj për në vendin e kryerjes së veprës, lidhja, etj.

Vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë e personit dhe kryhet me veprime aktive ose mosveprime në forma të ndryshme, si: mbyllja në një vend duke e penguar atë të lëvizë lirisht, mbajtja e tij me forcë në një vend ku nuk dëshiron të qëndrojë, etj.

Si vepra penale e marrëdhënieve seksuale me dhunë edhe heqja e paligjshme e lirisë, kryhen me dashje direkte, por dallimi kryesor midis tyre qëndron pikërisht në anën subjektive dhe në qëllimet që do të realizojë autori i veprës penale. Në arritjen e përfundimeve të drejta, duhet patur parasysh se analiza e anës subjektive të krimit qëndron dallimi midis veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë dhe veprave të tjera penale dhe mos konkurimit të kësaj vepre me heqjen e paligjshme të lirisë.

Në këto rrethana, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e gjen të bazuar pretendimin e të gjykuarit për mos ekzistencën e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal dhe çështja penale në këtë pjesë duhet të pushohet...”.

- b. Në të dytën, heqja e paligjshme e lirisë shoqëron marrëdhënien seksuale, ose homoseksuale. Për shembull, personi A takon të miturin në rrugë, e tërheq me forcë nga krahu dhe pas një shkurreje kryen marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të. Më pas e lë të lirë të largohet. Duke patur në vëmendje analizën e bërë lidhur me konceptin e konkurimit fiktiv të përthithjes, një tjetër rast i tij është konkurimi ndërmjet veprës kryesore dhe veprës së padënuar shoqëruese dytësore (inkluzioni), e cila ekziston gjatë realizimit në të njëjtin kohë të figurave të veprës kryesore dhe asaj ndihmëse. Këto figura mund të realizohen me një, apo më shumë veprime në lidhshmëri natyrore, kohore dhe hapësinore.

Kështu që, në shëmbullin e mësipërm nuk kemi konkurim ndërmjet heqjes së paligjshme të lirisë dhe marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale me të mitur. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga praktika gjyqësore. Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.261, datë 01.12.2006²²¹, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit I.V për veprën penale të kryerjes së marrëdhënies homoseksuale me dhunë me të mitur, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 18 vjet burgim, lidhur me kryerjen e këtij fakti tipik: *“Në datë 26.03.2006, rreth orës 10.00, i dëmtuari ka dalë nga shtëpia e tij për të shkuar tek shtëpia e tezes së tij e cila ndodhet në Lagjen “8 Shkurti” të qytetit të Fierit. Pasi ka qëndruar për disa orë, përsëri i vetëm ka marrë rrugën e kthimit për në shtëpinë e tij. Si rrugë të kthimit ka zgjedhur të ecë përgjatë shinave të trenit. Kur ka qenë afërsisht në gjysmën e rrugës së kthimit në afërsi të shinave të trenit e ka thirrur një person i panjohur prej tij, të cilin ai e ka përshkruar si: “një person i seksit mashkull me flokë të zeza dhe kaçurrela”. Ky person i ka kërkuar atij që ta ndihmonte të ngrinte një send të rëndë, por që është refuzuar prej tij sepse nuk kishte dalluar asnjë send. Atëherë agresori i tij e ka urdhëruar që t’i afrohej dhe mbasi e ka kapur kundër dëshirës së tij e ka zhveshur në pjesën e poshtme të trupit dhe më pas ka kryer marrëdhënie homoseksuale me të. .. ka kërcënuar që të mos tregonte për ngjarjen dhe është larguar..”*. Pra, siç vihet re kualifikimi ligjor i veprës penale është bërë duke marrë në konsideratë rregullat e konkurimit fiktiv të përthithjes.

- c. Në të tretën, heqja e paligjshme e lirisë pason marrëdhënien seksuale, ose homoseksuale. Për shëmbull, personi A pasi kryen marrëdhënie seksuale me të miturin e fut atë në garazhin e makinës dhe e mban aty për disa ditë. Sipas doktrinës juridike një tjetër rast i konkurimit fiktiv të përthithjes është konsumpioni i veprës plotësuese të padënuar, e cila ekziston vetëm si vazhdimësi natyrore e veprës kryesore, si formë për realizimin e qëllimit për çka është kryer edhe vepra kryesore. Vepra e mëvonshme mbulohet nga vepra e mëparshme nëse e mira juridike që mbrohet është e njëjta, në të kundërt kur të mirat juridike të cënuara janë të ndryshme atëherë kemi të bëjmë me konkurim ndërmjet veprave penale. Duke u bazuar tek ky rregull kualifikimi ligjor i faktit tipik të trajtuar në shëmbullin e mësipërm bëhet duke konkuruar veprat me njëra tjetrën. Ky qëndrim është reflektuar edhe në praktikën gjyqësore. Kështu, në vendimin nr.934 datë 17.04.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë²²² thekson se :”... *Banesa ku jetonte i pandehuri A.P ndodhej pranë banesës së shtetasit të mitur A.C, i moshës dhjetë vjeç. I pandehuri dhe i mituri A.C kishin njohje të mëparshme si banorë të se njëjtës lagjes. Në datën 16.03.2013, rreth orës 17.00 i dëmtuari A.C ka dalë nga banesa e tij që të luante në sheshin para banesës së tyre së bashku me shokët e tij. Në kohën që është larguar shoku i tij dhe i mituri A.C ka mbetur vetëm duke lozur, i pandehuri ka dalë tek porta e banesës së tij dhe i ka kërkuar të dëmtuarit A.C që të afrohej tek ai. Kur i mituri A.C është afruar, i pandehuri ka hyrë në banesën e tij duke i folur te miturit A.C, duke i thënë se nuk kishte para (leke) dhe i ka kërkuar të miturit të hynte brenda banesës që ta ndihmonte t’i shkruante një letër shitëses. I dëmtuari A.C, i ka besuar te pandehurit, dhe në kohën që i mituri ka hyrë brenda në banesë, i pandehuri në gjykim ka mbyllur derën e banesës me çelës. I dëmtuari, i mitur A.C, ka filluar të qajë dhe të bërtasë nga frika, por i pandehuri ka fikur dritat dhe e ka kërcënuar të miturin duke i kërkuar të pushonte*

²²¹ Shih vendimin nr.245, datë 26.09.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²²² Shih vendimin nr.934, datë 17.04.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

të qarat, dhe të bertiturat, pasi do t'i fuste duart në fyt. I pandehuri i ka kërkuar të miturit A.C të zhvishej, por i dëmtuari nuk ka pranuar. I pandehuri ka filluar t'ia heqë vetë rrobat, ndërkohë që i mituri qante dhe bërtiste. I pandehuri A.P i ka thënë të miturit të demtuar, të shtrihej në krevat dhe të kthehej nga pas, ku i pandehuri ka filluar ta prekë atë në trup. I pandehuri ka kryer marrëdhënie me të, pavarësisht faktit se i dëmtuari ka patur dhimbje dhe ka refuzuar kryerjen e marrëdhënieve. Pasi kanë kryer marrëdhënie, i dëmtuari ka patur dhimbje, por njëkohësisht ka patur frikë të kërkonte ndihmë, se mos i pandehuri i bënte ndonjë gjë tjetër. I pandehuri nuk e ka lejuar të dëmtuarin të largohet nga banesa e tij. I mituri A.C, i ka kërkuar gjatë natës që ta linte të shkonte tek prindërit e tij, pasi ai i dëgjonte nga brenda banesës prindërit që e kërkonin dhe e thërrisnin, por i pandehuri e ka kërcenuar dhe i ka thënë të miturit të demtuar, se do ta vriste, dhe të mos lëvizte, dhe të mos përgjigjej, duke e mbajtur gjatë gjithë natës në banesë. Të nesërmen e ngjarjes, duke qenë se i pandehuri nuk ka shkuar në punë, një nga punëtorët e quajtur G.M, (i pyetur me cilesinë e dëshmitarit në gjykim), ka shkuar bashkë me dy punëtorë të tjerë tek banesa e tij, të pandehurit, duke e kërkuar, duke trokitur në derën e banesës, por i pandehuri nuk i është përgjigjur thirrjeve të tyre. Aty, dëshmitari dhe dy punëtorët e tjerë, kanë dëgjuar në lagje, se kishte humbur edhe një fëmijë, që jetonte pranë banesës së të pandehurit A.P, dhe duke menduar se mosparaqitja në punë e të pandehurit, mund të kishte lidhje me fëmijën, kanë njoftuar policinë. Duke qenë se nga verifikimet e bëra ka rezultuar se i pandehuri ka qenë i dënuar më parë për heqjen e paligjshme të lirisë, nga ana e punonjësve të policisë është shkuar menjehere, në banesën e të pandehurit, ku gjatë kontrollit të banesës se tij, e kanë gjetur atë në tualet të fshehur, poshtë lavamanit mbante të dëmtuarin e mitur, nën kërcënimin e thikës që ai të mos fliste. Sa më sipër, Gjykata, në vështrim të neneve 100/2 dhe 110/2 të Kodit Penal, e gjen fajtor të pandehurin A.P për kryerjen e veprave penale të “Marrëdhënieve homoseksuale me të mitur” të kryer me dhunë dhe “Heqja e paligjshme e lirisë”, shoqëruar me vuajtje të rënda fizike...”.

Është e mundur që heqja e paligjshme e lirisë të pasojë marrëdhënien seksuale me të mitur dhe të paraprijë një akt tjetër seksual ndaj të njëjtit subjekt pasiv. Duke mbajtur në vëmendje rregullat e mësipërme theksojmë se në këtë rast kemi konkurim ndërmjet këtyre figurave të veprës penale. Një vlerësim i tillë është bërë edhe në vendimin nr.1224 datë 14.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë²²³, ku është theksuar se: “I pandehuri e ka çuar të dëmtuarën në disa nga banesat e kushërinjve apo të njohurve të tij, por të gjithë kanë refuzuar të mirëpresin të pandehurin dhe i kanë sugjeruar të dëmtuarës të largohej nga Xh, pasi ishte i martuar dhe se nuk kishte punë me të. I pandehuri e ka dërguar të dëmtuarën edhe në banesën e tij në fshatin Pezë, por një veprim i tillë nuk është pranuar nga familjarët e të pandehurit, aq më shumë që ai ishte i martuar, me bashkëshorten në shtëpi dhe me fëmijë të mitur.

Gjatë qëndrimit të të dëmtuarës me të pandehurin, ai ka kryer disa herë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën në banesat e të njohurve të tij apo edhe në ambiente të jashtme pranë Liqenit Artificial apo Qytetit Studenti. E dëmtuara është ndjerë e kërcënuar nga i pandehuri, i cili disa herë i ka thënë se do ta vriste, hidhte në liqen etj. E dëmtuara ka komunikuar në telefon edhe me familjarë apo punonjës të policisë dhe gjatë bisedave i pandehuri e ka kërcënuar që të deklaronte se kishte ardhur vetë dhe qëndronte me dëshirën e saj. I pandehuri jo vetëm që ka kryer

²²³ Shih vendimin nr.1224, datë 14.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

marrëdhënie jashtë vullnetit të të dëmtuarës, por ai edhe e ka lidhur të dëmtuarën në një pemë pranë Liqenit Artificial apo Qytetit Studenti duke e lënë në atë gjendje disa orë midis datave 08.05.2013 dhe 09.05.2013.

Sa më sipër Gjykata krijon bindjen se i pandehuri Sh.D ka kryer veprën penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë me të mitura 14-18 vjeç parashikuar nga neni 101 pg.1 i Kodit Penal. I pandehuri ka përdorur si dhunën fizike dhe atë psikologjike me qëllim që të kryejë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën. Veprimet e të pandehurit kanë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar jetën dhe shëndetin e shtetasve dhe në mënyrë të posaçme integritenin seksual të të dëmtuarës. I pandehuri ka vepruar me dashje dhe me veprime aktive me qëllimin e vetëm të realizimit të dëshirave të tij seksuale.

Në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale “Heqje e paligjshme e lirisë” parashikuar nga neni 110 pg.1, në zbatim të ligjit nr.22/2014 “Për dhënie amnistie” gjykimi ndaj të pandehur Sh.D duhet pushuar. ...”

Ndërkohë një tjetër pyetje që shtrohet është: Nëse subjekti aktiv heq dorë nga kryerja e figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, a do të mbajë përgjegjesi penale për figurën e veprës penale të “Heqja e paligjshme e lirisë”, e cila i paraprin, e shoqëron, apo e pason të parën?

Në nenin 24 të Kodit Penal parashikohet se: “*Personi që më vullnetin e tij dhe në mënyrë përfundimtare heq dorë nga kryerja e veprës penale, me gjithë mundësitë që ka për kryerjen e saj, nuk ka përgjegjësi penale. Kur veprimet e gjeratëhershme përmbajnë elementët e ndonjë vepre tjetër penale, personi përgjigjet për veprën e kryer*”.

Vetë dispozita në këtë rast të lë të kuptosh në mënyrë të qartë që, vepra penale do të konsiderohet e kryer dhe personi do të përgjigjet për të kur veprimet e ndërmarra deri në atë moment përmbajnë elementët e ndonjë vepre penale. Pra, ndërmarrja e veprimit përcakton dhe në këtë rast çastin se kur vepra penale do të konsiderohet e kryer. Në doktrinën e së drejtës penale ky parashikim njihet me termin “tentativa e cilësuar”, me të cilin nënkuptohet shkaktim gjatë tentimit të një vepre të pasojës së një vepre tjetër, duke e realizuar këtë të fundit në tërësinë e elementëve të saj²²⁴. Janë të mundura dy raste: vepra të realizohet me të njëjtin veprim të tentimit, prej së cilës subjekti aktiv është tërhequr dhe e cila me veprën, që ka mbetur në tentim qëndron në raport të bashkimit ideal ose fiktiv ligjor; ose vepra penale të realizohet me veprim të ndryshëm nga ai i tentimit, prej së cilës subjekti aktiv është tërhequr dhe me veprën në tentim, prej së cilës është hequr dorë qëndron në raport të bashkimit real.²²⁵

Është e qartë që rasti i dytë nuk përfshihet tek nocioni i tentimit të cilësuar, koncepti i bashkimit (konkurimi) real²²⁶ e dikton një diferencim të tillë. Në këtë rast, krahas veprimit të kryerjes së veprës penale prej së cilës është tërhequr, subjekti aktiv kryen edhe një veprim tjetër, duke konsumuar një figurë të veprës penale tjetër. Kështu, nëse subjekti aktiv e fton të miturën në dyqanin e tij dhe duke e mashtruar, me anë të dhënies së çokollatave, e fut në ambientet e brendshme të dyqanin me qëllimin për të kryer marrëdhënie seksuale me të, por heq dorë nga kryerja e aktit seksual, më pas e qëllon të miturën me pëllëmbë duke e kanosur që të mos u trengonte prindërve të saj.

²²⁴ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.338.

²²⁵ Po aty

²²⁶ Konkurimi real është një nga format e bashkimit, në të cilën i njëjti person ka kryer disa vepra penale me veprime ose mosveprime të ndryshme në kuptimin natyror, nga teoria e të drejtës penale përkufizohet si, konkurimi real ose material i veprave penale.

Në këtë rast, subjekti aktiv do të përgjigjet për veprën penale të rrahjes parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal.

Më të ndërlikuara do të konsideronim rastet e konkurimit ideal²²⁷ dhe atij fiktiv, në analizë të të cilave do të theksonim:

- Për figurën e realizuar të veprës që qëndron në raport konkurimi ideal me veprën, prej së cilës, është hequr dorë, ato dënohen si vepra të vetme dhe autonome. Në një përfundim të tillë do të arrihej edhe nëse nuk do të ishte parashikuar neni 24/2 i Kodit Penal. Në këtë rast bëhet fjalë për ato vepra vetjake, autonome, për të cilat autori do të mbante përgjegjesi edhe kur vepra penale, prej së cilës është hequr dorë, do të ishte përfunduar. Për shembull, nëse subjekti aktiv ka si qëllim që njëkohësisht të kryejë marrëdhënie seksuale me të miturin dhe ta vrasë.
- Në rastin e konkurimit fiktiv të figurës së veprës penale dhe asaj prej së cilës është hequr dorë, analiza duhet të bëhet sipas llojit të konkurimit fiktiv.
 - a. Në konkurimin fiktiv të specialitetit (ligjor), dispozitat e ndryshme, të të njëjtit seksion, ose në seksione të ndryshme, rregullojnë të njëjtat marrëdhënie juridike. Njëra e rregullon në kushte të përgjithshme, ndërsa tjetra në mënyrë më të detajuar²²⁸. Në këtë rast, do të gjejnë zbatim ato dispozita ligjore që e rregullojnë marrëdhënien përkatëse në mënyrë të detajuar. Në shkencën e të drejtës në përgjithësi, ashtu edhe atë penale, ky njihet si parimi “ligji i posaçëm ka përparësi mbi atë të përgjithshëm” (*lex specialis derogat generali*).
 - b. Në konkurimin fiktiv të subsidiaritetit, një vepër penale paraqitet si fazë paraprake e veprës penale të dytë²²⁹. Pra, figurat e parashikuara nga nene të ndryshme të Kodit Penal, përfaqësojnë shkallë të ndryshme të kryerjes së veprës penale, ose thënë ndryshe, shkallë të ndryshme të cënimit të së njëjtës të mirë juridike të mbrojtur nga legjislacioni penal²³⁰.
 - c. Në konkurimin fiktiv të përthithjes disa veprime në kuptimin natyror, formalisht plotësojnë elementët e dy ose më shumë figurave të veprave penale por, ndërmjet tyre ekziston një lidhshmëri kohore, hapësinore dhe qëllimore, sepse kryerja e njëres vepër shërben si mjet ose paraqitet si formë për realizimin e një vepre tjetër dhe autori i tyre synon apo dëshiron pasojat e vetëm njëres prej veprave. Vepra që shërben si mjet mund të kryhet përpara veprës tjetër me qëllim që të sigurohen kushtet për realizimin e saj, ose e shoqëron (inkluzicioni)²³¹

²²⁷ Konkurimi ideal është një nga format e bashkimit, në të cilën personi me një veprim ose mosveprim të vetëm në kuptimin natyror konsumohet elementët e dy ose më shumë figurave të veprave penale, situata përkufizohet si konkurimi ideal ose formal i veprave penale.

²²⁸ Nga pikëpamja e logjikës formale bëhet fjalë për dy norma juridike që rregullojnë dy koncepte, në marrëdhënie gjini dhe lloj me njëri tjetrin. Koncepti lloj përbëhet nga një tërësi elementesh, ndërsa koncepti gjini ka të gjithë elementët e konceptit lloj por edhe të tjerë. Shih Luan Pirdeni “Hyryje në Logjikë”, Shtëpia Botuese “Koçi”, Tiranë, 2007, f. 32.

²²⁹ Vep. e cit. Ismet Salihu “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i ripunuar, Botimet “Fama 2008”, Prishtinë, 2008, f. 362.

²³⁰ Shih Nicola Corea “Le Sezioni Unite dicono no alla consumazione”, artikull në adresën e internetit <http://www.altalex.com/index.php?idnot=34106>, akses në datë 16 Prill 2013.

²³¹ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.412.

apo e pason atë (konsumcioni i veprës plotësuese të padënuar)²³², por gjithmonë në funksion të arritjes së rezultatit kriminal të synuar nëpërmjet veprës kryesore.

Disa autorë të së drejtës penale kanë elaboruar konceptin e aktivizimit të dispozitës së spostuar, në rastin kur dispozita, e cila duhet të zbatohet duke marrë në konsideratë rregullat e përgjithshme, nuk mund të zbatohet për arsye nga më të ndryshmet, për shembull, për shkak të heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, apo për shkak të mungesës së ankimit nga e drejta e të dëmtuarit. Sipas këtyre autorëve riaktivizimi i dispozitës së spostuar nuk mund të diskutohet në rastin e konkurimit fiktiv të specialitetit, në aspekt të lidhjes me natyrë dispozitë e përgjithshme, dispozitë e posaçme. Riaktivizimi i dispozitës së spostuar është i mundur në rastin e konkurimit fiktiv të përthithjes dhe subsidiaritetit.

Autorë të tjerë²³³ theksojnë se heqja dorë vullnetare konsiderohet si baza personale fakultative për përjashtim nga përgjegjësia penale. Në rastin e heqjes dorë vullnetare vetë tentimi është i dënueshëm kështu që ekziston vepra kryesore dhe e njëjta e përjashton mundësinë, që veprat, të cilat janë në bashkim fiktiv me të, të fitojnë rëndësi të vetme dhe të dënohen si vepra të vetme. Për vepra të tilla, subjekti aktiv nuk do të përgjigjet posaçërisht edhe kur vepra të jetë e përfunduar. I tillë është rasti kur subjekti aktiv është tërhequr nga kryerja e marrëdhënies seksuale me të mitur, por të dëmtuarës i janë shkaktuar lëndime trupore, të cilat janë në konkurim fiktiv me veprën marrëdhënie seksuale me dhunë. Në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me tentim cilësues, sepse figurat e realizuara qëndrojnë në bashkim fiktiv me njëra tjetrën. Në dobi të kësaj analize, duhet të theksohet edhe teza për vëzhgim të vetëm dhe vlerësim të veprimit të tentimit dhe heqjes dorë vullnetare. Veprimi i tentimit dhe i tërheqjes duhet të shikohen si elementë pozitivë dhe negativë të një bilanci të njëjtë dhe bazë për vlerësim përfundimtar. Vëzhgimi i vetëm i veprimit të tentimit dhe heqjes dorë e përjashton mundësinë për përgjegjësinë penale të subjektit pasiv për veprat që qëndrojnë në konkurim fiktiv me veprën prej së cilës është tërhequr.

Në rastin e heqjes dorë nga kryerja e veprës kryesore, subjekti aktiv do të mbajë përgjegjësi penale për figurën e veprës penale të konsumuar që qëndron në konkurim subsidiar dhe, ose fiktiv me veprën kryesore prej së cilës është hequr dorë. Neni 24 i Kodit Penal është i qartë në këtë drejtim, duke parashikuar përgjegjësinë penale për ato veprime e deriatëhershme që përmbajnë elementët e ndonjë vepre tjetër penale. Kështu, nëse subjekti aktiv zgjedh vendin, në të cilën do të dërgojë të miturin, përcakton momentin kur i mituri lë shkollën, duke e marrë më pas me forcë dhe duke e dërguar në vendin e paracaktuar me qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale dhe duke hequr dorë më pas nga kryerja e kësaj të fundit, ai do të mbajë përgjegjësi për veprën penale heqje të paligjshme të lirisë, sepse veprimet e deriatëhershme plotësojnë elementet e figurës së veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe praktika gjyqësore. Kështu, në vendimin nr.365, datë 04.04.2007 Kolegji Penal i

²³² Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.413.

²³³ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.319

Gjykatës së Lartë²³⁴ thuhet se “...Të dy gjykatat pranojnë të provuar se, më 31.12.2001, gjatë kohës që e dëmtuara G.U (lindur më 31.01.1985), ishte duke ecur në superstradën afër fshatit Lekaj (Kavajë), të gjykuarit ndaluan automjetin me të cilin ishin duke udhëtuar pranë saj dhe, pasi e ndaluan dhe e lidhën këmbë e duar e i mbyllën sytë, e futën në bagazh. Pranojnë gjithashtu se, mbasi bënë një rrugë dytësore në këtë gjëndje, ndaluan automjetin dhe pasi i zgjidhën këmbët e duart, e vendosën në sendilën e pasme të automjetit ku e zhveshën plotësisht dhe tentuan të kryejnë marrëdhënie seksuale me të, por pasi konstatuan që ishte me menstruacione, nuk realizuan kontaktin seksual, duke u shprehur me fjalët: “Të lumtë se na shpëtove”. Të gjykuarit kanë pretenduar se, pranimi i ngjarjes si më sipër nuk i përgjigjet realitetit dhe se ata nuk kanë kryer veprën penale për të cilën u deklaruan fajtorë dhe u dënuan, pretendim, të cilin ky Kolegj e gjen të pabazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe të analizuara e të çmuara në të dy shkallët e gjykimit, konform kërkesave të dispozitave të neneve 152 e 380 të K.Pr.Penale.

Mirëpo, përsa i përket cilësimit ligjor të ngjarjes kriminale si më sipër, Kolegji arriti në përfundimin se, cilësimi ligjor i bërë nga të dy gjykatat është i gabuar. U arrit në këtë përfundim, pasi, sikundër pranojnë të dy gjykatat vepra penale e marrëdhënies seksuale me dhunë me të miturën G. mbeti e pa përfunduar, pasi të gjykuarit, megjithëse kishin mundësi që të vazhdonin veprimet për kryerjen e marrëdhënies seksuale me të, ndodhur para një rrethane të gjendjes fiziologjike në të cilën ndodhej ditën e ngjarjes ajo, me vullnetin e tyre të lirë hoqën dorë në mënyrë përfundimtare nga realizimi i kontaktit seksual me dhunë. Gjendjen e menstruacioneve në të cilën ishte e dëmtuara, Kolegji, e konsideron jo pengesë objektive për vazhdimin e veprimeve të kundërligjshme nga ana e të gjykuarve për të përfunduar aktin seksual me të, por një gjendje të veçantë, vlerësimi i së cilës për vazhdimin ose jo të këtyre veprimeve, ishte në varësi të qëndrimit subjektiv të tyre. Mirëpo, megjithëse bazuar në sa u parashtruan më lart, ndodhemi para rrethanës së heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, parashikuar nga neni 24 i K.Penal dhe, për rrjedhojë, të gjykuarit nuk mund të përgjigjen penalisht për veprën penale për të cilën ishin akuzuar dhe deklaruar fajtorë e u dënuan, ky Kolegj arriti në përfundimin se, veprimet e gjeratëherëshme (deri në momentin e heqjes dorë nga realizimi i kontaktit seksual), sikurse janë lidhja dhe futja në bagazhin e automjetit të të dëmtuarës, përmbajnë elementët e figurës së krimit të heqjes së paligjshme të lirisë, parashikuar nga neni 110/II i K.Penal, vepër për të cilën ata duhet të përgjigjen penalisht...”.

Këtu vlen të theksohet se, është i ndryshëm rasti kur heqja e paligjshme e lirisë shoqëron marrëdhënien seksuale, ose homoseksuale. Për shembull, personi A takon të mitur në rrugë, e tërheq me forcë nga krahu dhe e fut pas një shkurreje me qëllim për të kryer marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të, por ai heq dorë nga kryerja e marrëdhënies dhe e lë të lirë të largohet të miturin. Në këtë rast subjekti aktiv nuk do të mbajë përgjegjësi penale për figurën e veprës penale të “Heqja e paligjshme e lirisë”, sepse është element i anës objektive të veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”. Pra, duhet të evidentohet dallimi ndërmjet heqjes së lirisë që paraprin kryerjen e marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale dhe

²³⁴ Shih vendimin nr 365 datë 04.04.2007 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

heqjen e lirisë që shoqëron kryerjen e marrëdhënies, si element thelbësor i kësaj të fundit.

Duke konstatuar ngjashmërinë që ka rrëmbimi, ose mbajtja peng e personit me qëllim përfitimin, me heqjen e paligjshme të lirisë me qëllim për të kryer marrëdhënie seksuale me të mitur, është e rëndësishme të analizohen diferencat thelbësore ndërmjet këtyre figurave të veprës penale. Kjo analizë merr vlerë të shtuar për shkak të problematikave të shfaqura në praktikën gjyqësore dhe kualifikimit të gabuar ligjor që bëhet në këto raste të ngjashme.

Figura e veprës penale të “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit” është parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal²³⁵, në të cilin përcaktohet se: “*Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi, për t’iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara, për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.*

Po kjo vepër e kryer ndaj të miturit nën moshën 14 vjeç dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e të miturit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet dhe, kur është shkaktuar vdekja, me burgim të përjetshëm”.

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ka si objekt juridik parësor lirinë e personit. Interpretimi dhe zbatimi korrekt i kësaj dispozite kërkon të mbahen parasysh ndërmjet të tjerave, dy elementë thelbësorë²³⁶:

- Përfitimi i padrejtë dhe realizimi i interesave të tjera të paligjshme në kuptim të rasteve të parashikuara nga dispozita dhe
- lirimi i viktimës përkundrejt marrjes së këtij përfitimi.

Edhe pse është e vendosur në seksionin VII “Veprat penale kundër lirisë së personit”, neni 109 ka për objekt jo thjesht mbrojtjen e lirisë personale, por edhe paprekshmërinë dhe mbrojtjen e pasurisë. Veprimet dhe motivet e autorëve të veprës penale e kthejnë viktimën në një instrument, “send” të çënuar si qenie njerëzore dhe në interesat e tij pasurore e jopasurore. Ekziston një lidhje e ngushtë midis qëllimit të veprës, përfitimit dhe lirimit të personit për këtë shkak. Ai shkëmbehet, pra lihet i lirë, vetëm përkundrejt realizimit të përfitimit të pasurisë, përfitimeve dhe qëllimeve të tjera të parashikuara në dispozitë²³⁷.

Neni 109 është i qartë në këtë drejtim, sepse ligjvënësi ka përcaktuar vendimtare në kuptim të anës subjektive realizimin e qëllimit “... për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër” dhe jo shkakun e saj. Pra, qëllimi i përfitimit dhe lirimi i viktimës përkundrejt realizimit të këtij qëllimi, përbëjnë në mënyrë të njëkohshme elemente thelbësore të kësaj vepre penale.

Neni 109 i Kodit Penal (ashtu sikurse edhe neni 110 i tij), duhet të konsiderohet i kryer me heqjen e paligjshme të lirisë, rrëmbimin a mbajtjen peng të viktimës, pavarësisht nëse autori ka arritur ose jo të realizojë përfitimet dhe qëllimet e parashikuara në vepër dhe përkundrejt të cilave ai do të lirojë viktimën.

²³⁵ Shih nenin 109 të Kodit Penal.

²³⁶ Shih vendimin unifikues nr.1, datë 25.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²³⁷ Po aty

Një nga elementët specifike që është dallues dhe përcaktues në kualifikimin e veprës sipas nenit 109, apo nenit 110 të Kodit Penal, lidhet me anën subjektive të tyre, pikërisht me qëllimin, motivin e autorit të veprës penale dhe që ka të bëjë me realizimin e një përfitimi pasuror, përfitimeve a qëllimeve të tjera (të ngjashme). Kjo situatë del nga vet kuptimi në tërësi i nenit 109 të Kodit Penal, ku përfitimet dhe qëllimet duhet të jenë të padrejta, të përbëjnë një interes të paligjshëm, për vehte ose për të tjerët, përkundrejt lirimit të viktimës. Motivi dhe qëllimi i veprës sipas nenit 109 të Kodit Penal, lidhet me realizimin në mënyrë të padrejtë të një përfitimi pasuror, të një qëllimi tjetër të paligjshëm a në rrugë të paligjshme, përfshirë edhe qëllime të tjera të ngjashme me ato të përmendura shprehimisht në këtë dispozitë. Kjo e fundit përjashton qëllimin për të kryer marrëdhënie seksuale.

Ndërkohë, heqja e paligjshme e lirisë nuk i ka të përcaktuara motivet në kuptim të anës subjektive, gjë që do të thotë se ato janë të tilla që nuk përfshihen në nenin 109 të Kodit Penal ose në vepra të tjera penale. Kështu, nëse subjekti aktiv e kap të miturin dhe e fut në bagazhin e mjetit të tij, e dërgon në pyll dhe kryen marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale, ai ka konsumuar në përqsaje të konkurimit fiktiv të përthithjes figurat e veprave penale të “Heqja e paligjshme e lirisë” dhe “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, ku e para shërben si mjet për realizimin e veprës qëllim. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga praktika gjyqësore. Kështu, përmendim vendimin nr.128 datë 01.03.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë²³⁸, në të cilin është theksuar se: *“...Në procesverbalin e kallzimit të datës 18.09.2002 ajo ka pretenduar se, i gjykuari K.D, ndonëse ishte martuar ndërsa kjo e mitur (e datëlidjes 03.05.1989) në vazhdimësi e shqetësonte duke i shprehur dashurinë dhe në kundërshtim me vullnetin e saj, para disa muajsh, e futi me zor në makine duke e qëlluar me grushta, e çoi tek liqeni i Kurjanit ku tentoi të kryente marrëdhënie seksuale me të, porse ajo nuk e lejoi. Në vazhdim ajo ka deklaruar se e takoi të gjykuarin K më datën 15.09.2002, i cili i tha se e kërkonte i gjykuari Rr.K dhe përsëri me dhunë e futi në një makinë ku ishin edhe të gjykuarit Rr.K, Xh.K e një person tjetër. Më pas, sipas saj, e çuan tek shtëpia e xhaxhait të të gjykuarit Xh e pastaj në Roskovec, ku me ta u bashkua dhe i gjykuari S.K. Gjatë kesaj kohe, rezultoi se të gjykuarin K.D e njoftuan se e kërkonte policia dhe ai është larguar e paraqitur në komisariat.*

Ne vazhdim e dëmtuara ka pretenduar se e çuan në fshatin Kurjan tek shtëpia e të gjykuarit A.K, gruaja e të cilit, ju shtroi për të fjetur në një dhomë me të gjykuarin Xh.K, i cili ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me të. Në këtë banesë ajo pretendon se kanë qendruar dy netë ndërsa natën e tretë me që ishte vënë në lëvizje policia u larguan prej aty e qëndruan në pyll.

Organi i akuzës ka dërguar për gjykim të pandehurit K.D, R.K e Xh.K, akuzuar për veprat penale të rrëmbimit të personit në bashkëpunim dhe kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të mitura nën moshën 14 vjeç, parashikuar nga nenet 109/2 e 100/1 i Kodit Penal, të pandehurin S.K për kryerjen e veprës penale të rrëmbimit të personit në bashkëpunim parashikuar nga neni 109/2 i K.Penal dhe të pandehurin A.K për akuzën e përkrahjes së autorit të krimit parashikuar nga neni 300/1 i K.Penal, mbajtje të lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, për veprën penale të kultivimit të lëndëve narkotike parashikuar nga neni 284/1 i K.Penal dhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armeve luftarake parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal.

²³⁸Vendimin nr.128, datë 01.03.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e rrethit, ka vendosur ndryshimin e akuzës për rrëmbim personi të kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 109/2 i K.Penal për të gjykuarin K.D, R.K, Xh.K e S.K në veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese parashikuar nga neni 114/a pika 1,4,5,6 të K.Penal, ka deklaruar fajtorë e dënuar të gjykuarit K.D, R.K e Xh.K për veprën penale të marrëdhënieve seksuale me të mitura nën moshën 14 vjeç, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal dhe të gjykuarin A.K e ka deklaruar fajtor e dënuar për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, për përkrahje të autorëve të krimit e të kultivimit të bimëve narkotike parashikuar nga nenet 278/2 i K.Penal, 302/1 dhe 284/1 i K.penal dhe të pafajshëm për veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 i K.Penal...

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në analizën tërësore të provave e pretendimeve të ngritura, çmon se vendimet e gjykatave janë pjesërisht të drejta e të bazuara në ligj e në prova. Kështu, drejt kanë konkluduar e vendosur gjykatat për kryerjen e veprës penale të marrëdhënieve seksuale me të mitura nën moshën 14 vjeç për të gjykuarit R e Xh.K. Po kështu, i drejtë e i bazuar në ligj e në prova është vendimi për të gjykuarin A K.

Kolegji Penal vendosi lënien në fuqi të vendimit nr.374, datë 01.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë në pjesën që deklaroi fajtor e dënon të gjykuarit Rr.K e Xh.K për veprën penale të marrëdhënieve seksuale me të mitura që nuk kanë arritur moshën katermbëdhjetë vjeç, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal dhe për deklarimin fajtor e dënimit të gjykuarit A.K.

Gjithashtu, vendosi prishjen e vendimit të mësipërm në pjesën që bën fjalë për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese parashikuar nga neni 114/a pika 1, 4, 5, 6 për të gjykuarin Xh.K, Rr.K, S.K e K.D dhe për këtë të fundit edhe për deklarimin fajtor për veprën penale të marrëdhënies seksuale me të mitura e kthimin e akteve për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Vlorë, me tjetër trup gjykues...”.

2.1.6. Relacioni me figurën e veprës penale të “Fyerja”.

Krimi “Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur”, siç e theksuam më lart ka objekt juridik mbrojtjeje lirinë seksuale, por akti seksual dhe veprimet që e përbëjnë, apo shoqërojnë atë çënojnë edhe ndjenjën e dinjitetit personal. Kjo e fundit përbën objektin juridik të mbrojtjes të figurës së veprës penale të “Fyerja”^{239,240}. Pavarësisht koneksitetit natyror të tyre, ndërmjet krimit “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe kundërvajtjes penale të “Fyerja” ekzistojnë dallime thelbësore si nga objekti që ato prekin ashtu edhe nga ana subjektive. Nga ana subjektive të dyja veprat penale kryhen me dashje, por ndërsa në krimet seksuale te subjekti ekziston qëllimi për të kryer aktin seksual, në veprën e fyerjes ekziston vetëm qëllimi për t’i prekur të dëmtuarës ndjenjën e dinjitetit personal. Këto dallime janë evidentuar edhe nga praktika gjyqësore.

²³⁹ Shih nenin 119 të Kodit Penal, në të cilin parashikohet se: “ Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”.

²⁴⁰ Me fyerje kuptohet cenimi i nderit e dinjitetit personal nga fjalë, ose gjeste poshtëruese.

Kështu, në vendimin e datës 14.07.1980, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë²⁴¹ në të cilin theksohet se: “Nga aktet rezulton se i gjykuari ka shkuar si zakonisht në qendren e punës. Përpara se të fillonte punën ai ka parë se në magazinën e sektorit ka shkuar e dëmtuara, me të cilën njëhej edhe më parë, sepse që të dy kanë qënë punëtorë të një brigadë. Pak më vonë nga hyrja tjetër ka shkuar në magazinë i gjykuari me preteks se do të merrte një vegël punë për të punuar. Sa ka hyrë në magazinë, sikundër ka shpjeguar e dëmtuara, ka mbyllur derën dhe i ka thënë “po tani që je vetëm” dhe megjithëse e dëmtuara i ka thënë të dilte jashtë, ai fillimisht e ka qëlluar lehtë me grusht në stomak, pastaj e ka kapur nga të dyja duart e ka mbështetur tek cepi i murit dhe e ka puthur të dëmtuarën. Ndërkohë, ajo i ka kundërshtuar këto veprime dhe duke parë se ai nuk po shkëputej ka thirrur “o s”. Meqënëse jashtë magazinës ka pasur njerëz ndër të tjerë edhe dëshmitari S.B, i cili sa ka dëgjuar këtë thirrje menjëherë ka hyrë në magazinë dhe i ka folur të gjykuarit për këto veprime. Për këtë vepër gjykata e rrethit Fier e ka deklaruar fajtor të gjykuarin për kundërvajtjen penale të fyerjes sipas nenit 185/1 të Kodit Penal. Ky konkluzion nuk është arritur si rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes sepse në varësi me disa veprime të ushtruara nga i gjykuari ndaj të dëmtuarës, si qëlluarja lehtë me grusht në stomak, kapja fort prej duarsh për të mposhtur qëndresën e saj, mbështjetja për murit, duhet të hetohet ana subjektive e të gjykuarit nëse ka pasur synim që nëpërmjet këtyre veprimeve të kryente marrëdhënie seksuale me dhunë, apo ka dashur vetëm ta puthë atë.

Gjatë rihetimit të kësaj çështjeje duhet të hetohen sidomos këto momente kryesore: Pse ka shkuar në magazinë i gjykuari, ka patur ose jo vegël për të marrë atje, në qoftë se po, pse e ka zënë derën e magazinës, cilat janë veprimet që ka kryer ai ndaj të dëmtuarës? Saktësimi sa më i plotë i tyre duke patur parasysh pikën 2 të udhëzimit nr.1 datë 14.03.1979 “Mbi krimet seksuale” do të hedhë dritë mi elementet e figurës së krimit që ka kryer i gjykuari. Në dosjet hetimore ndodhet vendimi mbi ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës nga neni 97/1 e 11/2 në nenin 185 i Kodit Penal. Ky vendim nuk është i argumentuar në mënyrë bindëse sepse ana subjektive, në rastin konkret në një kohë kur i gjykuari mban qëndrim mohues, duhet të dalë nga tërësia e rrethanave të ngjarjes. Prandaj duke e parë çështjen në tërësi të dy vendimet e gjykatave duhet të prishen dhe çështja duhet t’i dërgohet organeve të hetuesisë për të rihetuar nëse në veprimet e kryera nga i gjykuari ekzistojnë apo jo elementet e krimit të marrëdhënies seksuale me dhunë në fazën e tentativës dhe në rast se po i gjykuarai t’i nënshtrohet përgjegjësisë penale për këtë krim...”.

Praktika gjyqësore ka treguar se kryerja e aktit seksual, ose homoseksual shoqërohet edhe me veprime të tjera të cilat nuk kanë karakter seksual, si të tilla mund të përmendim urinimin e të dëmtuarit pas kryerjes së aktit seksual, pështymën, lëpirjen anale etj. Ky i fundit përbën edhe faktin tipik në vendimin nr.245 datë 26.09.2012 të Kolegjit Penale të Gjykatës së Lartë²⁴², në të cilin përcaktohen rrethanat e faktit si më poshtë: “....Ky person i ka kërkuar atij që ta ndihmonte të ngrinte një send të rëndë, por që është refuzuar prej tij sepse nuk kishte dalluar asnjë send. Atëherë agresori i tij e ka urdhëruar që t’i afrohej dhe mbasi e ka kapur kundër dëshirës së tij e ka zhveshur në pjesën e poshtme të trupit dhe më pas ka kryer marrëdhënie homoseksuale me të. Mbasi ka përfunduar aktin i ka urinuar në fytyrë dhe e ka kërcënuar që të mos tregonte për ngjarjen dhe është larguar...”.

²⁴¹ Shih vendimin e datës 14.07.1980 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Revista Drejtësia Popullore e nr.3, 1980.

²⁴² Shih vendimin nr.245 datë 26.09.2012 të Kolegjit Penale të Gjykatës së Lartë.

Pyetja që lind në këtë rast është: Cili do të jetë kualifikimi ligjor në këto raste?

Duke marrë në konsiderate dallimin ndërmjet figurave të veprës penale të “Fyerja” dhe “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, theksojmë se për të bërë kualifikimin e duhur ligjor duhet të përcaktohet qëllimi që ka subjekti aktiv në kryerjen e veprimeve të tilla. Kështu, nëse këto veprime janë kryer në funksion të arritjes së kënaqësisë seksuale, atëherë kualifikimi do të bëhet sipas nenit 100 të Kodit Penal, sepse ato konsiderohen pjesë përbërëse e aktit seksual. Ndërsa, nëse ato kryhen me qëllim për të cënuar nderin dhe dinjitetin personal të të dëmtuarit, kualifikimi do të bëhet sipas konkurimit real²⁴³ ndërmjet figurave të veprës penale të “Fyerja” dhe “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”.

²⁴³ Konkurimi real është një nga format e bashkimit, në të cilën i njëjti person ka kryer disa vepra penale me veprime ose mosveprime të ndryshme në kuptimin natyror, nga teoria e të drejtës penale përkufizohet si, konkurimi real ose material i veprave penale.

KAPITULLI III

FORMA TË TJERA TË INKRIMINIMIT TË PEDOFILISË

3.1. Marrëdhënia seksuale në gjini

Një nga figurat e krimit seksual që legjislacioni penal ka parashikuar është edhe figura e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”. Kjo figurë, në aspektin historik, ka qënë e parashikuar edhe nga Kodet Penale të mëparshme, si ai i vitit 1952, ashtu edhe ai vitit 1977.

Në nenin 106^{244,245} të Kodit Penal në fuqi, është parashikuar se: *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet”*.

Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në gjini në literaturën juridike njihen me termin incest²⁴⁶, i cili çënon normat morale. Lidhur me zbulimin e këtyre marrëdhënieve parashtrihen vështirësi të konsiderueshme dhe tregohen edhe pasojat lidhur me marrëdhëniet familjare gjatë procedurës së ndjekjes. Si rezultat i këtyre diskutimeve, disa shtete kanë hequr dorë nga ndëshkimi i këtyre marrëdhënieve (Franca, Portugalia, Belgjika). Mirëpo, incesti mbetet ende i ndëshkueshëm për shumë shtete (Italia, Danimarka, Gjermania, Greqia etj.)²⁴⁷.

E drejta penale bashkëkohore, marrëdhëniet seksuale në mes të anëtarëve të familjes i konsideron si shkelje të lirisë seksuale dhe moralit në përgjithësi. Ligjvënësi i vendit tonë është udhëhequr me qëndrimin, se me këtë veprë penale çënohet integriteti seksual si tërësi e lirisë për të vendosur lidhur me marrëdhëniet seksuale dhe moralin në përgjithësi e jo martesë dhe familja, kur këtë veprë penale e ka radhitur në kapitullin e veprave penale kundër lirisë seksuale. Kështu, kanë vendosur edhe legjislacionet penale të vendeve të tjera si për Shqipëri, Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina etj.²⁴⁸.

Elementi me vlerë kualifikimi ligjor, duke e diferencuar nga figurat e tjera të veprës penale, është subjekti aktiv dhe pasiv. Për të patur këtë figurë krimi duhet që marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale të jenë kryer midis prindërit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, ose motrave, personave në gjini në vijë të

²⁴⁴ Shih nenin 106 të Kodit Penal.

²⁴⁵ Kjo dispozitë ka pësuar ndryshime me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001. Përpara këtij ndryshimi neni 106 kishte këtë përmbajtje: “Kryerja e marrëdhënieve seksuale midis prindërit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, midis personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie apo të birësimit, dënohet me burgim gjer në pesë vjet”.

²⁴⁶ Incesti ose gjaktrazimi, siç është quajtur më parë, do të thotë: marrëdhënie seksuale me pëlqim (dëshirë) në mes të anëtarëve të familjes në vijë të drejtë dhe të tërthorët të gjakut. Andaj, shkaqet e inkriminimit të këtyre marrëdhënieve, kryesisht janë të natyrës morale dhe shëndetësore. Legjislacioni penal i vendeve të cilat e inkriminojnë incestin si veprë penale nuk dallojnë shumë sa i përket elementeve të formës së thjeshtë të kësaj veprë penale.

²⁴⁷ Shih Ismet Salihu, Hilmi Zhitija dhe Fejzullah Hasani “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës” Botimi 1, i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, viti 2014, fq.707.

²⁴⁸ Po aty.

drejtë, ose ndërmjet personave që ndodhen në raporte kujdestarie, ose birësimi. Nga përmbajtja e këtij neni rezulton se rrethi i personave të dëmtuar është i kufizuar, ashtu si dhe i atyre të subjektit aktiv.

Veçori tjetër është se nuk kërkohet që ajo të realizohet me dhunë, ose në ndonjë rrethanë tjetër cilësuese, si pazotësia e të dëmtuarit për t'u mbrojtur etj. Për disa autorë këto elementë përbëjnë figura të tjera krimi²⁴⁹.

Pyetja që lind në këtë rast është: A konkuron figura e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” me figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini, ose kujdestari”?

Përcaktimi i faktit nëse këto dy figura konkurrojnë ose jo, është e kushtëzuar nga interpretimi dhe analizimi i elementëve, që përbëjnë secilën prej tyre, duke nxjerrë në pah edhe diferenca ndërmjet tyre. Kështu, diferencat ndërmjet tyre konsistojnë në:

- **Objekti-** Figura “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale dhe zhvillimin seksual normal të personit të mitur (vajzës e djalit), shëndetin dhe jetën e saj ose të tij, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet kriminale²⁵⁰. Ndërsa figura “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari” ka si objekt të tij ato marrëdhënie juridike, të cilat garantojnë moskryerjen e marrëdhënieve seksuale apo homoseksuale midis prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë në gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose birësimi²⁵¹.
- **Subjekti-** Në figurën e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” subjekti është i përgjithshëm. Ndërsa në figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari” kërkohet raporti ndërmjet subjektit aktiv dhe atij pasiv.
- Elementi i vullnetit pozitiv ndaj aktit seksual nga subjekti aktiv dhe pasiv është një diferencë tjetër ndërmjet këtyre figurave të veprës penale. Të dyja këto figura të veprës penale kërkojnë që akti seksual të kryhet vullnetarisht ndërmjet subjekteve, por në këtë drejtim ekziston një diferencë e theksuar. Kështu, në rastin e aktit seksual me të mitur, kriminalizimi është rezultat i faktit që i mituri nuk e ka arritur atë zhvillim të përgjithshëm, në të cilin të kuptojë karakterin e veprës dhe pasojat e saj, si dhe mund të kryejë normalisht marrëdhënie seksuale pa pasojë të dëmshëm për shëndetin dhe zhvillimin normal seksual. Gjithashtu, ai nuk e ka arritur atë zhvillim mendor që të kuptojë karakterin e rëndësisë së saj. Figura e veprës penale të “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini apo nënkujdestari”, nga ana subjektive kërkon që të dy subjektet aktive të kryejnë aktiv seksual me pëlqimin dhe dëshirën e secilit prej tyre. Një rregull i tillë përjashton rastin e vullnetit të vesuar të njërit subjekt. I tillë është rasti kur njëri nga subjektet aktiv përdor dhunën, armën, apo është i mitur. Në të gjitha këto raste nuk mund të flitet për vullnet dhe dëshirë për të kryer marrëdhënie seksuale me personin në gjini

²⁴⁹ Shih Esmet Elezi “E drejta penale, pjesa e posaçme” Tiranë 2009 , fq.127.

²⁵⁰ Shih Ismet Elezi “E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Shtëpia Botuese “ERIK”, Tiranë, 2009, f. 114.

²⁵¹ Shih vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 75, datë 19 Shkurt 2003.

ose nën kujdestari. Kjo bën që kualifikimi ligjor të bëhet duke marrë në konsideratë elementët cilësues, si përdorimi i dhunës, armës, apo të qënurit i mitur.

Në doktrinën e së drejtës penale në Shqipëri, është mbajtur qëndrimi se për sa kohë që objekti i drejtpërdrejtë i këtyre figurave është i ndryshëm, atëherë duhet të pranojmë edhe konkurrimin ndërmjet tyre. Për të njëjtën arsye, figura “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, konkurren me të gjitha krimet e tjera seksuale. Sipas tyre, krimi i marrëdhënies seksuale në gjini konkuron në çdo rast me krimet e tjera seksuale²⁵².

Qëndrimi që ka mbajtur praktika gjyqësore ndër vite është i njëjtë me qëndrimin e teorisë²⁵³. Më poshtë, po paraqesim disa raste të praktikës gjyqësore, në të cilat është mbajtur qëndrimi i mësipërm:

Kështu, në vendimin nr.75, datë 19.02.2003 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë²⁵⁴ thekson se: “Vendimi i Gjykatës të Apelit Tiranë nr.454, datë 11.10.2002, në pjesën që bën fjalë për pushimin e gjykimit të çështjes në ngarkim të të gjykuarit L.A, për veprën penale të marrëdhënies seksuale në gjini, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal, është marrë në aplikim të gabuar të ligjit material dhe për këtë shkak duhet të priset.

Siç del nga aktet e ndodhura në dosje, të dy gjykatat kanë pranuar të provuar se, në datën 5.2.2002, rreth orës 14.00, i gjykuari, duke kaluar pranë tuneleve të fshatit Sharrë - Tiranë, në burimin aty pranë, ka parë duke mbushur ujë, motrën e tij Z. dhe vëllanë A, të dy binjakë, të datelindjes 28.4.1990.

Kur është afruar pranë tyre, i gjykuari e ka kapur motrën Z për dore dhe duke e tërhequr me forcë e ka futur në tunel. E ndodhur në këtë vend, Z ka bërë përpjekje për t’u larguar, por nuk ka mundur, për shkak se i gjykuari duke e rrahur, nuk e ka lejuar.

Mbas këtyre veprimeve dhe mbasi i ka mbyllur gojen me dorë, i gjykuari ka kryer me motrën e tij të mitur marrëdhënie seksuale.

Përsa i përket cilësimit ligjor të veprimeve të kryera nga i gjykuari, vërehet se të dy gjykatat kanë konkluduar në menyra të ndryshme.

Gjykata e shkallës së parë këto veprime i ka vlerësuar se përbëjnë elementët e veprave penale të marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitur, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal dhe marrëdhënies seksuale me persona në gjini, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal.

Gjykata e apelit, në vendimin e saj, duke prishur vendimin e gjykatës të shkallës së parë dhe duke pushuar gjykimin e çështjes për veprën penale të parashikuar nga neni 106 të Kodit Penal, ka pranuar se kryerja nga i gjykuari i marrëdhënies seksuale me dhunë me motrën e tij të mitur përbën vetëm elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal.

Këtë përfundim gjykata e apelit e bazon në arsyetimin se neni 100/2 i Kodit Penal, nuk konkuron me nenin 106 të Kodit Penal.

²⁵²Shih gjithashtu, “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Posaçme”, Botim i “Universitetit të Tiranës”, “Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike”, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1983, f. 214

²⁵³Shih vendimin e Gjykatës së Lartë nr.75, dt. 19 Shkurt 2003. Shih gjithashtu, “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Posaçme”, Botim i “Universitetit të Tiranës”, “Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike”, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1983, f. 214. Shih Ismet Elezi “E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme”, Shtëpia Botuese “ERIK”, Tiranë, 2007, f. 122. Si dhe Ismet Elezi “Të forcojmë luftën kundër krimeve të parashikuar nga nenet 160-163 të Kodit Penal”, Drejtësia Popullore, nr. 1, viti 1968, f. 34.

²⁵⁴ Shih vendimin nr.75, datë 19.02.2003 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Duke patur parasysh kushtet e konkurimit të veprave penale, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me objektin që çënohet nga veprimtaria kriminale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se arsyetimi i vendimit të gjykatës të apelit, është i gabuar dhe i pabazuar në ligje.

Neni 100/2 i Kodit Penal, ka si objekt të tij garantimin e atyre marrëdhënieve juridike të cilat sigurojnë paprekshmerinë dhe zhvillimin seksual normal të të miturve, që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç ose që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, me qëllim për të mbrojtur shëndetin e tyre nga veprimet kriminale.

Neni 106 i Kodit Penal ka si objekt të tij ato marrëdhënie juridike, të cilat garantojnë moskryerjen e marrëdhënieve seksuale apo homoseksuale midis prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë në gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose birësimi.

Nisur nga sa u paraqit, del se i gjykuari, duke kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me një të mitur, që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç dhe duke kryer marrëdhënie seksuale me motrën e tij, ka kryer dy vepra penale dhe kjo për shkakun se ai me veprimet e tij, ka cenuar si objektin e nenit 100/2 të Kodit Penal, ashtu dhe objektin e nenit 106 të Kodit Penal.

Duke qenë në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar konkurimin e këtyre dy veprave penale dhe duke e deklaruar për to të gjykuarin fajtor, ka vepruar në përputhje të plotë me ligjin.

Bazuar në këtë përfundim, vendimi i gjykatës së apelit me të cilin është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes, për veprën penale të parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal, duhet të prishet si i pabazuar në ligje. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin i gjykuari është deklaruar fajtor, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 100/2 dhe 106 të Kodit Penal, duhet të lihet në fuqi.....”.

Gjithashtu, në vendimin nr 19 datë 18.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁵⁵ është mbajtur qëndrimi se: “I pandehuri G M pasi u ka siguruar furgon nënës dhe bashkëshortes së tij është kthyer në banesën e tij në fshatin Vaqarr ku kishte lënë fëmijet.

Në datë 01.03.2009 rreth orëve të drekës i pandehuri u ka kerkuar të dy djemve të tij dëshmitarit G dhe shtetasit K.M të dilnin nga banesa dhe të shkonin të luanin.

Pasi i ka nxjerrë përjashta të dy djemtë dhe është siguruar që ata nuk do të ktheheshin pasi ka mbyllur dhe deren e banesës ka qëndruar në shtëpi së bashku me vajzën, dëshmitaren S.M.

I pandehuri G.M duke qenë vetëm në banesë me vajzën e tij i ka lindur mendimi kriminal për të kryer marrëdhënie seksuale me vajzën e tij me dëshmitaren S.M.

Per te realizuar këtë i pandehuri G.M ka kapur për dore vajzën e tij dhe e ka cuar tek dhoma e gjumit. Mbas kësaj e ka shtrirë me forcë në krevat dhe pasi i ka hequr tutat dhe me pas të mbathurat ka kryer marrëdhënie seksuale me të.

Gjatë kohës së kryerjes së marrëdhënieve seksuale i pandehuri G.M nuk e ka lejuar që ajo të bërtiste duke e kërcënuar se do ta vriste në rast të kundërt....

Gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri G.M, duhet të përgjigjet penalisht për veprat penale të “Marrëdhënie seksuale me të mitur”, “Marrëdhënie seksuale në gjini”, parashikuar nga nenet 100/1 dhe 106 të K.Penal...”.

Pavarësisht qëndrimit të mësipërm, në disa raste të tjera gjykata ka mbajtur qëndrim se këto vepra nuk konkurojnë me njëra tjetrën. Kështu, përmendim vendimin

²⁵⁵ Shih vendimin nr.19, datë 18.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

nr.964, datë 24.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin është arsyetuar se: *“...Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka filluar procedimin penal me nr.441, datë 02.02.2008, në ngarkim të të pandehurit R.I, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Marrëdhënie seksuale me të mitur”, “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç”, “Shkaktimit të vetëvrasjes” dhe “Heqje e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga Neni 100/2, 101/2, 99 dhe 110/1 i K.Penal.*

Nga shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështje, rezulton si më poshtë: Kallzuesja E.I është e datëlindjes 01.06.1985 dhe deri në vitin 2000 ka jetuar me familjen e saj në fshatin Blerim të rrethit Pukë. Ajo ka kallzuar se pasi ka mbushur moshën 11 vjeç babai i saj, i pandehuri R.I, ka filluar të abuzojë seksualisht me të. Ai e merrte shpesh në dhomë dhe fillimisht ka kryer me të veprime të turpshme si prekje të organeve gjenitale dhe pjesë të tjera të trupit duke shfryrë epshin e tij me këto veprime. Të gjitha këto veprime ai i bënte duke e porositur që të mos fliste me njeri përsa kishte ndodhur dhe duke e kërcënuar se do ta rrihte.

Pas dy vjetesh, në moshën 13 vjeçare, pasi i pandehuri kishte rreth dy vjet që kryente këto veprime ai e ka marrë në dhomë dhe pasi e ka zhveshur ka kryer me të marrëdhënie seksuale.

I pandehuri R.I babai i kësaj vajze 13 vjeçare, ka vazhduar në këtë mënyre të kryejë marrëdhënie seksuale me E rregullisht duke e mbajtur atë nën presionin që të mos tregonte, ndikim ky që plotësohej dhe me dhunën që ai do të ushtronte ndaj nënës së saj të cilën shpeshherë e dhunonte në sy të fëmijëve madje në raste të veçante dhe e ka goditur dhe atë. E trembur, e tronditur psikologjikisht E. nuk ka treguar familjarëve të saj dhe në këtë mënyrë ata kanë vazhduar të kryejnë marrëdhënie dhe pasi ajo ka mbushur moshën 14 vjeç. Ajo kallëzoi se marrëdhëniet seksuale i kanë kryer në çdo rast në shtëpi natën, pasi binin për të fjetur gjumë, pasi ata flinin bashkë për shkak se prej shumë vitesh prindërit e saj nuk flinin në një dhomë me njëri-tjetrin. Për këtë fakt, nëna e saj, Sh. ka deklaruar se ka ajo shpesh kishte bërë debat me bashkëshortin e saj për faktin se ai flinte me vajzën madje i kishin lindur dhe dyshime për natyrën e marrëdhënieve të tyre, por nuk kishte dashur ta besonte një fakt kaq të rëndë. E. pasi ka kaluar moshën e hershme të adoleshencës ka filluar të kuptojë se marrëdhënia seksuale mes saj dhe babait nuk ishte e natyrshme, por kjo është përdorur nga i ati, R. si një argument tjetër presioni mbi të, duke i thënë se po të merrej vesh kjo marrëdhënie mes tyre, do të ishte e turpshme për ta në sytë e opinionit publik, duke e detyruar të mos flasë me nënën apo motrat e saj.

Në vitin 2000 familja e R.I ka ardhur me banim në Laknas-Tiranë. I pandehuri R.I, përsëri ka vazhduar të kryejë marrëdhënie me E, por tani duke përdorur dhe banesën e vëllait të tij, që ishte emigrant në Itali, e cila ndodhej aty afër. Me kalimin e viteve, marrëdhënia e R me E filloi të merrte përmasa të tjera. I pandehuri vazhonte të bëhej më i dhunshëm ndaj të bijës E, duke mos e lejuar të shoqërohej me djem të tjerë dhe duke ndërhyrë në jetën e saj private.

Në vitin 2004 E, ka mbetur shtatzanë gjatë marrëdhënies seksuale që kishte me R. dhe për këtë ajo ka vënë në dijeni vetëm atë dhe me ndihmën e tij e ka bërë ndërprerjen e shtatzanisë në një klinikë private.

Në vitin 2007 në muajin gusht, E ka vendosur që t'i ndërpresë marrëdhëniet me R, duke ja bërë të ditur të gjithë historinë nënës dhe motrave të saja. E ëma Sh ka folur me vajzën, e cila i është lutur të mos ta bënte publike dhe të ndikonte tek babai i saj që ai mos ta shqetësonte më. Sh. ka folur me R., i cili e ka pranuar se kishte kryer marrëdhënie seksuale me E, por i është lutur që të mos fliste me njeri pasi po i jepte fjalën se nuk do ta shqetësonte më vajzën, E, vetëm mos ta bënte publike dhe mos ta

kallzonte në polici. Kështu që, e gjithë familja, kanë vendosur bashkë që ta mbajnë të fshehtë për shkak të opinionit. Ky premtim është mbajtur nga i pandehuri vetëm disa muaj, por pastaj ai në disa raste e ka provokuar atë duke e prekur nëpër shtëpi apo duke tentuar ta puthë.

Në datën 11.01.2008, në mëngjes, në momentin që E ka qënë duke larë duart, R, ka tentuar ta prekë me duar dhe ta puthë. Pas refuzimit të E, që e ka kundërshtuar ai është revoltuar me të dhe e ka goditur. E prekur nga ky akt dhe gjithë kjo situatë dhe duke e parë veten pa shprese E. ka tentuar të vrasë veten duke pirë fostoksinë. Si pasojë e helmit të pirë gjendja e saj shëndetsore është përkeqësuar dhe ajo është dërguar nga familjaret e saj në gjendje të rëndë në spital. Pas trajtimit të specializuar mjekësor ajo ka mundur të shpëtojë dhe ka qendruar e shtruar në spital për gjashtë ditë. Sh, ka mësuar nga E faktin se para tre vjetesh ajo kishte mbetur shtatzanë dhe i ati e kishte dërguar në një klinikë private ku ajo kishte abortuar duke e paraqitur me emër të rremë. Duke menduar se publikimi i këtij raporti do të dëmtonte vajzën e saj Sh është detyruar mos të reagoje duke kërkuar që i pandehuri mos ta shqetësonte me vajzën duke i ndërprerë marrëdhëniet me të.

Gjykata bazuar në nenin 375 të K.Pr.Penale vendosi: a) ndryshimin e kualifikimit të veprës penale “Marrëdhënie seksuale me të mitur”, nga neni 100/2 në nenin 100/1 të K.Penal, pasi dhuna në këtë moshë nuk provohet; b) ndryshimin e kualifikimit të veprës penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”, nga neni 101/2 në nenin 101/1 të K.Penal, pasi dhuna në këtë moshë e ka çuar E në një gjendje psikologjike të rënduar dhe të pashpresë për të cilën ajo ka tentuar të vrasë dhe veten duke pirë fostoksinë...”

Për të përcaktuar nëse këto figura të veprës penale konkurojnë ndërmjet tyre duhet të analizohen koncepti i konkurimit fiktiv të specialitetit dhe parimet e aplikimit të tij. Koncepti i konkurimit fiktiv të specialitetit është elaboruar nga doktrina e së drejtës penale në kushtet e mungesës së një parashikimi në Kodin Penal. Konkurimi fiktiv i specialitetit ekziston kur për zbatimin e një situatë kriminale konkurojnë më shumë se një dispozitë ligjore për një veper penale, por zbatohet vetëm ajo që tregon në mënyrë të hollësishme padrejtësinë kriminale²⁵⁶. Konkurim fiktiv i specialitetit nënkupton konkurim ligjesh, kur dispozita të ligjeve të ndryshme ose të së njëjtit ligj, rregullojnë të njëjtin objekt juridik mbrojtjeje. Kështu, njëra dispozitë parashikon kushtet e përgjithshme, ndërsa dispozita tjetër e parashikon në mënyrë më të detajuar^{257,258}. Në këtë rast, do të gjejmë zbatim ato dispozita ligjore që e rregullojnë marrëdhënien juridiko penale përkatëse në mënyrë të detajuar. Në doktrinën e së drejtës penale, ky njihet si parimi “ligji i posaçëm ka përparësi mbi atë të përgjithshëm” (*lex specialis derogat generali*).

Kodi Penal italian²⁵⁹, ndryshe nga Kodi ynë Penal, e parashikon duke e rregulluar me një dispozitë të veçantë konkurimin fiktiv të specialitetit (konkurimin e ligjeve). Kështu, në nenin 15 të tij parashikohet se: “Kur më shumë se një ligj penal ose më shumë se një dispozitë e të njëjtit ligj penal rregullon të njëjtën marrëdhënie,

²⁵⁶ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.408.

²⁵⁷ Nga pikëpamja e logjikës formale bëhet fjalë për dy norma juridike që rregullojnë dy koncepte, në marrëdhënie gjini dhe lloj me njëri tjetrin. Koncepti lloj përbëhet nga një tërësi elementesh, ndërsa koncepti gjini ka të gjithë elementët e konceptit lloj por edhe të tjerë.

²⁵⁸ Shih Luan Pirdeni “Hyrje në Logjikë”, Shtëpia Botuese “Koçi”, Tiranë, 2007, f. 32.

²⁵⁹ Shih nenin 15 të Kodit Penal Italian.

ligji ose dispozita e ligjit të posaçëm ka përparësi ndaj ligjit ose dispozitës së ligjit të përgjithshëm, përveç kur parashikohet ndryshe”.

Pavarësisht se në Kodi tonë Penal nuk ka një dispozitë të përgjithshme që të parashikojë parimin “ligji i posaçëm ka përparësi mbi atë të përgjithshëm”, fryma e këtij parimi është përcjellë në dispozitën e posaçme të nenit 248 të Kodit Penal që parashikon figurën e veprës penale të “Shpërdorimi i detyrës”. Kjo dispozitë e sanksionon shprehimisht se shpërdorimi i detyrës sipas këtij neni dënohet vetëm kur “nuk përbën veprë tjetër penale”.²⁶⁰

Në të drejtën penale një situatë e tillë krijohet në rastet që njëra normë juridike parashikon figurën e përgjithshme të veprës penale, ndërsa të tjerat, figurat e posaçme të saj. Kështu, neni 102 i Kodit Penal, sanksionon figurën e përgjithshme të veprës penale “Marrëdhënia seksuale me dhunë me të rritura”. Kurse dispozitat e tjera të këtij seksioni, siç është neni 106 i Kodit Penal, i cili parashikon figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini ose kujdestari”, apo neni 100 i Kodit Penal, i cili parashikon figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” etj, parashikojnë figurat e posaçme.

Në këto kushte, kur subjekti aktiv kryen marrëdhënie seksuale me të miturën, e cila është vajza e tij, veprimet e tij përmbajnë të gjithë elementët që përshkruan neni 100 i Kodit Penal dhe njëkohësisht ato përmbajnë edhe elementët që përshkruan neni 106 i Kodit Penal. Për rrjedhojë, në pamje të parë duket se ky person duhet të dënohet edhe sipas nenit 100 edhe sipas nenit 106. Pra, formalisht jemi përpara konkurimit të figurave përkatëse të parashikuara nga këto dispozita. Nëse do të bënim një kualifikim të tillë, do të cënonim parimin e “ne bis in idem”, në kuptimin material, sepse do ta dënonim të njëjtin person dy herë për të njëjtën veprë^{261.262}. Kjo pasi, vetëm në dukje veprimi aktiv përmban elementët e dy figurave të veprave penale, ndërsa në fakt kemi vetëm një figurë të veprës penale, sepse figura “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” nuk është gjë tjetër veçse një formë e posaçme e shfaqjes së figurës së përgjithshme “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, por në një relacion të tillë (por me kah të dyanshëm) është edhe me figurën e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose kujdestari”. Kështu që nuk kemi konkurim të këtyre figurave të veprës penale. Në doktrinën e së drejtës penale janë diferencuar dy situata. Situata e parë, në teorinë e të drejtës penale njihet si raporti i njëanshëm i konkurimit të ligjeve (figurave të veprave penale)²⁶³ sepse çështja e konkurimit shtrohet vetëm kur veprimet ose mosveprimet e personit përmbajnë elementët e normës (figurës) së posaçme. Në të kundërt, nëse nuk përmbajnë elementët e saj kemi vetëm një veprë dhe për rrjedhojë nuk ka konkurim.

²⁶⁰Shih nenin 248 të Kodit Penal.

²⁶¹Shih gjithashtu Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 408-411.

²⁶²Kështu në vendimin nr.68, dt. 29 Shkurt 2012 të Gjykatës së Lartë arsyetohet se: “Ndalimi ligjor i dënimit më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale është shprehje e parimit të së drejtës penale i cili përjashton jo vetëm deklarinimin fajtor dhe dënimin e të gjykuarit më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale, por edhe kualifikimin ligjor të së njëjtës veprë sipas dispozitave të ndryshme të Kodit Penal. Nuk mund të bëhet cilësimi ligjor i veprës një herë sipas një dispozite të përgjithshme dhe një herë sipas një dispozite të posaçme”.

²⁶³Shih “Concorso Apparente di Norme”, “Digesto delle Discipline Penali”, Volume 2”, Botimet “UTET”, Quarta Edizione”, Rishtypur 1994, f. 416 e vijim. Shih gjithashtu, “Relazione sul tema, il concorso di reati”, Botim i “Fondazione dell’Avvocatura Trevigiana Scuola Forense”. në adresën e internetit:

http://www.ordineavvocatitrevise.it/sito/images/stories/RELAZIONE_CONCORSO_DI_REATI_Lezione_del_29.06.2012.pdf, akses në datë 25 Shkurt 2012.

Situata e dytë, e cila është më e ndërlikuar lidhet me ato raste që normat janë reciprokisht të përgjithshme dhe të posaçme ndaj njëra tjetrës²⁶⁴. Konkretisht, bëhet fjalë për figurat që janë të dyja të posaçme, në raport me figurën e përgjithshme²⁶⁵. Për shembull, nëse i referohemi figurave të veprave “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe “marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”, konstatohet se të dy këto figura, kanë nga një element që i individualizon, e para subjektin pasiv, ndërsa e dyta, lidhjen gjinore, ose të kujdestarisë ndërmjet subjektit aktiv dhe pasiv.

Këto figura janë reciprokisht të përgjithshme dhe të posaçme ndaj njëra tjetrës, sepse nëse babai kryen marrëdhënie seksuale me vajzën e tij të mitur, vepra e kryer nga ai mund të cilësohet si “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, por nga ana tjetër mund të cilësohet edhe si “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”. Në këtë rast pyetja që lind është: A mund të kemi konkurim ndërmjet tyre? Nëse jo, cili do të jetë kualifikimi ligjor?

Pavarësisht se nga pikëpamja formale figurat kanë element të ndryshëm, ato nuk mund të konkurojnë ndërmjet tyre, sepse qëllimi i legjislacionit penal dhe detyrë e tij, është marrja në mbrojtje e të mirave juridike të parashikuara nga neni 1/b i Kodit Penal. Pra, t’i sigurojë një mbrojtje efektive marrëdhënies juridike të vendosura nga veprimet ose mosveprimet kriminale të personave, duke caktuar dënim penal ndaj tyre. Për rrjedhojë, nëse dy figura kanë të njëjtin objekt ato nuk mund të konkurrojnë, pasi secila nga ato e siguron mbrojtjen e marrëdhënies juridike përkatëse²⁶⁶.

Si konkluzion, theksojmë se figurat që kanë të njëjtin objekt grupor nuk konkurrojnë me njëra tjetrën. Këtë qëndrim kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.1, datë 12.03. 2002²⁶⁷. Një nga pyetjet që duhet t’i jepte përgjigje me këtë vendim kjo gjykatë ishte: “A konkurrojnë me njëra tjetrën figurat e krimit të kontrabandës, që janë parashikuar në seksionin e V-të, të kreut të III-të të K. Penal (nenet 171-177 të K. Penal)?

Lidhur me këtë ajo thekson se: “Figura e krimit të kontrabandës me mallra në regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i K.Penal dhe ajo e kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i këtij Kodi, nuk konkurrojnë as me njëra tjetrën, as edhe me figurat e tjera të krimit të kontrabandës që përfshihen në seksionin e V të nenit të III të K.Penal në të cilin janë përfshirë krimet në fushën e doganave (nenet 171-179 të K. Penal).

Në këtë përfundim arrihet duke u nisur së pari, nga fakti që, ashtu sikurse u përmend, objekti i të gjitha këtyre figurave krimi është i njëjtë (marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave të shtetit) dhe së dyti, nga fakti që vet ligjvënësi, për arsye praktike, duke dashur të lehtësojë zbatimin sa më të drejtë të tyre në funksion të zhvillimit të një luftë sa më efektive në këtë fushë të kriminalitetit, e ka ndarë kontrabandën në disa figura krimi, të cilat, teorikisht dhe praktikisht, mund të

²⁶⁴Shih Nicola Corea “Le Sezioni Unite dicono no alla consunzione”, artikull në adresën e internetit <http://www.altalex.com/index.php?idnot=34106>, akses në datë 16 Prill 2013.

²⁶⁵Në kuptim të logjikës formale bëhet fjalë për dy koncepte lloj të të njëjtit koncept gjini. Ato kanë element pjesërisht të përbashkët, por kanë edhe element të tjerë që i karakterizojnë. Shih Luan Pirdeni “Hyrtje në Logjikë”, Shtëpia Botuese “Koçi”, Tiranë, 2007, f. 32.

²⁶⁶Shih edhe “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i Gjykatës së Lartë të RPSSH dhe Universiteti i Tiranës, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, f. 319.

²⁶⁷ Shih vendimin unifikues nr.1, datë 01.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

përbënin paragrafë të veçantë të së njëjtës dispozitë të pjesës së posaçme të K. Penal”.

Siç rezulton, një nga kushtet që kërkohet lidhur me konkurimin fiktiv të specialitetit është që figurat duhet të kenë të njëjtin objekt të grupor, ose me koneksitet derivativ ndërmjet tyre.

Lidhur me kualifikimin ligjor autorët mbajnë qëndrim të ndryshëm. Disa janë të mendimit se duhet zbatuar dispozita që sanksionon dënimin më të rëndë; të tjerë, se kjo duhet të shihet rast pas rasti dhe të vendoset në varësi të rrethanave konkrete, si dhe grupi i tretë që mendojnë se duhet të zbatohet dispozita më e lehtë²⁶⁸, si rrjedhojë e parimit “çdo dyshim në favor të lirisë” (bin dubio pro libertate)²⁶⁹.

Duke marrë në konsideratë qëllimin e ligjit penal, të dënimit penal, parimin e drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe dënimit, si dhe faktin që legjislatori e përcakton masën dhe llojin e dënimit për veprat konkrete në varësi të rrezikshmërisë shoqërore që ato paraqesin, qëndrimi që kualifikimi ligjor të bëhet sipas dispozitës që parashikon dënimin me të rëndë është më i bazuar në shkencën e së drejtës penale.

Si përfundim theksojmë se për të shmangur të gjitha problematikat lidhur me konkurimin ndërmjet figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” dhe figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, është e nevojshme ndërhyrja legjislative duke e parashikuar si rrethanë cilësuese në njërin nga figurat e veprës penale, atë të marrëdhënies seksuale ose homoseksuale në gjini ose nën kujdestari me të miturit²⁷⁰.

²⁶⁸Në kuptimin e figurës për të cilën sanksionohet dënim më i vogël.

²⁶⁹Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 410.

²⁷⁰Një zgjidhje të tillë ka bërë edhe legjislatori i Republikës së Kosovës. Kështu në nenin 243 të Kodit Penal të Kosovës është parashikuar figura e veprës penale të “Marrëdhëniet seksuale brenda familjes” me përmbajtje si vijon:

“1. Kushdo që kryen akt seksual me paraardhës ose pasardhës të familjes i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose me vëlla apo motër që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kur prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku ose njerka, gjyshi apo gjyshja, daja apo axha, tezja ose halla, kryen akt seksual me fëmijën e tij, me fëmijën e birësuar, me thjeshterin e tij, me nipin ose me mbesën e vajzës apo të djalit, me nipin ose me mbesën e motrave apo të vëllezërve, mes moshave gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet, dënohet me jo më pak se (3) tre vjet burgim.

3. Kur prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku ose njerka, gjyshi apo gjyshja, daja apo axha, tezja ose halla, kryen akt seksual me fëmijën e tij, me fëmijën e birësuar, me thjeshterin e tij, me nipin ose me mbesën e vajzës apo të djalit, me nipin ose me mbesën e motrave apo të vëllezërve, që është në mes të moshës katërmëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

4. Kur prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku ose njerka, gjyshi apo gjyshja, daja apo axha, tezja ose halla, kryen akt seksual me fëmijën e tij, me fëmijën e birësuar, me thjeshterin e tij, me nipin ose me mbesën e vajzës apo të djalit, me nipin ose me mbesën e motrave apo të vëllezërve, nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

5. Kur vëllai apo motra më e madhe kryen akt seksual me vëllanë apo motrën, me vëllanë ose motrën e adoptuar, me vëllanë apo motrën e birësuar, që është midis moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet, motra apo vëllai më i madh dënohet me dënimin nga paragrafi 2. i këtij neni.

6. Kur vëllai apo motra më e madhe kryen akt seksual me vëllanë apo motrën, me vëllanë ose motrën e adoptuar, me vëllanë apo motrën e birësuar, që është në mes të moshës katërmëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, motra apo vëllai më i madh dënohet me dënimin nga paragrafi 3. i këtij neni.

Analiza e bërë më sipër lidhur me konkurimin ndërmjet figurave të veprës penale “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”, është e vlefshme edhe në lidhje me konkurimin ndërmjet figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” dhe figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”.

Kodi Penal²⁷¹ ka parashikuar se: *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në tre vjet”*.

Doktrina e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore deri së fundmi ka pranuar konkurimin ndërmjet këtyre figurave të veprës penale.

Në vendimin e datës 26.05.1979 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë²⁷² ka arritur në përfundimin se personi që tenton të hyjë në marrëdhënie seksuale me dhunë me një person që e ka në vartësi duke shpërdoruar detyrën, kryen përveç krimit të marrëdhënies seksuale me dhunë, edhe atë të shpërdorimit të detyrës, pasi të dy këto krime, për shkak të elementëve përbërës konkurojnë me njëri-tjetrin. Kështu, ajo thekson se: *“...Gjykatës i bëhet vërejtje për ta pasur parasysh në të ardhmen, mbasi në veprimet e të gjykuarve ekzistojnë plotësisht edhe elementët e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës sepse dihet që për shkak të elementeve kryesore përbërëse, vepra penale e marrëdhënieve seksuale me dhunë dhe ajo e shpërdorimit të detyrës përjashtojnë njëra tjetrën, si rrjedhim ato konkurojnë”*. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe plenumi i Gjykatës së Lartë në udhëzimin nr.1, datë 14.03.1979 mbi krimet seksuale²⁷³.

Praktika gjyqësore²⁷⁴ ka ndryshuar qëndrim, duke bërë kualifikimin sipas figurës së “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur”. Një kualifikim i tillë është në përputhje me konceptin e konkurimit fiktiv të specialitetit dhe parimet e zbatimit të tij.

3.2. Vepra të turpshme

Parashikimi i figurës së veprës penale “Vepra të turpshme” nga Kodi Penal që hyri në fuqi në vitin 1995 është vazhdim i traditës së Kodeve Penale të mëparshme të vitit 1952 dhe 1977, të cilët bënin të njëjtin parashikim.

Në Kodin Penal të 1977 është parashikuar se *“Kryerja e veprave të turpshme me persona që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç dënohet me heqje liri nga një deri në pesë vjet”²⁷⁵*.

Të njëjtën përmbajtje mbart edhe Kodi Penal i vitit 1995, duke parashikuar se: *“Kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, dënohet me burgim gjer në pesë vjet”²⁷⁶*.

7. Kur vëllai apo motra më e madhe kryen akt seksual me vëllanë apo motrën, me vëllanë ose motrën e adoptuar, me vëllanë apo motrën e birësuar, që është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet, motra apo vëllai më i madh dënohet me dënimin nga paragrafi 4. i këtij neni”.

²⁷¹ Shih nenin 105 të Kodit Penal.

²⁷² Shih vendimin e datës 26.05.1979 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁷³ Shih udhëzimin nr 1 datë 14.03.1979 të Plenumit të Gjykaës së Lartë.

²⁷⁴ Shih vendimin nr 1581 datë 18.11.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁷⁵ Shih neni 98 të Kodit Penal 1977.

²⁷⁶ Shih nenin 108 të ligjit nr 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

Me ndryshimet e ligjit nr.144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, përmbajtja e nenit 108 u ndryshua si më poshtë²⁷⁷: “Kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet²⁷⁸.

Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

Siç konstatohet, legjislacioni penal nuk ka dhënë përkufizimin e termit “vepra të turpshme”. Ndërsa doktrina e së drejtës penale është përpjekur në këtë drejtim duke i përkufizuar veprat e turpshme (luxuri) si ato forma të kënaqjes së epshit seksual që nuk përmbajnë elementët e ndonjë krimi tjetër seksual (të marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale, ngacmimit seksual, dhunës seksuale, pornografisë, prostitucionit, apo trafikimit). Lidhur me termin “vepra të turpshme” edhe jurisprudenca ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Sipas saj, në nocionin “Vepra të turpshme apo akte seksuale” përfshihen të gjitha ato akte të adresuara drejt zonave erogjene dhe që janë të përshtatshme për të cënuar apo kompromentuar vendosmërinë e lirë të seksualitetit të viktimës dhe që rezultojnë të afta për të hyrë në sferën seksuale të viktimës, me mjete që lidhen me shtrëngim, presion apo abuzim të kushteve të inferioritetit fizik apo psikik. Në të gjitha këto raste, do të përfshihen çdo lloj prekje, kapje, shtypje mbi zonat intime të viktimës, të ndjeshme dhe të afta për të shkaktuar ndjesi seksuale qoftë edhe në mënyrë jo të plotë dhe/ose për një periudhë kohore të shkurtër, duke qenë i parëndësishëm fakti nëse viktimja e ka arritur këtë kënaqësi erotike²⁷⁹. Shprehja “pjesë intime” nënkupton gjinjtë e një femre, penisi, vagina dhe/apo anusi, ndërsa shprehja “prekje” nënkupton kontakt direkt ose indirekt, pa penetrim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë send²⁸⁰.

Objekti juridik i kësaj figure të veprës penale konsiston në mbrojtjen e marrëdhënieve juridiko-sociale që sigurojnë zhvillimin normal seksual e formimin moral të miturve, domethënë të personave që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç.

Lidhur me objektin e kësaj figure të veprës penale jurisprudenca thekson se: “Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar lirinë, integritetin dhe paprekshmërinë seksuale të fëmijëve të

²⁷⁷ Shih nenin 23 të ligjit nr 144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

²⁷⁸ Ky paragraf reflekton sugjerimin e Konvetës Lanzarote, e cila në nenin 22 parashikon “Korrupsioni i fëmijëve” me këtë përmbajtje: “Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e shkakimit të qëllimshëm, për qëllime seksuale, të një fëmije që nuk ka arritur moshën e përcaktuar në zbatimin e nenit 18, paragrafi 2, që të jetë dëshmitar i abuzimit seksual ose aktiviteteve seksuale, edhe pa qenë pjesëmarrës...”.

²⁷⁹ Shih vendimin nr.337, datë 11.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁸⁰ Shih nenin 228 të Kodit Penal të Kosovës.

mitur të moshës nën katërmbëdhjetë vjeç. Cënimi i kësaj marrëdhënieje nga shtetasit, përbën krim dhe passjell përgjegjësi penale. Doktrina e së drejtës penale dhe jurisprudence sqaron se, **“liria seksuale”** parashikuar nga neni 108 i K.Penal – është një ndër elementët mjaft thelbësorë të lirisë individuale. Por, më i rëndësishëm sesa **“liria për të disponuar trupin tënd”** është **“liria shpirtërore”** e individit, e mbrojtur nga kjo dispozitë. Jo pa qëllim, zhvillimi normal i shëndetin mendor dhe fizik të fëmijëve është bërë objekt i një mbrojtjeje mjaft të fuqishme ligjore jo vetëm nga vendi ynë por, edhe nga të gjithë vendet e botës së qytetëruar. Pasojë e kësaj rëndësie të veçantë ka qenë hartimi i Konventës “Për të Drejtat e Fëmijëve” e miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara më dt.20.11.1989. Kjo Konventë mjaft e rëndësishme është nënshkruar nga të gjitha vendet e Europës Perëndimore, mes tyre edhe Shqipëria, që në vitin 1992...”²⁸¹.

Teknikat e inkriminimit konsistojnë në kryerjen e veprimeve aktive të turpshme fizike ose morale ndaj të miturit nën 14 vjeç. Me veprime të turpshme (luxuri) kuptohen ato forma të kënaqjes së epshit seksual që nuk përmbajnë elementët e ndonjë krimi tjetër seksual. Të tilla veprime të turpshme janë: të prekurit e organeve gjenitale si dhe çdo formë tjetër të kënaqurisë të epshit seksual, të panatyrshme ose të kundranatyrshme me personat që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç. Efekti që këto veprime të turpshme kanë tek të miturit është negative për zhvillimin psiko-social të tyre. Prandaj kryerja e veprave të turpshme në teori dhe praktikë pranohet se mund të bëhet jo vetëm me veprime fizike, por edhe me anë bisedash këshillash që e shtyjnë të miturin të fillojë një marrëdhënie seksuale. Kështu, në vendimin nr.337, datë 11.02.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vlerëson se: *“...Nga ana objektive, krimi i “Vepra të turpshme” kryhet nga autori me veprime aktive, apo me biseda dhe këshilla, të kundërligjshme, shoqërisht të rrezikshme...”*²⁸².

Lidhur me anën objektive, në vendimin nr.1175, datë 18.07.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë thekson se²⁸³: *“Nga pikëpamja objektive vepra penale “Vepra të turpshme” kryhet me veprime aktive kriminale në formën e ndërmarrjes së veprimeve dhe shfaqjes së sjelljeve që prekin integritetin fizik seksual të të miturit nën katërmbëdhjetë vjeç dhe sferën e tij psikologjike e psikike. Veprimet e të pandehurit në këtë vepër penale drejtohen ndaj fizikut dhe shëndetit seksual të të miturit dhe ka për qëllim të përmbushë dëshirat seksuale të të pandehurit, pavarësisht mos kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të dëmtuarin. I pandehuri orienton veprimet e tij ndaj të miturit në pjesë të ndryshme të trupit, duke vepruar në forma të pahijshme, në kundërshtim me sjelljen normale e morale të individëve në shoqëri, duke ndikuar si pasojë në sferën seksuale dhe psikologjike të të miturit. Pavarësisht moskrijimit të raporteve seksuale mes të pandehurit dhe të dëmtuarit veprimet e kundërligjshme kriminale të të pandehurit dëmtojnë shëndetin seksual dhe psikologjik të të miturit, i cili për shkak të moshës nuk ka krijuar ende perceptime të qarta e të vetdijshme të natyrës seksuale dhe vlerësohet i papërgatitur për t’u përballur me sjellje të tilla, për të cilat nga pikëpamja shkencore është provuar që ndikojnë në ardhmërinë e jetës dhe shëndetit të tij seksual...”*

Ana subjektive e krimit është kriteri kryesor për të dalluar këtë figurë të veprës penale nga veprat e tjera seksuale. Pikërisht, kjo e fundit shërben për të bërë diferencimin e duhur ndërmjet veprave të turpshme dhe aktit seksual (marrëdhënies seksuale), sepse shpeshherë marrëdhënia seksuale ngel në fazën e “veprave të turpshme” si për shembull prekja e organeve gjenitale, e cila krijon konfuzion nëse

²⁸¹ Shih vendimin nr.337, datë 11.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁸² Shih vendimin nr.337, datë 11.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁸³ Shih vendimin nr.1175, datë 18.07.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane

subjekti aktiv ka patur si qëllim të kryejë marrëdhënie seksuale, apo vepra të turpshme, për shkak se të dyja janë në funksion të kënaqjes së epshit seksual.

Kjo vështirësi në kualifikimin ligjor konstatohet edhe në jurisprudencë. Kështu, si të tillë mund përmendim vendimin nr.715, datë 30.06.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin vërehen qëndrimet e ndryshme të mbajtura nga gjykatat e dy shkallëve. Kështu, në këtë vendim²⁸⁴ theksohet se : *“Sipas deklarimeve të të dëmtuarës, në muajin korrik 2007 ajo ka shkuar në dyqanin e të gjykuarit dhe atje ai ka filluar ta prekë në pjesë të ndryshme të trupit. Disa ditë më pas ajo ka shkuar sërish në dyqan, mbi kërkesën e prindërve të saj për të blerë sende ushqimore. Kur është futur në dyqan, i gjykuari ka mbyllur derën, e ka shtrirë të dëmtuarën në tavolinë dhe ka kryer me të marrëdhënie seksuale. Sipas deklarimeve të të dëmtuarës, ajo nuk ka ndierë dhimbje dhe nuk ka patur as humbje gjaku nga kryerja e aktit seksual. E dëmtuara nuk i ka treguar askujt mbi ngjarjen, pasi kështu i kishte kërkuar dhe i gjykuari. Në vijimësi, me një frekuencë prej 1 herë në javë, e dëmtuara ka deklaruar se ka kryer marrëdhënie seksuale me të gjykuarin, në dyqan, në të njëjtin pozicion të treguar më lart. Këto marrëdhënie janë kryer mes të dëmtuarës dhe të gjykuarit deri në janar 2008. Në këtë kohë, xhaxhai i të dëmtuarës, shtetasi F. K. ka pretenduar se nëpërmjet shtetasit L V, drejtor i shkollës ku mësonte e dëmtuara, është vënë në dijeni të faktit se ajo kishte marrëdhënie me të gjykuarin. Nisur nga këto rrethana ai i ka kërkuar nënës së të dëmtuarës dhe asaj vetë të shkonin në Tepelenë. Pasi ka biseduar në lidhje me këtë lidhje, e dëmtuara nuk ka pranuar se ishte e vërtetë dhe është kthyer me të ëmën në fshat. E ëma e të dëmtuarës ka shkuar në shtëpinë e të gjykuarit, ku për shkak të marrëdhënieve të mira familjare, bashkëshorti i saj kish lënë vajzën e vogël. Në bisedë e sipër me bashkëshorten e të gjykuarit ajo është shprehur mbi fjalët që ishin hapur dhe kishte konstatuar turbullimin psikik që i ishte shkaktuar atij.*

Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr.140, datë 11.05.2009 ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.V, për kryerjen e veprës penale “Vepra të turpshme”, dhe, në bazë të neneve 108 e 49 të Kodit Penal, dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr.130, datë 04.09.2009, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit penal nr.140, datë 11.05.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë përsa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale të kryer. Deklarimin fajtor të të pandehurit G.V për kryerjen e veprës penale të “Marrëdhëniet seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çmon se vendimi nr.130, datë 04.9.2009 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë është marrë në shkellje të ligjit procedural dhe për këtë arsye duhet të prishet, duke u kthyer aktet po asaj gjykate për rishqyrtim, sepse nuk është bërë një hetim i gjithanshëm gjyqësor...”.

Pyetja që lind duke analizuar vendimet e mësipërme është: Cili është kualifikimi i ligjor nëse subjekti aktiv në një interval kohor fillestar kryen vepra të turpshme ndaj të miturës dhe pasi disa kohësh kryen marrëdhënie seksuale në mënyrë të vazhdueshme sipas një frekuence të caktuar?

Subjekti aktiv në periudha të ndryshme kohore ka kryer veprime të ndryshme si prekje në pjesë të ndryshme të trupit dhe kryerja e marrëdhënies seksuale. Në këtë rast kualifikimi ligjor duhet të bëhet sipas figurës së veprës penale të “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”. Siç theksuam më lart, ana subjektive e

²⁸⁴ Shih vendimin nr.715, datë 30.06.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

krimit është kriteri kryesor për të dalluar këtë figurë të veprës penale nga veprat e tjera seksuale. Pra, qëllimi i subjektit aktiv për të kryer vepra të turpshme apo marrëdhënie seksuale.

Me anë subjektive të figurës së veprës penale kuptohet përmbajtja e brendshme e saj, qëndrimi psikik që mban personi, kundrejt veprës së kryer prej tij²⁸⁵. Në dallim nga ana objektive, vlerësimi për ekzistencën e saj, nuk është një çështje fakti. Ajo zbulohet e qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm se ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive²⁸⁶. Siç shprehet edhe Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr.284, datë 6.10.2000 “...pavarësisht se është “mendim” ai “lexohet” nëpërmjet veprimeve konkrete që kryen i pandehuri për realizimin e veprës penale”. Në këtë logjikë arsyeton edhe Kolegji Penal i kësaj gjykate, në vendimin nr.289, datë 7.11.2012, ku shprehet se: “Interpretimi i një elementi të ndërgjegjes së individit që kryen një veprë penale është sa e vështirë ashtu edhe e rëndësishme për përcaktimin e fajësisë nëpërmjet kualifikimit ligjor. Natyrisht ky perceptim për gjykatën nuk duhet bërë mbi baza subjektive, por në bazë të “leximit” të veprimeve konkrete dhe të vlerësimit në harmoni të të gjitha provave dhe të konkluzionit që del prej tyre.”

Duke patur parasysh rrethanat e faktit të rastit të sipërpërmendur, qëllimi i subjektit aktiv ka qënë kryerja e marrëdhënieve seksuale me të miturën. Episodi i kryerjes së veprimeve të turpshme duhet të konsiderohet si fazë paraprake, plotësuese e marrëdhënies seksuale. Kështu, subjekti aktiv ka konsumuar dy figura të veprës penale atë të “Vepra të turpshme” dhe “Marrëdhënia seksuale me të mitur”, por ato nuk konkurojnë me njëra tjetrën sipas rregullave të konkurimit fiktiv të subsidiaritetit. Konkurrimi fiktiv në formën e subsidiaritetit nënkupton rastet, në të cilat një veprë penale paraqitet si fazë paraprake e veprës penale të dytë²⁸⁷. Pra, figurat e parashikuara nga nene të ndryshme të Kodit Penal, përfaqësojnë shkallë të ndryshme të kryerjes së veprës penale, me fjalë të tjera shkallë të ndryshme të cënimit të së njëjtës të mirë juridike të mbrojtur nga legjislacioni penal²⁸⁸. Kështu që subjekti aktiv duhet të mbajë përgjegjësi për figurën e veprës penale të “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”.

Rëndësia e elementit anë subjektive është theksuar edhe në vendimin nr.594, datë 24.03.2014 nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë²⁸⁹, në të cilin thekson se: “...Në kohën që e dëmtuara ka marrë ashensorin për t’u ngjitur lart në katin e shtatë në banesën e saj, bashkë me të në ashensor është futur edhe i pandehuri, i cili ka shtypur butonin për në katin e dytë, ndërsa vajza ka shtypur butonin për në katin e shtatë. Ndonëse ashensori është ngjitur në katin e dytë dhe dera e tij është hapur, i pandehuri P.Sh, nuk ka zbritur, por ka vazhduar lart, së bashku me vajzën në ashensor.

Pasi është mbyllur dera e ashensorit i pandehuri ka qënë përballë me vajzën dhe i është afruar asaj duke e prekur atë.

²⁸⁵Shih “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i Gjykatës së Lartë të RPSSH dhe Universiteti i Tiranës, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, f. 143.

²⁸⁶Shih Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007, f. 136.

²⁸⁷Shih Ismet Salihu “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i ripunuar, Botimet “Fama 2008”, Prishtinë, 2008, f. 362.

²⁸⁸Shih Nicola Corea “Le Sezioni Unite dicono no alla consumazione”, artikull në adresën e internetit <http://www.altalex.com/index.php?idnot=34106>, aksesuar në Maj 2015.

²⁸⁹ Shih vendimin nr.594, datë 24.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Ai i ka futur dorën brenda tutave tek pjesa e përparme dhe ajo ka ndier dorën e tij. Ai ka tentuar ta fusë dorën më poshtë, por ajo ia ka hequr direkt duke bërtitur dhe duke e shtyrë.

I pandehuri i ka thënë se “nuk ka gjë dhe se nuk po i bënte gjë”. Më pas kanë arritur në katin e shtatë, ku ai është përpjekur për ta penguar për të dalë, por vajza e ka shtyrë dhe ka dalë.

Në këtë kohë ai e ka kapur nga duart për ta tërhequr për ta futur në ashensor. Me pas dera e ashensorit është mbyllur, ndersa vajza ka hyrë menjëherë brenda në banesë dhe e frikësuar ka telefonuar të emën e saj, duke i treguar për ngjarjen si me sipër.

Edhe për sa i takon kualifikimit ligjor të veprës penale gjykata çmon se organi i akuzës e ka vlerësuar drejt atë, pasi në rastin në gjykim çmohet se në veprimet e të pandehurit P.Sh ekzistojnë elementët përbërës të figurës së veprës penale, të kryerjes së “Veprave të turpshme” parashikuar nga neni 108/1 i Kodit Penal, si ata që lidhen me objektin dhe anën objektive të veprës penale, ashtu edhe ata që lidhen me subjektin dhe anën subjektive të saj.

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur zhvillimin normal seksual të të miturës në moshën nën katërmbëdhjetë vjeç. Ligjvënësi me parashikimin e kësaj vepre penale mbron këtë kategori personash nga ato veprime nëpërmjet të cilave personi që i kryen ka për qëllim vetëm kënaqjen e epshit seksual dhe jo kryerjen e marrëdhënieve seksuale...”.

Një element i rëndësishëm për të përcaktuar nëse subjekti aktiv ka patur si qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale, apo vetëm vepra të turpshme, është fakti nëse akti seksual është realizuar apo jo pavarësisht mundësisë së realizimit të tij²⁹⁰. Një element tillë ka qënë determinat për kualifikimin ligjor edhe në praktikën gjyqësore. Kështu, në vendimin nr.296, datë 26.02.2007 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁹¹ vlerëson se: “...shtetasja A.K ka kallzuar në Komisarjatin e Policisë Nr.3, Tiranë të pandehurin E.Q, duke pretenduar se ky i fundit, gjatë muajve prill-maj të vitit 2006, në vendin e quajtur Instituti Bujqësor Kamëz tek Fusha e Sportit në një bunker ka kryer disa herë marrëdhënie seksuale me të bijën e saj, të dëmtuarën P.K, e cila siç rezulton nga administrimi i certifikatës së njësisë nr.11, datë 09.05.2006 me nr.42/18 është e datëlindjes 04.05.1993.

Lidhur me sa më sipër, fillimisht nga organi i prokurorisë i pandehuri është akuzuar për veprën penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal.

Vetë shtetasja P.K, gjatë hetimeve paraprake, deklaroi se ajo është takuar disa here me dëshirën e saj me të pandehurin dhe vetëm është puthur dhe pasi i janë zhveshur rrobat deri edhe të brendshmet, ajo është prekur në vende intime nga ky i fundit.

Mosdeflorimi i të dëmtuarës është konstatuar edhe nga grupi i ekspertëve mjekoligjorë, të cilët në aktin e ekspertimit mjeko ligjor nr.493, dt.09.05.2006 të bërë prej tyre kanë konkluduar se “... e dëmtuara P.K nuk rezulton të jetë e defloruar...”.

Nga sa më sipër rezulton se i pandehuri i ka konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të “Veprave të turpshme” parashikuar nga neni 108 të K.Penal, prandaj Gjykata çmon se ai duhet deklaruar fajtor për sa akuzohet.....”.

²⁹⁰ Këtu duhet të merren në konsideratë kushtet e heqjes dorë nga vepra penale, apo kur ajo mbetet në tentative.

²⁹¹ Shih vendimin nr.296, datë 26.02.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane

Gjithashtu, lidhur me këtë element në vendimin nr.14, datë 24.01.1961 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë²⁹² thekson se: “...korruptimi me anë të veprave të turpshme i personave që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale ekziston vetëm në ato raste kur autori i krimit përdor forma të ndryshme, për të kënaqur epshin e tij seksual, pa bërë bashkim seksual. Pretendimet që ngrihen se mund të jemi përpara krimit të korrupimit me anë të veprimeve të turpshme, ose tentativës për të hyrë në marrëdhënie seksuale me një person të mitur, që nuk është i zoti për tu mbrojtur nuk janë të drejta. Do të ishim përpara korrupimit me anë të veprave të turpshme në kuptim të nenit 162 të Kodit Penal vetëm atëherë kur subjekti i krimit do të vepronte kundër një personi që nuk ka arritur pjekurinë seksuale si dhe kur ai ka përdorur të gjitha format e kënaqjes së epshit seksual, por pa bërë bashkimin seksual. Në fakt nga raporti i mjekut është vërtetuar se e dëmtuara ka arritur pjekurinë seksuale. Fakti që e dëmtuara ka arritur pjekurinë seksuale e bën të paaplikueshëm nenin 162. Gjithashtu, është i padrejtë pretendimi se duhet të jemi përpara tentativës së kryerjes së marrëdhënies seksuale. Nga provat e administruar nuk del që krimi të ketë mbetur në tentativë, përkundrazi del se i gjykuari është bashkuar seksualisht me të dëmtuarën.

Një analizë e tillë juridike është bërë edhe në vendimin nr.3701, datë 29.10.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në të cilin theksohet se: “Se nga organi i Prokurorisë pranë kësaj gjykate, është sjellë për gjykim çështja penale me nr.3441 akti me të pandehur F.M, i cili akuzohet për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” e mbetur në tentative dhe të “Vepra të turpshme”, të parashikuar nga nenet 100/1 e 22 dhe 108/2 i K.Penal.

...Në këtë moment S. i ka treguar se “F. donte të bënte gjëra turpi, se ai me hoqi mua pantallonat dhe mbathjet, por unë fillova të qaja dhe ai nuk bëri gjë”. Pas kësaj më tha “ Të lutem mos i trego babit” ...

Gjykata arsyeton se në rastin konkret nuk mund të kemi dhe veprën penale të marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me të mitur dhe gjithashtu të kemi dhe veprën penale të vepra të turpshme të parashikuar nga neni 108/2 të K.Penal, **këto dy figura krimi nuk mund të konkurojnë me njëra tjetrën pasi të gjitha veprimet që i pandehuri F.M ka bërë për të realizuar aktin seksual, të cilat prokuroria i ka klasifikuar edhe si veprime që kanë konsumuar veprën penale të “vepra të turpshme” janë kryer në funksion vetëm të kryerjes së aktit seksual të parashikuar si element të figurës së veprës penale të kryerjes së marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me të mitur të mbetur në tentativë të parashikuar nga neni 100/1-22 të K.Penal.**

Nga analiza e faktit dhe provave të shqyrtuara në këtë gjykim rezulton se veprimet e kryera prej të pandehurit F.M parashikohen si elementë të veprave penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 100/1 e 22 të Kodit Penal. Vepra penale e marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me të mitur ka mbetur në tentativë për arsye të pavarura prej të pandehurit, për shkak se S. ka bërë titur dhe qarë dhe nuk e ka lejuar të kryejë veprimet që i ka këshilluar i pandehuri, i cili kur ka parë reagimin e saj i ka thënë që të mos i tregonte gjë babit të saj për atë që ndodhi. Por, këto veprime prej të pandehurit F.M janë kryer me qëllim që ai të kënaqte epshet seksuale të tij në vijim të marrëdhënies seksuale që mbetën në tentativë, mendim i cili i kishte lindur më parë. Vendi i kryerjes së veprës penale konfirmohet krahas shpjegimeve të dhëna prej Sonilës, edhe nga kqyrja e vendit të ngjarjes dhe tabela fotografike që ka shoqëruar

²⁹² Shih vendimin nr.14, datë 24.01.1961 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

kqyrjen. Sipas kqyrjes së banesës ku jetonte i pandehuri, ajo përbëhej nga një dhomë dhe një aneks ku në këtë dhomë është vënë re edhe një divan tre vendësh, i shtruar me çarçafë dhe mbi të ndodhej edhe një batanije ngjyrë jeshile me lule, që vërteton saktësisht deklaratimet e dhëna prej S. në lidhje me vendin ku është tentuar të kryhet me të vepra penale e marrëdhënieve seksuale dhe ku ajo është vendosur prej të pandehurit, i cili sipas deklaratimeve të dhëna prej saj e ka zhveshur duke i hequr pantallonat dhe të mbathurat. Por, veprimi, për të cilin i kishte lindur me parë mendimi ka ngelur në tentativë, për arsye të pavarura prej tij, pasi S. ka nisur të qajë dhe i pandehuri është trembur, madje i ka kërkuar S. që këtë fakt të mos ia tregonte babait të saj... ”.

3.2.1. Rrethana me vlerë cilësimi ligjor

Me ndryshimet e ligjit nr.144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, përmbajtja e nenit 108 u ndryshua²⁹³ duke parashikuar disa rrethana cilësuese si më poshtë:

- A.** Po kjo vepër, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare. Kualifikimi ligjor sipas kësaj figure të veprës penale kërkon që ndërmjet subjektit aktiv dhe pasiv të ekzistojnë lidhje familjare. Siç vihet re, legjislatori ka përdorur termin “marrëdhënie familjare”, por pa dhënë një përcaktim për të. Duke marrë në konsideratë frymën ofensive të kësaj rrethanë cilësuese, e cila në thelb është e njëjtë me atë që përçon neni 106 i Kodit Penal²⁹⁴, këtij termi duhet t’i japim përcaktimin sipas këtij të fundit, duke konsideruar lidhje familjare, kur veprat e turpshme kryhen ndërmjet prindërit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, ose motrave, personave në gjini në vijë të drejtë, ose ndërmjet personave që ndodhen në raporte kujdestarie, ose birësimi.
- B.** Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale. Parashikimi i kësaj rrethanë cilësuese ishte, ndër të tjera, zbatim i detyrimeve, ose angazhimeve të marra përsipër nga Republika e Shqipërisë me ratifikimin e Konventës Lanzarote,²⁹⁵ për të marrë masa legjislativë për kriminalizimin ose për të parashikuar si vepër penale shkaktimin me qëllim, për qëllime seksuale, të një fëmije, i cili nuk e ka arritur moshën e përcaktuar, për të qenë dëshmitar i abuzimit seksual ose i aktiviteteve seksuale, edhe pa iu dashur të marrë pjesë në to²⁹⁶. Konventa Lanzarote veprime të tilla i përcakton me termin “Korruptimi i fëmijëve”.

²⁹³Shih nenin 23 të ligjit nr.144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

²⁹⁴Neni 106 i Kodit Penal parashikon figurën e veprës penale të “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”.

²⁹⁵Shih ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

²⁹⁶Shih nenin 22 të Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009, në të cilin theksohet se: “Çdo palë merr masat e nevojshme legjislativë ose masa të tjera për të parashikuar si vepër penale shkaktimin me qëllim, për qëllime seksuale, të një fëmije i cili nuk e ka arritur moshën e përmendur në nenin 18,

Legjislatori ynë në inkrimimin e këtij fakti tipik ka përdorur teknikën e “rrethanës cilësuese”, duke bërë “numërim, përshkrim” në të njëjtën dispozitë. Legjislacione të tjera kanë përdorur teknika të tjera. Për shembull, Kodi Penal italian ka përdorur teknikën klasike të parashikimit si figurë e veçantë e veprës penale. Kështu, në nenin 609 *inquires* ky kod parashikon figurën e veprës penale të “Përfshirja e të miturit” duke theksuar se: “*Kushdo që kryen akte seksuale në prani të personave nën moshën katërmëdhjetë vjet, në mënyrë që ta përfshijë edhe atë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet*”.

Parashikimi i bërë nga kodi nuk është tërësisht në përputhje me parashikimin e konventës Lanzarote. Kodi jonë Penal nuk ka parashikuar edhe tog fjalëshin “*edhe pa iu dashur të marrë pjesë në to*”. Një zgjedhje e tillë është në përputhje me parimet shkencore penale mbi bazën e të cilave është ndërtuar seksioni i krimeve seksuale, sepse nëse do të bënim një parashikim të tillë atëherë do të kishim konvergencë ndërmjet anës objektive të kësaj figure të veprës penale e kryer sipas rrethanës cilësuese dhe anës objektive të figurës së veprës penale që konsumohet nga kryeja e sjelljes seksuale. Kështu, do të ndërlikohej kualifikimi ligjor nëse i mituri do të bëhej pjesë e veprimeve seksuale si për shembull, pjesë e marrëdhënies seksuale. Në këtë rast, do të konsumoheshin figurat e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe “Vepra të turpshme”, sipas rrethanës cilësuese. Pra, një parashikim i tillë do të cënonte parimet e ligjshmërisë dhe *ne bis in idem*.

Pyetja që lind është: Nëse i mituri i përfshirë qëllimisht si dëshmitar i marrëdhënies seksuale që kryhet ndërmjet dy personave, me vullnetin e tij bëhet pjesë e këtij akti seksual, cili do të jetë kualifikimi ligjor?

Sipas rregullave të konkurimit fiktiv në formën e subsidiaritetit, figura e veprës penale të “Vepra të turpshme” në rrethanë cilësuese sipas paragrafit të dytë, paraqitet si fazë paraprake e figurës së veprës penale të dytë²⁹⁷. Pra, kualifikimi ligjor do të jetë sipas figurës së veprës penale të “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”.

- C. Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi.

Parashikimi edhe i kësaj rrethane cilësuese ishte, ndër të tjera, zbatim i detyrimeve, ose angazhimeve të marra përsipër nga Republika e Shqipërisë me ratifikimin e Konventës Lanzarote,²⁹⁸ për të marrë masa legjislative për të parashikuar si vepër penale propozimin e qëllimshëm, nëpërmjet teknologjive të informimit dhe të komunikimit, të një të rrituri për të takuar një fëmijë që nuk e ka arritur moshën e përmendur në nenin 18, paragrafi 2, për qëllimin e kryerjes së ndonjëres nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenin

paragrafi 2, për të qenë dëshmitar i abuzimit seksual ose i aktiviteteve seksuale, edhe pa iu dashur të marrë pjesë në to”.

²⁹⁷Shih. Ismet Salihu “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i ripunuar, Botimet “Fama 2008”, Prishtinë, 2008, f. 362.

²⁹⁸ Shih ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”,

18, paragrafi 1.a, ose nenin 20, paragrafi 1.a, kundër tij ose saj, kur ky propozim ndiqet nga akte materiale që të çojnë në një takim të tillë²⁹⁹.

Nga studimi i praktikës gjyqësore rezulton se, kryerja e veprave të turpshme ndaj të miturve sjell pasojat të rënda psikologjike për ta, saqë në disa raste ka shkaktuar tentativën për vetëvrasje, apo realizimin e saj. Gjithashtu, është konstatuar se në disa raste veprat e turpshme kryhen ndaj disa të miturve njëkohësisht. Në disa prej këtyre rasteve, kualifikimi ligjor i bërë nuk është sipas rregullave juridiko-penale të konkurimit, apo të ekzistencës së figurave të veprës penale. Pyetja që lind është: Cili është kualifikimi ligjor i faktit tipik nëse i mituri, ndaj të cilit janë kryer veprat e turpshme, kryen vetëvrasje?

Meqënëse figura e veprës penale “Vepra të turpshme” nuk parashikon si rrethanë cilësuese shkaktimin e vetëvrasjes, atëherë duhet të analizohet ekzistenca e figurës e veprës penale “Shkaktimi i vetëvrasjes” parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal³⁰⁰. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, dy nga elementet determinant me vlerë kualifikuese janë:

- Ekzistenca e varësisë apo marrëdhënieve familjare ose bashkëjetesës ndërmjet subjektit aktiv dhe pasiv.
- Trajtimi i keq sistematik ose sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin.

Nëse pas kryerjes së veprës së turpshme plotësohen kushtet e sipërcituara, atëherë plotësohen elementët e secilës figure të veprës penale dhe në këto kushte do të kishim konkurim ndërmjet tyre. Ndërsa, nëse nuk plotësohen kushtet e sipërpërmendura atëherë kualifikimi duhet të bëhet vetëm sipas figurës së veprës penale të “Vepra të turpshme”. Lidhur me këto situata në praktikën gjyqësore nuk janë mbajtur qëndrime të njëjta.

Kështu, nga analiza e vendimit nr.1099, datë 17.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁰¹, rezulton se: “Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka sjellë për gjykim të pandehurin K.L i akuzuar për veprat penale të “Kryerjes së veprave të turpshme” dhe “Shkaktimit të vetëvrasjes” mbetur në tentative sipas nenit 108 e 99-22 të Kodit Penal, akuza të cilat në përfundim edhe të hetimit gjyqësor rezultojnë të provuara plotësisht në ngarkim të të pandehurit.

...bashkëshortët B e V.Rr, të cilët kanë konstatuar se në kohë të ndryshme i pandehuri K.L duke ushtruar dhune fizike e psikologjike ka ngacmuar seksualisht vajzat e tyre te quajtura B.Rr 14 vjeçe, B.Rr, 10 vjeçe si dhe A.Rr, 6 vjeçe, duke kryer me to veprime të turpshme. Të njëjtat veprime i pandehuri kishte kryer edhe me vajzën e vëllait të kallzuesit shtetasen M.Rr, 12 vjeçe. Të miturat B dhe M.Rr, si pasojë e turpësive dhe e poshtërimit që kanë ndjerë nga veprimet e të pandehurit, kanë tentuar të presin damarët e duarve me qëllim për t'u vetëvrasur.

²⁹⁹ Shih nenin 23 të Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009, në të cilin theksohet se: “Përdorimi i fëmijëve për qëllime seksuale. Çdo palë merr masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar si vepër penale propozimin e qëllimshëm, nëpërmjet teknologjive të informimit dhe të komunikimit, të një të rrituri për të takuar një fëmijë që nuk e ka arritur moshën e përmendur në nenin 18, paragrafi 2, për qëllimin e kryerjes së ndonjëres nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenin 18, paragrafi 1.a, ose nenin 20, paragrafi 1.a, kundër tij ose saj, kur ky propozim ndiqet nga akte materiale që të çojnë në një takim të tillë..”

³⁰⁰ Neni 99 i Kodit Penal përcakton se: “Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes të një personi, si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, të kryera nga personi që e ka në varësi apo nga personi me të cilin ka marrëdhënie familjare ose bashkëjetese, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

³⁰¹ Shih vendimin nr.1099, datë 17.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në një rast i pandehuri ka shkuar në shtëpinë e M-së ku ka gjetur edhe shtetasen B.Rr dhe pasi i ka zhveshur me forcë, është zhveshur edhe vete dhe ka filluar t'i fërkonte duke nxjerrë organin seksual dhe u ka kërkuar vajzave që t'i fërkonin si dhe të fusnin në gojë penisin e tij si dhe më pas u derdhte spermën në trup. Këto veprime i pandehuri i ka kryer edhe me të miturat A e B.Rr, ku i ka futur në oborrin e shtëpisë së tij duke i zhveshur dhe duke i fërkuar në organet seksuale, ku më pas u jepte ndonjë lek me qëllim që ato të mos tregonin.

Nga çmuarja e faktit si më sipër dhe analiza e dispozitës ligjore për të cilën akuzohet i pandehuri, për gjykatën krijohet bindja, se ai (i pandehuri K.L) ka konsumuar veprën penale të “Kryrje e veprimeve të turpshme” parashikuar nga neni 108 i K.Penal.

Nga çmuarja e faktit si më sipër dhe analiza e dispozitës ligjore për të cilën akuzohet i pandehuri, për gjykatën krijohet bindja, se ai (i pandehuri) ka konsumuar dhe veprën penale të “Shkaktim vetëvrasje, e mbetur në tentative” parashikuar nga neni 99 e 22 i K.Penal.

Nga ana objektive, për të pasur figurën e krimit, kërkohet trajtimi i keq sistematik ose sjellje të tjera sistematike, që ulin rendë dinjitetin njerëzor të viktimës (rrahje sistematike, plagosje e lehtë, përzënie nga shtëpia e bashkëshortes, fyrjet e rënda, shpifjet, talljet, mundimet, torturat, lënie pa ushqim etj.) trajtimi sistematik kuptohet një sjellje e keqe, e përsëritur disa herë.

Kështu, nga veprimet e të pandehurit K.L, vajzat e mitura kanë tentuar të vetëvriten duke prerë damarët e dorës, pasi prindërit e tyre kanë marrë vesh veprimet e turpshme të kryera nga i pandehur...”.

Qëndrimi i mbajtur nga organi i prokurorisë dhe më pas nga gjykata lidhur me kualifikimi ligjor të faktit tipik të sipërcituar, nuk është në përputhje me kriteret shkencore të ekzistencës dhe konkurimit të figurave të veprave penale objekt analize.

Lidhur me këtë qëndrim të kësaj gjykate në vendimin nr.151, datë 30.05.2012 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë³⁰² thekson se: “Duke pasur parasysh gjithë sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se ...Gjykata e Apelit Tiranë të ketë marrë në analizë dhe të ketë vlerësuar të gjithë pretendimet e ngritura gjatë gjykimeve dhe në ankim nga palët.

Arsyetimi i gjykatës së apelit mbështetur në vetdeklarimet e të dëmtuarave përpara gjykatës, por edhe nga provat e tjera, se nuk ndodhemi përpara elementëve të veprës penale të shkaktimit të vetëvrasjes së mbetur në tentativë, është i drejtë.

Kjo pasi edhe sipas akteve të ekspertimit mjekoligjor rezulton se tek të dëmtuarat konstatohen plagë sipërfaqësore që hyjnë në kategorinë e plagëve të lehta të parrezikshme për jetën.

Gjithashtu nuk plotësohen kriteret e nenit 99-22 të Kodit Penal, që janë ana subjektive, dashja e të pandehurit për të shkaktuar vetëvrasjen e të dëmtuarave, si dhe ana objektive, pasi nuk rezulton e provuar kryerja e veprimeve të dhunshme të të pandehurit ndaj dëshmitareve të mitura. Për të pasur këtë vepër penale, kërkohet dashja e të pandehurit dhe lidhja shkakësore ndërmjet veprimeve të tij dhe ardhjes së pasojës.

Pretendimet e organit të akuzës për ekzistencën e dashjes indirekte dhe për veprimet e dhunshme të të gjykuarit ndaj të dëmtuarave, nuk rezultojnë të jenë të provuara, e për rrjedhojë nuk mund të pranohen, siç me të drejtë ka vepruar Gjykata e Apelit Tiranë.

³⁰² Shih vendimin nr.151, datë 30.05.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Kolegji Penal vlerëson se, jo vetëm ana subjektive e të pandehurit për të kryer këtë veprë penale (shkaktimin e vetëvrasjes) mungon, por dhe vetë veprimet e të dëmtuarave nuk përmbajnë elementë të veprës penale në fjalë. Nuk përmbajnë për shkak se veprimet e tyre janë kryer në kushtet e tronditjes dhe gjendjes së turpit përballë familjes së tyre, por pa u shoqëruar me veprime serioze dhe konkrete për të kryer aktin. Në gjendjen e tronditjes duke pasur një ndjenjë të rëndë turpi kanë dashur të nxjerrin në pah këtë situatë dhe jo veprime të cilat do të shkaktonin vetëvrasjen. Pra, nuk jemi para rastit të shkaktimit të vetëvrasjes e po kështu kësaj veprë të mbetur në tentativë, sepse nuk është ndërprerë as nga ndonjë ndërhyrje e faktorëve apo personave të tjerë, as nga ndonjë rrethanë tjetër në mënyrë që të plotësohen kriteret ligjore të konsumimit të veprës penale për të cilën ka qenë akuzuar i gjykuari...”.

Karakteristikat specifike të figurës së veprës penale të “Shkaktimi i vetëvrasjes” përjashtojnë konsumimin e saj kur pasojë e figurave të veprës penale “Vepra të turpshme” është vetëvrasja e të miturit. **Në këto kushte, është e nevojshme parashikimi si rrethanë cilësuese kur si pasojë e veprimeve të turpshme është vetëvrasja e të miturit.**

Nga analiza e faktit tipik të mësipërm rezulton se gjykatat nuk ka marrë në konsideratë faktin që veprat e turpshme janë kryer ndaj disa personave, ose më shumë se një herë. Në kushtet kur vepra penale kryhet ndaj disa të miturve, atëherë kualifikimi ligjor duhet të bëhet aq herë sa është numri të dëmtuarve. Megjithatë për të gjitha benefitet juridike është e nevojshme parashikimi si rrethanë cilësuese e tyre.

3.2.2. Veprat e turpshme dhe prishja e qetësisë publike.

Në jetën e përditshme ndodhin veprime, që çënojnë moralin shoqëror si për shembull, heqja e pantallonave dhe nxjerrja e organeve gjenitale, gjatë qëndrimit në trotuarin e rrugës, në të cilin kalojnë edhe të mitur.

Veprat e turpshme duhet të dallohen nga aktet e “pahijshe” që kryhen në publik, të cilat çënojnë moralin publik.

Në nenin 274 të Kodit Penal, është parashikuar figura e veprës penale të “Prishja e qetësisë publike”, sipas së cilës: “*Hedhja e gurëve apo sendeve të tjera në banesën e shtetasit, krijimi i zhurmave shqetësuese si, me anë të shkrepjes së armëve apo plasjeve të ndryshme, të përdorimit jashtë rregullave të sirenave të automjeteve, apo çdo lloj tjetër sjelljeje të papëlqyeshme, në rrugë, sheshe e vende publike, që çënojnë dukshëm qetësinë e moralin apo tregon mospërfillje të hapët për mjedisin, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet...*”.

Dallimi ndërmjet figurave të veprës penale të “Vepra të turpshme” dhe “Prishja e qetësisë publike” qëndron në disa elementë:

- a. Objekti i këtyre figurave të veprës penale është i ndryshëm nga njëri – tjetri. Objekti i të parës është mbrojtja juridiko penale e lirisë seksuale së fëmijës nën 14 vjeç, ndërsa i të dytës është ruajtja e rendit, qetësisë dhe moralit publik.
- b. Gjithashtu, ana objektive është elementi që i diferencon ato. Në të parën kemi veprime me natyrë seksuale si puthja, prekja etj. Ndërsa, në të dytën kemi hedhjen e gurëve apo sendeve të tjera në banesën e shtetasit, krijimin i zhurmave shqetësuese si, me anë të shkrepjes së armëve apo plasjeve të ndryshme, të përdorimit jashtë rregullave të sirenave të automjeteve, apo çdo lloj tjetër sjelljeje të papëlqyeshme, në rrugë, sheshe e vende publike,

që çënojnë dukshëm qetësinë e moralin apo tregon mospërfillje të hapët për mjedisin.

- c. Ana subjektive e veprave penale. Kryerja e veprave të turpshme realizohet me qëllim kënaqjen e epshit seksual. Motivet për prishjen e qetësisë publike lidhen me motive rrugaçërie ose vagabontizmi.

Lidhur me dallimin ndërmjet tyre në vendimin nr.5478, të vitit 2014 Gjykata Italiane e Kasacionit ka theksuar se: “*Dallimi ndërmjet veprave të turpshme dhe veprimeve në kundërshtim me moralin publik duhet të identifikohen në faktin se të parat, në mënyrë intensive dhe serioze, çënojnë ndjenjën seksuale, duke i shkaktuar vëzhguesit ndjenja neverie ose dëshira erotike, ndërkohë që të dytat ndikojnë në ndjenjën e zakonshme të sjelljes së mirë, duke gjeneruar bezdisje dhe qortim.*”^{303,304}.

Ndërsa, në vendimin nr.15676, të vitit 2010 Gjykata Italiane e Kasacionit ka vlerësuar se: “*...Kualifikohet si vepër penale e akteve të turpshme në vende publike, dhe jo ajo e veprave në kundërshtim me moralin publik, sjellja e qëndrueshme në zbrëthimin e pantallonave dhe duke i ekspozuar organet gjenitale në publik, për aq kohë sa qëllimi i këtyre veprimeve ka ndikim të qartë në sferën seksuale më shumë se zakonet e përbashkëta të sjelljes së mirë.*”^{305,306}.

Në jurisprudencën e vendit tonë evidentohen raste, në të cilat kualifikimi ligjor nuk është bërë konform elementëve të figurave të veprës penale të sipërcitura. Në këtë aspekt mund të sjellim për analizë vendimin nr.176, date 27.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin theksohet se: “*.....Shtetaset M.B dhe Dh.F të cilat kanë kallëzuar se, rreth orës 17:30, kanë dalë me njëra tjetrën nga kodrat e Liqenit Artificial për të bërë vrap. Ndërsa ato po bënë ecje të lirë, në afërsi të vendit të quajtur “Varrezat”, u ka dalë nga një shkurre i pandehuri i cili ka qenë i veshur me pantallona të shkurtra të bardha, në krahë mbante një çantë dhe në dorë kishte disa rroba.*

I pandehuri, në mënyrë të përsëritur, ka ulur dhe ngritur pantallonat duke u treguar kallëzueseve organin gjenital të cilin e lëvizte me dorë duke ecur në drejtim të tyre. Shtetësja Dh. ka thënë se do lajmëronte organet e policies, por ai u ka thënë le ta lajmëronin dhe u ka kërkuar të afroreshin tek ai. Shtetaset M. B dhe Dh.F janë larguar me vrap dhe, pasi kanë vrapuar disa metra, kanë kthyer kokën dhe kanë parë që ai po i ndiqte nga pas. Në këtë kohë ato janë larguar në drejtim të shkollës Willson dhe kanë telefonuar në numrin 129.

Kallëzueset deklaruan se i pandehuri ka kryer veprime të tilla edhe në dy raste të mëparshme (përpara 10 ditësh dhe përpara një jave). Shtetasja Dh.F deklaroi se, për rastin e ndodhur përpara një jave, ajo ka vënë në dijeni mamanë e saj, e cila i ka thënë se nëse do përsëritej prapë një situatë e tillë të njoftonte policinë.

Përsa i përket kualifikimit juridik të fakteve të vërtetuara më sipër, Gjykata vëren se, neni 274 i Kodit Penal, i cili parashikon se : “Hedhja e gurëve apo sendeve të tjera në banesën e shtetasit, krijimi i zhurmave shqetësuese si, me anë të shkrepjes së armëve apo plasjeve të ndryshme, të përdorimit jashtë rregullave të sirenave të

³⁰³Shih vendimin nr.5478/2014 të Gjykatës Italiane të Kasacionit.

³⁰⁴Rasti në të cilin Gjykata u shpreh sështë konfiguruar vepra e parashikuar në nenin 527 K.Penal në sjelljen e një personi i cili tregonte dhe prekte organet e tij gjenitalet në një plazh të mbushur me pushues.

³⁰⁵ Shih vendimin nr.15676 të vitit 2010 të Gjykatës Italiane të Kasacionit.

³⁰⁶ Duhet të theksojmë se ekzistojnë dallime konceptuale ndërmjet parashikimit që bën Kodi Penal shqiptar dhe atij që bën Kodi Penal italian për veprat e turpshme.

automjeteve, apo çdo lloj tjetër sjelljeje të papëlqyeshme, në rrugë, sheshe e vende publike, që çënojnë dukshëm qetësinë e moralin apo, tregon mospërfillje të hapët për mjedisin, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve që garantojnë rendin dhe sigurinë publike, nga veprime të kundërligjshme e shoqërisht të rrezikshme. Këto veprime, për t’u cilësuar si vepër penale nga ligji duhet që:

- *Objekt i veprimeve të jenë marrëdhëniet juridike që garantojnë rendin dhe sigurinë publike dhe veçanërisht moralin shoqëror, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal;*
- *nga ana objektive kjo vepër kryhet në disa forma si psh: me hedhjen e gurëve ose sendeve të tjera të forta në banesën e tjetrit; krijimi i zhurmave shqetësuese si me anë të plasjeve të ndryshme, të shtënave me armë; përdorimi jashtë rregullave i borive dhe sirenave të automjeteve; çdo lloj sjellje tjetër e cilësuar si e papërshtatshme, e papëlqyeshme nga shoqëria, si fjalë fyese të shqiptuara me zë të lartë, thyerja e xhamave të ndërtesave, bërtitja, ulëritja dhe këndimi me zë të lartë, tej orarit të lejuar; ndotja dhe prishja e vendeve me karakter publik, apo me vlera morale dhe shpirtërore për komunitetin. Si kusht i domosdoshëm i anës objektive është fakti se, autori i veprimeve të lartëpërmendura duhet të veprojë në mënyrë të dukshme, duke treguar hapur një mospërfillje ndaj rregullave të vendosura nga shteti apo shoqëria e për pasojë, kjo sjellje bie ndesh me moralin shoqëro...”³⁰⁷.*

Në rastin konkret duket se gjykata ka gabuar në kualifikimin ligjor të veprës penale sepse nuk ka marrë në konsideratë rrethanat në të cilat është kryer veprimi dhe natyrën e tij nga të cilat mund të deduktohet qëllimi i subjektit aktiv të veprës penale, sepse nëse qëllimi lidhet me realizimin e kënaqësisë seksuale të tij, atëherë jemi përpara ngacmimit seksual kur i dëmtuari është i mitur mbi 14 vjeç ose figurës së veprës penale vepra të turpshme kur ai është nën 14 vjeç. Fakti që subjekti aktiv i ka kryer disa herë të njëjtat veprime ndaj të njëjtëve të dëmtuar si dhe fakti që i ka ndjek nga pas, tregon se ai nuk është nisur nga motive rrugaçërie apo vagabontizmi, por është nisur me qëllimin e realizimit të epshit seksual.

Në vendimin nr.366 të vitit 2000 Gjykata Italiane e Kasacionit ka theksuar se: “...Sjellja që përkethehet në masturbim përballë një të mituri në një vend të hapur për publikun nuk është një veprim në kundërshtim me moralin publik, por një vepër e turpshme, në kundërshtim me parimet e moralit seksual...”³⁰⁸

Nuk mund të konsiderohen të turpshme ato manifestime të dashurisë reciproke, të dukshme në publik, që nuk shqetësojnë ndjeshmërinë njerëzore të moralit të zakonshëm, i cili është indiferent ndaj përfaqimeve dhe puthjeve mes individëve me vullnet të plotë, ndërsa aktet që janë shprehje brutale e instikteve seksuale të tilla si puthja në buzë, prekja e pjesëve intime, e bërë pa miratimin e personit tjetër. Një qëndrim të tillë ka mbajtur në vendimin nr.7234 të vitit 1998 Gjykata Italiane të Kasacionit³⁰⁹.

Ekspozimi i organeve gjentiale mashkullore ndaj një të mituri, edhe nëse kryhet për të lënduar apo përbuzur dhe jo për të kënaqur impulset seksuale, është për

³⁰⁷ Shih vendimin nr.176, datë 27.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁰⁸ Shih vendimin nr.366 të vitit 2000 të Gjykatës Italiane të Kasacionit

³⁰⁹ Shih vendimin nr.7234 të vitit 1998 të Gjykatës Italiane të Kasacionit

vet natyrën e tij fyes ndaj moralit të përbashkët dhe integron veprën e akteve të turpshme. Vepra e akteve të turpshme dënohet si e kryer me dashje, pra për konfigurimin e saj është i mjaftueshëm vullneti i ndërgjegjshëm për të kryer aktin objektiv të përshtatshëm për të cenuar ndjenjën seksuale, duke qenë e parëndësishme arsyeja që e ka shtyrë subjektin për të kryer këtë sjellje të turpshme³¹⁰.

Pyetjes nëse figura e veprës penale “Vepra të turpshme” ngel në tentative Gjykata Italiane e Kasacionit në vendimin nr.314 të vitit 1971, i është përgjigjur duke vlerësuar se: “Në veprën e akteve të turpshme nuk është e konfigurueshme tentativa për shkak se duke përjashtuar mundësinë e cënimit të moralit publik—që mbrohet edhe nga norma - do të mungojë objektiviteti i veprës...”.³¹¹

3.3. Figura e veprës penale të “Pornografia”

3.3.1 Disa aspekte historike dhe kuptimi i pornografisë

Figura e veprës penale të pornografisë është parashikuar nga Kodi Penal që hyri në fuqi në vitin 1995, duke vazhduar traditën e kodeve penale të mëparshme, por duke sjellë risi në kuadër të teknikës së inkriminimit si qasje e zhvillimeve ndërkombëtare.

Në Kodin Penal të vitit 1952, në nenin 293 të tij parashikohej figura e veprës penale të “Pornografisë”, në të cilën parashikohej se: “*Prodhimi, shpërndarja dhe reklamimi i veprave, botimeve, figurave, ose sendeve të tjera pornografike, si dhe tregtija e tyre, ose mbajtja e tyre me qëllim shitjeje ose shpërndarjeje denohen me burgim gjer në tre vjet...*”³¹²

Edhe në Kodin Penal të vitit 1977, në nenin 136 parashikohej figura e veprës penale të “Pornografisë” në të cilën theksohet se: “*Prodhimi, shpërndarja dhe reklamimi i veprave, botimeve, i figurave dhe i sendeve të tjera pornografike si dhe tregtimi i tyre, ose mbajtja e tyre me qëllim shitjeje ose shpërndarjeje denohen me heqje lirie deri në tre vjet.*”³¹³

Siç vihet re, përmbajtja e neneve të kodeve penale të vitit 1952 dhe vitit 1977 janë në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të Gjenevës, datë 12.10.1923 “Mbi ndjekjen e shpërndarjes dhe të tregtisë së botimeve pornografike”.

Ndërsa në nenin 117 të Kodit Penal të vitit 1995, lidhur me figurën e veprës penale të pornografisë parashikohej se: “*Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet*”.

Kjo dispozitë u bë objekt i disa ndërhyrjeve legjislative. Kështu, me ligjin nr.9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar u shtua paragrafi i dytë me këtë përmbajtje: “

“*Përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.....*”³¹⁴. Një

³¹⁰ Shih vendimin nr.1702 të vitit 1972 të Gjykatës Italiane të Kasacionit

³¹¹ Shih vendimin nr.314 të vitit 1971 të Gjykatës Italiane të Kasacionit.

³¹² Shih nenin 293 të Kodit Penal të vitit 1952.

³¹³ Shih nenin 136 të Kodit Penal të vitit 1977.

³¹⁴ Shih nenin 1 të ligjit nr.9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

ndërhyrje e tillë ishte e nevojshme në kuadër të ratifikimit të Konventës “Për krimin në fushën e kibernetikës”³¹⁵.

Në momentin e këtij studimi neni 117 i Kodit Penal, pas shtesave dhe ndryshimeve të bëra me ligji nr.144, datë 2.5.2013 ka këtë përmbajtje: “*Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim deri në dy vjet.*

Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

*Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet*³¹⁶.

Siç konstatohet, teknikat e inkriminimit të kësaj figure të veprës penale kanë ndryshuar në krahasim me ato që kodet e mëparshme parashikonin. Kështu, në Kodin Penal të vitit 1995, ekzistenca e figurës së veprës penale u kondicionua me “ekzistencën e mjedisit ku ka fëmijë”.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se legjislacioni penal ka pasqyruar në përmbajtjen e tij të gjitha zhvillimet në kuadrin juridik ndërkombëtar. Kështu, ajo ka reflektuar edhe parashikimet e bëra nga konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual” Lanzarote, datë 25.10.2007, e cila është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009. Me anë të kësaj konvente shtetet anëtare ranë në marrëveshje lidhur me format e inkriminimit. Në nenin 20 kjo konventë parashikon se: “

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme, kur kryhet pa të drejtë:

- a) prodhimi i pornografisë së fëmijëve;*
- b) ofrimi ose vënia në dispozicion e pornografisë së fëmijëve;*
- c) shpërndarja ose transmetimi i pornografisë së fëmijëve;*

³¹⁵ Kjo konvente është ratifikuar me ligjin nr.8888, datë 25.04.2002 dhe në nenin 9 të saj parashikonte se: “Çdo Palë do të adaptojë legjislacion të tillë dhe masa të tjera, që mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë si vepra penale sipas ligjit të brendshëm, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë, në drejtimit e mëposhtme:

- a) prodhimin e pornografisë me fëmijë, me qëllimin e shpërndarjes së tij nëpërmjet një sistemi kompjuterik;*
- b) ofrimi apo vënia në disponim e pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik;*
- c) shpërndarja apo transmetimi i pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik;*
- d) prokurimi i pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik për vete apo për një tjetër*

e) zotërimi i pornografisë për fëmijë nëpërmjet një sistemi kompjuterik apo në një mjet të memorizimit të të dhënave kompjuterike.

2. Për qëllimin e paragrafit 1 të mësipërm “pornografi me fëmijë” do të përfshijë material pornografik që dallon nga ana pamore:

- a) një minoren, i cili angazhohet në drejtime të qarta seksuale;*
- b) një person, i cili duket që është minoren, i angazhuar në drejtime të qarta seksuale;*
- c) imazhe realiste që prezantojnë një minoren të angazhuar në drejtime të qarta seksuale.*

3. Për qëllimin e paragrafit 2 të mësipërm, termi “minoren” do të përfshijë të gjithë personat nën moshën 18 vjeç. Një Palë mundet, megjithatë, të kërkojë një limit moshe më të vogël, e cila nuk duhet të jetë më pak se 16 vjeç.

4. Çdo Palë mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë në tërësi apo pjesërisht paragrafin 1(d) dhe 1(e) dhe 2 (d) dhe 2 (c)”.

³¹⁶ Shih nenin 117 të Kodit Penal.

- d) përdorimi i pornografisë së fëmijëve për vete ose për ndonjë person tjetër;
- e) posedimi i pornografisë së fëmijës;
- f) krijimin e aksesit në mënyrë të vetëdijshme për pornografinë e fëmijës, nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.....

Risi e kësaj Konvente ishte parashikimi dhe inkriminimi i veprimeve, që lidhen me pjesëmarrjen e një fëmije në performanca pornografike.

Kështu, në nenin 21 të saj përcaktohet se: “1. *Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme:*

- a) *rekrutimin e fëmijës për të marrë pjesë në performanca pornografike ose bërjen e një fëmije që të marrë pjesë në të tilla performanca;*
- b) *shtrëngimi i një fëmije që të marrë pjesë në performanca pornografike ose përfitimi nga shfrytëzimi ose në raste të tjera prej shfrytëzimit të fëmijës për këto qëllime;*
- c) *marrja pjesë me vetëdije në performancat pornografike, që përfshijnë pjesëmarrjen e fëmijëve.*

2. *Secila palë mund të rezervojë të drejtën që të kufizojë aplikimin e paragrafit 1.c për rastet kur fëmijët janë rekrutuar ose shtrënguar në përputhje me paragrafin 1.a ose b....”*

Legjislacioni ynë penal nuk ka dhënë përkufizimin e termi “Pornografi e fëmijëve”. Megjithatë, përpjekjet janë bërë nga doktrina e së drejtës penale, por dhënia e një përkufizimi për pornografinë e fëmijëve është i vështirë për shkak të trajtimit të pakët të këtij koncepti, si dhe koneksitetit dhe nënkuptimit si një pornografi e zakonshme³¹⁷. Termi “pornografi e fëmijëve” nënkupton pornografinë konvencionale me subjekt fëmijët, me përmbajtje të imazheve me natyrë seksuale shfrytëzuese të fëmijëve viktima, pavarësisht pëlqimit të fëmijës për çdo akt seksual të përshkruar në çdo imazh.³¹⁸

Termi “pornografi e fëmijëve” përfshin, por nuk kufizohet në, “çdo paraqitje, në çfarëdo mënyrë, të një fëmije të përfshirë në aktivitete të vërteta ose të simuluar eksplicite seksuale ose çdo paraqitje e pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale”³¹⁹ si dhe përdorimin e një fëmije për të krijuar një të tillë shfaqje.

Pavarësisht se Kodi Penal nuk ka dhënë një përkufizim për pornografinë e fëmijëve, meqë Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual” (Lanzarote), mund t’i referohemi drejtpërdrejt përkufizimit të dhënë nga ajo. Kështu, në nenin 20/2 të saj theksohet se: “*Termi “pornografi fëmije” do të thotë çdo material që vizualisht pasqyron një fëmijë të angazhuar në një sjellje eksplicite reale ose të simuluar seksuale ose ndonjë pasqyrim i organeve seksuale të fëmijës për qëllimet seksuale parësore*”³²⁰.

Edhe legjislacionet penale të vendeve të tjera kanë dhënë përkufizimin e pornografisë së fëmijëve. Kështu, Kodi Penal i Kosovës e përkufizon pornografinë e

³¹⁷ Shih Per Erik Astrom “Beyond all tolerance, A growing problem demanding new counter-measures”, Save the Children Sweden, 2004 fq.11.

³¹⁸ Janis Wolak et al., Child-Pornography Possessors Arrested in Internet-Related Crimes: Findings from the National Juvenile Online Victimization Study vii, n.1 (Nat’l Ctr. for Missing & Exploited Children ed., 2005) [hereinafter Child-Pornography Possessors].

³¹⁹ Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the Sale of Children, Child Prostitution and Child Pornography, G.A. Res. 54/263, Annex II, U.N. Doc. A/54/49, Vol. III, art.2, para.c, entered into force Jan. 18, 2002 [hereafter Optional Protocol].

³²⁰ Shih nenin 20/2 të Konventës e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, Lanzarote, 25.10.2007, e cila është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009,

fëmijëve si: “Shprehja “pornografi me fëmijët” nënkupton çfarëdo pamje vizuale apo shfaqje ose pasqyrim vizual, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyrë elektronike, mekanike apo me mjete tjera, që paraqet ose pasqyron³²¹:

- a. gjenitalet (vagina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale; ose një fëmijë të vërtetë, i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;
- b. një person, i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose
- c. pamje realiste të një fëmije joekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar.

Ndërsa, lidhur me përkufizimin e termit “Pornografi” theksojmë se llojet e imazheve apo mediave që konsiderohen pornografike kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e kohës. Për qëllimet e këtij punimi, pornografia është përcaktuar si çdo media me aktivitet seksual ose lakuriqësi që është e qartë dhe ka si qëllim kryesor zgjimin seksual. Megjithatë, një përcaktim i tillë duhet të trajtohet me fleksibilitet. Kështu, për shembull në Shtetet e Bashkuara nuk ka rregulla të qarta se cilat do të konsiderohen media, ose materiale pornografike. Standardet ndryshojnë nga juridiksioni në juridiksion dhe udhëzimet janë në përgjithësi të paqarta.

Pornografia që përfshin fëmijët, megjithatë, është emërtuar në mënyrë të vazhdueshme si e turpshme dhe posedimi i këtij lloji të pornografisë është kriminale. Disa praktika gjyqësore kanë vendosur udhëzime të përgjithshme mbi ato që konsiderohen materiale të turpshme, pornografike. Për shembull, Roth v. United States (1957)³²² vendosi që materiali i turpshëm, kur ai konsiderohet i dënueshëm nga secili person, duke përdorur standardet morale të shoqërisë, dhe ku media e ka vetëm rol epshor jo artistike.

Në rastin Ginsberg v. New York (1968)³²³ gjykata vendosi që një shtet mund të miratojë standarde më të rrepta për shitjen e materialit pornografik për fëmijët. Rasti në fjalë ka të bëjë me ligjin e New Yorkut, i cili kriminalizoi shitjen për fëmijët nën 17 vjeç të materialeve që konsiderohen nga ana e shtetit si “të dëmshme për të miturit”. Sam Ginsberg, ishte dënuar në bazë të ligjit për shitjen e dy Revistave “Girlie” për një djalë 16-vjeçar. Ginsberg kundërshtoi ligjin për arsye se kishte krijuar një standard më të kufizuar për fëmijët se sa për të rriturit, duke shkelur kështu Amendamentin e Parë të drejtën e të miturve për të lexuar. Gjykata pranoi statutin. Ajo vlerësoi se edhe pse revistat nuk konsiderohen materiale të turpshme për të rriturit, ishte e lejueshme për shtetin e New York për të ndaluar shitjen e tyre për të miturit dhe se nuk ka një të drejtë të të miturve për pornografi (për të lexuar apo shikuar).

Në rastin Ginzburg v. United States (1965)³²⁴ gjykata paraqiti parimin se qëllimi i shitësit, që dëshmohet në mënyrën se si ai e paraqet ose reklamon materialin e tij, mund të jetë një faktor vendimtar në përcaktimin nëse diçka ishte e turpshme. Botuesi R.Ginzburg u dënua në bazë të statutit federal për postimin (me mail) të tre botimeve me përmbajtje seksuale: një revistë e quajtur EROS që përmbante artikuj dhe foto-ese për dashurinë dhe seksin; një çështje e një gazete dyjavore që shpalli përkushtimin e saj për të “mbajtur marrëdhëniet seksuale si art duke parandaluar që të bëhet një shkencë” dhe që përmbante artikuj rreth seksit botuar më parë në revista

³²¹ Shih nenin 228 të Kodit Penal të Kosovës.

³²² Shih vendimin Roth v. United States (1957) të Gjykatës Supreme të SHBA-ve

³²³ Shih vendimin Ginsberg v. Neë York (1968) të Gjykatës Supreme të SHBA-ve

³²⁴ Shih vendimin Ginzburg v. United States (1965) të Gjykatës Supreme të SHBA-ve

profesionale; dhe një libër të shkurtër të quajtur Manual shtëpiak mbi imoralitetin selektiv, një “autobiografi seksuale” e një shtëpiakeje, që përfshinte pikëpamjet e autorit mbi ligjet që rregullojnë praktikat private konsensuale seksuale të të rriturve dhe barazinë e gruas në marrëdhëniet seksuale. Gjykata e Lartë la në fuqi dënimin e Ginzburg. Duke shkruar për shumicën, gjyqtari Brennan u shpreh se në një rast të tillë, prova se i pandehuri paraqiti qëllimisht materialet në fjalë sa më tërheqëse për interesin e konsumatorëve erotike mund të mbështesë qendrimin se materialet janë të turpshme. Ai shkroi: “Ku theksi i vetëm i furnizuesit është në aspektet seksuale provokative të botimeve të tij, ky fakt mund të jetë vendimtar në përcaktimin e veprës si të turpshme”, edhe në qoftë se botimet ekzaminuar jashtë kontekstit nuk mund të konsiderohen të turpshme.

Në rastin *Miller v. California* (1973)³²⁵ Gjykata Supreme ka dhënë udhëzime të mëtejshme se çfarë materialesh ishin të turpshme. Sipas këtij vendimi, çdo media e cila kishte tepruar interesin në lakuriqësi, seks, ereksion, janë konsideruar të jenë të turpshme. Në këtë rast historik, Gjykata riezaminoi dhe ndryshoi standardin e veprës se turpshme të vendosur në rastin *Roth* 16 vjet më parë dhe krijoi një përkufizim të ri të veprës së turpshme, qe është dhe standardi aktual.

Rasti kishte të bënte me ligjin e Kalifornisë, i cili kriminalizoi postimet e materialeve të turpshme. Marvin Miller u dënua sipas ligjit, pas kryerjes së një postimi në masë (me mail) të reklamave për libra dhe filma për të rritur që kishte për shitje. Gjykata Supreme ndryshoi vendimin e gjykatës së apelit dhe e dërgoi rastin për rishikim në dritën e standardeve të reja të Amendamentit të Parë të përcaktuara në vendim.

Duke shkruar për shumicën, gjyqtari Warren Burger paraqiti testin e ri, me tre pjesë: *Udhëzimet bazë duhet të jenë: (a) nëse personi mesatar në aplikimin e standardeve bashkëkohore të komunitetit vlerëson se veprimi, i marrë në tërësi, bën thirrje për interes epshor; (B) nëse veprimi përshkruan, në një mënyrë dukshëm fyese, sjellje seksuale të përcaktuara në mënyrë specifike me ligjin në fuqi të shtetit; dhe (c) nëse veprimi marrë në tërësi, nuk ka vlera serioze letrare, artistike, politike, apo shkencore*. Z.Burger hodhi poshtë në mënyrë të qartë kërkesën që materiali i turpshëm të jetë “krejtësisht pa vlerë shërbyese sociale”, duke e zëvendësuar atë me standarde më të rrepta të mungesës se “vlerave serioze letrare, artistike, politike, apo shkencore”. Z.Burger gjithashtu hodhi poshtë kërkesën se “standartet bashkëkohore të komunitetit” që përdoren për të vlerësuar “interesin epshor” dhe konceptin “dukshëm fyese” duhet të jenë standartet kombëtare. Në vend të kësaj, juria duhet të përdorë standartet e komunitetit lokal. Elementi i tretë i ri që erdhi pas vendimit Miller ishte kufizimi i përcaktimit të veprimeve të turpshme me ato të përcaktuara në mënyrë specifike nga ligjet e shtetit.

Në rastin *New York v. Ferber* (1982)³²⁶, Gjykata Supreme vendosi se pornografia e fëmijëve nuk gëzonte mbrojtjen e Amendamentit të Parë. Rasti kishte të bënte me ligjin e pornografisë së të miturve në Nju Jork, i cili kriminalizoi prodhimin ose shitjen e çdo përshkrimi vizual të fëmijëve nën moshën 16 vjeç të angazhuar në akte seksuale, pavarësisht nëse përshkrimi do të konsiderohet i turpshëm ose jo. Gjykata la në fuqi dënimin e një personi që u shiti agentëve të fshehtë dy filma të djemve të rinj duke masturbuar.

Gjykata vendosi se shtetet kanë të drejtë për një liri veprimi më të gjërë në rregullimin e materialeve pornografike të fëmijëve se sa në ato të të rriturve, duke

³²⁵ Shih vendimin *Miller v. California* (1973) të Gjykatës Supreme të SHBA-ve

³²⁶ Shih vendimin *New York v. Ferber* (1982) të Gjykatës Supreme të SHBA-ve

theksuar interesin e shtetit në mbrojtjen e fëmijëve, të cilët mund të shfrytëzohen ose të keqpërdoren për prodhimin e pornografisë së fëmijëve. Ky interes tregon se shtetet mund të miratojnë rregullore të pornografisë së fëmijëve, që mund të gjenden antikushtetues nën standardin *Miller*, nëse aplikohet për pornografinë që përfshin të rriturit. Në rastet që përfshijnë fëmijë, një juri “nuk ka nevojë të vërtetojë se materiali ka të bëjë me interesin e personit mesatar; nuk është e nevojshme që sjellja seksuale e portretizuar të jetë bërë në një mënyrë dukshëm fyese dhe materiali në fjalë nuk ka nevojë të merret parasysh si një i tërë”. Gjykata vuri në dukje se gjithsesi materiali që nuk përfshin performancë të drejtpërdrejtë të akteve seksuale me fëmijët ende kishte të drejtë për mbrojtje nga Amendamenti i Parë.

Objekti juridik i saj janë normat e moralit shoqëror në mjediset e të miturve të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet dhe mosveprimet kriminale, të cilat çojnë në shthurjen morale të të miturve.

3.3.2. Kuptimi i termit “fëmijë”

Përcaktimi i termit “fëmijë”, për qëllimet e pornografisë së fëmijëve, do të konsiderohet “çdo person nën moshën 18 vjeç”, pavarësisht nga moshja e arritjes së pjekurisë seksuale. Moshja që përcaktohet nga ligji, në të cilën një person mund të konsiderohet i aftë për të dhënë pëlqimin për aktivitetin seksual ndryshon nga vendi në vend, një pengesë e vështirë për mbrojtjen e qëndrueshme dhe të harmonizuar të fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në nivel ndërkombëtar. Ndërsa, një person nën moshën 18 vjeç mund të jetë në gjendje për të dhënë pëlqimin lirisht për marrëdhëniet seksuale, një individ i tillë nuk është ligjërisht në gjendje për të dhënë pëlqimin për çdo formë të shfrytëzimit seksual, duke përfshirë edhe pornografinë e fëmijëve.

Për më tepër, në rrethana që kërkojnë “inkriminimin e dyfishtë”, kur një krim i kryer jashtë shtetit duhet të jetë i parashikuar si krim edhe në vendin e abuzuesit në mënyrë që shkelësi të ndiqet penalisht në vendin e tij. Marrëveshja për një moshë të përbashkët se kush do të konsiderohet i mbrojtur nga termi “fëmijë” është vendimtare. Çdo mospërputhje mund të ndalojë ndjekjen penalisht të abuzuesit, i cili ka abuzuar seksualisht me fëmijën. Për këto arsye, “fëmijë”, për qëllimet e legjislacionit të pornografisë së fëmijëve, duhet të përcaktohet si “të gjithë personat nën moshën 18 vjeç”.³²⁷

Kodi ynë Penal nuk ka parashikuar në mënyrë eksplicite moshën e fëmijës, atë nën 18 vjeç, siç ka bërë, për shembull Kodi Penal italian, i cili në nenin 600 të tij parashikon se: “*Kushdo, që duke përdorur të miturit nën 18 vjeç, realizon shfaqje pornografike apo prodhon materiale pornografike apo nxit të miturit nën 18 vjeç të marrin pjesë në shfaqje të tilla, dënohet me burgim nga 6 në 12 vjet dhe me gjobë nga 25.822 në 258.228 euro*”³²⁸. Ndërsa, Kodi Penal i Kosovës ka vendosur një kufi tjetër lidhur me moshën. Kështu, në nenin 237 të tij parashikohet se: “*1. Kushdo që shet, ofron të shesë, shfaq ose në mënyrë tjetër i siguron personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet fotografi, material audiovizuel apo sende të tjera me përmbajtje pornografike ose e lejon personin e tillë të shoh një shfaqje të gjallë me përmbajtje pornografike apo me dashje e sjell personin e tillë në një shfaqje të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet....*”.

³²⁷Shih International Centre for Missing & Exploited Children (ICMEC) - Child Pornography- Model legislation & Global Review, 2012, 7th Edition, pg.1.

³²⁸ Shih nenin 600 të Kodit Penal Italian.

Në nenin 3 të Konventës Lanzarote, është parashikuar se: “...Për qëllimet e kësaj Konvente: a “fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç...”³²⁹.

Për të gjitha arsyet që përmendem më sipër është e rëndësishme që shtetet t'i referohen moshës 18 vjeç.

Pasojat e kësaj figure të veprës penale për jetën e fëmijëve të abuzuar seksualisht, me ushtrimin e pornografisë ndaj tyre, janë të mëdha dhe zgjasin në kohë, sepse ato vijnë jo vetëm nga abuzimi seksual, që ndodh fizikisht, apo psikologjikisht ndaj tyre, por edhe nga ruajtja e të dhënave të kriminit për një kohë të gjatë³³⁰. Subjekti aktiv i kësaj veprë penale mund që jo vetëm të ngacmojë seksualisht fëmijën, por edhe të dokumentojë aktet seksuale me foto ose video. Këtë dokumentim, ai mund ta përdor si “mjet kërcënues” të nevojshëm, ose të mjaftueshëm për t'i bërë shantazh të miturit, në mënyrë që të përfitojë një nënshtrim të mëtejshëm, i cili është i nevojshëm për të vazhduar marrëdhënien seksuale dhe për të ruajtur fshehtësinë. Këto imazhe të dokumentuara u lejojë abuzuesve të ripërjetojnë fantazitë e tyre seksuale³³¹.

Një numër i madh i subjekteve aktive të pornografisë të të miturve përdorin teknologjitë kompjuterike për të organizuar, për të ruajtur dhe për të rritur madhësinë e koleksioneve të pornografisë së miturve. Imazhet personale të paligjshme të fëmijëve, ata i hedhin në website të ndryshme. Kur këto imazhe arrijnë të hyjnë në cyberspace (hapsirën virtuale), ato janë të pamundura të zhduken dhe mund të vazhdojnë të qarkullojnë përgjithmonë. Kështu, fëmija riviktimizohet sërish, pasi këto imazhe mund të shihen përsëri dhe përsëri.

Interneti ka krijuar një botë të re tërheqëse të informacionit dhe komunikimit për të gjithë që kanë akses në shërbimet online. Ndërsa, kjo teknologji ofron mundësi të pashembullt për fëmijët dhe të rriturit, nga ana tjetër, ka pasur një ndikim të pamasë mbi shfrytëzimin seksual të fëmijëve, në mënyrë specifike përmes shpërndarjes së imazheve të abuzimeve seksuale të fëmijëve.

Zhvillimi ka rritur mundësinë e aksesit dhe përdorimit të teknologjisë nga pajisjet kompjuterike, të cilat gjenden lehtësisht, në ditët e sotme në çdo shtëpi, duke revolucionarizuar shpërndarjen e këtyre imazheve dhe duke rritur lehtësinë e posedimit dhe shpërndarjes, uljen e kostos së prodhimit dhe shpërndarjes, sidomos përtej kufijve ndërkombëtarë.

Asnjë vend nuk është i imunizuar nga kjo formë e shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe duhet bërë përpjekje nëpërmjet qeverisë, organeve të zbatimit të ligjit dhe shoqërisë civile për të siguruar që fëmijët të jenë të mbrojtur.

³²⁹ Shih nenin 3 të Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual” (Lanzarote).

³³⁰ Shih, Qendra Ndërkombëtare për Fëmijët e Zhdukur dhe të Shfrytëzuar (ICMEC) është duke udhëhequr një lëvizje globale për mbrojtur fëmijët nga abuzimi seksual, shfrytëzimit dhe rrëmbimit. Puna ICMEC sjell besimin tek fëmijët dhe familjet e tyre me: krijimin e burimeve globale për të gjetur fëmijët e humbur dhe për të parandaluar shfrytëzimin seksual të fëmijëve; nxitjen e krijimit qendrave operative kombëtare të bazuar në një model partneriteti publik-privat; ndërtimin e një rrjeti ndërkombëtar për të shpërndarë imazhet dhe informacion në lidhje me fëmijët e humbur; duke ofruar trajnime për zbatuesit e ligjit si prokurorët, gjyqtarët, profesionistët e tjerë ligjor, organizatat joqeveritare, dhe zyrtarët e qeverisë; propozon ndryshime në ligje, traktatet, dhe sistemet për mbrojtjen e fëmijëve në mbarë botën; kryerjen e konferenca ndërkombëtare të ekspertëve për të rritur profesionalizmin e tyre; nxitjen dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet vendeve; dhe duke çuar koalicionet globale për çrrënjosjen e pornografisë së fëmijëve nga interneti dhe për të sulmuar abuzimin seksual të fëmijë si një epidemi e shëndetit publik.

³³¹ ICMEC - Child Pornography- Model legislation & Global Review, 2012,

3.3.3 Format e inkriminimit

Teknikat e inkriminimit për këtë figurë të veprës penale janë përcaktuar nga konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual” (Lanzarote). Me anë të kësaj konvente shtetet anëtare ranë në marrëveshje lidhur me format e inkriminimit.

Në nenin 117 të Kodit Penal të vitit 1995, lidhur me figurën e veprës penale të pornografisë janë pasqyruar këto teknika inkriminimi të kërkuara nga konventa me anë të parashikimeve të bëra nga ligji nr.144, datë 2.5.2013 si: “*Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim deri në dy vjet.*”

Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet... ”.

Pra, siç vihet re, paragrafi i dytë i nenit 117 të Kodit Penal parashikon format e inkriminimit të sugjeruara nga Konventa Lanzarote. Për herë të parë u inkriminua pornografia e fëmijës, sepse deri në këtë moment ishte kriminalizuar vetëm “pornografia në mjediset ku ka fëmijë”. Tashmë është kriminalizuar edhe pornografia e fëmijëve.

Në zbatim të këtij detyrimi Republika e Shqipërisë ka marrë masat legislative përkatëse duke kriminalizuar format e parashikuara në nenin e sipërcituar. Kështu, me anë të ligjit nr.144, datë 2.5.2013 ka parashikuar se: “...*Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet*”³³². Më poshtë po trajtojmë disa forma inkriminimi:

3.3.3.1. Kriminalizimi i posedimit të materialeve pornografike me fëmijë, pa marrë parasysh qëllimin për t’i shpërndarë ato (Karakteri formal i veprës penale të pornografisë)

Një nga teknikat e inkriminimit që përdor Kodi Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Pornografia” është posedimi i pornografisë së fëmijëve. Kështu, në nenin 117/2 të tij theksohet se: “...*Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.*”³³³

Kjo teknikë inkriminimi është parashikuar edhe nga kodet penale të mëparshme. Kështu, në nenin 293 të Kodit Penal të vitit 1952 parashikohej se: “*Prodhimi, shpërndarja dhe reklamimi i veprave, botimeve, figurave, ose sendeve të tjera pornografike, si dhe tregtija e tyre, ose mbajtja e tyre me qëllim shitjeje ose shpërndarjeje denohen me burgim gjer në tre vjet...*”³³⁴

Edhe në Kodin Penal të vitit 1977, në nenin 136 parashikohej figura e veprës penale të “Pornografisë” në të cilën theksohet se: “*Prodhimi, shpërndarja dhe*

³³² Shih nenin 117 /3 të Kodit Penal.

³³³ Shih nenin 117 të Kodit Penal.

³³⁴ Shih nenin 293 të Kodit Penal të vitit 1952.

*reklamimi i veprave, botimeve, i figurave dhe i sendeve të tjera pornografike si dhe tregtimi i tyre, ose mbajtja e tyre me qëllim shitjeje ose shpërndarjeje denohen me heqje lirie deri në tre vjet.*³³⁵

Kodi Penal që hyri në fuqi në vitin 1995, parashikonte figurën e veprës penale të “Pornografia”³³⁶, parashikonte se: “*Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet*”.

Siç konstatohet, Kodi i ri Penal nuk parashikonte në mënyrë ekspicite teknikën e inkriminimit të posedimit të pornografisë së fëmijëve.

Kjo teknike inkriminimi u parashikua me ligjin nr.144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke parashikuar se: “*...Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet...*”³³⁷.

Ky parashikim përbënte një risi në krahasim me kodet penale të mëparshme sepse posedimi i pornografisë nuk kondicionohet me qëllim specifik mbajtjeje për shpërndarje, ose shitje. Për efekt konsumimi, mjafton posedimi i pornografisë duke formalizuar në mënyrë të dukshme këtë figurë të veprës penale.

Kodi ynë Penal ka përdorur teknikën inkriminuese të përshkrimit, duke përshkruar në një dispozitë të vetme të gjitha format që përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale. Legjislatorët e vendeve të tjera kanë përdorur teknika të ndryshme. Për shembull, Kodi Penal italian ka përdorur teknikën klasike të inkriminimit, duke parashikuar në një dispozitë më vetë posedimin e pornografisë. Kështu, në nenin 600 quarter ka parashikuar se: “*Kushdo, jashtë rasteve të nenit 600 ter, me vetëdije gjen apo mban materiale pornografike të realizuara duke përdorur të mitur nën 18 vjeç, dënohet me burgim deri në 3 vjet dhe me gjobë jo më pak se 1.549 euro. Dënimi rritet jo më shumë se dy të tretat kur materiali i mbajtur është i një sasive të madhe...*”³³⁸.

Çdo imazh i pornografisë së fëmijëve që është fituar, inkurajon rritjen e mëtejshme të kësaj industrie të paligjshme, nga “porositës” të pornografisë të fëmijëve. Një nga rastet kur pornografia ndodh në “kohë reale” është rasti kur abonentët paguajnë për të parë abuzimin e transmetuar në internet të fëmijëve nëpërmjet klikimit të faqeve të paligjshme që shpërndajnë materiale pornografike me të mitur.

Viktimat e paraqitura në imazhe janë fëmijë gjithmonë e më të vegjël, imazhet po bëhen më grafike dhe më të dhunshme. Internet Watch Foundation (IWF) në Mbretërinë e Bashkuar thekson se, nga të gjitha raportet e pornografisë së fëmijëve të marra nga IWF në vitin 2009, 72% e viktimave duket të jetë fëmijët 10 vjeç ose më të rinj, 23% kanë qenë 6 vjeç ose më të rinj, dhe 3% janë 2 vjeç ose më të rinj.³³⁹ Sipas raportit të vitit 2011 vjetor të IWF, numri i viktimave që shfaqeshin nën moshën 10

³³⁵ Shih nenin 136 të Kodit Penal të vitit 1977.

³³⁶ Shih nenin 117 ligjit nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

³³⁷ Shih nenin 117 të Kodit Penal.

³³⁸ Shih nenin 600 quarter të Kodit Penal Italian.

³³⁹ Shih Internet Watch Foundation, 2009 Annual and Charity Report 18, at [http://www.iwf.org.uk/assets/media/annual-reports/IWF 2009 Annual and Charity Report.pdf](http://www.iwf.org.uk/assets/media/annual-reports/IWF%2009%20Annual%20and%20Charity%20Report.pdf).

vjet u rrit në 74%.³⁴⁰ Për më tepër, IWF raportoi një rritje të tmerrshme në përqindjen e imazheve të abuzimit seksual me fëmijë në internet, nga 7% në vitin 2003 në 29% në vitin 2006, duke demonstruar një rritje të kërkesave për imazhe më të rënda të abuzuesve.³⁴¹ Kjo prirje shqetësuese vazhdon, IWF raportoi se 67% të imazheve nga viti 2011 e në vazhdim përkruanin përdhunimin apo torturimin e një fëmije.

Gjetje të ngjashme janë konfirmuar edhe nga një studim i mëparshëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila tregon se 83% e të arrestuarve posedues të pornografisë së fëmijëve kishin imazhe të fëmijëve 6 deri në 12 vjeç; 39% kishin imazhet e fëmijëve 3 deri në 5 vjeç; dhe 19% kishin imazhet e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël nën moshën 3 vjeç.³⁴² 92% e të arrestuarve kishin imazhe të të miturit duke u fokusuar në organet gjenitale apo që tregojnë aktivitetin e qartë seksual; 80% kishin fotografi që tregonin depërtimin seksual të fëmijës, duke përfshirë edhe seksin oral; dhe 21% kishin materiale pornografike me fëmijë që përkruanin dhunë të tillë si përdhunimi, skllavëria, dhe torture.³⁴³

Shumica e këtyre imazheve përfshinin fëmijë të cilët ishin të lidhur, të nënshtruar, me sytë të lidhur, ose duke vuajtur akte seksuale sadiste. I njëjti studim gjithashtu tregoi se 40% e të arrestuarve posedues të materialeve pornografike me fëmijë ishin “shkelës të dyfishtë”, të cilët abuzonin seksualisht fëmijët dhe njëkohësisht zotëronin materiale pornografike me fëmijëve, duke sugjeruar se mund të ketë një korrelacion midis posedimit, mbajtjes së thjeshtë të materialeve pornografike me fëmijë dhe kryerjen e abuzimit seksual mbi një fëmijë.

Kriminalizimi i posedimit të mbajtjes së materialeve pornografike me fëmijë, jo vetëm që mund të frenojë rritjen e kësaj industrie, por edhe sjell parandalimin e incidenteve të mëtejshme të abuzimit seksual ndaj fëmijëve.

Posedimi i pornografisë së fëmijëve nuk ka qënë e inkriminuar më përpara, bëhet fjalë për kodet penale të vitit 1952, 1977, si dhe kodi penal i vitit 1995, sipas këndvështrimit të sipërpërmendur³⁴⁴. Pas disa vitesh, në zbatim edhe të angazhimeve të marra përsipër me ratifikimin e Konventës Lanzarote³⁴⁵, me ligjin nr.144 të vitit 2013 “Për disa shtresa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” në nenin 29 përcaktohet se: “Neni 117 ndryshohet si më poshtë: “*Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.....*”.

Pra, siç verehet posedimi i pornografisë së fëmijëve është kriminalizuar nga legjislacioni jonë penal. Pavarësisht kohës relativisht të shkurtër nga kriminalizimi, praktika gjyqësore ka treguar qasje të rëndësishme në kuptimin dhe zbatimin e kësaj formë inkriminimi. Në këtë drejtim vlen të përmendet vendimi nr.1048 datë 05.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin theksohet se: “...*Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion për kërkimet e kryera rezultoi se nga*

³⁴⁰Shih Internet Watch Foundation, 2011 Annual and Charity Report 12, at <http://www.iwf.org.uk/accountability/annual-reports/2011-annual-report>.

³⁴¹Shih Internet Watch Foundation, 2006 Annual and Charity Report 19, at http://www.enough.org/objects/20070412_iëf_annual_report_2006_web.pdf.

³⁴²Shih Janis Wolak et al., Child-Pornography Possessors Arrested in Internet-Related Crimes: Findings from the National Juvenile Online Victimization Study.

³⁴³Po aty

³⁴⁴Kodi i ri Penal që hyri në fuqi në vitin 1995, parashikonte se: “*Neni 117 Pornografia Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet*”.

³⁴⁵Shih nenin 20 të kësaj konvente.

Shqipëria, më datë 01.04.2015, ora 13:21:35 UTC, është gjeneruar raporti me Nr.385, për përdoruesin (userhash) me kodin 28D85C612E0E643ABD85198FE1236F6D. Ky përdorues, nga IP 92.60.22.7, datë 30.01.2015, 00:08:26 UTC, ka disponuar materialin pornografik me të mitur me të dhëna (filehash) 308C9E3650EC52EC9049BC1BC4108B1F. Gjithashtu nga Interpoli Wiesbaden është vënë në dispozicion dhe video me materialin pornografik me të mitur, një tabelë fotografike mbi këtë video si dhe materiale të tjera në lidhje me kërkimin dhe dokumentimin e provës së gjetur në rrjetin e Donkey 2000.

Nga verifikimet paraprake ka rezultuar se adresa e mësipërme IP (Internet Protocol) i përket subjektit AbiseNet. Ky subjekt, me shkresën 3737, datë 12.06.2016 ka konfirmuar se adresa IP i përket te pandehurit E V, me adresë në rrugën "Muhamet Gjollështa". Në këto kushte, është kërkuar dhe pranuar nga gjykata kryerja e kontrollit personal dhe banesës së të pandehurit E.V si dhe sekuestrimit të pajisjeve kompjuterike të këtij personi. Në datë 03.07.2015 është kryer kontrolli i banesës së te pandehurit E.V, ku janë gjetur e në vijim sekuestruar një njësi kompjuterike, një hard disk i jashtëm i Markës "Toshiba" dhe një hard disk i jashtëm i tipit "LACIE". Në të njëjtën datë është bërë dhe kontrolli personal i pandehurit E.V, veprim gjatë të cilit janë gjetur dhe pajisje të tjera dixhitale, konkretisht një aparat telefonik "ONE PLUSE", një USB, një hard disk i jashtëm i markës "ADATA", dhe një tjetër hard disk i jashtëm me shënime "2.5 SATA EXTERNAL CASE serial ATA".

- Organet e policisë gjyqësore kanë bërë këqyrje të njësisë kompjuterike të sekuestruar në banesën e te pandehurit E.V. Nga ky veprim rezulton se në këtë pajisje ndodhen dy skedarë të emërtuar "Incoming" dhe "Temp". Në skedarin "Incoming" konstatohen një numër i konsiderueshëm skedarësh, foto dhe video, të cilat pasqyrojnë akte seksuale me të mitur. Disa nga pamjet janë printuar gjatë këqyrjes së kryer. Skedari përmban foto dhe video në një sasi shumë të madhe konkretisht në një kapacitet prej 392 Gb.

- Gjithashtu është kryer edhe ekspertimi kompjuterik i pajisjeve që i janë sekuestruar të pandehurit. Sipas aktit të ekspertimit nr.1961 datë 11.11.2015, të ekspertëve të Institutit të Policisë Shkencore, ka rezultuar e provuar se në njësinë kompjuterike pa markë, me ngjyrë të zezë dhe gri e pikërisht në hard diskun e markës HITCHI me nr.serial FL34YN4K është konstatuar një folder me emërtimin "eMule", në brendësi të të cilit janë konstatuar një numër i madh skedarësh fotografi dhe video me përmbajtje pornografi me të mitur. Ky folder ka një madhësi prej 392 GB. Gjithashtu në hard diskun e markës HITCHI me numër serial JP1572JE1MKwJK përveç të tjerave theksohet se: **"..Në këtë hard disk u konstatuan disa të dhëna që tregojnë se janë shkarkuar (download) materiale me përmbajtje pornografi me të mitur dhe se këto materiale janë hapur dhe parë..."**.

I pandehuri E.V, në periudhën prill-korrik 2015, ka poseduar në pajisjet e tij kompjuterike, një sasi mjaft të madhe materialesh pornografike me të mitur. Materialet përbëhen nga foto dhe video të shumta, me materiale pornografike, në të cilat janë përfshirë edhe persona të mitur të moshave të ndryshme saktësisht një vajze që prezumohet e moshës 4 vjeç, një djalë i moshës 7 vjeç, një vajzë e moshës 8 vjeç etj...

Mbi këtë bazë organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar procedimin penal duke e akuzuar të pandehurit E.V për veprën penale "Pornografia" parashikuar nga neni 117/2 i K.Penal.

Hetimi dhe gjykimi i të pandehurit E.V është bërë me mase sigurimi personal me karakter shtrëngues "arrest ne burg" nga data e ndalimit 03.07.2015 e në vijim. Lidhur sa sipër Gjykata vëren se neni 117/2 i K.Penal parashikon se:

“Prodhimi, importimi, ofrimi, venia ne dipsozicion, shperndarja, transmetimi përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme me të, me çdo mjet ose forme dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se ligjvënësi ka parashikuar mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve të vendosura për të siguruar normat e moralit shoqëror në mjediset e të miturve të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale. Këto veprime, për t’u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që:

*Objekti: Jane çënuar nga i pandehuri E.V marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar integritetin moral, fizik, psikologjik të të miturit të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale...*³⁴⁶.

3.3.3.2. Kriminalizimi i shkarkimeve dhe shikimeve nga interneti i imazheve pornografike me fëmijë dhe përdorimi i internetit për të shpërndarë pornografinë e fëmijëve.

Subjekti aktiv i kësaj figure të veprës penale përdor internetin për të parë, shkarkuar, shpërndarë, treguar pornografinë e fëmijëve në mënyrë të përditshme. Prandaj, si u theksua me lart, është e domosdoshme që vëmendje specifike t’i kushtohet, kompjuterit ose teknologjisë, internetit, e cila përdoret për të krijuar pamje, për të poseduar, ose shpërndarë materiale pornografike me fëmijë, ose që shërben në ndonjë mënyrë tjetër për të kryer veprën e pornografisë së fëmijëve.

Vihet re se ka një dallim në mes të të shikuarit të një imazhi në internet dhe shkarkimit të imazhit nga interneti. Të dyja veprimet të realizuara me vetëdije si shikimi edhe shkarkimi duhet të penalizohen si vepra të veçanta dhe të dallueshme.

Në vendimin nr.1048, datë 05.04.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka theksuar se: *“...Ana objektive. Vepra penale është kryer nga i pandehuri E.V me veprime aktive të kundërligjshme serioze dhe konkrete duke shkarkuar fotot dhe videot me përmbajtje pornografike me të mitur në pajisjet e tij kompjuterike, duke realizuar posedimin dhe përdorimin e materialeve pornografike, e për rrjedhojë duhet të pergjigjet penalisht...*³⁴⁷.

Shpërndarja e videove, materialeve vizuale etj, me përmbajtje pornografike të fëmijëve çënon edhe jetën private të protagonistëve të tyre, nderin e personalitetin e tyre.

Pyetjet që lindin në rastin konkret janë: 1. Cilat janë dallimet ndërmjet figurave të veprës penale të “Pornografia” parashikuar nga neni 117 dhe figurës së veprës penale të “Ndërhyrje të padrejta në jetën private” parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal. 2. A konkurojnë këto figura të veprës penale me njëra-tjetrën?

Lidhur me pyetjen e parë evidentojmë se dallimet ndërmjet këtyre veprave qëndrojnë:

- a) Tek objekti i mbrojtur. Figura e veprës penale të “Pornografia” objekti i mbrojtur është janë normat e moralit shoqëror në mjediset e të miturve të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet dhe mosveprimet kriminale, të cilat çojnë në shthurjen morale të të miturve. Në disa raste objekti i mbrojtjes merr karakter multi-ofensiv, duke patur si

³⁴⁶ Shih vendimin nr.1048, datë 05.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁴⁷ Shih vendimin nr.1048, datë 05.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

objekt dytësor jetën private, nderin e personalitetit, zhvillimin seksual të fëmijës etj. Ndërsa, figura e veprës penale “Ndërhyrja të padrejta në jetën private ka si objekt mbrojtjeje marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar jetën private të personit nga ndërhyrje të padrejta në të.

- b) Ana objektive, hipotezat e dispozitave të nenit 121 dhe 117 të Kodit Penal përcaktojnë anën objektive të secilës prej tyre. Kështu, vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën anën objektive të figurës së veprës penale të “Ndërhyrja të padrejta në jetën private”³⁴⁸. Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, përbën anën objektive të figurës së veprës penale “Pornografia”³⁴⁹.
- c) Qëndrimi psikik i subjektit aktiv ndaj objektit të mbrojtur dhe që kërkohet dhe dëshirohet të cënohet është dallimi në anën subjektive të këtyre figurave.

Për të konkretizuar dallimet ndërmjet këtyre figurave të analizojmë një rast praktik. Në vendimin nr.62, date 27.02.2013 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë³⁵⁰ theksoi se: “

I gjykuari K.B dhe kallëzuesja, shtetësja D.K, janë banues në fshatin Gradishtë Lushnjë dhe kanë pasur një lidhje intime bashkë. Ajo e akuzon se ai ka shpërndarë me “blue-tooth” një video ku të dy kanë kryer marrëdhënie seksuale. Video, e cila ishte rreth 25-30 sekonda është shpërndarë edhe në ambientet e shkollës ku studion motra e kallëzueses, shtetësja A.K.

Mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë Lushnjë, Prokuroria e Lushnjës ka regjistruar procedimin penal nr.109 duke e akuzuar të gjykuarin për veprën penale të “Shpërndarjes së materialeve pornografike” sipas nenit 117 të K.Penal³⁵¹.

Prokuroria e ka dërguar çështjen në gjykim me akuzën e “Shpërndarjes së materialeve pornografike” sipas nenit 117 të K.Penal. I gjykuari nuk e ka pranuar akuzën dhe ka kërkuar pafajësi. Kallëzuesja, në cilësinë e të dëmtuarës akuzuese, i është drejtuar më datë 30.11.2011 Gjykatës së Lartë, me deklaratën noteriale nr.2773, rep të datës 30.11.2011 para Noterit Sh.C dhe kërkon heqjen dorë përfundimisht nga ankimi dhe dënimi i K.B, pasi kjo është kundra vajtje penale që ndiqet mbi ankim me vullnetin e saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me vendimin nr.50 (492), datë 28.04.2009 ka vendosur:

- i. Deklarimin fajtor të të pandehurit K.B për kryerjen e veprës penale “Ndërhyrje e padrejtë në jetën private” në dëm të shtetases D.K, parashikuar*

³⁴⁸ Shih nenin 121 të Kodit Penal

³⁴⁹ Shih nenin 117 të Kodit Penal

³⁵⁰ Shih vendimin nr 62 datë 27.02.2013 të Kolegjit penal të Gjykatës së Lartë

³⁵¹ Neni 117 K.Penal “Pornografia”, “Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”

nga Neni 121 i K.Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me shtatë muaj e gjysëm burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.212, datë 27.04.2011, ka vendosur:

i. Lënien në fuqi të vendimit penal nr.50 (492), datë 28.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, gjen zbatim amnistia e veprës penale, sipas ligjit nr.107/2012 “Për dhënie amnistie” për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë i gjykuari B. dhe për pasojë vendimet do të prishen dhe do të vendoset pushimi i gjykimit.

I gjykuari K B është dënuar me vendim të formës së prerë për kundravajtjen penale të “Ndërhyrje e padrejtë në jetën private” në dëm të shtetas D.K, parashikuar nga Neni 121 i K.Penal. Koncepti i formës së prerë së vendimit lidhet ngushtë me parimin e sigurisë juridike pasi ka të bëjë me shqyrtimin përfundimtar të çështjes. Sipas K.Pr.Penale një vendim merr formë të prerë në dy raste: i) kur palët nuk kanë bërë ankim ndaj vendimit dhe ii) mbasi është shqyrtuar në gjykatën e apelit.

I gjykuari, është dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të “Ndërhyrje e padrejtë në jetën private”³⁵², në dëm të shtetas D.K, parashikuar nga Neni 121 i K.Penal. Kjo vepër parashikohet si kundërvajtje penale ku si sanksion penal ka dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy vjet, dhe është një vepër që pretendohet e kryer para datës 30 shtator 2012. Si rrjedhim kjo vepër penale futet në atë bashkësi që përfshin neni 5 i Ligjit “Për dhënie amnistie” i sipërcituar dhe si e tillë duhet pushuar.

Kolegji Penal vlerëson se çështja në ngarkim të të gjykuarit K.B, duhet të pushohet në bazë të nenit 387/1 të K.Pr.Penale³⁵³ për shkak se ndjekja penale nuk mund të vazhdojë...”

Gjykata në kualifikimin ligjor të faktit tipik duhet të analizojë pjesët përbërëse të tij. Kështu, fakti tipik mund të segmentizohet në dy pjesë. Në pjesën e parë përfshihet krijimi i videos, që përmban regjistrimin, fiksimin e marrëdhënies seksuale të kryer ndërmjet shtetasve K.B dhe D.K, nga shtetasi K.B. Në pjesën e dytë përfshihet shpërndarja e videos në ambientet e shkollës së motrës së shtetas D.K. Secila prej këtyre pjesëve përbën një fakt tipik më vete.

Lidhur me kualifikimin ligjor të faktit tipik të parë duhet t’i jepet përgjigje pyetjes nëse: A mund të konsiderohet pornografi e fëmijëve regjistrimi i videos nga shtetasi K.B?

Duke iu referuar përkufizimit të termit “pornografi fëmije, sipas të cilit ajo do të thotë çdo material që vizualisht pasqyron një fëmijë të angazhuar në një sjellje eksplicite reale ose të simuluar seksuale ose ndonjë pasqyrim i organeve seksuale të fëmijës për qëllimet seksuale parësore³⁵⁴, arrijmë në përfundimin se videoja, në të

³⁵² N.121 K.Penal “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”

“Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

³⁵³ Neni 387/1 i K.Pr.Penale “Vendimi i pushimit të çështjes”

“1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun...”

³⁵⁴ Shih nenin 20/2 të Konventës e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, Lanzarote, 25.10.2007, e cila është ratifikuar nga Republika e ahqipërisë me ligjin nr 10071 datë 09.02.2009

cilën pasqyrohet marrëdhënia seksuale ndërmjet shtetasve K.B dhe D.K, konsiderohet pornografi e fëmijëve nëse njëri prej protagonistëve të përfshirë në të është fëmijë, nën 18 vjeç, në të kundërt ajo nuk mund të konsiderohet pornografi e fëmijëve. Nga ana objektive figura e veprës penale të “Ndërhurja të padrejta në jetën private” kërkon fiksimin, regjistrimin ose transmetimin i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimin e këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij. Kështu, fiksimi ose regjistrimi i videos, në të cilën pasqyrohet një aspekt i jetës private të shtetasve K.B dhe D.K, kondicionohet për efekt konsumimi të figurës së veprës penale me publikimin e saj. Lidhur me këtë fakt tipik duhet të analizojmë edhe një çështje tjetër juridike që lidhet me sjelljen eksplicite seksuale reale që pasqyron vizualisht materiali. Pra, pyetja që lind është: A konkuron figura e veprës penale të “Pornografisë” me figurën e veprës penale përkatëse që konsumohet nga kryerja e sjelljes eksplicite seksuale, psh marrëdhënia seksuale që kryejnë protagonistet, nga të cilët njëri është i mitur, e cila më pas pasqyrohet vizualisht në një material, fotografi, video etj?

Është e qartë që sipas shembullit të marrë më sipër janë konsumuar të dy figurat e veprave penale të “Pornografia” dhe “Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur”. Konkluzioni nëse ato konkurojnë me njëra-tjetrën do të arrihet pasi të analizohet koncepti i konkurimit fiktiv në formën e përthithjes, i cili në bazë të vlerësimit konkret të padrejtësisë materiale i dy ose më shumë veprave të kryera, konkludohet se padrejtësia e njëres vepër e mbulon padrejtësinë e tjetrës, sipas rregullit *lex consumenc derogat, legi consumpetax*³⁵⁵.

Në thelb të këtij koncepti qëndron eksperiencia e përgjithshme, sipas së cilës nëse kryerja e një veprë penale shoqërohet me realizimin e një veprë tjetër, kjo e dyta thithet nga e para sepse legjislatori kur përcakton dënimin për veprën më të rëndë, mban parasysh edhe veprën më pak të rëndë që përgjithësisht lidhet me të parën. Në këto raste zbatohet ajo normë që sanksionon dënimin më të rëndë. Ndërsa, kur nuk mund të përcaktohet se cili është dënimi më i rëndë, duhet t’i referohemi rëndësisë që paraqet marrëdhënia juridike e mbrojtur³⁵⁶.

Sipas doktrinës të së drejtës penale, një nga rastet e konkurimit fiktiv të përthithjes është konkurrimi ndërmjet veprës mjet dhe veprës qëllim. Kur disa veprime në kuptimin natyror, formalisht plotësojnë elementët e dy ose më shumë figurave të veprave penale por, ndërmjet tyre ekziston një lidhshmëri kohore, hapësinore dhe qëllimore, sepse kryerja e njëres vepër shërben si mjet ose paraqitet si formë për realizimin e një veprë tjetër dhe autori i tyre synon apo dëshiron pasojat e vetëm njëres prej veprave. Vepra që shërben si mjet, mund të kryhet përpara veprës tjetër me qëllim që të sigurohen kushtet për realizimin e saj, ose e shoqëron (inkluzicioni)³⁵⁷ apo e pason atë (konsumcioni i veprës plotësuese të padenuar)³⁵⁸, por gjithmonë në funksion të arritjes së rezultatit kriminal të synuar nëpërmjet veprës kryesore.

Ekzistojnë këto kufizime në zbatimin e rregullës së thithjes:

³⁵⁵ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.411.

³⁵⁶Shih Nicola Corea “Le Sezioni Unite dicono no alla consumazione”, artikull në adresën e internetit <http://www.altalex.com/index.php?idnot=34106>, akses në datë 16 Prill 2013. Shih gjithashtu, Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 411.

³⁵⁷ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.412.

³⁵⁸ Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme”, botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, fq.413.

- Një veprë që dënohet më rëndë, nuk mund të quhet si mjet për kryerjen e një veprë tjetër që dënohet më pak. Kështu, në udhëzimin nr.1, datë 26 Nëntor 1954 të Plenumit të Gjykatës së Lartë “Mbi bashkimin e krimeve dhe dënimeve” thuhet se: *“plagosja e rëndë nuk mund të konsiderohet si mjet për kryerjen e krimit të shtrëngimit për martesë, pasi plagosja e rëndë dënohet më shumë se vetë krimi i shtrëngimit për martesë”*³⁵⁹. Të njëjtin qëndrim mban edhe teoria e të drejtës penale dhe praktika gjyqësore e vendeve të tjera³⁶⁰.
- Të gjitha veprat duhet të çënojnë të njëjtin subjekt pasiv.
- Nuk ka konkurrim vetëm atëherë kur, teorikisht, vepra-qëllim nuk mund të arrihet në asnjë mënyrë tjetër pa veprën-mjet³⁶¹.

Duke marrë në konsideratë konceptin e konkurimit fiktiv në formën e përthithjes, në të cilin njëra veprë shërben si mjet, ndërsa tjetra si qëllim, theksojmë se në rastin kur kryerja e marrëdhënieve seksuale me të miturin shërben si mjet për realizimin e veprës qëllim prodhimit të pornografisë së fëmijëve, kemi konkurrim ndërmjet këtyre veprave, sepse nuk plotësohen tre kushtet e sipërcituara. Kështu, figura e veprës penale “Pornografia” dënohet me lehtë se marrëdhënia seksuale ose, homoseksuale me të mitur³⁶².

Lidhur me faktin e dytë, shpërndarjen e videos në mjediset e shkollës të motrës së shtetas D.K theksojmë se, është e nevojshme të përcaktohet fakti nëse protagonistët e videos, ose nxënësit e shkollës janë të mitur nën 18 vjeç. Për këtë duhet të evidentohen tre raste:

- Rasti kur njëri nga protagonistët e videos është i mitur atëherë një video e tillë përbën pornografi e fëmijëve dhe shpërndarja e saj plotëson elementet e shkaqeve ligjore të figurës së veprës penale “Pornografia” e parashikuar nga neni 117/2 i Kodit Penal.
- Rasti kur asnjëri nga protagonistët nuk janë të mitur, por mjedisi ku ajo shpërndahet ka fëmijë. Në këtë rast kualifikimi ligjor duhet të bëhet sipas paragrafit të parë të nenit 117 të Kodit Penal, sepse regjistrimi i një video të tillë konsiderohet pornografi dhe shpërndarja në mjediset ku ka fëmijë plotëson elementët e kësaj figurë të veprës penale.
- Rasti kur asnjëri nga protagonistet e videos nuk janë të mitur dhe shpërndarja e saj pa pëlqimin e shtetas D.K, është e qartë që plotëson shkaqet ligjore të figurës së veprës penale të “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”. Edhe në dy rastet e mësipërme kjo figurë e veprës penale konsumohet, por sipas rregullave dhe parimeve të konkurimit fiktiv të

³⁵⁹Shih “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i Gjykatës së Lartë të RPSSH dhe Universiteti i Tiranës, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, f. 321.

³⁶⁰Shih Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 413.

³⁶¹Vep e cit. Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i përditësuar, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007, f. 330. Shih gjithashtu Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007, f. 413.

³⁶²Në nenin 100 të Kodit Penal parashikohet se: *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*

Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet”.

specialitetit, sepse figura e veprës penale të “Pornografia” është më speciale se figura e veprës penale të “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”.

3.3.3.3. Penalizimi i atyre që iu bëjnë të ditur të tjerëve se ku mund të gjejnë pornografinë e fëmijëve.

Ofrimi i informacionit se ku mund të sigurohen materiale pornografike me fëmijë, për shembull duke siguruar, ose sugjeruar një adresë interneti duhet të penalizohet. Një person, i cili ndihmon në kryerjen e një krimi nëpërmjet të ofruarit të këshillave ose duke marrë veprime që lehtësojnë me vetëdije posedimin ose shkarkimin me përmbajtje të paligjshme duhet të penalizohet. Kjo gjë nuk duhet të konsiderohet si një sugjerim, por duhet të shihet si një angazhim i marrë përsipër me ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual³⁶³. Në nenin 24 të saj theksohet se: “1. *Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim, ndihma ose shtytja për të kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.*

2. *Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim, tentativat për të kryer një nga veprat penale, të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.*

3. *Secila palë mund të rezervojë të drejtën të mos e aplikojë tërësisht ose pjesërisht paragrafin 2 për shkeljet në përputhje me nenin 20, paragrafi 1.b, d, e, dhe f, neni 21, paragrafi 1.c, neni 22 dhe neni 23.....”.*

Në Kodin tonë Penal nuk janë reflektuar parashikimet e mësipërme të Konventës Lanzarote³⁶⁴. Megjithatë, kjo nuk pengon aplikimin e instituteve të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht instituti i bashkëpunimit, tentativës³⁶⁵. Në mënyrë specifike, në kuadër të atyre që thamë më lart, Kodi Penal duhet të marrë masat e duhura të kërkuara nga konventa, sepse kjo të ndikonte në përmirësimin e politikës penale.

3.3.3.4. Kriminalizimi i veprimeve të prindërve ose kujdestarëve të cilët pajtohen për pjesëmarrjen e fëmijës së tyre në pornografinë e fëmijëve.

Ngjashëm me ndihmën dhe inkurajimin në kryerjen e një krimi, një prind ose kujdestar ligjor, i cili përkrah pjesëmarrjen e fëmijës së tij në pornografi, është duke mbështetur dhe duke marrë “masa favorizuese” për kryerjen e krimeve të shumta si: përdhunimi, shfrytëzimi seksual, sulmit seksual, abuzimit seksual, si dhe prodhimin e pornografisë me fëmijë, janë duke u kryer këtë krim ndaj fëmijës së tij/saj³⁶⁶.

Nuk mund të ketë dhe nuk mund të konceptohet dhënie pëlqimi, autorizimi, nga prindi ose kujdestari i fëmijës që ai të lejohet të marrë pjesë në pornografinë me fëmijë. Ashtu si një prind apo kujdestar nuk mund të japë pëlqimin dhe nuk ka asnjë

³⁶³ Shih ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

³⁶⁴ Shih nenin 117 i Kodit Penal.

³⁶⁵ Shih nenin 22 dhe 25 të Kodit Penal.

³⁶⁶ Shih Child Pornography “ Model legislation & Global Review” 2012, Seventh Edition.International Centre for Missing & Exploited Children, fq 3

vlerë ligjore autorizimi i tij për fëmijën që ai të drejtojë automjetin, ashtu nuk mundet që të ligjërohet edhe pëlqimi i prindi ose kujdestarit në emër të një fëmije që të lejojë pjesëmarrjen e tij në pornografi³⁶⁷.

Duke hedhur në industrinë e pornografisë një fëmijë, qoftë kjo për përfitim monetar ose jo, është një tradhti ndaj të miturit dhe shkelje të besimit, abuzim i rëndë me përgjegjësinë prindërore dhe përgjegjësinë që rrjedh nga kujdestaria. Shëndeti i fëmijës dhe mirëqenia e përgjithshme janë të rrezikuara dhe ekspozimi ndaj rasteve të tilla të abuzimit dhe keqtrajtimit nuk mund të mbetet pa u ndëshkuar.

3.3.3.5. Veprimet e joshjes, tërheqjes (Grooming) së të miturit për të realizuar raport seksual duhet të penalizohen.

Joshja, tërheqja paraqet veprimet fillestare të ndërmarra nga një abuzues seksual ndaj fëmijëve për t'u "socializuar" ose "për të përgatitur" fëmijën për një marrëdhënie seksuale. Përgjithësisht janë dy forma të tërheqjes së fëmijëve: joshje online dhe shpërndarje ose shfaqje të pornografisë (të rritur ose fëmijë) për një fëmijë.

Joshje online e një fëmije për akte seksuale ndodh kur një abuzues përdor internetin për të joshur, për të ftuar, ose bindur fëmijën të takohen për akte seksuale. Abuzuesit seksualë të fëmijëve përdorin një shumëllojshmëri të mjeteve të tilla si e-mail, faqet e rrjeteve sociale, mesazheve të çastit, dhe chat room për të ftuar besimin e fëmijës dhe pastaj caktojnë një takim ballë për ballë.

Pasi lidhja është zhvilluar, abuzuesit seksualë të fëmijëve do të tregojnë materiale pornografike (të rritur apo fëmijë) për një fëmijë, në mënyrë që t'i hequr frikën dhe habinë e tij/saj, për të "normalizuar" atë që nuk është normale dhe për të udhëzuar fëmijën për aktivitete seksuale.

Të dhënat mbi shkallën e joshjeve në internet është vështirë për t'u përcaktuar, për shkak të mungesës së një mirëkuptimi universal të termit. Nga studimet rezulton se, fëmijët në internet në një gamë të gjerë të vendeve dhe rajoneve shpesh flasin me të huajt dhe japin të dhënat personale, të cilat mund të jenë hapat e parë në fillimin e një joshjeje.³⁶⁸ Joshjet për të pasur marrëdhënie, mund të ketë një qëllim personal seksual ose komercial me qëllim shfrytëzimin dhe kështu shpesh paraprijnë krijimin ose shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve.

Konventa Lanzarote sugjeron kriminalizimin e veprimit të "Joshjes" duke përdorur termin "Tundimi i fëmijëve për qëllime seksuale". Kështu, në nenin 23 të konventës theksohet se: "*Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e propozimit të qëllimshëm, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, të një të rrituri për të takuar një fëmijë, që nuk e ka mbushur moshën e përcaktuar në zbatim të nenit 18, paragrafi 2, për qëllimin e kryerjes së ndonjëres prej veprave penale të përcaktuara, në përputhje me nenin 18, paragrafi 1.a, ose nenin 20, paragrafi 1.a, kundër tij ose saj, kur ky propozim pasohet nga akte materiale që çojnë në një takim të tillë...*"³⁶⁹.

Një parashikim i tillë, me disa specifika të ndryshme, është pasqyruar në nenin 108/4 të Kodit Penal në të cilin parashikohet se: "*Propozimi i bërë nga një i rritur, me*

³⁶⁷ Po aty

³⁶⁸ Shih Trent Toone, Kids revealing too much online, study says, Deseret News, Feb. 6, 2011, at <http://www.deseretnews.com/article/705366050/Kids-revealing-too-much-online-study-says.html?pg=all>

³⁶⁹ Shih ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrotjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual".

çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.....”³⁷⁰. Një zgjedhje e tillë nuk është në kundërshtim me konventën sepse ajo është më gjithëpërfshirëse dhe nuk e përjashton parashikimin e saj.

3.3.3.6. Përgjegjësia penale e fëmijëve të përfshirë në pornografi.

Nuk duhet të ketë përgjegjësi penale për fëmijët e përfshirë në pornografi dhe një parashikim i tillë duhet të jetë i shprehur në mënyrë të qartë në çdo legjislacionin kombëtar. Pavarësisht nëse një fëmijë është viktimë “vullnetare” ose dëshmitar jo bashkëpunues, nuk duhet harruar fakti se ai/ajo është fëmijë viktimë.

Përgjegjësia penale duhet të përqëndrohet në kundërvajtësi i rritur, i cili është përgjegjës për shfrytëzimin e fëmijës dhe në krimet që ai/ajo ka kryer ndaj këtij fëmije.

Dispozitat ligjore duhet të miratojnë mbrojtjen e fëmijës viktimë si dëshmitar në çdo procedurë gjyqësore që mund të ndodhë, përfshirë lejimin e dëshmisë së dhënë pa praninë e të akuzuarit dhe duke krijuar mundësinë për praninë e detyrueshme të mbrojtësve të viktimave në sallën e gjyqit.

3.3.3.7. Rëndimi i sanksioneve për shkelësit përsëritës, pjesëmarrësit në krimin e organizuar, si dhe faktorë të tjerë që mund të konsiderohen në caktimin e dënimit.

Të gjitha format e inkriminuara sipas paragrafeve përkatës të nenit 117 që parashikon figurën e veprës penale të “Pornografi e fëmijëve” duhet të përcaktojnë dënime të rrepta, të ashpra, zbatimi i të cilave do të garantojë një pengesë vërtetë të efektshme në kryerjen e këtyre figurave të veprës penale.³⁷¹

Dispozitat e dënimit duhet të marrin parasysh faktorët rëndues.³⁷² Rrethanat rënduese mund të përfshijnë numrin e imazheve të prodhuara, kohëzgjatjen e prodhimit, shpërndarjes, zotërimit, apo brutalitetin e imazheve, ose të dhënave ekzistuese për autorin e veprës penale, dhunën seksuale ndaj fëmijëve (duke përfshirë përdhunim, tortura, dhe robëria) duke u paraqitur dhe inkurajuar në imazhet që janë prodhuar, shpërndarë, zotëruar dhe çdo kërcënim të mundshëm apo rreziku që autori mund të paraqesë për komunitetin.

Konventa Lanzarote³⁷³ iu sugjeron shteteve anëtare që të përpiqen për të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të siguruar që rrethanat e mëposhtme, për aq kohë sa ato nuk formojnë pjesë të elementeve përbërëse të një veprë penale, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren në konsideratë si rrethana rënduese për përcaktimin e sanksioneve në lidhje me shkeljet të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë:

³⁷⁰ Shih nenin 108 të Kodit Penal

³⁷¹ Shih Eva J. Klain, Prostitution of Children and Child-Sex Tourism: An Analysis of Domestic and International Responses 47 (Nat'l Ctr. for Missing & Exploited Children ed., 1999).

³⁷² Prostitution of Children and Child-Sex Tourism.

³⁷³ Shih nenin 28 të Konventës Lanzarotë ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

- a) vepra penale ka dëmtuar seriozisht shëndetin fizik ose mendor të viktimës;
- b) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar me akte torture ose të dhunës serioze;
- c) vepra penale është kryer kundër një viktime veçanërisht e cënueshme;
- d) vepra penale është kryer nga një pjesëtar i familjes, një person që bashkëjeton me fëmijën ose një person që ka abuzuar me autoritetin e tij ose të saj;
- e) vepra penale është kryer nga njerëz të ndryshëm që veprojnë së bashku;
- f) vepra penale është kryer brenda kuadrit të një organizate kriminale;
- g) personi, i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, ka qenë i dënuar më parë për vepra penale të së njëjtës natyrë.

Mediat nga e gjithë bota kanë raportuar se organizatat kriminale³⁷⁴ dhe terroriste³⁷⁵ janë gjithnjë duke u angazhuar në pornografinë e fëmijëve për të gjeneruar të ardhura për të mbështetur aktivitetet e tyre³⁷⁶. Disa arsye që shpjegojnë këtë tendencë janë: -fëmijët janë të shumtë dhe lehtësisht të manipulueshëm; -pornografia e fëmijëve është më e lehtë dhe e lirë për t'u prodhuar; -ka një treg të madh të konsumit për të; -ajo është jashtëzakonisht fitimprurëse; dhe ka më pak rrezik, shumë më pak se trafikimi i armëve dhe i drogës.

Detyrimi i profesionistëve të qëndrave të kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale, mësuesëve, oficerë të zbatimit të ligjit, personave që merren me fotografim, profesionistëve të IT-së, ISP-së, për të raportuar dyshimet për pornografinë e fëmijëve në subjektet e zbatimit të ligjit apo tek ndonjë agjenci tjetër³⁷⁷.

Ka tre grupe të individëve dhe organizatave, të cilëve u kërkohet për të raportuar dyshimet për aktivitetet pornografike dhe abuzimet seksuale me fëmijë tek subjektet e zbatimit të ligjit apo ndonjë organ tjetër kompetent:

- a) individë që gjatë punës së tyre të përditshme për shkak të kapaciteteve profesionale, janë në kontakt me fëmijët dhe kanë si detyrë kujdesin ndaj fëmijëve të abuzuar;
- b) individë gjatë punës së tyre të përditshme profesionale, nuk vijnë në kontakt me fëmijët, por potencialisht mund të jenë të ekspozuar ndaj pornografisë së fëmijëve, si rezultat i përgjegjësive të tyre të punës; dhe
- c) organizatat apo korporatat, shërbimet e të cilëve përdoren për të riprodhuar aktivitete të pornografisë me fëmijë dhe si rezultat, duhet të ushtrojnë një sasi të caktuar të industrisë përgjegjësisë/juridike shtetësinë.

Grupi i parë është pothuajse i vetë-shpjegueshëm. Anëtarët e këtij grupimi duke përfshirë, profesionistët e kujdesit shëndetësor, profesionistët e shërbimeve sociale, mësuesit, dhe zyrtarë të zbatimit të ligjit, por pa u kufizuar vetëm në subjektet e përmendura, bazuar në ndërveprimet e përditshme me fëmijë, mund të krijojnë dyshime të bazuara në lidhje me potencialin e viktimizimit të fëmijëve.

Grupi i dytë është i përbërë kryesisht nga profesionistët të cilët merren me fotografitë ose profesionistët e IT-së, të cilët mund të zbulojnë aksidentalisht imazhe

³⁷⁴ Shih European Commission, Child Sexual Abuse, Jun. 12, 2012, at http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/child-sexual-abuse/index_en.htm.

³⁷⁵ Shih Richard Kerbaj and Dominic Kennedy, Link Between Child Porn and Muslim Terrorists Discovered in Police Raids, TIMES ONLINE, Oct. 7, 2008 (on file ëith the International Centre for Missing & Exploited Children).

³⁷⁶ Shih Sergey Stefanov, Russia Fights Child Porn and Terrorism on the Internet, PRAVDA, Dec. 4, 2002, at <http://english.pravda.ru/hotspots/terror/04-12-2002/1620-porn-0/>

³⁷⁷ Shih nenin 12 të Konvetës Lanzarote.

të pornografisë së fëmijëve gjatë përpunimit të filmit, riparimit të një kompjuteri, ose gjatë ofrimit të shërbimit të një kompjuteri të kompanisë në zyrën e një punonjësi. Ky grup nuk ka detyrim për të kërkuar për materialin e paligjshme, por vetëm për të raportuar atë nëse bie rastësisht në kontakt gjatë ushtrimit të shërbimit, pranë autoriteteve kompetente.

Së fundi, grupi i fundit përbëhet kryesisht nga ISP, kompanitë e kartës së kreditit dhe bankat. Në shumë raste, zbatuesit e ligjit nuk marrin dijeni për shumë vepra në lidhje me pornografinë e fëmijëve nëse ISP-të nuk i raportojnë ato (vullnetarisht ose sipas detyrim ligjor). Duke pasur parasysh trafikun e rëndë të pornografisë së fëmijëve në internet, ISP-të janë në një pozitë pothuajse ideale për të raportuar rastet ku dyshohet për vepra pornografike me fëmijë³⁷⁸.

Në lidhje me anëtarët e industrisë financiare, aftësinë për të përdorur kartat e kreditit dhe pagesa të tjera, metodat për të blerë pornografinë e fëmijëve e kanë bërë më të lehtë se kurrë marrjen e materialeve pornografike me fëmijë, për më tepër, shpërndarja në internet ka lehtësuar qasje të menjëhershme nga mijëra e ndoshta miliona individë në të gjithë botën. Kompanitë financiare duhet të jenë vigjilente dhe duhet në mënyrë proaktive të kërkojnë dhe të raportojnë rastet e transaksioneve për pornografi fëmijësh tek zbatuesit e ligjit ose në një organ tjetër kompetent.

³⁷⁸ Shih Child Pornography “Model legislation & Global Review” 2012, Seventh Edition. International Centre for Missing & Exploited Children, fq.17.

KAPITULLI IV

ASPEKTE PROCEDURALE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TË MITURIT- VIKTIMË TË TRAFIKIMIT, OSE SHFRYTËZIMIT SEKSUAL, OSE ABUZIMIT SEKSUAL

Pozita e të dëmtuarit dhe të drejtat e tij gjatë procesit penal, duket se nuk ka patur vëmendje specifike nga legjislatori, sepse ky i fundit përqëndrohet në zbulimin, gjetjen, ndëshkimin e autorit të veprës penale. Një aspekt i tillë ka bërë që në doktrinë të theksohet se tipari diskrecionar karakterizon drejtësinë tonë penale, sepse i gjithë sistemi procedural penal, duke përfshirë edhe atë penal material, ka fokus atë të sipërcituar, duke mos i kushtuar rëndësi, në veçanti pasojave të veprës penale dhe pozitës të të dëmtuarit nga ajo³⁷⁹. Një qasje e tillë ka qënë prezente pothuajse në të gjitha shtetet.

Dekadat e fundit, për shkak të nevojës dhe domosdoshmërisë, organizmat ndërkombëtare janë investuar në krijimin e një kuadri ligjor, i cili të përmirësonte pozitën dhe të drejtat e të dëmtuarin nga vepra penale në përgjithësi,³⁸⁰ dhe viktimës së mitur në veçanti³⁸¹. Vendi ynë ka treguar në permanencë vullnetin që të përqafojë nismat ndërkombëtare duke ratifikuar me shpejtësi konventat ndërkombëtare me objekt pozitën e viktimës në procesin penal.

Gjithashtu, janë marrë masa konkrete që këto zhvillime ndërkombëtare të mos ngelin thjesht në kuadër të miratimit formal të tyre, por të materializohen me masa dhe parashikime konkrete në legjislacionin e brendshëm, duke bërë të mundur përafrimin e këtij të fundit me konventat ndërkombëtare. Në këtë frymë janë edhe disa nga shtesat dhe ndryshimet e bëra në ligjin nr.35/2017, datë 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Me anë të këtyre ndryshimeve, është përmirësuar ndjeshëm pozita juridike e viktimës në përgjithësi, të miturit-viktimë³⁸², si dhe të miturit-viktimë e abuzimit seksual dhe viktimës së trafikimit të qënieve njerëzore³⁸³ në procesin penal duke u bërë subjekt i rëndësishëm i saj.

Për herë të parë, edhe pse pas kaq vitesh, Republika e Shqipërisë³⁸⁴ ka miratuar me ligjin nr.37/2017 “Kodin e drejtësisë penale për të mitur”. Ky kod është miratuar me datë 30.03.2017 dhe hyn në fuqi me datë 01.01.2018. Objekt i këtij Kodi

³⁷⁹ Shih Sandër Simoni “Trajtimi i Viktimave të trafikimit si deshmitarë gjatë procesit gjyqësor, mundësitë ligjorepër kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore”, shkrim në botimin e Shkollës së Magjistraturës “Kuadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore”, shkurt 2013, fq.77.

³⁸⁰ Shih “The responsibilities and the rights of victims of crime”. The Modern Law Review 1992 Jul; 55(4): 482-505

³⁸¹ Shih Sebba L. “The victim’s role in the penal process: A theoretical orientation”. The American Journal of Comparative Law 1982; 30(2): 217-240.

³⁸² Shih nenin 58/b të ligjit nr. 35/2017 dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905 , datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

³⁸³ Shih nenin 58/b të ligjit nr. 35/2017 dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

³⁸⁴ Shqipëria ka qënë e vonuar në miratimin e një kodi të tillë. Sjellim në vëmendje se Kosova një kod të tillë e ka miratuar që nga viti 2010, saktësisht Kodi Nr. 03/ L-193 “I drejtësisë për të mitur”, datë 8 korrik 2010.

janë rregullimet e posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale³⁸⁵. Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij³⁸⁶.

Pavarësisht zhvillimeve të përmendura më sipër, akoma është në fazën embrionale koncepti i “viktimologjisë” dhe nuk janë marrë të gjitha masat që këto konventa kërkojnë në këtë drejtim.

Për shkak të pasojave që sjell trafikimi, si dhe format e abuzimit seksual të të miturit, janë parashikuar nga legjislacioni shqiptar, si vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Hetimi dhe gjykimi i trafikimit të të miturve nga Gjykata e Krimeve të Rënda^{387, 388}, e ka bërë më efikase goditjen e këtij fenomeni me rrezikshmëri të lartë shoqërore, duke u veçuar nga format e tjera të shfrytëzimit, ose abuzimit seksual.

Është e rëndësishme të theksojmë se ka patur një angazhim në rritje të të gjitha strukturave shtetërore, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, përmes masave parandaluese dhe mbrojtëse, si të natyrës ligjore, ashtu edhe të tipit administrativ, social, ekonomik, etj. Republika e Shqipërisë është angazhuar në mënyrë të veçantë, me parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i të miturve, duke shprehur vullnet në luftën kundër këtij fenomeni edhe nëpërmjet ratifikimit të disa konventave³⁸⁹, të cilat zënë një vend të veçantë në hierarkinë e akteve ligjore³⁹⁰.

Së pari, është e nevojshme që të përcaktohet saktë se kush konsiderohet i mitur-viktimë. Përcaktimi i saktë i togfjalëshi “i mitur –viktimë” është i rëndësishëm, sepse lidhet drejtpërdrejtë me objektin e mbrojtur. Prandaj, vetë aktet ndërkombëtare, për të kufizuar interpretimin subjektiv, kanë dhënë përkufizimet e termave që përbëjnë këtë togfjalësh “viktimë” dhe “i mitur”.

³⁸⁵ Shih nenin 1/1 të ligjit nr. 37/2017 “Kodin e drejtësisë penale për të mitur”.

³⁸⁶ Shih nenin 1/2 të ligjit nr. 37/2017 “Kodin e drejtësisë penale për të mitur”.

³⁸⁷ Krijuar me ligjin nr.9110, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda”.

³⁸⁸ Me miratimin e ligjit nr.35/2017 dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, kompetenca lëndore e hetimit dhe gjykimin të trafikut të të miturve i ka kaluar prokurorisë dhe gjykatës së juridiksionit të zakonshëm.

³⁸⁹ Konventa ndërkombëtare për ndalimin e trafikut të grave dhe fëmijëve, përfunduar në Gjenevë, më 1921 dhe protokollin amendues i saj. - Konventa për ndalimin e trafikut të grave në moshë madhore, përfunduar në Gjenevë më 1933 dhe protokollin amendues i saj. - Konventa për ndalimin e trafikut të personave dhe shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve dhe protokollin final i saj në 1950. - Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002. - Protokoll “Kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002. - Protokollin “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002. - Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAË, 1979, ratifikuar me ligjin nr.7767, datë 09.11.1993. - Konventa Europiane “Për Kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, ratifikuar me ligjin nr.9265, datë 29.07.2004.

³⁹⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 122, “ 1.Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”

Kështu, konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”³⁹¹, e cila është instrumenti i parë ndërkombëtar që përkufizon termin “viktimë”, si çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qënieve njerëzore, në ndryshim nga instrumentet e tjerë ndërkombëtarë, të cilat limitohen duke i lënë secilit shtet të çmojë se kush do të quhet viktimë dhe për rrjedhojë të përfitojë mbrojtjen e nevojshme.

Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”³⁹², thekson se “viktimë” do të thotë çdo fëmijë që i nënshtrohet shfrytëzimit seksual, ose abuzimit seksual.

Deklarata e Kombeve të Bashkuara përcakton se: “viktimat nënkuptojnë personat të cilët, individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike apo mentale pësimet emocionale, humbjet ekonomike apo keqësimin substancial të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo moskryerjes së tyre, të cilat paraqesin shkelje të ligjeve penale në fuqi në kuadër të shteteve anëtare, duke përfshirë edhe ligjet të cilat ndikojnë në keqpërdorimin e pushtetit.”³⁹³

Në bazë të deklaratës, personi konsiderohet viktimë pavarësisht nëse është identifikuar subjekti aktiv i veprës apo si është trajtuar ai. Gjithashtu, viktimë konsiderohen anëtarët e familjes, personat që varen nga viktima drejtpërdrejt dhe personat të cilët kanë pësuar lëndime për shkak se kanë ndërhyrë në mënyrë që t’u dalë në ndihmë viktimave dhe të parandalojnë viktimizimin e tyre.³⁹⁴

Direktiva nr.29/2012 e Bashkimit Europian, i ka kushtuar vëmendje përkufizimit të termit “viktimë”. Kështu, sipas saj ky i fundit përkufizohet si person fizik që ka pësuar dëmtim, fizik apo mendor, vuajtje shpirtërore apo dëm pasuror, të shkaktuar drejtpërdrejt nga veprime ose mosveprime që janë në shkelje të ligjit penal të vendeve anëtare³⁹⁵.

Gjithashtu, në rekomandimin nr.8 të vitit 2006 të Këshillit Europian është dhënë një përkufizim për termin viktimë, sipas së cilës duhet të përfshijë, kur është e përshtatshme, familjarët e afërt ose në ngarkim të viktimës direkte, subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar vepra penale³⁹⁶.

Në Direktivën 2004/80/EC, me objekt kompensimin e viktimave, është dhënë kuptimi i viktimës, e cila kufizohet vetëm në viktimat e një krimi me dashje dhe me dhunë.

Përkufizimi i saktë i termit viktimë merr rëndësi, sepse në varësi të tij përcaktohet rrethi i personave që përfitojnë mbrojtje dhe gëzojnë të drejtat procedurale për shkak të dëmtimit që kanë pësuar nga vepra penale.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet përkufizimi apo kuptimi i termit të dëmtuar apo viktimë. Madje, edhe në ligjin nr.35/2017 dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905 , datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar nuk është dhënë një përkufizim i tillë.

³⁹¹ Shih nenin 4/e të Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, ratifikuar me ligjin nr 9642, datë 20.11.2006.

³⁹² Shih nenin 3/c të Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009.

³⁹³ Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimin dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, e vitit 1985.

³⁹⁴ Po aty.

³⁹⁵ Shih nenin 2 të Direktivës nr.29/2012 të Bashkimit Europian.

³⁹⁶ Shih Rekomandimin nr.8/2006 të Këshillit Europian.

Ndërsa në ligjin nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, është dhënë përkufizimi për termin “i mitur viktimë”. Sipas këtij kodi “I mitur viktimë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një veprë penale³⁹⁷.

Në mungesë të një parashikimi të tillë për viktimën në përgjithësi, doktrina e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore³⁹⁸ janë përpjekur që të japin një përkufizim dhe një përcaktim të tillë. Kështu, përmendim vendimin nr.2 datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin theksohet se: *“personi i dëmtuar është titullari i interesit juridik të mbrojtur nga norma penale, në vartësi të llojit të veprës penale, marrëdhënies dhe të mirës juridike që mbrohet nga e drejta penale. Kështu, i dëmtuari është personi fizik i cili është i lënduar në trupin e tij, i dëmtuar në shëndetin e tij, i dëmtuar për shkak të cenimit të së drejtave dhe lirive themelore, prekja dhe kufizimi i të cilave, mbrohet nga norma penale, i cënuar në moralin e tij dhe të familjes, etj. I dëmtuar mund të jetë edhe personi juridik, të cilit vepra penale i ka cënuar interesa pasurore të drejtpërdrejta në raport me veprimtarinë që ai ushtron”*.

Koncepti i viktimës është elaboruar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila arsyeton se fusha e zbatimit të Vendimit Kuadër të Këshillit European, nuk përfshin personat juridikë që kanë pësuar drejtpërdrejtë dëmtim nga shkeljet e ligjit penal në vendet anëtare³⁹⁹.

Megjithatë, duke iu referuar përkufizimit të dhënë nga Direktiva nr.29/2012, konstatojmë se ajo i lejon shtetet anëtare të zgjedhin nëse do të aplikojnë të njëjtat standarde si për personat fizik, ashtu edhe për ata juridik.

Për të përcaktuar rrethin e personave që mund të konsiderohen viktimë ka patur qëndrime të ndryshme në doktrinë. Para së gjithash mund të themi se viktimë konsiderohet çdo anëtar i familjes së viktimës, që ka pësuar një dëmtim, e shkaktuar kjo e fundit drejtpërdrejtë nga vepra penale. Termi “dëmtim” duhet të nënkuptojë marrëdhënien shpirtërore individuale, duke përfshirë atë të varësisë materiale të drejtpërdrejtë ndërmjet viktimës dhe të afërmit të tij.

Përsa më sipër, anëtarë të familjes janë bashkëshorti, personi që jeton me viktimën një marrëdhënie përkushtimi të ngushtë, në një banesë të përbashkët dhe me baza të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të afërmit në vijë të drejtë si prindërit dhe fëmijët, vëllezër dhe motra si dhe personat në ngarkim të viktimës. Kriteri i marrëdhënies së përkushtimit të ngushtë, në një banesë të përbashkët dhe me baza të qëndrueshme dhe të vazhdueshme kërkon një lidhje të ngushtë emocionale dhe ndërvarësi financiare, ashtu sikurse të ish-in të martuar.

Direktiva⁴⁰⁰ iu jep diskrecion shteteve anëtare që të përcaktojnë një rreth më të kufizuar lidhur me anëtarët e familjes, të cilët mund të përfitojnë nga të drejtat, duke përcaktuar edhe radhën e preferimit të tyre me qëllim shmangien e kërkesave kontradiktore drejtuar organeve proceduese, për shkak se këto të drejta janë të njëjta për të gjithë anëtarët e familjes të viktimës. Në këtë optikë, shtetet anëtare të direktivës duhet të parashikojnë një modalitet, siç është caktimi i një përfaqësuesi të vetëm të anëtarëve të familjes. Gjithsesi, përcaktimi i përparësisë është i nevojshëm

³⁹⁷ Shih nenin 3/5 të ligjit nr. 37/2017 “Kodin e drejtësisë penale për të mitur”.

³⁹⁸ Shih vendimin nr.2 datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

³⁹⁹ Shih C-467/05, Dell’Orto, C-205/09, Eredics.

⁴⁰⁰ Shih nenin 2/2 të Direktivës.

për të siguruar që bashkëshorti apo partneri dhe fëmijët e viktimës të jenë të parët në akses me organet proceduese⁴⁰¹.

Në ligjin nr.35/2017 dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905 , datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, lidhur me rrethin e personave që mund të konsiderohen viktimë është përdorur termi “trashëgimtarët e viktimës”⁴⁰². Pra, nuk është përcaktuar në mënyrë shteruese rrethi i personave viktimë.

Lidhur me përcaktimin e termit “i mitur” aktet juridike ndërkombëtare kanë konsideruar të mitur çdo person nën moshën 18 vjeç⁴⁰³. Megjithatë, Konventa “Mbi të drejtat e fëmijës” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB më datë 20.11.1989, ka karakter fleksibël në lidhje me kufirin e moshës, duke e lënë në vullnetin e shteteve palë vendosjen e këtij limiti. Kështu, kjo konventë përcakton se: “Me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet”⁴⁰⁴.

Ndërsa në ligjin nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, është përcaktuar se “I mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç⁴⁰⁵.

Mund të ndodhin që moshë e viktimës të jetë e paqartë dhe të këtë indicie të mendohet se viktima është fëmijë. Në këto raste duhet të procedohet sikur kjo viktima është fëmijë⁴⁰⁶. Për sa kohë nuk verifikohet moshë e viktimës, viktima duhet të trajtohet si fëmijë dhe duhet të gëzojë të gjitha masat e veçanta të mbrojtjes.

Në qoftë se është i nevojshëm vlerësimi i moshës së fëmijës, duhen mbajtur parasysh elementet e mëposhtme⁴⁰⁷:

- ✓ Ky vlerësim duhet të mbajë parasysh jo vetëm pamjen fizike të fëmijës por edhe pjekurinë e tij/të saj psikologjike.
- ✓ Kur përdoren procedura shkencore me qëllim përcaktimin e moshës së fëmijës, duhen lejuar hapësira të vogla gabimi. Këto metoda duhet të jenë të sigurta dhe të respektojnë dinjitetin njerëzor.
- ✓ Fëmija duhet të gëzojë përparësinë në dyshim në qoftë se është e pasigurtë moshë e saktë.
- ✓ Sa herë që është e mundur, pasojat ligjore ose pesha e kriterit të moshës duhet të reduktohet ose të minimizohet. Nuk duhet që prej

⁴⁰¹Nocioni “roli i viktimës në sistemin gjyqësor penal” ndryshon në shtete të ndryshme dhe nënkupton në vecanti të drejtat procedurale të viktimës të përcaktuara në Direktivën dhe nuk duhet të ngatërrohet me kuptimin e termit “viktima” sipas parashikimit në nenin 2.Viktima sipas nenit 2 të Direktivës është e tillë pavarësisht rolit në sistemin gjyqësor penal kombëtar.Koncepti i Direktivës “roli i viktimës në sistemin gjyqësor penal” nënkupton të drejtat procedurale të viktimës në kontekstin e procesit penal që pavarësisht diskrecionit të shteteve duhet të jetë i tillë që të garantojë mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimës.

⁴⁰² Shih nenin 40 të ligjit nr.35/2017 dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905 , datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁴⁰³ Shih nenin 3/b të Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, ratifikuar me ligjin nr 10071 datë 09.02.2009. Nenin 4/d të Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, ratifikuar me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006.

⁴⁰⁴ Shih nenin 1 të konventës “Mbi të drejtat e fëmijës” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me datë 20.11.1989.

⁴⁰⁵ Shih nenin 3/3 të ligjit nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”.

⁴⁰⁶ Shih “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq. 46.

⁴⁰⁷Komisioneri i lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR), “Guidelines on Policies in dealing with Unaccompanied Children Seeking Asylum” (Udhëzues për politikën që trajtojnë fëmijët e pashoqëruar që kërkojnë azil) shkurt 1997.

kritereve të rrjedhin avantazhe ose disavantazhe të shumta ligjore, pasi kjo mund të përbëjë një shtysë për shtrembërime. Parimi udhëheqës duhet të jetë nëse individi në fjalë paraqet “mospjekuri” dhe lëndueshmëri, çka mund të kërkojë një trajtim më të ndjeshëm.

Për të arritur një konkluzion lidhur me moshën, treguesit fillestar duhet të përfshijnë⁴⁰⁸:

- Pamjen fizike të të riut në fjalë
- Pjekurinë e tij/të saj psikologjike,
- Deklaratat e të riut/së resë; dhe
- Dokumentin që ajo apo ai mban me vete, ose mungesën e një pasaporte apo atë të dokumentave të tjera.

Nëse përsëri është e paqartë moshja e personit të ri, duhen bërë edhe këto dy shqyrtime⁴⁰⁹:

- Një ekzaminim mjekësor - vetëm me pëlqimin e subjektit në fjalë - dhe duhet marrë opinioni i një punonjësi profesionist të shëndetësisë.
- Shqyrtimi me anë të një autoriteti vendas, ose të huaj në varësi nga vjen i mituri.

Vlerësimi i moshës përfshin faktorë fizikë, zhvillimorë, psikologjikë dhe kulturorë. Nëse mendohet se është i nevojshëm një vlerësim i moshës, ai duhet të kryhet nga profesionistë të pavarur me specializim të përshtatshëm dhe që janë familjarë, në sfondin etnik - kulturor të fëmijës⁴¹⁰. Shqyrtimet asnjëherë nuk duhen bërë me pahir ose të jenë të papërshtatshme në pikëpamjet kulturore.⁴¹¹

4.1. Aktet juridike ndërkombëtare me fokus garantimin e të drejtave të të miturit viktimë e krimeve me natyrë seksuale.

Pavarësisht domosdoshmërisë, përpjekjet e para me objekt specifik garantimin e të drejtave të viktimave, i ndeshim rreth viteve 80-të të shekullit të XX. Këto përpjekje u kurorëzuan me miratimin e aktit të parë ndërkombëtar, me karakter universal, Deklaratës së Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit e adoptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara⁴¹².

Në këtë akt jepet kuptimi i termit viktimë. Gjithashtu, afirmohen disa nga të drejtat me të rëndësishme të victimës, ndër të cilat përmendim ndihmën juridike dhe të drejten për njoftim mbi të gjitha aspektet procedurale. Rikthimi i pronës,

⁴⁰⁸ Shih “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimat të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq.49.

⁴⁰⁹ Shih “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimat të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq.49.

⁴¹⁰ Separated Children in Europe Programme. Statement of Good Practices. (Fëmijët e ndarë në programin evropian. Dëshmim i praktikave të mira). Save the children dhe UNHCR, Botim i tretë, 2004.

⁴¹¹ Shih SOSFS Recommendations: Socialstyrelsens foertfattningssamling (Rekomandimet e SOSFS: Përmbledhje e rregullave për bordet sociale), 1986: 26 dhe 1993: 11, Suedia, cituar në Separated Children in Europe Programme (Fëmijët e ndarë në Programin evropian). Workshop lidhur me vlerësimin e moshës dhe identifi kimin. Bukuresht, 20-22 mars 2003. Raport prej Kate Haltvorsen

⁴¹² The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985).

kompensimi i dëmit, rivendosjen e të drejtave, kompensim i siguruar nga shteti kur mjetet financiare të kryerësit janë të pamjaftueshme⁴¹³ etj.

Konventa e Palermos dhe Protokollit i saj shtesë “Mbi parandalimin e trafikut të grave e të fëmijëve” janë aktet juridike ndërkombëtare, të cilat parashikojnë një kuadër me të plotë juridik për të drejtat e viktimës.⁴¹⁴ Në nenin 25 të Konventës parashikohet se: “1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura, brenda mundësive të tij, për të siguruar ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të veprave penale të përfshira në këtë Konventë, veçanërisht në rastet e kërcënimit për raprezalje dhe terrorizmit.

2. Çdo Shtet Palë duhet të vendosë procedurat e duhura, të cilat do të sigurojnë mundësi kompensimi dhe zhdëmtimi për viktimat e veprave penale të përfshira në këtë Konventë.

3. Çdo Shtet Palë, në varësi të legjislacionit të tij të brendshëm, duhet të bëjë të mundur që pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave të paraqiten dhe merren në konsideratë në fazat e duhura të procedurave penale kundër të pandehurve, në mënyrë të tillë që të mos cenohet të drejtat e mbrojtjes”.

Ndërsa në nenin 6/2 të Protokollit II parashikohet se: “..2. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ ose administrativ të përmbajë masa të tilla që u sigurojnë viktimave të trafikut në rastet e duhura:

(a) informacion në lidhje me procedurat gjyqësore dhe administrative;

(b) asistencë, në mënyrë që të paraqesin shqetësimet dhe problemet që kanë dhe t’u merren parasysh në shkallët përkatëse të procedurave penale kundër autorëve të veprave penale, pa cënuar të drejtën e mbrojtjes”.

Nenet e sipërpërmendura përcaktojnë detyrimin e shteteve palë, që në varësi të ligjit të tyre kombëtar, të mundësojnë që pretendimet dhe kërkesat e viktimave të bëhen prezent dhe të merren në shqyrtimin gjatë etapave të përshtatshme të procedurave të hetimit. Shtetet palë, duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ të përmbajë masa të tilla që u sigurojnë viktimave të trafikut në rastet e duhura, informacion në lidhje me procedurat gjyqësore, asistencës e t’i kushtojnë vëmendje inkurajimit të viktimave për të bashkëpunuar me autoritet.

Vlen të theksohet se Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”⁴¹⁵ është akti më i plotë juridik ndërkombëtar me fokus të drejtat e viktimës, duke përfshirë të gjitha rastet e trafikimit pavarësisht subjektit pasiv të veprës penale. Qëllimi i kësaj konvente është mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit, ndërtimi i një kuadri gjithpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, duke garantuar barazinë gjinore, si dhe duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive.⁴¹⁶

Risia e kësaj Konvente qëndron tek dhënia një përkufizimi për termin “viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore” në ndryshim nga instrumentet e tjerë ndërkombëtarë, të cilët limitohen duke i lënë secilit shtet të çmojë se kush do të quhet

⁴¹³ Shih Sander Simoni “Trajtimi i Viktimave të trafikimit si dëshmitarë gjatë procesit gjyqësor, mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore”, shkrim në botimin e Shkollës së Magjistraturës “ Kuadri ligjor mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore”, shkurt 2013, fq 77 .

⁴¹⁴ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollit II i saj “Mbi parandalimin , pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”.

⁴¹⁵ Kjo konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006 “Përratifikimin e “Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

⁴¹⁶ Shih nenin 1/b të Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”

viktimë dhe për rrjedhojë të përfitojë mbrojtjen e nevojshme. Kështu, sipas kësaj konvente me “viktimë” do të nënkuptohet çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore⁴¹⁷.

Në kuadër të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin (OSBE) është hartuar një Plan - Veprim për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore⁴¹⁸ që ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave, mospenalizmin e personave të trafikuar për vepra penale të lidhura me trafikimin, ngritjen e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit dhe hartimin e Udhëzuesve për identifikimin e saktë, informimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve të trafikuar⁴¹⁹.

Një nga aktet ndërkombëtarë më të rëndësishme në kuadër të mbrojtjes të të drejtës së viktimës për kompensim është Konventa e Këshillit të Evropës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, e cila është ratifikuar, me ligjin nr.9265, datë 29.07.2004 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”⁴²⁰. Hartuesit e kësaj konvente u bindën për nevojën e trajtimit të gjendjes së viktimave të krimeve të qëllimshme të dhunës që kanë pësuar dëmtim trupor ose dëmtim të shëndetit dhe të personave të varur të tyre, të cilët kanë vdekur si rezultat i këtyre krimeve. Gjithashtu, ata duke pasur parasysh se ishte e nevojshme të prezantohen ose të zhvillohen skema për kompensimin e këtyre viktimave nga shteti, në territorin e të cilit janë kryer këto viktima, sidomos kur personi që ka kryer krimin nuk është identifikuar ose nuk ka mjete, duke pasur parasysh se është e nevojshme të caktohen kushte minimale në këtë fushe⁴²¹. Në këtë fokus, kjo konventë i kushtoi një vëmendje të veçantë të drejtës së kompensimit të viktimës, në veçanti nxitjen e shteteve për përcaktimin e skemave që garantojnë kompensimin e viktimave. Kjo konventë synon ndihmën e viktimave në rastet kur ato nuk mund të kompensohen në një mënyrë tjetër⁴²². Kjo konventë përcakton edhe rrethin e personave që mund të kompensohen. Në nenin 2 të saj parashikohet se: *“Nëse kompensimi nuk mund të jepet nga burime të tjera, shteti ndihmon në kompensimin: a) e atyre që kanë pësuar një dëmtim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit që ka rrjedhur direkt nga një krim i dhunshëm; b) e personave të varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë”*. Konventa parashikon se, kompensimi mbulon shpenzimet mjekësore, të ardhurat e humbura, shpenzimet për mbajtjen e personave të varur etj.

Akti juridik ndërkombëtar më i rëndësishëm për trajtimin e të miturve viktimë e trafikimit është Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, e njohur si Konventa Lanzarote⁴²³. Me ratifikimin e kësaj konvente shteti Shqiptar angazhohet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar hetimet dhe procedimet penale kryhen me interesat

⁴¹⁷Shih nenin 4/e të Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”

⁴¹⁸Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr.557, PC.DEC/557, 24 Korrik 2003, shtojca e Planit - Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 685, PC.DEC/685, 7 Korrik 2005.

⁴¹⁹ Shih “Udhërrëfyes Referimi për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Europë.

⁴²⁰E hartuar në Strasburg me 24.11.1983 dhe e ratifikuar nga shteti ynë me ligjin nr.9265 datë 29.07.2004.

⁴²¹ Shih pjesën e parë të Konventës.

⁴²²Shih nenet 2, 3 dhe 4 të Konventës e Këshillit të Evropës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”.

⁴²³ Shih ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

më të mira dhe respektimin e të drejtave të fëmijës⁴²⁴; do të adoptojë një trajtim mbrojtës ndaj viktimave, duke siguruar që hetimet dhe procedimet penale të mos përkeqësojnë traumën e përjetuar nga fëmija dhe që përgjigja e drejtësisë penale të pasohet nga asistenca, kur është e mundur⁴²⁵; do të sigurojë që hetimet dhe procedimet penale të trajtohen si përparësi dhe të kryhen pa asnjë vonesë të pajustificuar⁴²⁶; do të sigurojë që masat e aplikueshme sipas këtij kapitulli nuk paragjykojnë të drejtat e mbrojtjes dhe kërkesat për një gjyq të paanshëm dhe objektiv, në përputhje me nenin 6 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; do të përpiket të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që të gjitha intervistat me viktimën ose, kur është e përshtatshme, ato me një fëmijë dëshmitar, mund të regjistruhen në video dhe këto intervista të regjistruara mund të pranohen si prova gjatë procedimeve në gjykatë, në përputhje me rregullat që parashikon ligji i brendshëm⁴²⁷.

Si akte ndërkombëtare me karakter rekomandues mund të përmendim vendimin e datës 15.03.2001 të Këshillit të BE-së për pozitën e viktimave në procedimet penale. Ky vendim parashikon se shtetet duhet të shqyrtojnë në rast se ligjet dhe procedurat vendase janë të përshtatshme dhe përgjegjëse për viktimat e trafikut, e të inkurajojnë kompensimin e tyre. Gjithashtu, Rekomandimi nr.8511 i Komitetit të Ministrave të KE-së “Për pozicionin e të dëmtuarit në kuadrin e procedurës penale” parashikon se: “Një gjykatë penale duhet të urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit nga vepra penale. Duhet të hiqen kufizimet ekzistuese dhe pengesat teknike që çojnë në mosrealizimin e një të drejte të tillë, kompensimi duhet të jetë përparësi në rastin e një dënimi alternativ e se gjykata duhet t’i kushtojë vëmendje nevojës për kompensim të dëmit.” Ndërsa Rekomandimi nr.8721 i Komitetit të Ministrave të KE-së “Mbi ndihmën e viktimave dhe parandalimin e diskriminimit” shton se: “Shtetet duhet të vlerësojnë masën e mbulimit të siguracioneve nga skemat private ose publike të sigurimit për sigurimin efikas të viktimave sipas nevojave të tyre”.

Vlen të përmendet Rekomandimi nr.9713 i KE-së, Rekomandimi (1985)11 për pozitën e viktimës në fushën penale dhe procedurën penale, Rekomandimi (2006)8 për asistimin e viktimave të krimit, si Udhërrëfyes i vitit 2011 i Komitetit të Ministrave dhe Këshillit European për drejtësinë miqësore për të mitur. Rekomandime të tjera në fushën e mbrojtjes së viktimave janë rekomandimet 87/4, 87/18, 87/21 dhe 06/8.

Në kuadër të Bashkimit European për mbrojtjen e të drejtave të viktimës në procesin penal, rëndësi themelore kishte Vendimi Kuadër i Këshillit 2001/220/JHA. Ky vendim paraqet vlera historike sepse ai është zëvendësuar nga Direktiva nr.29/2012 e Parlamentit European dhe Këshillit e datës 25.10.2012⁴²⁸, që vendosi standardet minimale të të drejtave, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimit.

⁴²⁴ Shih nenin 30/1 të ligjit nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

⁴²⁵ Shih nenin 30/2 të ligjit nr.10071 datë 09.02.2009.

⁴²⁶ Shih nenin 30/3 të ligjit nr.10071 datë 09.02.2009.

⁴²⁷ Shih nenin 35/2 të ligjit nr.10071 datë 09.02.2009.

⁴²⁸ Shih Direktiva nr.29, të vitit 2012 të Parlamentit European dhe Këshillit e datës 25.10.2012 e Bashkimit European.

4.2. Aspektet procedurale të karakterit jo- penal që e paraprijnë procedurën penale.

4.2.1 Identifikimi i viktimës, si aspekti themelor në zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e abuzuesit, ose shfrytëzuesit seksual të të miturit.

Identifikimi i të miturit, viktimë e abuzimit seksual, ose trafikimit, është një nga aspektet procedurale kryesore, i cili jep kontribut të rëndësishëm për zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e abuzuesit, ose shfrytëzuesit, si dhe bën të mundur mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Termi “Identifikimi i të miturit-viktimë” nënkupton një proces nëpërmjet të cilit personat e trajnuar dhe të kualifikuar nga autoritetet kompetente (polici, inspektorët e punës, rojet e kufirit, autoritetet e migracionit, ambasada dhe konsullata, etj.) në bashkëpunim me OJF të specializuara, marrin masa që synojnë identifikimin dhe mbrojtjen e të miturve-viktimë; mbledhin të dhëna për rastet e shfrytëzimit, ose të abuzimit, nga vet viktimat ose nga burime të tjera që posedojnë informacione për veprime të paligjshme kundër viktimës; bëjnë analizën e informacioneve të mbledhura dhe krahasimin e karakteristikave të rasteve specifike me indikatorët ekzistues të shfrytëzimit, ose abuzimit; arrijnë në konkluzionin që një i mitur është viktimë e shfrytëzimit ose abuzimit dhe referimi e tij për mbrojtjen dhe asistencën e nevojshme.

Në mënyrë që të mbrohen dhe të ndihmohen, është e rëndësishme që viktimat të identifikohen menjëherë dhe saktë. Në aktet e së drejtës ndërkombëtare është e theksuar rëndësia dhe nevoja për identifikim efektiv të personave, viktimave, në të cilët përfshihet edhe i mituri-viktimë. Kështu, si të tilla përmendim: Aktin e OKB-së (ECOSOC) Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, në të cilin theksohet se: *“Dështimi në identifikimin korrekt të një personi të trafikuar mund të rezultojë si një mohim i të drejtave të tij. Për këtë, shtetet palë janë të detyruar të sigurojnë se identifikimi mund dhe duhet të zhvillohet”*.⁴²⁹ Plani i Veprimit i Bashkimit Europian në fushën e anti-trafikimit, adaptuar nga Këshilli i Europës në Dhjetor 2005, përfshin një paketë masash me qëllim që të lehtësojë zhvillimin e aftësive në identifikimin e personave të trafikuar (për shembull organizimi i workshop-eve dhe forma të tjera të shkëmbimit të praktikave më të mira).⁴³⁰

Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qenieve njerëzore”⁴³¹, thekson se: *“Çdo Palë do t'u sigurojë autoriteteve të veta kompetente persona të trajnuar dhe të kualifikuar në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në identifikimin dhe ndihmën ndaj viktimave, duke përfshirë fëmijët dhe do të sigurojë që autoritetet e ndryshme bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si dhe me organizata të ngjashme mbështetëse, në mënyrë që viktimat të mund të identifikohen me një procedurë që merr parasysh situatën e veçantë të viktimave gra dhe fëmijë dhe në raste të përshtatshme, i pajis me lejet e qëndrimit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 14 të kësaj Konvente”*.

⁴²⁹ Shih OKB ECOSOC, “Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Raporti i Kombeve të Bashkuara nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut në Këshillin Ekonomik dhe Social”, E/2002/68/Add.1, 2002, faqe. 6.

⁴³⁰ Shih “Plani i BE-së për praktikën më të mira, standartet dhe procedurat për luftimin dhe parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore”. Fletore Zyrtare C 311, 09/12/2005.

⁴³¹ Kjo Konventë është ratifikuar me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual” (Lanzarote)⁴³², ka si synim të rrisë standardin e mbrojtjes që u ofrohet fëmijëve, të zhvillojë dhe të plotësojë më tej standardet e përfshira në të. Kjo Konventë nuk cënon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Protokollit të saj Opsional për shitjen, prostituimin dhe pornografinë e fëmijëve.⁴³³ Çdo palë merr masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të ndihmuar viktimat, në kuadrin afatshkurtër dhe afatgjatë, për rimëkëmbjen e tyre fizike dhe psikosociale.

Në marrjen e masave duhet të mbahen në konsideratë pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijëve.⁴³⁴ Në rastet kur prindërit ose personat që kujdesen për fëmijët përfshihen në shfrytëzimin seksual ose abuzimin seksual të fëmijës, procedurat parashikojnë mundësinë e largimit të autorit të supozuar të aktit; mundësinë e largimit të viktimës nga mjedisi i tij/saj familjar. Kushtet dhe kohëzgjatja e largimit përcaktohet në përputhje me interesin më të madh të fëmijës.⁴³⁵

Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë një angazhim serioz në arritjen e një procesi identifikimi sa më efektiv, i cili shprehet në miratimin nga Këshilli i Ministrave i vendimit nr.582, datë 27.07.2011 “Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit”.

Procedurat standarde të veprimit (procedurat) për identifikimin dhe referimin e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit në zbatim të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe planit të saj të veprimit, kanë për qëllim kryesor identifikimin dhe referimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave të trafikimit, të rritur apo të mitur, për të gjitha llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar. Identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit sipas procedurave në këtë dokument, bëhet me qëllimin kryesor mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës, dhe pritet të kontribuojë ndjeshëm në dy shtyllat e tjera të luftës kundër trafikimit të personave, në atë të parandalimit të trafikimit dhe ndëshkimit të trafikantëve⁴³⁶.

Procedurat parashikojnë situata në të cilat vendi ynë, Shqipëria, apo zona të caktuara të vendit, përdoren, apo mund të përdoren si vend rekrutimi, tranzitimi dhe destinacioni për shfrytëzimin e personave të trafikuar shqiptarë dhe të huaj, si edhe situata në të cilat personat e trafikuar me shtetësi shqiptare, apo të hamendësuar shqiptare ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë⁴³⁷.

Rëndësia e zhvillimit të metodave efektive për identifikimin e të miturve-viktima të abuzimit seksual është theksuar në studime të shumta. Sipas vlerësimeve të bëra nga ekspertë ndërkombëtarë, rreth 65% e viktimave të abuzimit seksual të mitur,

⁴³²Ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

⁴³³ Shih nenin 42 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual” (Lanzarote).

⁴³⁴ Shih nenin 14 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual” (Lanzarote).

⁴³⁵ Neni 11/1 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual” (Lanzarote).

⁴³⁶ Shih paragrafin 1 të vendimit nr.582, datë 27.07.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit”.

⁴³⁷ Po aty

në përgjithësi dhe atyre të trafikimit në veçanti nuk janë të identifikuar⁴³⁸. Kjo ndodh për arsye të ndryshme. Si për shembull, personat e mitur, që kanë mbushur moshën për përgjegjesi penale dhe që janë të trafikuar në një shtet të huaj shpesh herë janë të frikësuar ndaj mundësisë së ndjekjes penale të tyre për shkelje të ligjit vendas. Ky është veçanërisht rasti kur një i mitur i huaj shkel ligjet e emigracionit në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin në një territor të tretë⁴³⁹. Veç kësaj, të miturit-viktimitë e abuzimit seksual shpesh nuk u besojnë strukturave të agjensive shtetërore, për sa kohë ato nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe mundësitë e tyre për t'u marrë në mbrojtje dhe për t'u ofruar ndihmë, si viktimat.

Trauma psikologjike nuk i lejon të miturit viktimitë e abuzimit seksual që në mënyrë adekuate të vlerësojnë ngjarjet në mënyrë që të bëjnë hapat e duhura për ndrequr situatën. Në rastet e trafikimit, të miturit, më shpesh në mënyrë rutinë, janë trajtuar si emigrantë të paligjshëm sesa si persona të trafikuar, janë ndaluar në mënyrë gjyqësore ose administrative, janë gjobitur ose janë dëbuar nga vendi. Pas kthimit të tyre në vendin e origjinës, këta persona mund të ndiqen më tej për përdorim të dokumentacionit fals, për largimin nga vendi në mënyrë ilegale etj. Si rrjedhim, vuajtjet dhe trauma e përjetuar gjatë shfrytëzimit komplikohen më tej nga ankthi që shkaktohet gjatë takimeve me organet e zbatimit të ligjit.

Pavarësisht nga vendi ku ndodh shfrytëzimi, ose abuzimi i të miturit- viktimitë, ata kanë gjithmonë frikë nga hakmarja e shfrytëzuesit, ose e abuzuesit, e cila mund të targohet jo vetëm kundër tyre, por edhe kundër familjarëve të tyre. Viktimat që janë subjekt i shfrytëzimit seksual, haptazi janë të frikësuar nga reagimet e mjedisit të tyre social që shpesh kthehen në kundërvuajtje⁴⁴⁰. Shumë viktimat nuk besojnë se rishqyrtimi gjyqësor do të jetë efektiv dhe nuk nuk e shikojnë të arsyeshme që t'u bëjnë thirrje strukturave zyrtare.

Të miturit-viktimitë, të cilët mbeten të pidentifikuar janë të privuar nga mbrojtja dhe ndihma e nevojshme dhe për pasojë ata e kanë shumë të vështirë rikthimin në jetën normale, si psh. të gjejnë një hapësirë në rrethin e tyre të ngushtë, si dhe në shoqëri në përgjithësi. Përvoja e OJF-ve të shumta që ofrojnë shërbime për të miturit e trafikuar, tregon se një numër i konsiderueshëm prej tyre, të cilët kërkojnë rishtazi asistencë, kanë qënë të përfshirë në trafikun e qenieve njerëzore edhe në të kaluarën, duke qënë viktimat në mënyrë të përsëritur. Kjo çon në përfundimin se edhe nëse të miturit e trafikuar kanë arritur të shpëtojnë nga trafikantët, ato shpesh rikthehen dhe bien pre e trafikantëve nga dëshpërimi dhe mungesa e mundësive.

Kështu, në identifikimin e të miturve viktimitë kryesisht është e nevojshme dhënia e mbrojtjes së të drejtave të viktimitë në mënyrë që të sigurohet riintegrimi i suksesshëm. Njëkohësisht, identifikimi i tyre është shumë i rëndësishëm për kohezionin e vetë shoqërisë. Kur ata nuk janë të gatshëm për të dhënë dëshmi, atëherë abuzuesit dhe shfrytëzuesit nuk ndëshkohen për krimin e kryer dhe mbeten të lirë të riefrojnë gjenerimin e më shumë viktimitëve. Si rezultat, rastet e pidentifikuara bëhen faktor kryesor në shtyrjen drejt fenomenit të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të të miturit në shoqëri. Prandaj theksojmë se, identifikimi në kohë është një masë e rëndësishme kundër këtij fenomeni dhe kështu bëhet një masë e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e interesave të shoqërisë në përgjithësi.

⁴³⁸Shih Limanowska, B., "Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Europën Jug-Lindore", UNICEF, OKB OHCHR, OSBE/ ODIHR, 2002, faqe. 142.

⁴³⁹ Shih "Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar" Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, fq.18.

⁴⁴⁰ Po aty.

Identifikimi i një të mituri viktimë është një proces i gjatë. Ai mund të kërkojë shkëmbimin e informacionit me vende të tjera dhe agjentë të ndryshëm, duke përfshirë organizata shtetërore dhe joshtetërore në ndihmë të viktimave.

Çdo masë që ka të bëjë me fëmijët duhet të bazohet në parimet e përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Si rrjedhim, interesi më i lartë i fëmijës duhet marrë gjithmonë si konsideratë parësore dhe pikëpamjet e fëmijës duhet të merren parasysh në të gjitha çështjet që ndikojnë tek ai.⁴⁴¹

Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”⁴⁴², ka për qëllim të parandalojë trafikimin e qenieve njerëzore, të mbrojë viktimat e trafikimit në përgjithësi dhe atyre të mitur në veçanti, të ndjekë penalisht trafikantët, të nxisë bashkërendimin e masave në nivel kombëtar si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Mbrojtja e viktimave normalisht fillon me identifikimin dhe njohjen e viktimës. Kjo konventë thekson se: “Nëse autoritetet kompetente kanë arsye të bazuar të besojnë se një person ka qenë viktimë e trafikimit, ai person nuk do të largohet nga territori deri sa të kryhet procesi i identifikimit si viktimë e veprës penale dhe ai person do të marrë asistencën e paraparë me Konventë”⁴⁴³.

Detyrimi për të përcaktuar dhe identifikuar statusin e personit të trafikuar deduktohet nga detyrimi (që i bie të gjithë aktorëve të përfshirë në procedurë, e veçanërisht policisë dhe prokurorisë) për të mbrojtur viktimat dhe për të parandaluar trafikimin.⁴⁴⁴ Viktimat duhet të identifikohen në mënyrë formale si të tilla, në mënyrë që të parandalohet trajtimi i tyre si emigrantë të parregullt ose si kriminelë. Identifikimi bëhet nga profesionistë të trajnuar posaçërisht (oficerë policie, punonjës socialë, inspektorë të punës, mjekë, ofrues të shërbimeve mbështetëse, etj.) të cilët ndjekin procedurat dhe kriteret përkatëse të identifikimit.

Pasi procesi i identifikimit ka përfunduar dhe është marrë një vendim përfundimtar lidhur me faktin nëse një person ka qenë ose jo një viktimë e abuzimit seksual ose shfrytëzimit seksual, autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që viktimat e identifikuar të marrin asistencë të plotë mbrojtjeje. Vlen vënia në dukje se në asnjë rrethanë, procesi i identifikimit s’duhet të varet nga procedura burokratike dhe të vështira që rezultojnë të kufizojnë aksesin e viktimave për paketën minimale të ndihmës dhe mbrojtjes.

4.2.1.1 Dallimet themelore ndërmjet termit “identifikim i të miturit – viktimë” dhe termit “kualifikim si vepër penale i abuzimit, ose shfrytëzimit seksual”.

Procesi i identifikimit mund të jetë i pavarur nga çdo procedurë tjetër penale kundër autorit të krimit. Fakti tipik penal nuk ka ndikim si në fillim ashtu dhe në fund të procesit të identifikimit. Termi “identifikimi i të miturit viktimë” është i lidhur ngushtë me termin “kualifikimi i krimeve, proces penal”. Megjithatë, ekzistojnë diferenca konceptuale ndërmjet këtyre termave përsa i përket objektivit-qëllim, pasojave, shkallës së përgjegjësisë, etj.

⁴⁴¹ Shih OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, supra note 7, fq. 30.

⁴⁴² Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qenieve njerëzore”, 16 maj 2005 e ratifikuar me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006.

⁴⁴³ Shih nenet 10/2 dhe 12 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qenieve njerëzore”.

⁴⁴⁴ Shih parimet e përgjithshme të përmbledhura në nenin 2 të Protokollit të Palermos.

Kështu, qëllimi i procesit penal, kualifikimit ligjor është zbulimi dhe ndëshkimi i autorëve të abuzimit seksual ose shfrytëzimit seksual, si dhe parandalimi i këtyre veprimtarive kriminale, duke iu nënshtruar operacionit intelektual të kualifikimit ligjor. Kjo është çështje e rëndësishme, sepse serioziteti i një krimi, ndikon drejtpërdrejtë në llojin e dënimeve (dënimi me burgim, me gjobë etj) për të cilin janë dënuar autorët. Ky është një proces i formalizuar në mënyrë rigorozë, si çdo krim i cili është përcaktuar me hollësi në legjislacionin penal⁴⁴⁵.

Duke e krahasuar me procesin penal dhe kualifikimin ligjor, identifikimi i të miturve viktimë, është një procedurë më e thjeshtë. Informacioni i marrë për qëllime identifikimi të viktimave duhet t'i nënshtrohen vetëm verifikimit të përgjithshëm. Në këtë fazë nuk janë të nevojshme dëshmitë përfundimtare. Si pasojë, identifikimi është një proces më pak i formalizuar, sesa procesi penal dhe mund të mbështetet në udhëzime dhe indikatorë të caktuar. Për këtë arsye, grupi i indikatorëve për identifikimin e viktimave duhet të jetë fleksibël dhe i adaptueshëm për sfidat e reja dhe tendencat e reja emergjente në fenomenin e abuzimit seksual, ose shfrytëzimit seksual.

Abuzimi seksual, si dhe shfrytëzimi seksual është një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i të miturit nuk duhet të ndikohen negativisht nga masat kundër abuzimit, ose shfrytëzimit, në veçanti ato të anti-trafikimit. Kjo është e rëndësishme, sepse një kuptim jo i drejtë, ndikon në mënyrën se si trajtohen ata⁴⁴⁶. Viktimizmi i dytë mund të ndodhë në qoftë se viktimat nuk janë trajtuar me ndjeshmërinë e duhur. Të drejtat e njeriut kërkojnë identifikimin e hershëm dhe ndihmë për të miturit-viktimë⁴⁴⁷. Prosesi i bërjes së një identifikimi zyrtar/bindës mund të jetë i gjatë, kështu që identifikimi paraprak në kohë dhe efektiv i viktimave është vendimtare për mirëqënien e tyre.

Subjektet që kryejnë identifikimin duhet të mbrojnë privatësinë dhe identitetin e të miturit, të dhënat e viktimave duhet të mbahen dhe të përdoren vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare⁴⁴⁸. Shkëmbimi i informacionit duhet të respektojë konfidencialitetin e viktimave.

4.2.1.2 Subjektet që realizojnë identifikimin e të miturit viktimë.

Përvojat e vendeve të ndryshme kanë treguar se në procesin e identifikimit duhet të përfshihen të gjithë agjentët private, institucionet zyrtare, shoqëria civile, duke u angazhuar seriozisht në të. Lidhur me subjektet, të cilët duhet të realizojnë procesin e identifikimit Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”⁴⁴⁹ parashikon se:

“1. Çdo Palë do t'u sigurojë autoriteteve të veta kompetente persona të trajnuar dhe të kualifikuar në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qënieve njerëzore, në

⁴⁴⁵ Shih “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore, fq.22.

⁴⁴⁶ Shih UNODC, “Toolkit to Combat Trafficking in Persons”, 1st ed., Vienna/Neë York, 2006, Tool 6.1, p. 103.

⁴⁴⁷ Shih OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, Vienna, 2011, fq. 26.

⁴⁴⁸ Shih Convention for the Protection of Individuals with regard to Automatic Processing of Personal Data (1981, as amended in 1999), CETS No. 108; European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms (1950), CETS No. 005, Article 8 (Right to respect for private and family life).

⁴⁴⁹ Shih nenin 10 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qënieve njerëzore”, 16 maj 2005 e ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.

identifikimin dhe ndihmën ndaj viktimave, duke përfshirë fëmijët dhe do të sigurojë që autoritetet e ndryshme bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si dhe me organizata të ngjashme mbështetëse, në mënyrë që viktimat të mund të identifikohen me një procedurë që merr parasysh situatën e veçantë të viktimave gra dhe fëmijë dhe në raste të përshtatshme, i pajis me lejet e qëndrimit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 14 të kësaj Konvente.

2. Çdo Palë do të miratojë këto masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të identifikuar viktimat, në bashkëpunim me palët e tjera dhe organizatat e ngjashme mbështetëse. Secila Palë do të sigurojë që, nëse autoritetet kompetente kanë shkaqe të arsyeshme të besojnë se një person ka qenë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ai person nuk do të largohet nga territori i saj derisa autoritetet kompetente të kenë kryer procesin e identifikimit si viktimë e një shkeljeje, të parashikuar në nenin 18 të kësaj Konvente dhe gjithashtu do të sigurojë që personi të marrë ndihmën e parashikuar në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2”.

Në bazë të parashikimit të mësipërm procesi i identifikimi të të miturve viktimat duhet të kryhet nga autoritetet kompetente. Termi “autoritetet kompetente” do të thotë autoritet publik,⁴⁵⁰ që mund të kenë kontakt me të miturit viktimat, të tilla si Shërbimet policore, Inspektoriat i Punës, Policia Kufitare, Autoritetet e Emigracionit, Ambasadave etj.

Konventa, gjithashtu, kërkon që autoritetet e ndryshme të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me OJF-të që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për viktimat⁴⁵¹. Identifikimi i viktimave, shpesh, bëhet nga shërbimet policore ose OJF-të e specializuara, që ofrojnë asistencë për viktimat e abuzimit seksual, në veçanti ato të trafikimit të qenieve njerëzore. Identifikimi i tyre mund të bëhet në vendin e destinacionit, tranzit ose në vendin e origjinës të miturve të trafikuar, pasi të jenë kthyer, në vendin e arsimimit, në vendin e punës, qendrat sociale etj.

Është e rëndësishme që agjencitë përgjegjëse për të identifikuar viktimat të punësojnë personel të kualifikuar dhe të aftë për të identifikuar ato, të cilat më pas duhet t’i referojnë drejt organizatave përkatëse për shërbim dhe mbrojtje. Konventa nuk kërkon që autoritetet kompetente të kenë specialistë për çështjet e trafikimit njerëzor, ose abuzimit seksual, por kërkon që ato të kenë njerëz të kualifikuar në mënyrë që viktimat të identifikohen në mënyrë sa më efektive.

Karakteristikat e trafikimit të të miturit, ose abuzimit seksual janë në gjendje dinamike të vazhdueshme. Prandaj është e rëndësishme të sigurohet monitorimi i duhur dhe analiza e tendencave të reja në lidhje me metodat e operimit të subjekteve aktive të këtyre veprave, metodat e reja që ndikojnë tek viktimat dhe mënyra të reja të shfrytëzimit, ose abuzimit. Në mënyrë që të përfitojnë një analizë të tillë, është e nevojshme të bëhet vlerësimi i këtyre rezultateve në punën e përditshme anti-trafikim, ose anti-abuzim, si dhe agjencitë t’i përfshijnë ato në trajnimet profesionale.

Me vlerë është që të vihet në dukje se ka struktura të shumta që për arsye të veprimtarisë së tyre shpesh ndeshen me miturit e trafikuar, ose abuzuar si punonjësit social, zyrat e punësimit, mjekët dhe infermierët etj. Në mënyrë që të organizohet një sistem sa më efikas i identifikimit është e nevojshme, që të angazhohen specialistët në fazën e identifikimit paraprak të viktimave. Specialistët duhet të trajnohen në mënyrë specifike në trajtimin e të miturve të trafikuar, ose abuzuar dhe roli i tyre duhet të jetë i fokusuar kryesisht në drejtim të mbrojtjes së interesave të viktimave. Për këtë arsye, ata duhet të jenë të aftë në informimin e viktimave të supozuara për të drejtat e tyre,

⁴⁵⁰ Shih “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore, fq 52.

⁴⁵¹ Ibid, paras 129-130.

përfshirë të drejtën për të marrë ose jo pjesë në procedurat penale, e drejta për të pasur informacion të plotë mbi çështjet e sigurisë, për të dëshmuar në skemat e mbrojtjes, etj. Konventa Lanzarote thekson se: “1. *Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të siguruar që konfidencialiteti i imponuar nga ligji i brendshëm për profesionistë të caktuar që thirren për të punuar në kontakt me fëmijët nuk do të përbëjnë ndonjë pengesë për mundësinë e këtyre profesionistëve, që t’u raportojnë shërbimeve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në çdo situatë kur ata kanë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një fëmijë është viktimë e shfrytëzimit seksual ose e abuzimit seksual.*

2. *Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të inkurajuar çdo person që di ose dyshon, në mirëbesim, shfrytëzimin seksual ose abuzimin seksual të fëmijëve për t’ua raportuar këto fakte shërbimeve kompetente...*”⁴⁵²

Në qasje të standardeve ndërkombëtare për trajtimin e të miturve- viktima të abuzimit seksual, ose shfrytëzimit seksual theksojmë se subjektet që mund të kontribuojnë në realizimin efektiv të procesit të identifikimit janë⁴⁵³:

- a. **Organet e pushtetit qendror/vendor.** Organet e pushtetit qendror duhet të ndër marrin angazhimet bazë për organizimin, bashkërendimin e duhur, financimin dhe sigurimin e një kuadri rregullator efektiv për luftimin e krimit të shfrytëzimit, ose abuzimit seksual të të miturit në përgjithësi dhe për identifikimin e viktimave në veçanti, gjithashtu me një zbatim sa më efektiv të tyre. Mungesa e angazhimit të këtyre organeve mund të shkaktojë lehtësisht rrëzimin e sistemit të krijuar, si dhe mungesë cilësie në atë çfarë ofrohet⁴⁵⁴. Edhe pse përfshirja e subjekteve të ndyshme në procesin e identifikimit është e nevojshme, qëndrueshmëria e sistemit është e brishtë. Ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për t’u përcaktuar procedura efikase për një identifikim të shpejtë të fëmijëve viktima.⁴⁵⁵ Duhet bërë përpjekje për të bashkërenduar ndarjen e informacionit midis organizmave dhe individëve (përfshirë organizmat e zbatimit të ligjit, ato shëndetsore, arsimore, të mirëqenies sociale si dhe OJF), në mënyrë që fëmijët viktima të identifikohen e të ndihmohen sa më parë të jetë e mundur⁴⁵⁶. Autoritetet e emigracionit të kufirit e të zbatimit të ligjit duhet të krijojnë dhe zbatojnë procedura për identifikimin e fëmijëve viktima në portet e hyrjes apo në vende të tjera. Autoritete të shërbimit social, të shëndetësisë ose të arsimit duhet të vihen në lidhje me autoritetet me rëndësi të zbatimit të ligjit, sa herë që ka informacion ose dyshim se një fëmijë po shfrytëzohet apo po trafikohet ose rrezikon të shfrytëzohet dhe trafikohet, apo abuzohet. Zyrtarët qeveritarë që përgjigjen për politikën, po ashtu si dhe një spektër i gjerë i organizmave të zbatimit të ligjit dhe të mirëqenies së fëmijës, kanë për detyrë të vënë në zbatim procedura që do të mundësonin identifikimin e fëmijëve të trafikuar, ose abuzuar sa më shpejt e sa më me efektshmëri që të jetë e mundur. Në veçanti të miturit e trafikuar mund të identifikohen në pika të ndryshme gjatë procesit të trafikimit

⁴⁵² Shih nenin 12 të Konvetës Lanzarotë ratifikuar me ligjin nr 10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

⁴⁵³ Shih ICMPD, “Guidelines for the Development of a Transnational Referral Mechanism for Trafficked Persons: South-Eastern Europe”, Vienna, 2009, p. 26-27.

⁴⁵⁴ Shih “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore, fq. 53.

⁴⁵⁵ Shih “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq. 48.

⁴⁵⁶ Po aty.

si: ndërsa shoqërohen nga trafikantët në largësi nga vendet e tyre të zakonshme të banimit; ndërkohë që largohen nga vendi i tyre; ndërsa kalojnë kufirin në një vend të huaj; ose në kohën që shfrytëzohen. Institucionet e ndryshme, si qeveritare ashtu dhe joqeveritare, duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e të miturve në këto faza të ndryshme të procesit të trafikimit. Një nga angazhimet kryesore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, si anëtare e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, është nxitja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për shfrytëzimin e të gjitha burimeve të mundshme për identifikimin, mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës ndaj viktimave të trafikimit. Në përmbushje të PSV-ve, MPJ ka udhëzuar ambasadat dhe konsullatat gjerësisht për institucionalizimin e bashkëpunimit me autoritetet e vendit pritës dhe me organizatat jofitimprurëse⁴⁵⁷. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka vazhduar të jetë aktive në identifikimin e rasteve të trafikimit, duke zbatuar plotësisht PSV-të, si hallkë e rëndësishme në intervistimin formal dhe identifikimin formal të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Policia e Shtetit ka bashkëpunuar me KKSAT dhe AMKR për dhënien e shërbimeve të nevojshme për viktimat e trafikimit⁴⁵⁸.

- b. **Pjesëmarrja e shoqërisë civile.** Përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse duhet të jenë pjesë aktive e procesit të identifikimit të të miturve-viktimë, si dhe në krijimin e një kuadri rregullator për procesin e identifikimit, pasi ato kanë ekspertizë të rëndësishme të fituar nga puna në këtë fushë⁴⁵⁹. Shoqëria civile mund të luajë një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë procesit të identifikimit. Përveç kësaj viktimat duhet të kenë të drejtën e ankimit dhe zgjedhjes ndërmjet ndihmës që ofrojnë institucionet qeveritare dhe OJF-ve. Organizatat jofitimprurëse⁴⁶⁰ dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të informojnë institucionet shtetërore dhe/ose autoritete të shërbimeve sociale sa herë që kanë informacion, ose dyshime se një fëmijë po shfrytëzohet ose po trafikohet ose rrezikon të shfrytëzohet dhe trafikohet, ose abuzohet seksualisht. Në Shqipëri, identifikim fillestar të viktimave të trafikimit kryejnë të gjithë ato aktorë që kanë mundësinë të identifikojnë raste potenciale të trafikimit të personave. Një rol të rëndësishëm në identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit jep dhe shoqëria civile, organizatat palë në MKR dhe organizata të tjera që operojnë në këtë fushë. Punonjësit social shtetërorë të Zyrave Rajonale të Shërbimit Social si dhe punonjësit e Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit kanë marrë pjesë gjatë intervistës formale për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit⁴⁶¹.
- c. **Koordinimi multidisiplinar dhe ndërsektoriale.** Një koordinim i tillë është i nevojshëm në veçanti në rastin e trafikimit të miturit, i cili është një fenomen kompleks. Kështu që, për një identifikim sa më efikas të këtyre viktimave

⁴⁵⁷ Shih paragrafin e 3.1 të Raportit “Për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore” janar -dhjetor 2011, fq. 22.

⁴⁵⁸ Shih paragrafin e 3.1 të Raportit “Për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore” janar -dhjetor 2011, fq. 21.

⁴⁵⁹ Shih “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore, fq. 53.

⁴⁶⁰ Shih “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimat të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq. 49.

⁴⁶¹ Shih paragrafin e 3.1 të Raportit “Për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore” janar -dhjetor 2011, fq. 21.

duhet të sigurohet pjesëmarrja e specialistëve dhe agjentëve të ndryshëm⁴⁶². Qasje multidisiplinore do të thotë njohuri, ekspertiza dhe disiplina të ndryshme, si dhe metodat respektive që janë të kombinuara për të siguruar mbështetje të gjithanshme dhe ndihmë për viktimat e mitur të trafikimit. Termi “ndër-sektorial” do të thotë se ndërhyrjet duhet të projektohen dhe implementohen në mënyrë që ato të përfshijnë të gjithë sektorët përkatës të shoqërisë. Në rastet e fëmijëve viktimat të trafikimit, duhen punësuar njerëz proaktiv, por edhe të ndjeshëm për identifikimin e viktimave. Një qasje e tillë duhet të sigurojë që të gjithë aktorët të jenë të vetëdijshëm për nevojat e veçanta të fëmijëve dhe të dinë se si të aplikojnë masat e veçanta, gjatë identifikimit të një fëmije, viktimë të trafikimit. Çdo masë që ka të bëjë me fëmijët e trafikuar duhet të bazohet në parimet e përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të Drejtat e Fëmijës”. Si rrjedhojë, interesi më i mirë i fëmijës duhet marrë gjithmonë si konsideratë parësore dhe pikëpamjet e fëmijës duhet të merren parasysh në të gjitha çështjet që ndikojnë tek ai/ajo⁴⁶³.

Shërbimet sociale, autoritetet shëndetësore dhe arsimore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e fëmijëve që abuzohen, shfrytëzohen ose që eventualisht trafikohen, si në vendin e tyre të prejardhjes ashtu dhe në një vend të huaj. Ato duhet të jenë të vetëdijshëm e të vëmendshëm ndaj shenjave që tregojnë se fëmijët po shfrytëzohen, ose abuzohen, p.sh.nëse ata nuk ndjekin rregullisht shkollën ose kur janë shumë të shpërqendruar e nuk mësojnë. Shërbimet sociale duhet të luajnë një rol të veçantë në kontrollin e mirëqenies së fëmijëve që janë identifikuar në një pikë kufitare si viktimat të mundshme trafikimi (ose në rrezik të abuzohen për arsye të tjera) e të vënë në dijeni shërbimet e emigrimit ose shërbimet policore.

Shërbimet sociale, punonjës të shëndetësisë e autoritete të arsimit mund të jenë gjithashtu aktivë në vendet e prejardhjes së fëmijëve, duke identifikuar ata që hipotetikisht mund të trafikohen. Për shembull, fëmijët që e braktisin shkollën para se të kryejnë arsimin e detyrueshëm në rrethana ku ka arsye të dyshohet se mund të trafikohen.

Organet e drejtësisë duhet të jenë të vëmendshëm, gjatë procedimit dhe gjykimit të të miturve subjekte aktive të veprave penale, në veçanti kur këta të fundit i kryejnë ato në zbatim të urdhërave të personit që i trafikon, ose i abuzon, që të zbulojnë këtë fakt, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në identifikimin e të miturve viktimë. Pavarësisht rrethanave në të cilat ndodh identifikimi, këto organe kanë si detyrë që t’i japin përparësi mbrojtjes së fëmijëve të përfshirë në këto vepra, duke vënë në plan të parë interesat më të larta të të miturit e t’i mbrojnë këta të fundit që të mos rrezikohen e të dëmtohen. Ata nuk duhet t’i trajtojnë fëmijët si kriminelë, por si viktimat.

Inspektorët e Inspektoriatit të Punës gjatë realizimit të inspektimeve në qendrat e realizimit të punës në punëdhënës të ndryshëm, mund të identifikojnë të mitur, të cilët nuk mund të punojnë për shkak të moshës së tyre, ose nuk duhet të përfshihen në atë punë që po kryejnë për shkak të papërshtatshmërisë së saj, shenja që tregojnë se ata mund të jenë viktimat të punës së detyruar, trafikimit. Në secilin nga këto raste inspektorët e punës duhet të vihen në kontakt me shërbimet përgjegjëse sociale dhe autoritetet policore.

⁴⁶² Shih “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore, fq. 29.

⁴⁶³ Shih OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, *supra* note 7, p. 30.

Përveç organizmave shtetëror, organizatat jofitimprurëse dhe ato të shoqërisë civile kanë dhënë ndihmesën e tyre në identifikimin e të miturve viktime. Disa prej tyre e realizojnë atë në kuadër të qëllimit të krijimit të tyre, ndërsa disa të tjera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre vihen në kontakt me të mitur, për të cilët dyshohet se kanë qenë viktime të abuzimit ose shfrytëzimit seksual. Në të gjitha rastet ata kanë detyrimin që të njoftojnë shërbimet policore, ose punonjësit social. Për një efektivitet më të lartë në realizimin e identifikimit është e nevojshme që anëtarët e këtyre organizatave³ t'i shoqërojnë shërbimet policore gjatë operacioneve hetimore, që zhvillojnë në ato vende, në të cilat mendohet se mbahen të mitur viktime të trafikimit, abuzimit seksual. Për shkak të përgatitjes profesionale këta përfaqësues e kanë më të lehtë që të fitojnë besimin e të miturve viktime.

4.2.1.3 Sistemi i Indikatorëve për identifikimin e të miturit viktime

Për identifikimin e të miturve-viktime mund të përdoren një mori indikatorësh. Gjatë procesit të identifikimit, personi përgjegjës për identifikimin duhet të krahasojë të dhënat në lidhje me rrethanat individuale të rastit me indikatorët specifikë të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të abuzimit seksual të të miturit. Secili nga indikatorët përshkruan një element të ndryshëm përcaktues të përkufizimit ligjor të trafikimit të të miturit, ose të abuzimit seksual⁴⁶⁴. Përdorimi i indikatorëve ndihmon personin përgjegjës të identifikojë e të konstatojë nëse kanë ndodhur veprimet e caktuara të tilla si rekrutimi, transportimi, transferimi nëse viktime i ishte nënshtruar një lloji të caktuar të shfrytëzimit, ose abuzimit etj.

Duke patur parasysh faktin se treguesit e caktuar pasqyrojnë elementët përbërës të ndryshëm të kimit të trafikimit, prostitucionit, pornografisë etj. të të miturit (aktet, metodat, qëllimet) këto mund të konsiderohen si tregues të drejtpërdrejtë të trafikimit, ose abuzimit. Në praktikë, mund të ndodhë që personi përgjegjës për identifikimin nuk mund të marrë të dhëna të mjaftueshme gjatë intervistimit në lidhje me praninë e treguesve të drejtpërdrejtë që do të ndihmojnë të konstatohet se i mituri është viktime⁴⁶⁵. Kjo ndodh për disa arsye, për shembull kur viktime nuk është i gatshëm ose heziton të tregojë të vërtetën për shkak të frikës apo shqetësimit në gjendjen psikologjike.

Ndonjëherë informacioni vihet në dispozicion nga të afërmit apo të njohurit e viktime e më pas nga vetë viktime. Në këtë rast informacioni i dorëzuar është i pa plotë. Në raste të tilla, një specialist me përvojë duhet të ketë aftësi të mjaftueshme për të qenë në gjendje të përdorë indikatorët e tërthortë të trafikimit. Indikatorët e tërthortë janë bazuar në të dhënat statistikore, si dhe njohuritë personale, portreti social dhe psikologjik i të miturve viktime të trafikimit, në një situatë të veçantë të vendit ku është gjetur viktime, si dhe rrethana të tjera relevante për personalitetin dhe stilin e jetesës së viktime.

Kështu, grupi i indikatorëve të përdorur për identifikimin e të miturve viktime mund të ndahet në dy grupe:

- Indikatorët e drejtpërdrejtë, të cilët korrespondojnë me përcaktimin ligjor të identifikimit të miturve të trafikuar, ose abuzuar.

⁴⁶⁴ Shih “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore, fq. 41.

⁴⁶⁵ Po aty

- Indikatorët e tërthortë, të cilët bazohen në të dhënat e administruara përmes praktikës, studimeve sociologjike dhe analizimit të rasteve reale të trafikimit, prostitucionit, pornografisë (profile statistikore, sociale dhe psikologjike të personave të trafikuar, marrëveshjet e bëra për të organizuar udhëtimin jashtë vendit, situatën e vendit ku viktimat është gjetur etj).

4.3. Caktimi i një kujdestari

Nëse në përfundim të procesit të identifikimit arrihet që të identifikohet një, ose disa të mitur, të cilat kanë qënë viktimat të trafikimit, shfrytëzimit, ose abuzimit seksual, hapi i parë që duhet të ndërmerret është caktimi i një kujdestari për ta shoqëruar të miturin përgjatë gjithë procesit, deri sa të gjendet dhe zbatohet një zgjidhje e qëndrueshme në interesat më të mirë të fëmijës.

Ky aspekt procedural paraqet rëndësi substanciale për mbrojtjen e të drejtave të të miturit, aq sa është ngritur në standard me karakter ndërkombëtar, i parashikuar nga aktet ndërkombëtare dhe i detyrueshëm për t'u ndërmarrë nga të gjitha shtetet, të cilat kanë ratifikuar këto akte. Kështu, në mënyrë eksplicite Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore” parashikon se⁴⁶⁶: “*Pas identifikimit të një fëmije të parashikuar si viktimë, çdo palë: -a) do të parashikojë përfaqësimin e fëmijës nga një kujdestar ligjor, organizatë, ose autoritet ligjor që do të veprojë në emër të interesave më optimale të këtij fëmijë...*”.

Në kuadër të parashikimit të mësipërm shtetet anëtare duhet jo vetëm të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm një aspekt të tillë procedural, por ato duhet ta realizojnë atë në mënyrë efektive, sapo të identifikohet një fëmijë si viktimë e mundshme trafikimi, ose abuzimi seksual, ose, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një person është fëmijë dhe viktimë trafikimi, abuzimi seksual duhet caktuar një kujdestar. Është efikase që nëse është e mundur të caktohet i njëjti person kujdestar përgjatë gjithë procesit⁴⁶⁷.

UNICEF në udhëzimet e saj⁴⁶⁸ për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve viktimat të trafikimit, thekson se pavarësisht nga statusi ligjor i individit të caktuar si kujdestar ligjor, kujdestar i përkohshëm, këshilltar/përfaqësues, punonjës social ose punonjës i një OJF-je, përgjegjësitë e tyre duhet të jenë⁴⁶⁹:

- Të sigurojë që të gjitha vendimet e marra janë në interesin më të mirë të fëmijës.
- Të sigurojë që fëmija viktimë gëzon përkujdesje të përshtatshme, banesë, masa shëndetësore, mbështetje psiko-sociale, arsimim dhe përkrahje gjuhësore.
- Të sigurojë që fëmija viktimë e ka mundësinë për përfaqësim ligjor të çfarëdo lloji sa herë që është e nevojshme.
- Të këshillohet, të këshillojë e ta mbajë të informuar fëmijën viktimë për të drejtat e tij/ të saj.
- Të ndihmojë në identifikimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme në interesin më të mirë të fëmijës.

⁴⁶⁶ Shih nenin 10/4/a të Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve”, ratifikuar me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006.

⁴⁶⁷ Shih “Udhërefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimat të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq. 55.

⁴⁶⁸ Po aty.

⁴⁶⁹ Shih “Programi për fëmijët e ndarë në Europë, Deklaratë e praktikave të mira”, Save the Children, Botim i tretë 2004, fq. 18.

- f) Të ngrejë një lidhje midis fëmijës viktimë dhe organizatave të ndryshme që mund të sigurojnë shërbime për fëmijën.
- g) Ta ndihmojë fëmijën viktimë në gjetjen e familjes së vet.
- h) Të bëjë të mundur që nëse kryhet riatdhësimi ose ribashkimi familjar, ky të jetë në interesin më të mirë të fëmijës viktimë.

Roli i kujdestarit nuk është i njëjti me atë të përfaqësuesit ligjor⁴⁷⁰, sepse ai duhet të jetë avokat i fëmijës në një spektër të gjerë diskutimesh e vendimesh mbi të ardhmen e tij, sidomos që të garantojë që procesi i vendimmarrjes, në radhë të parë, do të mbajë parasysh interesat më të mirë të fëmijës. Gjithashtu, roli i tij është që të jetë një hallkë midis fëmijës dhe organizmave të ndryshme, me të cilat fëmija bie në kontakt, të garantojë që fëmija të informohet për çdo zhvillim me rëndësi për të, si dhe ta shoqërojë fëmijën, edhe fizikisht, sidomos kur ajo ose ai zhvendoset në një vend tjetër⁴⁷¹.

Rolin e kujdestarit në radhë të parë mund ta realizojnë prindi i fëmijës, ose kujdestari ligjor, nëse ata nuk janë subjekte aktive të veprave penale të trafikimit, ose abuzimit, ose shfrytëzimit seksual të kryera ndaj fëmijës. Në këto raste, menjëherë nga identifikimi duhet të merret kontakt me prindin, në mënyrë që t'i mundësohet atij realizimi i rolit si prind.

Nëse nuk mundet të merret kontakt me prindrit ose kujdestarin ligjor, mund që të caktohet një kujdestar në mënyrë të përkohshme për të garantuar mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijës. Në rast se fëmija vendoset në një institucion rezidencial, qoftë edhe përkohësisht, përfaqësuesi i këtij institucioni mund të caktojë kujdestarin.

Kujdestari i të miturit viktimë duhet të caktohet nga shërbimi zyrtar i mbikqyrjes së një vendi. Në qoftë se nuk ekziston një shërbim i tillë ose një organizëm ligjor i ngjashëm, autoriteti kombëtar që përgjigjet për shërbimet sociale apo një tjetër institucion i përshtatshëm ka përgjegjësinë për vendosjen e një shërbimi mbikëqyrjeje. Ky mund të jetë një shërbim që i identifikon, përzgjedh dhe angazhon vetë kujdestarët ose një shërbim që angazhon organizata të tjera ta bëjnë këtë gjë. Shërbimi mbikqyrës ka përgjegjësinë që të monitorojë apo kontrollojë punën që bëjnë individët kujdestarë. Në parim caktimi i kujdestarëve nuk duhet të bëhet nga Ministria e Brendshme, nga një shërbim emigrimi apo nga policia. Kjo shmang përshtypjen se caktime të tilla mund të pasqyrojnë interesat dhe/ose politikat e qeverisë e jo të përqendrohen në interesat më të mirë të fëmijës⁴⁷².

Institucionet shtetërore duhet të garantojnë që shërbimi mbikqyrës të jetë i pavarur, në mënyrë që të mbrohen interesat më të mira të fëmijëve. Kujdestarët nuk duhet të jenë drejtpërdrejt në varësi të ministrive, ose organizmave të zbatimit të ligjit, të cilat zbatojnë të tjera përparësi e politika. Sapo që caktohet, kujdestari i jep llogari përpara shërbimit mbikqyrës, ose organizatës, që e ka caktuar, lidhur me detyrën që kryen në ruajtjen e interesave më të mira të fëmijës dhe në zbatimin e përgjegjësiave që janë ngarkuar.

Personat që mbajnë këto përgjegjësi mund të përzgjidhen nga një sërë mjedisesh të specializuara. Megjithatë, për të kryer rolin e tyre me efektivitet, këshilltarët ose kujdestarët duhet të kenë njohuri të përshtatshme lidhur me kujdesin

⁴⁷⁰ Sidoqoftë, nëse është e përshtatshme dhe e nevojshme që fëmija të fillojë ose të marrë pjesë në procedura ligjore, ajo ose ai do të ketë nevojë gjithashtu për një përfaqësues ligjor (një avokat të kualifikuar).

⁴⁷¹ Shih "Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë të trafikimit në Europë". Unicef, Tiranë, 2007, fq. 56.

⁴⁷² Po aty.

për fëmijën dhe duhet të kuptojnë nevojat e veçanta dhe kulturore të fëmijëve të ndarë. Ata duhet të trajnohen dhe të marrin mbështetje profesionale si dhe t'i nënshtrohen kontrollit të referencave nga policia⁴⁷³.

Në momentin që i mituri viktimë identifikohet, subjekti identifikues duhet të vihet në komunikim me shërbimin mbikqyrës dhe të kërkojë që t'i vihet në dispozicion një kujdestar, pavarësisht se ku ndodhet fëmija.

Rolin e kujdestarit mund ta ofrojnë organizatat jofitimprurëse, nëpërmjet anëtarëve të tyre. Megjithatë, ky aspekt procedural duhet të rregullohet në mënyrën e duhur nga shërbimit mbikqyrës⁴⁷⁴.

Kujdestarët mund ta gjejnë veten nën trysni kundërthënëse të policisë ose zyrtarëve të tjerë që bëjnë kërkesa, të cilat sipas mendimit të kujdestarit nuk shkojnë në interesat më të mirë të fëmijës. Këto kundërthënie ndodhin sidomos kur policia ose shërbimet e prokurorisë kërkojnë të nisin ndjekje penale dhe dëshirojnë që fëmija të dëshmojë, apo edhe të marrë pjesë në një gjyq ose në një procedurë tjetër ligjore. Çdo vendim që merr një kujdestar duhet të jetë gjithmonë në interesin më të mirë të fëmijës, kujdestar i të cilit apo i së cilës ai është, d.m.th përpara interesave të "shoqërisë" apo të një "të mire të përgjithshme".

Kujdestari nuk ka të drejtë të ndër marrë zgjedhje që mund të duket sikur janë në interesin më të mirë të fëmijëve në përgjithësi (p.sh. të kalojë në përndjekjen e fëmijës), as nga ato që nuk janë dukshëm në interesin më të mirë të fëmijës në fjalë (p.sh. kur siguria e tij/e saj mund të rrezikohet nga dhënia e dëshmimeve, ekspozimi i fëmijës ose i të afërmeve të tij ndaj rrezikut të përsëritjes). Po kështu, në çdo takim ku është i pranishëm kujdestari e ku do të vendoset se çfarë do të ndodhë me fëmijën, kujdestari duhet të këmbëngulë për interesat më të mirë të fëmijës, që ato të jenë i pari peshim në vendimmarrje dhe gjithmonë duhet të tërheqë vëmendjen se duhen mbrojtur interesat më të mirë të fëmijës në fjalë.

Kujdestari ka të drejtën të refuzojë lejimin e një fëmije për të dhënë dëshmi në një procedurë penale dhe civile, në qoftë se kjo është në interesat më të mirë të fëmijës. Kujdestari ka gjithashtu të drejtën që të refuzojë dhënien e dëshmisë për një fëmijë nëse ai ose ajo thërritet ta bëjë një gjë të tillë. Kujdestarit gjithashtu duhet të udhëhiqen në punën e tyre prej parimit se "nuk duhet të dëmtojnë" fëmijën për të cilin përgjigjen, as me veprimet e tyre as me vendimet që ata bashkëmarrin në emër të fëmijës.

Ka rëndësi që policia dhe shërbimet e prokurorisë të jenë të vetëdijshëm për këto përcaktime dhe ta kuptojnë se nuk kanë të drejtë ta vënë një kujdestar nën trysni për të ndërmarrë veprime të cilat kujdestari i vlerëson se janë kundër interesave më të mirë të fëmijës. Kujdestarët ndodhen në një pozicion mjaft të privilegjuar për të dëgjuar mendimet e vetë fëmijës, si për atë që i ka ndodhur ashtu dhe për atë që fëmija dëshiron t'i ndodhë në të ardhmen.

Në përgjithësi është përgjegjësia e kujdestarit të garantojë që të dëgjohen mendimet e fëmijës e që ato të merren parasysh sa më shumë të jetë e mundur. Nganjëherë fëmijët shprehin një mendim apo një dëshirë lidhur me të ardhmen e tyre që mund t'u bjerë ndesh, sipas gjykimit të kujdestarit, interesave më të mirë të fëmijës. Për shembull, një djalosh 13-vjeçar që është gjetur duke larë xhamat e makinave, mund të thotë se dëshiron më mirë ta vazhdojë këtë punë që i sjell të ardhura sesa të kthehet në shkollë. Në këtë rast është përgjegjësi e kujdestarit t'i

⁴⁷³ Shih "Programi për fëmijët e ndarë në Europë, Deklaratë e praktikave të mira", Save the Children, Botim i tretë 2004, fq.19.

⁴⁷⁴ Shih "Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktime të trafikimit në Europë". Unicef, Tiranë, 2007, fq. 56.

shpjegojë fëmijës kërkesat ligjore për frekuentimin e shkollës dhe të diskutojë për ato mundësi që i vijnë sa më pranë dëshirave apo aspiratave të fëmijës.

Në realizimin e detyrës kujdestarët duhet të ndihmohen edhe nga institucionet shtetërore. Ky është një detyrim që rrjedh nga angazhimet ndërkombëtare të tyre. Kështu, në konventën e OKB⁴⁷⁵ “Mbi të drejtat e fëmijës” theksohet se: “*Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, nëushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët...*”

Përgjegjësitë e kujdestarit për t’u kujdesur për interesat në të mirë të fëmijës shkojnë më lart se sa thjesht garantimi i të dëgjuarit e të ndjekjes së mendimeve të fëmijës: ka shumë rrethana në të cilat fëmijët nuk janë të ndërgjegjshëm për rreziqet që lidhen me një mundësi të cilën ata kërkojnë dhe është detyrë e kujdestarit t’ia bëjë atij të qartë këtë. Për shembull, fëmijët e trafikuar mund të ndodhen ende për një kohë të gjatë nën ndikimin e trafikuesit të tyre edhe pasi kontrolli i drejtpërdrejtë të ketë përfunduar e të vazhdojnë të kërkojnë një ecuri, e cila në thelb është në interesat e trafikantit dhe jo në ato të fëmijës.

4.4. Referimi, si pikënisje e procedimit penal.

Fëmijët viktime duhet t’u referohen pa vonesë shërbimeve të përshtatshme. Termi “referim” këtu përdoret me kuptimin e ndihmës që i jepet një personi viktimë trafikimi për t’u kthyer nga një vend zakonisht tranziti, ose destinacioni në vendin e origjinës apo në një vend tjetër të tretë të sigurt, ose nga një burim mbrojtjeje dhe asistence në një tjetër brenda një vendi. Ndërsa, referimet nga një vend në një tjetër kërkojnë bashkëpunime dhe koordinime të nivelit transnacional, referimet nga një shërbim në tjetrin brenda një vendi, kërkojnë bashkëpunim dhe koordinime mes ofruesve të shërbimeve si edhe njësimi/standardizimi i cilësisë së shërbimeve. Në çdo rast, imperative e referimit dhe kthimit është sigurimi i vazhdimësisë së ndihmës, shmangia e rrezikut për jetën dhe e ritrafikimit⁴⁷⁶.

Shteti, nëpërmjet ministrive përkatëse, duhet të ndihmojë autoritetet e zbatimit të ligjit, autoritetet e shërbimit social, organizmat me rëndësi administrative, organizmat ndërkombëtare dhe OJF/organizatat e shoqërisë civile për përcaktimin e një mekanizmi efikas referimi për fëmijët viktime⁴⁷⁷.

Marrëveshja ku përcaktohen përgjegjësitë e aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore për sa i përket identifikimit, referimit, akomodimit, asistencës dhe rehabilitimit të viktimeve të trafikimit në Shqipëri është Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qënieve Njerëzore (MKR) e firmosur më datë 18 Korrik 2005. Në thelb, MKR është një sistem, një rrjet i ngritur mes policisë, shërbimit social, shërbimit diplomatik dhe konsullor, si dhe qendrave pritëse dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit⁴⁷⁸.

⁴⁷⁵ Shih nenin 18/2 të Konventës “Mbi të drejtat e fëmijës” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me datë 20.11.1989.

⁴⁷⁶ Shih “Doracak i ofruesve të shërbimeve për mbrojtjen e viktimeve të trafikimit”, Tiranë, qershor 2008, Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, fq. 43.

⁴⁷⁷ Shih “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktime të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq. 64.

⁴⁷⁸ Shih “Strategjia Kombëtare për luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore”, Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimtimit 2005- 2007 PERFSHIRE: Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përmirësojë bashkërendimin ndërinstitucional për pritjen fillestare, mbrojtjen dhe ndihmën mjekësore dhe sociale për viktimat aktuale, të supozuara apo të mundshme të trafikut njerëzor brenda dhe jashtë Shqipërisë nëpërmjet krijimit të një Mekanizmi Kombëtar Referues, që do të rregullojë detyrimet dhe bashkëpunimin mes të gjitha palëve të përfshira në identifikimin dhe referimin, akomodimin dhe ndihmën, bashkimin me familjen, kthimin vullnetar dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave të trafikuar.

Të gjitha ministritë përgjegjëse dhe organizmat qeveritare (përfshirë policinë, autoritetet e shërbimit social, Ministrinë e Brendshme) që përfshihen në referimin (kalimin) dhe ndihmën për fëmijët-viktima, duhet të zbatojnë politika dhe procedime që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe rrjetëzimin midis organizmave dhe individëve që punojnë me fëmijët viktima me qëllim që të sigurohet një vazhdimësi efikase në përkujdesin dhe mbrojtjen për fëmijët viktima.

Ministria e Brendshme duhet të caktojë “zyrtarët e lidhjes” që do të përgjigjen për lidhjen me autoritetet e shërbimeve sociale/shërbimet e mbikqyrjes e në veçanti me kujdestarin për fëmijën viktimë.

Me qëllim që të ndihmohen entet juridike-administrative në mbledhjen e informacionit dhe dokumentimit të nevojshëm për të mbërritur në një vendim joformal lidhur me të ardhmen e fëmijës, Ministria e Brendshme duhet të ndihmojë në lidhjen e kontakteve me autoritetet përgjegjëse në vendin e prejardhjes së fëmijës. Një ndihmë e tillë do t'u kërkohet edhe autoriteteve përkatëse si mbështetje dhe bashkërendim në marrëveshjet e tyre me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe ku është e arsyeshme, në kontaktet e tyre me përfaqësues të ambasadave të vendeve të prejardhjes së fëmijëve. Zyrtarët e lidhjes duhet të lidhen gjithashtu me pjestarë me rëndësi të organizmave të zbatimit të ligjit që merren me fëmijët viktima.

Zyrtarët e lidhjes, duhet të përgjigjen për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme në takime ku vendoset përfundimisht për të ardhmen e fëmijës në bashkërendim me organizma të tjera me rëndësi administrative e juridike.

Shumë organizata të ndryshme ka gjasa që të përfshihen në procesin e identifikimit dhe mbrojtjes së fëmijës që është trafikuar. Në qoftë se përfshihen dy a më shumë vende, siç ndodh në rastet e trafikimit ndërkufitar, autoritetet e disa vendeve të ndryshme duhet të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre dhe shkëmbimin e informacionit.

Ka rëndësi që organizata të ndryshme brenda për brenda një vendi, që luajnë rol në mbrojtjen dhe ndihmën ndaj fëmijëve që kanë qenë trafikuar, të bashkërendojnë veprimet e tyre dhe të bashkëpunojnë në mënyrë që të sigurohet referimi (kalimi) në kohë dhe efikas i viktimave tek shërbimet e përshtatshme. Bashkëpunimi ka rëndësi thelbësore për të garantuar që fëmijët e trafikuar të gëzojnë shërbime të përshtatshme dhe se do të merren vendime të arsyeshme lidhur me rastet e tyre. Bashkëpunimi kërkohet gjithashtu në përpjekjet që masat parandaluese kundër trafikimit të fëmijëve të jenë efektive.

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi kërkojnë ose ngritjen e një mekanizmi të veçantë në nivel kombëtar ose mund të mbështeten në mekanizma ekzistuese bashkëpunimi. Një argument për ngritjen e një mekanizmi të veçantë për bashkërendimin e rasteve të trafikimit është larmia dhe përzierja e veçantë e organizatave që luajnë rol këtu, si për shembull autoritetet e zbatimit të ligjit,

femijeve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktima të trafikimit – Marrëveshje bashkëpunimi për krijimin e një mekanizmi kombëtar referues për identifikim dhe asistencë të përmirësuar për viktimat e trafikut të qënieve njerëzore”, Tiranë, Shqipëri- Korrik 2005 (Ribotuar në korrik 2006).

autoritetet e shërbimit social, organizmat administrative, organizmat ndërkombëtare dhe organizatat shoqërisë civile.

I njëjti mekanizëm bashkërendimi mund të përdoret si për rastet e të rriturve të trafikuar ashtu dhe për ato të fëmijëve. Megjithatë, fëmijët e trafikuar kanë disa veçori që bëjnë dallim nga të rriturit e trafikuar, kështu që proceset e bashkërendimit dhe të referimit duhet të koordinohen në të tillë mënyrë që t'u përgjigjen nevojave të veçanta të fëmijëve në fjalë.

4.4.1. E drejta për akses në shërbimet mbështetëse të viktimës.

E drejta për mbështetje është një e drejtë themelore. Mbështetja është thelbësore për shërimin e viktimave dhe qëllimi i kësaj të drejtë është të sigurojë që viktimat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të kenë akses në shërbimet e mbështetjes pa pagesë, duke përfshirë informacion dhe këshilla, mbështetje emocionale, psikologjike dhe ndihmë praktike. Konventa Lanzarote, përcakton se: “ *Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të asistuar viktimat për një afat të shkurtër dhe të gjatë, për shërimin e tyre fizik dhe psikosocial. Masat e marra sipas këtij paragrafi do të marrin parasysh plotësisht pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijës.*

Secila palë do të marrë masat, sipas kushteve që parashikon ligji i brendshëm, për të bashkëpunuar me organizata joqeveritare, organizata të tjera përkatëse ose elemente të tjera të shoqërisë civile të përfshira për asistencën e viktimave.

Kur prindërit ose personat, që kujdesen për fëmijët, janë përfshi rë në shfrytëzimin ose abuzimin e tij ose të saj seksual, procedurat e ndërhyrjes që merren me zbatimin e nenit 11, paragrafi 1, do të përfshijnë:

- *mundësinë e largimit të personit i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, të pretenduar;*
- *mundësinë e largimit të viktimës nga mjedisi i familjes së tij ose të saj. Kushtet dhe kohëzgjatja e këtij largimi do të përcaktohet në përputhje me interesat më të mira të fëmijës*

Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të siguruar që personat, të cilët janë të afërm me viktimën, të mund të përfitojnë, kur mundet, nga asistenca terapeutike, përkatësisht kujdesi psikologjik i emergjencës”⁴⁷⁹.

E drejta për mbështetje është parashikuar si një e drejtë themelore edhe nga Direktiva nr.29, datë 25.10.2012 e Parlamentit European dhe Këshillit të Bashkimit European⁴⁸⁰.

Direktiva i referohet mbështetjes që sigurohet para, gjatë dhe për një kohë të përshtatshme pas procedurave penale dhe për këtë arsye duhet të vihet në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur pasi një krim është kryer, pavarësisht nëse është denoncuar, dhe bazuar në nevojat e viktimës. Një sistem reference për shërbimet e mbështetjes së viktimës (paragrafi 2) është një aspekt i rëndësishëm i shpërndarjes së shërbimeve, në mënyrë që të kapërcehen vështirësitë, të sigurohet mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave. Specialisti i shërbimeve mund të sigurohet nga institucione të veçanta ose brenda kuadrit të përgjithshëm të shërbimeve mbështetëse; ose nëpërmjet një mekanizmi reference. Ato duhet të jenë pa pagesë, konfidenciale dhe të disponueshme bazuar në nevojat specifike të viktimës (paragrafi 3). Mbështetja

⁴⁷⁹ Shih nenin 14 të Konvetës Lanzarote.

⁴⁸⁰ Shih nenet 8 dhe 9 të Direktivës nr 29 datë 25.10.2012 e Parlamentit European dhe Këshillit të Bashkimit European.

e përgjithshme dhe e specializuar mund të sigurohet nga organizata qeveritare ose joqeveritare mbi baza profesionale dhe/ose vullnetare (paragrafi 4), por duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme.

Në nenin 9 të Direktivës përcaktohet se kjo e drejtë përfshin:

- a) informacion, këshillë dhe mbështetje mbi të drejtat e viktimës, duke përfshirë aksesin në skemat kombëtare të kompensimit dhe rolin e tyre në procedimin penal;
- b) informacion ose referencë direkte të çdo specialisti të rëndësishëm të shërbimeve të mbështetjes në vend;
- c) mbështetje emocionale dhe kur është e disponueshme mbështetje psikologjike;
- d) këshillë në lidhje me çështje financiare dhe praktike që rrjedhin për shkak të krimit;
- e) këshillë në lidhje me rrezikun dhe parandalimin e ndodhjes për herë të dytë dhe përsëritjes së viktimizimit, të kanosjes dhe shpagimit/hakmarrjes (paragrafi 1).

4.5. Aspektet procedurale penale dhe të drejtat e të miturit viktimë e abuzimit ose shfrytëzimit seksual.

Ratifikimi i konventave të lartpërmendura nga Republika e Shqipërisë, duke i bërë pjesë të sistemit juridik të brendshëm dhe të detyrueshëm për zbatim, kërkon që në legjislacionin procedural penal të reflektohen qasjet e tyre, të merren masat e duhura legjislative në funksion të realizimit të qëllimit të ekzistencës së tyre, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të viktimës në përgjithësi dhe asaj të të miturit në veçanti.

Fillimi i procedimit penal apo vazhdimi i tij për hetimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual nuk duhet të jetë i kondicionuar nga vullneti i të dëmtuarit të mitur. Ky është një aspekt i rëndësishëm procedural, në të cilin ka vënë theksin edhe Konventa Lanzarote, e cila thekson se: *“Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera, për të siguruar që hetimet ose procedimet e veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë nuk do të varen nga raportit ose akuza e bërë nga viktimja dhe që procedimet mund të vazhdojnë edhe në qoftë se viktimja i ka tërhequr deklaratat e tij ose të saj...”*⁴⁸¹.

Për fillimin e procedimeve në lidhje me veprat penale të përcaktuara lidhur me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual, ato do të vazhdojnë për një periudhë kohe të mjaftueshme që të lejojë fillimin eficient të procedimeve pasi viktimja ka mbushur moshën madhore dhe e cila është proporcionale me gravitetin e krimit në fjalë⁴⁸².

Hetimi duhet të realizohet nga subjekte, persona, njësitë ose shërbimet të specializuara në fushën e luftës kundër shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve ose persona të trajnuar për këtë qëllim. Këto njësi ose shërbime duhet të kenë burime të përshtatshme financiare. Pasiguria për moshën faktike të viktimës nuk duhet të pengojë fillimin e hetimeve penale⁴⁸³.

Një aspekti të tillë i është kushtuar rëndësi e madhe edhe nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur, në të cilin është parashikuar se ndjekja penale në çështjet e drejtësisë penale

⁴⁸¹ Shih nenin 32 të Konvetës Lanzarote.

⁴⁸² Shih nenin 32 të Konvetës Lanzarote.

⁴⁸³ Shih nenin 35 të Konvetës Lanzarote.

për të mitur, bëhet nga prokurorë të trajnuar dhe specializuar në këtë fushë⁴⁸⁴. Punonjësit e policisë gjyqësore që trajtojnë çështjet e drejtësisë penale me të mitur trajnohen dhe specializohen në drejtësinë penale për të mitur.

Veprimet e parashikuara nga ligji për Policinë e Shtetit lidhur me të miturit, kryen nga një punonjës i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur⁴⁸⁵.

Në sistemin e drejtësisë për të mitur, përfshihet punonjësi i Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, psikologu, përfaqësuesi procedural, ndërmjetësi, punonjësi i shërbimit të provës, punonjësi i qendrës së rehabilitimit për të mitur dhe paraburgimit, i specializuar në drejtësinë për të mitur⁴⁸⁶.

Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, Urdhri i Psikologut/Punonjësit Social, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Shërbimi i Provës dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe institucione të tjera marrin masa dhe hartojnë programet e trajnimit⁴⁸⁷. Organet kompetente, hartojnë dhe përditësojnë regjistrin e të trajnuarve lidhur me drejtësinë penale për të mitur.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon krijimin e Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë⁴⁸⁸. Përfaqësuesi i Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është personi mbështetës në rastet me të miturin dëshmitar dhe viktimë dhe ndër të tjera, ka për detyrë:

- a) të mbështesë të miturin emocionalisht;
- b) të japë mbështetje gjatë gjithë procesit penal. Kjo ndihmë mund të përfshijë masa për minimizimin e pasojave negative të veprës penale, masa për të ndihmuar të miturin në veprimtarinë e përditshme dhe masa në raport me çështjet administrative që lidhen me rrethanat e rastit konkret;
- c) të këshillojë nëse ndjekja e një terapie ose këshillimi profesional është i nevojshëm;
- d) të ruajë komunikimin me të afërmit, shokët dhe mbrojtësin e të miturit;
- e) të informojë të miturin lidhur me shërbimet shëndetësore, psikologjike ose sociale si dhe për mënyrat e mundshme të marrjes së këtyre shërbimeve;
- f) të informojë të miturin për gjendjen e tij procedurale, rëndësinë e dhënies së dëshmisë, kohëzgjatjen, formën, si dhe për rregullat procedurale të pyetjes;
- g) të informojë të miturin për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje dhe zbatimin e veprimeve të tjera procedurale;
- h) të informojë të miturin për të drejtën për ankim ndaj veprimeve procedurale të parashikuara me ligj;
- i) në bashkëpunim me mbrojtësin ose, në mungesë të tij, në bashkëpunim me të miturin dhe përfaqësuesin ligjor, të shmangë, sipas rastit, kontaktet e papërshtatshme dhe/ose të padëshirueshme për të miturin, mbajtjen në një sallë të veçantë ndërmjet seanceve, ose të masave të tjera për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit;
- j) në bashkëpunim me mbrojtësin ose në mungesë të tij, në bashkëpunim me të miturin dhe përfaqësuesin ligjor të kërkojë nga gjykata marrjen e masave mbrojtëse, nëse këto janë të nevojshme;
- k) të kërkojë marrjen e masave të veçanta nëse rrethanat në të cilat ndodhet i mituri, këto masa janë të nevojshme.

⁴⁸⁴ Shih nenin 29 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”.

⁴⁸⁵ Shih nenin 30 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”.

⁴⁸⁶ Shih nenin 32/1 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”.

⁴⁸⁷ Shih nenin 32/2 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”.

⁴⁸⁸ Shih nenin 35 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”.

Përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, nëse është caktuar me cilësinë e përfaqësuesit procedural, në rastet e të miturve viktimë dhe dëshmitarë nën 14 vjeç, jep edhe pëlqimin për dhënien e dëshmisë nga ana e të miturit.

Me poshtë do të trajtojmë disa aspekte procedurale penale në frymën e angazhimeve të marrë përsipër me ratifikimin e konventave të mësipërme:

4.5.1 Mosaplikimi i përgjegjësisë penale ndaj viktimave të shfrytëzimit seksual, si një aspekt themelor për mbrojtjen e të drejtave të të miturit.

Trafikimi i qënieve njerëzore, është një fenomen i shoqërisë moderne⁴⁸⁹, në të cilën personi është i privuar nga liria dhe e drejta për të zgjedhur, duke u përdorur ndaj tij forma të ndryshme të shtrëngimit, dhunës, kanosje etj, me qëllim shfrytëzimi seksual apo për punë apo dhe të detyrimit për të kryer veprimtari kriminale, apo heqja e organeve apo formë tjetër shfrytëzimi.⁴⁹⁰ Vulnerabiliteti i të miturit e shndërron atë në një subjekt lehtësisht të cënueshëm nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, duke përfshirë edhe trafikimin⁴⁹¹.

Të miturit viktimë të trafikimit, shfrytëzohen për kryerjen e shumë veprave të tjera penale të tilla si, vjedhja, vjedhja e xhepave, trafikimi i drogave, kultivimi i kanabisit, mashtrimi etj., duke u shëndërruar në strategji e qëllimshme e trafikuesve që t'i ekspozojnë viktimat ndaj rrezikut për t'u ndjekur penalisht dhe t'i manipulojnë dhe shfrytëzojnë për veprimtari kriminale.

Kjo veprimtari kriminale kërkon që organet shtetërore të tregohen vigjilente, të bëjnë diferencat nëse i mituri është subjekt aktiv, apo viktimë e një krimi, duke bërë një identifikim të saktë të viktimës dhe hetim të efektshëm të kriminit të trafikimit, si dhe për të siguruar mbrojtje të efektshme të të drejtave të viktimës, përfshirë mosdënimin për ato shkelje të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin që ata janë trafikuar⁴⁹².

Kryesisht moshë e mitur e tyre përbën shkak determinues për dobësinë e të miturit në momentin e identifikimit dhe kontaktit me organet shtetërore. Ky shkak ka bërë që aktet juridike ndërkombëtare t'i garantojnë të drejta themelore si të drejtën për t'u mbrojtur nga të tjerët, për kujdes dhe arsimim. Fakti se ata janë subjekt aktiv i veprës penale, sepse plotësojnë kushtin e moshës, nuk i përjashton shtetet nga detyrimi për garantimin e të drejtave të tyre.

Mosaplikimi i përgjegjësisë penale ndaj⁴⁹³ kësaj kategorie viktimash është sanksionuar nga një serë instrumentash ndërkombëtare. Në kuadër të OSBE-së, shtetet anëtare janë angazhuar të kenë një qasje të veprimeve anti-trafikim të mbështetur në

⁴⁸⁹ Shih "Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimin të viktimave të trafikimit" Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014, fq. 9.

⁴⁹⁰ ILO, Vlerësimi Global i Punës së Detyruar (Gjenevë, 2012): Në vitin 2012, ONP vlerësoi se 20.9 milionë njerëz janë viktimë të punës së detyruar, në shkallë botërore. Ky vlerësim përfshin të gjithë sferën e trafikimit të qënieve njerëzore.

⁴⁹¹ European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The EU Strategy towards the Eradication of Trafficking in Human Beings 2012-2016.

⁴⁹² Po aty

⁴⁹³ OSCE Ministerial Council, Declaration on Trafficking in Human Beings, MC(10). JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para.6 (Këshilli Ministerial i OSBE-së, Deklarata për Trafikimin e Qënieve Njerëzore).

të drejtat e njeriut dhe me viktimat në qendër, qasje kjo që respekton në çdo kohë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit⁴⁹⁴. Mosdënimi i viktimave të trafikimit për veprat penale që kanë kryer si pasojë, ose gjatë kohës së trafikimit, është një element thelbësor i kësaj qasjeje që mbështetet te të drejtat e njeriut.⁴⁹⁵

Dënimi i viktimave do të thotë dënim për krimet e trafikuesve të tyre, për krime që, po të mos ishte për shkak të statusit të tyre si persona të trafikuar, nuk do t'i kishin kryer. Ata e kanë të kufizuar vullnetin e lirë për shkak të masës së kontrollit të ushtruar mbi ta dhe metodat e përdorura nga trafikantët, për rrjedhojë ata nuk janë përgjegjës për kryerjen e shkeljes⁴⁹⁶.

Personat e trafikuar, po të mos ishin të trafikuar (dhe në mungesë të disa faktorëve që i përjashtojnë nga përgjegjësia penale, të tillë si moshë apo gjendja mendore) normalisht do të ishin persona me zotësi për të vepruar dhe që do të përgjigjeshin penalisht për veprat penale të kryera. Megjithatë, përgjegjësia e tyre për shkelje të lidhura me trafikimin kufizohet nga fakti se liria e tyre për veprim kufizohet nga trafikantët ose trafikimi: ata detyrohen të kryejnë shkelje ndërsa janë të trafikuar apo si pasojë e të qenit i trafikuar⁴⁹⁷.

Të qenit i “detyruar” për të kryer një krim, përfshin një gamë të plotë të rrethanave faktike në të cilat viktimat e trafikimit e humbasin mundësinë për të vepruar me vullnet të lirë; jo vetëm nën kërcënimin e dhunës fizike apo abuzimit emocional, por edhe në skenarët e tmerrshëm ku trafikantët i shfrytëzojnë viktimat duke abuzuar me pozitën e tyre të të qenit të pambrojtur.

Akti juridik ndërkombëtar që rregullon trafikimin është Protokollin i Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në veçanti gratë dhe fëmijët, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Protokollin i Palermos)^{498,499,500}. Ky protokoll nuk e parashikon shprehimisht mosdënimin e viktimave. Megjithatë në nenin 2/b të tij, në të cilin thekson qëllimet e Protokollit, një nga të cilat është “të mbrojtë dhe ndihmojë viktimat e trafikimit, me respekt të plotë për të drejtat e njeriut”. Grupi i punës për çështjet e trafikimit të personave, funksioni i të cilit është “të këshillojë dhe ndihmojë

⁴⁹⁴ Shih “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimin të viktimave të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014, fq 9.

⁴⁹⁵ OSCE Ministerial Council, Decision No.1 Enhancing the OSCE’s Efforts to Combat Trafficking in Human Beings, MC(8).DEC/1 (Vienna, 28 November 2000), para. 9; OSCE Ministerial Council, Ministerial Declaration On Combating All Forms of Human Trafficking, MC.DOC/1/11/Corr.1 (Vilnius, 7 December 2011). Vendime të Këshillit Ministerial të OSBE-së.

⁴⁹⁶ Shih “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimin të viktimave të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014, fq 11

⁴⁹⁷ Shih “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimin të viktimave të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014, fq. 10.

⁴⁹⁸ Protokollin mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

⁴⁹⁹ Ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj.

⁵⁰⁰ Kombet e Bashkuara, Op. Cit.,

http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12-a&chapter=18&lang=en.

Konferencën [e palëve të UNCTOC] për zbatimin e mandatit të saj në lidhje me Protokollin e Trafikimit të Personave”, ka rekomanduar, në vitin 2009 se për të siguruar mosdënimin dhe përjashtimin nga ndjekja penale të personave të trafikuar, shtetet palë duhet:

- të përcaktojnë procedurat e duhura për identifikimin e viktimave të trafikimit të personave dhe mbështetjen ndaj këtyre viktimave;
- të konsiderojnë, në përputhje me legjislacionin vendas, të mos dënojnë apo ndjekin penalisht personat e trafikuar për vepra të paligjshme të kryera nga ata si pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së tyre si persona të trafikuar apo kur janë të detyruar të kryejnë veprime të tilla të paligjshme

501

Në vitin 2010, Grupi i Punës e ripohon këtë rekomandim dhe shkon më tej duke u kërkuar Shteteve palë të sigurojnë që: *“dispozitat për mosdënimin dhe përjashtimin nga ndjekja penale të personave të trafikuar, të shprehen qartësisht në legjislacionin vendas, udhëzuesit, rregulloret, preambulat, apo instrumente të tjera. Duke vepruar në këtë mënyrë, Shtetet palë inkurajohen të shfrytëzojnë mjete të asistencës teknike si Ligji Model i UNODC kundër Trafikimit të Personave dhe parime dhe udhëzime të tilla si Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, si dhe standarde dhe udhëzime të tjera rajonale”*⁵⁰²

Në nenin 26 të saj, Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qenieve njerëzore”, parashikon se: *“Çdo palë, në përputhje me parimet bazë të sistemit të saj ligjor, duhet të parashikojë mundësinë për të mos dënuar viktimat për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, deri në atë masë që ato kanë qenë të detyruar të veprojnë në këtë mënyrë.”*⁵⁰³ Siç vërehet kjo lejon një shkallë diskrecioni, për Shtetet palë përderisa nuk parashikon që Shtetet nuk duhet të aplikojnë dënimin. Lidhur me këtë në relacionin shpjegues që shoqëron Konventën, në paragrafin 274 shpjegohet së: *“Secila Palë mund të përmbushë detyrimin e përcaktuar te Neni 26, duke parashikuar një dispozitë ligjore kryesore penale apo procedurale penale, ose masë tjetër, e cila lejon mundësinë për mosdënim të viktimave kur përmbushen kërkesat ligjore”*⁵⁰⁴.

Parimi i mosdënimimit është afirmuar edhe në akte të tjera ndërkombëtare. Kështu, në nenin 31/1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Statusin e Refugjatëve, parashikohet se: *“shtetet pale nuk do të vendosin masa ndëshkimore, në lidhje me hyrjen apo prezencën e paligjshme, ndaj refugjatëve të cilët duke ardhur drejtpërdrejt nga një territor ku jeta ose liria e tyre kërcënohen (në disa mënyra të caktuara), hyjnë apo janë prezent në territorin e tyre pa autorizim, me kusht që të*

⁵⁰¹ Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 14 dhe 15 prill 2009, CTOC/COP/WG.4/2009/2 (21 prill 2009).

⁵⁰² Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 27-29 janar 2010, CTOC/COP/WG.4/2010/6 (17 shkurt 2010), http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/CTOC_COP_WG4_2010_final_report_E.pdf.

⁵⁰³ Shih Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qenieve njerëzore”, 16 maj 2005 e ratifikuar me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006.

⁵⁰⁴ Shih “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimimit të viktimave të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014, fq. 10.

*paraqiten pa vonesë pranë autoriteteve dhe të tregojnë shkaqe të mira për hyrjen ose prezencën e tyre”.*⁵⁰⁵

Parimi i mosdënimit dhe përjashtimit nga ndjekja penale të personave të trafikuar njihet në disa instrumente ligjore jo të detyrueshme të miratuara. Këto instrumente theksojnë se të drejtat e viktimave të trafikimit, duhet të jenë në qendër të përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin. Parimi i 7-të, i parimeve dhe Udhëzimeve të Rekomanduara për Të drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore⁵⁰⁶ miratuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, përcakton se: *“Personat e trafikuar nuk duhet të ndalohen, akuzohen apo procedohen penalisht për hyrjen apo qëndrimin e paligjshëm në vendet e tranzitit ose destinacionit ose për përfshirjen e tyre në veprimtari të paligjshme në atë masë që përfshirja e tyre është pasojë e drejtpërdrejtë e gjendjes së tyre si persona të trafikuar.”*⁵⁰⁷

Parimi i mosaplikimit të përgjegjësisë penale, është njohur dhe pranuar në rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara,⁵⁰⁸ Deklarata e Brukselit për parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore⁵⁰⁹ dhe Deklarata e Majamit për Parimet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore⁵¹⁰.

Detyrimi për të mos dënuar, mbështetur në të drejtën ndërkombëtare, duhet të zbatohet nga shtetet në praktikën e tyre vendase. Të gjitha shtetet janë të detyruara të sigurojnë që legjislacioni vendas të jetë të përputhje me detyrimet ndërkombëtare, pavarësisht nga kërkesat apo kompleksiteti i sistemeve të tyre ligjore. Konventa e Vjenës e vitit 1969 për Ligjet e Traktateve të Neni 27 parashikon se: “Palët nuk mund

⁵⁰⁵ Kombet e Bashkuara, Konventa për Statusin e Refugjatëve, 189 UNTS 150 (Gjenevë, 28 korrik 1951).

⁵⁰⁶ UN Office of the High Commissioner for Human Rights, Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve njerëzore, E/2002/68/Add.1 (2002), vizituar më 31 janar 2013.

⁵⁰⁷ Shih “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014, fq. 11.

⁵⁰⁸ United Nations, Resolution on Traffic in women and girls / adopted by the General Assembly, A/RES/55/67 (31 January 2001), para. 6; also United Nations, Resolution Global Plan of Action to Combat Trafficking in Persons: resolution / adopted by the General Assembly, A/RES/64/293 (12 August 2010) -Rezoluta të Kombeve të Bashkuara: u kërkon Shteteve të “Sigurojnë që viktimat e trafikimit të personave të trajtohen si viktimat të krimit dhe që legjislacioni kombëtar të kriminalizojë me efektshmëri të gjitha trajtat e trafikimit” dhe inkurajon “qeveritë të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që viktimat e identifikuar të trafikimit të personave të mos dënohen për të qenit të trafikuar dhe që ato të mos vuajnë nga viktimizimi si rrjedhojë e veprimeve të ndërmarra nga autoritetet qeveritare”.

⁵⁰⁹ European Union (EU), Brussels Declaration on Preventing and Combating Trafficking in Human Beings, 14981/02 (29 November 2002), parag. 7, (Bashkimi Evropian (BE), Deklarata e Brukselit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore), vizituar më 10 prill 2013: “Viktimat e trafikuar duhet të njihen si viktimat të krimeve të rënda. Prandaj, ato nuk duhet të riviktimizohen, stigmatizohen më tej, procedohen penalisht apo të mbahen në qendra (para)burgimi për shkelje që mund të jenë kryer nga viktimat si pjesë e procesit të trafikimit”.

⁵¹⁰ The Miami Declaration of Principles on Human Trafficking (10 February 2005), para. 28 (Deklarata e Majamit për Parimet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore): “Personi i trafikuar duhet të njihet si viktimë e krimit të trafikimit. Shtetet nuk duhet ta kriminalizojnë statusin e personit të trafikuar dhe nuk duhet ta ndëshkojnë viktimën për akte të paligjshme të tilla si imigrimi i paligjshëm apo prostitucioni, të ndodhura ose të lidhura me aktin e trafikimit”.

të nxjerrin dispozitat e ligjit të brendshëm si justifikim për mos zbatimin e një traktati”⁵¹¹.

Parimi i mosdënimit, përveçse u kërkon shteteve të mos ndërmarrin akte të caktuara ndaj personave të trafikuar, u vendos atyre edhe disa detyrime pozitive. Në rastin e Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në lidhje me Nenin 4 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar), përcaktoi detyrimin e Shteteve, se respektimi i të drejtave të njeriut përfshin edhe pasjen e një legjislacioni të përshtatshëm për të garantuar mbrojtjen praktike dhe efikase të të drejtave të viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit”⁵¹².

Ky theks mbi mbrojtjen e të drejtave të viktimave tregon në realitet që detyrimi përfshin edhe garantimin që këta persona të mos dënohen për vepra penale të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin që ata kanë qenë të trafikuar⁵¹³.

Për më tepër, në të gjitha procedimet ku përfshihen fëmijë, duhet zbatuar parimi i emergjencës për të siguruar një reagim të shpejtë dhe për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijës, duke respektuar njëkohësisht shtetin e së drejtës.⁵¹⁴

4.5.2 Të drejtat e viktimës së mitur në kuadër të procedimit penal

4.5.2.1 E drejta për informim i të miturit

Standardi i gëzimit të të drejtave nga ana e të miturit-viktimë është i kondicionuar nga dijenia që ka ai për to. Në rastet e trafikimit të të miturit, shfrytëzimit seksual, ose abuzimit seksual, niveli i tyre i pjekurisë dhe aftësisë për të kuptuar, niveli i ulët i arsimimit i shumë viktimave⁵¹⁵ e bën edhe më të rëndësishme faktin që autoritetet në mënyrë aktive t’ua shpjegojnë viktimave të drejtat e tyre.

Informimi i të miturit-viktimë është një aspekt procedural shumë i rëndësishëm në trajtimin e tyre, i cili është afirmuar në akte juridike ndërkombetare⁵¹⁶. Kështu, Protokollin “Mbi parandalimin, pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”⁵¹⁷ parashikon⁵¹⁸ se shtetet palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ, ose administrativ të përmbajë masa të tilla, që u sigurojnë viktimave të trafikimit në rastet e duhura

⁵¹¹Shih nenin 27 të Konventës së Vjenës për Ligjin e Traktateve (1969), Seritë e Traktateve, vol.1155, p.331.

⁵¹² Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë, kërkesa nr. 25965/04 (Strasburg, 7 janar 2010), vizituar më 31 janar 2013, paragrafi 284.

⁵¹³ Shih “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014, fq. 11.

⁵¹⁴ Council of Europe, Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice (17 November 2010).

⁵¹⁵ Bëhet fjalë për të miturit të moshës 14-18 vjeç.

⁵¹⁶ Shih Raportin Titullin “Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar, në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Analizë e legjislacionit dhe praktikës shqiptare mbi trafikimin e qenieve njerëzore, duke përfshirë asistencën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe monitorimin e gjykatave”. Tiranë, 2009 fq. 28.

⁵¹⁷ Ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve të saj”.

⁵¹⁸ Neni 6, pika 2, të këtij Protokollin.

informacionin e duhur për proceset gjyqësore dhe ato administrative, si dhe mbështesin viktimën në shprehjen e shqetësimeve të tyre gjatë procedurave penale.⁵¹⁹

Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qënieve njerëzore”⁵²⁰ thekson se shtetet palë duhet të marrin masa për të ofruar ndihmë për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore, e cila do të konsistojë në këshillim dhe informacion, në veçanti në lidhje me të drejtat e tyre dhe me shërbimet në dispozicion të tyre, në një gjuhë që është e kuptueshme prej tyre. Gjithashtu, kjo konventë⁵²¹ detyron shtetet palë të sigurojnë që viktimat të kenë akses në informacion në lidhje me procedurat përkatëse gjyqësore dhe administrative, që nga kontakti i parë i tyre me autoritetet kompetente, në një gjuhë që ato mund ta kuptojnë.

Informimi i viktimave për proceset penale dhe ecurinë e tyre, shprehja e shqetësimeve dhe mendimeve prej tyre në çdo fazë të procesit përbëjnë parime bazë të Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë.

Konventa Europiane “Për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme”⁵²² parashikon⁵²³ se çdo shtet palë duhet të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për të siguruar që informacioni mbi skemën t’u jepet kërkuesve të mundshëm⁵²⁴.

Aktet e mësipërme kanë karakter të përgjithshëm. Ato nuk parashikojnë subjektet që kanë detyrimin për të realizuar informimin e të miturit. Lidhur me këtë aspekt, pavarësisht mungesës së aplikimit në vendin tonë, sjellin një kontribut të rëndësishëm interpretimi krahasues, aktet që veprojnë në Bashkimin Europian dhe parashikimet që ofrojnë ato. Kështu, neni 4 i Vendimit Kuadër të BE-së “Për Paraqitjen e Viktimave në Proceset Penale” kërkon që të ofrohet informacion për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore nga organizatat që ofrojnë mbështetje për to, duke i orientuar të denoncojnë veprën penale, procedurat që duhet të ndjekin, t’u ofrohet këshillim dhe/ose ndihmë ligjore, të informohen në lidhje me të drejtën për kompensim, si edhe të marrin informacion për vendimin e gjykatës⁵²⁵.

Në Rekomandimin nr.8 të vitit 2006 të Këshillit të Europës rekomandohet sigurimi i aksesit në informacion për viktimat, i cili do të konsistojë në informacion mbi shërbimet, procedurat ligjore dhe rolin e viktimës në këto procedura, informacion mbi të drejtën e viktimave për të qenë të mbrojtura dhe për të marrë kompensim nga autori i veprës penale ose nga shteti, ofrimin e këshillimit dhe asistencës ligjore.

Rekomandimi (85) 11 i Këshillit të Europës, rekomandon autoritetet që t’i japin informacionin përkatës viktimës. Ai parashikon ndër të tjera, që policia dhe

⁵¹⁹ Për më tepër, Deklarata e parimeve themelore të të drejtave të viktimës parasheh që “viktimat duhet informuar për shërbimet mjekësore dhe sociale në dispozicion si dhe për format e tjera relevante të ndihmës dhe në mënyrë të lehtë t’u sigurohet qasja në ato shërbime” (Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit e miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 40/34 të datës 29 nëntor 1985, par. 15).

⁵²⁰ Shih nenin 12/1/d të Konventës të Këshillit të Evropës “Për masat kundër Trafikimit të qënieve njerëzore”, 16 maj 2005 e ratifikuar me ligjin nr 9642 datë 20.11.2006.

⁵²¹ Shih nenin 15.1 të saj.

⁵²² Ratifikuar me ligjin nr 9265 datë 29.07.2004 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane “Për Kompensimin e Vikimave të Krimeve të Dhunshme”.

⁵²³ Shih nenin 11 të saj.

⁵²⁴ Në kudër të Bashkimit Europian.

⁵²⁵ Shih Raport Titull “Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar, në luftë kundër trafikimit të qënieve njerëzore me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore. Analizë e legjislacionit dhe praktikës shqiptare mbi trafikimin e qënieve njerëzore, duke përfshirë asistencën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore dhe monitorimin e gjykatave”. Tiranë, 2009, fq. 29.

gjykatat duhet të informojnë viktimat mbi mundësitë e marrjes së asistencës, këshillimit ligjor dhe praktik si dhe kompensimit.

Përmbushja e të drejtës së viktimës për t'u informuar është e lidhur ngushtë me të drejtën për kompensim dhe ushtrimin e të drejtave të tjera. Vetëm nëse viktimat i njej të drejtat dhe mundësitë e tij/saj brenda sistemit ligjor, ai/ajo mund t'i ushtrorë këto të drejta dhe mundësi.

Viktimat e trafikimit, shtrytëzimit, ose abuzimit kanë pak informacion mbi mënyrën sesi funksionon sistemi i drejtësisë penale dhe kjo i kufizon ato që të përdorin të drejtat e tyre brenda këtij sistemi.

Një qasje të rëndësishme lidhur me këtë të drejtë të viktimës sjell Direktiva nr.29, datë 25.10.2012 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian, e cila në nenin 3 të saj parashikon se duhet të sigurohet që viktimat, bazuar në karakteristika personale si gjinia, mosha, matura, marrëdhënia apo varësia nga autori i veprës penale, të kuptojnë dhe të kuptohen gjatë procedimit penal dhe autoritetet në mënyrë proaktive të asistojnë viktimat për këtë qëllim. Viktimat kanë të drejtë të kërkojnë praninë e një personi tjetër të zgjedhur prej tyre në kontaktin e parë me autoritetet, në rast se kanë nevojë për asistencë për shkak të impaktit të krimit apo kur kanë vështirësi për të kuptuar procedurën⁵²⁶.

Pra, organi procedues duhet të japë informacion kryesisht dhe jo të presë një kërkesë të viktimës për të japur informacion.

Viktimës duhet t'i garantohet akses efektiv në informacion. Kontakti i parë është kur viktimat kallëzojnë veprën penale, njofton nëpërmjet telefonit apo ndodhet në vendin e ngjarjes. Informacioni jepet në mënyra të ndryshme, me gojë, me shkrim, zakonisht duke shpërndarë njoftime e broshura dhe duke krijuar një sistem në të cilin ka një detyrim për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët që të informojnë viktimën për të drejtat e tij. Informacioni duhet të jepet pa vonesë dhe referuar jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, nënkupton kriter si "afat i arsyeshëm", "pa vonesë të pajustificuar" etj. Oficeri i policisë duhet të sigurohet që viktimat të informohen për shërbimet e mbështetjes së viktimave dhe i kërkon atyre nëse dëshirojnë të kontaktohen nga këto shërbime.

Pa këtë informacion, viktimat nuk kanë akses në këto shërbime që shpesh janë decizive për aftësinë e viktimave për të bashkëpunuar. Gjithashtu, kjo e drejtë nënkupton edhe informimin e viktimës për rolin e tij në çdo fazë të procedimit penal. Policia, prokuroria dhe gjykatat duhet të informojnë në mënyrë të vazhdueshme viktimën përgjatë procedimit kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, në mënyrë që viktimat të kuptojnë të drejtat dhe procesin.

Në nenin 6 të kësaj Direktive⁵²⁷ theksohet se të gjitha viktimat të kenë të drejtë të marrin informacion në lidhje me:

- a) Vendimin për përfundimin e procedimit penal dhe arsyet e këtij vendimi;
- b) Kohën dhe vendin e zhvillimit të procesit gjyqësor si dhe llojin e akuzave sipas kërkesës;
- c) vendimin përfundimtar të gjykatës (dhe arsyet e këtij vendimi);
- d) informacion mbi gjendjen e procedimit penal (paragrafi 2). Informacioni në lidhje me gjendjen e procedimit (paragrafi 2 (b)) përfshin të gjitha të dhënat e përditësuara të rëndësishme të çështjes.

⁵²⁶ Shih nenin 3/3 të Direktivës nr.29, datë 25.10.2012 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian.

⁵²⁷ Shih nenin 6 të Direktivës nr.29, datë 25.10.2012 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian.

Informacioni mund të komunikohet në mënyrë të personalizuar dhe nëpërmjet mjeteve të ndryshme (verbalisht ose me shkrim, duke përfshirë mjetet elektronike).

Kjo e drejtë nuk ishte parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale, duke mos u reflektuar ky aspekt i rëndësishëm i akteve ndërkombëtare, të cilat i kanë vënë një theks prevalent. Megjithatë, në ligjin nr.35/2017 dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar është pasqyruar një reflektim i tillë duke parashikuar të drejtën e viktimës të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa çënuar parimin e sekretit hetimor, si dhe të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues; e të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij⁵²⁸.

Ndërsa i Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i ka kushtuar një vend të veçantë të drejtës të të miturit viktimë për t’u informuar, duke përcaktuar në mënyrë të hollësishme edhe aspektet për të cilat duhet të informohet. Kështu, organi kompetent informon menjëherë dhe gjatë gjithë procesit të miturin viktimë, përfaqësuesin e tij ligjor ose procedural dhe mbrojtësin lidhur me⁵²⁹:

- a) procedurat e drejtësisë penale për të rritur e për të mitur, përfshirë rëndësinë dhe rolin e të miturit viktimë, kohën e dëshmisë, si dhe mënyrat në të cilat do të kryhet marrja në pyetje gjatë hetimit dhe gjykimit;
- b) mekanizmat mbështetëse për të miturin viktimë për bërjen e ankesës, marrjen pjesë në hetimet dhe procedurat gjyqësore, përfshirë vënien në dispozicion të mbrojtësit të të miturit;
- c) vendin dhe kohën e marrjes në pyetje;
- d) masat mbrojtëse në dispozicion të të miturit;
- e) mjetet ligjore ekzistuese për rishikimin e vendimeve që sjellin pasoja për të miturin viktimë;
- f) të drejtat e të miturit viktimë të zbatueshme në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;
- g) mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim nga autori i veprës penale, sipas legjislacionit përkatës;
- h) programet e drejtësisë restauruese në dispozicion dhe funksionimin e tyre;
- i) mundësinë e shërbimeve përkatëse, të tilla si ato shëndetësore, psikologjike, sociale, financiare dhe ligjore, si dhe mënyrat e përfitimit të tyre.

Nëse informimi nuk i është bërë drejtpërdrejtë të miturit nga organi kompetent, ky detyrim përmbushet, sipas rastit, nga përfaqësuesit ligjor, përfaqësuesi procedural ose mbrojtësi i të miturit. Njoftimi i të miturit bëhet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për të⁵³⁰. Në çdo fazë të procesit, përfaqësuesi ligjor i një dëshmitari/viktimit të mitur ka të drejtë⁵³¹:

- a) të shprehë opinionin e tij lidhur me nevojat e të miturit përpara organit procedural;
- b) të informohet në lidhje me akuzat e ngritura ndaj të pandehurit;
- c) të informohet në lidhje me marrëdhëniet mes të miturit dhe të pandehurit;
- d) të informohet lidhur me ecurinë e procesit dhe vendimet lidhur me masën e sigurisë që është vendosur ndaj të pandehurit, si dhe lidhur me lirimin e të pandehurit ose të dënuarit nga mjediset e burgimit ose të paraburgimit, me

⁵²⁸ Shih nenin 40/d/dh të ligjit nr. 35/2017, dt.30/03/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905 , datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” , të ndryshuar.

⁵²⁹ Shih nenin 34 të ligjit nr. 37/2017 “Kodin e drejtësisë penale për të mitur”.

⁵³⁰ Shih nenin 34/3 të ligjit nr. 37/2017 “Kodin e drejtësisë penale për të mitur”.

⁵³¹ Shih nenin 34/4 të ligjit nr. 37/2017 “Kodin e drejtësisë penale për të mitur”.

- përrashtim të rastit kur kjo vë përpara një rreziku real të pandehurin ose të dënuarin;
- e) të bëjë ankim në lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata, pavarësisht nëse kjo e drejtë ushtrohet ose jo nga prokurori i çështjes.

4.5.2.2. E drejta për interpretim, sqarim dhe përkthim.

Aktet juridike ndërkombëtare kanë afirmuar si një nga të drejtat me të rëndësishme të viktimës, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë të miturit viktimë, në procesin penal, të drejtës për interpretim, sqarim dhe përkthim, e cila kondicionon aksesin ose pjesëmarrjen efektive të viktimës në procesin penal. Një nga aktet, që parashikon në mënyrë eksplicite një kondicionim të tillë, është vendimi Kuadër i Këshillit të BE.⁵³²

Kjo kërkesë nuk duhet kuptuar si efektivitet në heqjen e vështirësive në komunikim, sepse kjo nuk lidhet vetëm me kuptimin e gjuhës, në të cilën zhvillohet procesi, por lidhet me kuptimin e aspekteve të procedurës.

Parashikimi i vendimit të lartpërmendur detyron shtetet anëtare që t'u sigurojnë viktimave një rol efektiv në proces dhe në rastin që nuk njihin gjuhën e procesit t'ju sigurohet, sipas kërkesës, përkthim dhe interpretim falas pa pagesë, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në deklaratimet dhe marrjet në pyetje, procedurat përpara autoriteteve hetimore dhe gjyqësore dhe pjesëmarrjen në seancat gjyqësore dhe seancat e përkohshme⁵³³.

Zhvillimet teknologjike të tilla si videokonferenca, telefoni ose interneti mund të përdoren, përveçse kur prezenca e përkthyesit kërkohet në mënyrë që viktimat të ushtrojnë në mënyrë të përshtatshme të drejtat e saj, ose çënohen të drejtat e mbrojtjes⁵³⁴.

Gjithashtu, shtetet anëtare duhet t'u sigurojnë viktimave një rol protagonist në proceset penale dhe në rastet kur nuk e kuptojnë ose flasin gjuhën. Atyre duhet t'u sigurohet, sipas kërkesës, pa pagesë përkthimi i informacionit, i cili është i domosdoshëm për të ushtruar të drejtat e tyre⁵³⁵.

Në Kodin tonë të Procedurës Penale, nuk ka qënë parashikuar në mënyrë eksplicite e drejta e viktimës për interpretim, sqarim, apo përkthim. Kështu, në nenin 123 të tij theksohet se: *“I pandehuri që nuk njeh gjuhën shqipe ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes për të kuptuar akuzën dhe për të ndjekur veprimet ku merr pjesë. Nëpërmjet përkthyesit ai është i detyruar të bëjë një deklaratë me shkrim që nuk e njeh gjuhën shqipe. 2. Autoriteti procedues cakton, gjithashtu, një përkthyes kur duhet të përkthehet një shkrim në gjuhë të huaj. 3. Përkthyesi caktohet edhe kur gjykata, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore e njohin gjuhën që duhet të përkthehet.”*⁵³⁶

Legjislacioni procedural penal duhet të pasqyrojë qasje të tilla. Kjo edhe në zbatim të angazhimeve ndërkombëtare. Konventa Lanzarote përcakton se: *“Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për*

⁵³² Shih nenin 5 të Vendimit Kuadër të Këshillit 15.03.2001/220/JHA “Për pozitën e viktimave në procedimet penale”.

⁵³³ Shih paragrafin 34 të Udhërrëfyesit

⁵³⁴ Shih paragrafin 2 të Udhërrëfyesit

⁵³⁵ Shih paragrafin 3 të Udhërrëfyesit

⁵³⁶ Shih nenin 123 të Kodit të Procedurës Penale

të siguruar hetimet dhe procedimet penale kryhen me interesat më të mira dhe respektimin e të drejtave të fëmijës...⁵³⁷.

Me ndryshimet e miratuara në Kodin e Procedurës Penale me ligjin 35/2017, në nenin 123 të tij është parashikuar tashmë që dispozitat për caktimin e përkthyesit për të pandehurin zbatohen edhe për viktimën. Pra, parashikimi i kësaj të drejtë në Kodin e Procedurës Penale është në përputhje të interesave më të mira të fëmijëve, si dhe një aspekt i rëndësishëm i së drejtës së informimit.

4.5.2.3 Të drejtat e viktimës në rastin e vendimit për të mos proceduar.

Të gjitha të drejtat e viktimës të sipërpërmendura do të ishin të cunguara nëse viktimës nuk i njihet e drejta për të ankuar vendimin e organit procedues, lidhur me hetimin e veprës penale, subjekt pasiv i së cilës është. Lidhur me këtë aspekt Direktiva nr.29, datë 25.10.2012 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian vë theksin tek parashikimi në legjislacionin procedural penal të një modaliteti, nëpërmjet të cilit viktimës t'i jepej mundësia të shprehte qëndrimin e saj lidhur me vendimin e organit procedues për të mos proceduar⁵³⁸. Kjo procedurë duhet të jetë transparente dhe e qartë dhe të sigurojë që viktima të kërkojë rishikimin pa përfaqësim ligjor dhe pa u penguar nga burimet financiare të kufizuara. Procedura konkrete dhe mekanizmi i rishikimit apo ankimit të vendimit për të mos proceduar është në diskrecionin e shteteve dhe përcaktohet nga ligji i brendshëm.

Vendimi për të mos proceduar përfshin rastin kur prokurori tërheq akuzën ose vendos pushimin e procedimit penal dhe nuk përfshin rastin kur vendimi merret nga gjykata. Ka dy përjashtime nga ky rregull: a) vendimi është rezultat i një marrëveshjeje jashtëgjyqësore, që përcakton një detyrim, dhe b) procedura specifike si ato ndaj anëtarëve të parlamentit apo qeverisë që kanë vepruar gjatë ushtrimit të detyrës. Rishikimi i vendimit duhet të bëhet nga një person ose autoritet tjetër nga ai që ka marrë vendimin për të mos proceduar. Konsiderohet si në përputhje me direktivën ankimi në të njëjtin organ, nëse ankimi shqyrtohet nga një person tjetër i këtij organi. Viktimat duhet të njoftohen për të drejtën për të marrë këtë informacion dhe duhet ta marrin atë pas parashtrimit së kërkesës.

Në Kodin tonë të Procedurës Penale, vendimi për të mos proceduar i korrespondon vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe vendimit për pushimin e akuzës apo çështjes penale të parashikuara nga nenet 290-291 dhe 328-329 të Kodit të Procedurës Penale⁵³⁹. Në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“Vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim, ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit”*. Siç vihet re, në këtë dispozite nuk është parashikuar në mënyrë eksplcitë e drejta e viktimës, të dëmtuarit për t'u njoftuar për vendimin për mosfillimin e procedimit penal, në rastin kur ky nuk ka bërë kallëzim ose ankim.⁵⁴⁰

⁵³⁷ Shih nenin 30 të Konvetës Lanzarotë ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.

⁵³⁸ Shih nenin 11 të Direktivës nr 29 datë 25.10.2012 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian.

⁵³⁹ Shih nenet 290, 291, 328, 329 të Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁴⁰ Sipas vendimit nr.2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Në morinë e personave që kallëzojnë veprat penale mund të përfshihen edhe persona juridikë, të cilët kanë jo vetëm detyrimin për të paraqitur kallëzim, por edhe që mund të jenë të dëmtuar nga vepra penale. Në të tilla rrethana, këta persona kanë të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit (neni*

Madje edhe nga praktika gjyqësore, në veçanti përmendim vendimin unifikues nr.2 datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rezulton se të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe rrjedhimisht edhe të drejtën e informimit e ka a) i dëmtuari akuzues, b) i dëmtuari ankues për veprat penale të parashikuara nga neni 284 i Kodit të Procedurës Penale dhe c) i dëmtuari që është njëkohësisht kallëzues. Pra, në bazë të vendimit unifikues nuk ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit, i dëmtuari nga vepra penale që nuk ka bërë kallëzim për veprat penale të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërkohë, i dëmtuari akuzues ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit vetëm kur pretendon se nuk jemi para veprës penale të parashikuar nga neni 59 (për të cilën duhet të paraqesë kërkesë në gjykatë për të kërkuar procedimin e të akuzuarit) por jemi para një veprë penale që ndiqet dhe përfaqësohet në gjyq nga prokurori. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues duke qartësuar pozitën e të dëmtuarit, arrijnë në konkluzionin se: *“sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale prokurori duhet t’i njoftojë vendimin e mosfillimit të procedimit penal, duke i dhënë mundësinë për t’u ankuar kundër këtij vendimi, kallëzuesit të veprës penale, i cili mund të jetë, rast pas rasti, edhe i dëmtuari nga vepra penale, si edhe ankuesit, kur ka të tillë, në kuptim të nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale”*. Ky konkluzion nuk është në përputhje me standardet minimale të përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Europian për të drejtat e viktimës në procesin penal lidhur me faktin se kur viktimja legjitimohet si palë paditëse në procesin penal vetëm pas procedimit të të pandehurit, duhet të sigurohet nga shtetet që të paktën viktimja e krimeve të rënda të ketë të drejtën e rishikimit/ankimit të vendimit për të mos proceduar⁵⁴¹.

Ndërsa, përse i përket vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, Kodi i Procedurës Penale në nenin 329/1 bën një parashikim tjetër duke përcaktuar se kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.2 datë 20.06.2013 kanë arritur në konkluzionin njëses se: *“...të drejtën për të paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes penale, e ka vetëm personi i dëmtuar nga vepra penale, subjekt ky që mund të jetë njëherazi edhe kallëzues, por kallëzuesit që nuk janë të dëmtuar nga vepra penale nuk legjitimohen nga ligji procedural penal të ushtrojnë të drejtën e ankimit sipas nenit 329 të K.Pr.Penale...”*⁵⁴².

Pra, të drejtën e ankimit ndaj vendimit të pushimit të akuzës apo çështjes nuk e ka vetëm i dëmtuari që ka bërë kallëzim apo për veprat penale të parashikuara nga neni 59 dhe 284, por i dëmtuari nga vepra penale për të gjitha veprat penale edhe kur nuk ka bërë kallëzim. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme të jepet përkufizimi i termit “të dëmtuar” pasi lidhet drejtpërdrejtë me detyrimin e prokurorit

291 K.Pr.Penale). Në bazë të nenit 291 të K.Pr.Penale, të legjitimuar për të paraqitur ankim janë vetëm kallëzuesi ose i dëmtuari ankues, sipas përcaktimeve të parashikuara prej nenit 284 të K.Pr.Penale. Po ashtu, në vendimin unifikues lidhur me të drejtën e ankimit dhe rrjedhimisht të informimit të vendimit për mosfillimin e procedimit penal theksohet se: *“Të drejtën e ankimit dhe për rrjedhojë, edhe legjitimimin për të ankimit vendimin e mosfillimit, Kodi i Procedurës Penale ia njuh, përveç subjektit të “dëmtuar akuzues”, që në bazë të nenit 58 të K.Pr.Penale, si pasojë e veprës penale ka të drejtë që të paraqesë kërkesë për fillimin e procedimit penal dhe të ngrejë akuzë drejtpërsëdrejti në gjykatë, edhe atyre subjekteve të dëmtuara pa ankimin e të cilëve nuk mund të fillojë procedimi penal, e kur ka filluar nuk mund të vazhdojë, në bazë të nenit 284 të K.Pr.Penale.”*

⁵⁴¹ Shih vendimin nr.2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁵⁴² Po aty

për t'i njoftuar vendimin dhe të drejtën e ankimit në gjykatë dhe pastaj të drejtën e thirrjes dhe pjesëmarrjes në gjykim, duke qënë se *mosnjoftimi për të marrë pjesë në gjykim, i këtyre subjekteve sipas rregullave të K.Pr.Penale mbi njoftimet, përbën një proces të parregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe shkelje të rëndë procedurale sipas nenit 428, pika "ç" të K.Pr.Penale.*

Direktiva nr.29, datë 25.10.2012 e Parlamentit European dhe Këshillit të Bashkimit European nuk përfshin në të drejtën e viktimës, në rastin e vendimit për të mos proceduar, ankimin ndaj vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes.

Sipas Kodit tone, të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes e ka vetëm i dëmtuari që është palë në procesin penal për shkak të legjitimitetit si paditës civil në këtë proces. Ky parashikim është në përputhje me Direktivën, për arsye se neni 11 është i kufizuar vetëm për viktimat që kanë një rol formal në sistemin gjyqësor penal.

Konventa Lanzarote lidhur me vazhdimin e procedimit edhe pas tërheqjes së ankimit nga viktimat thekson se: *"Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera, për të siguruar që hetimet ose procedimet e veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë nuk do të varen nga raportet ose akuza e bërë nga viktimat dhe që procedimet mund të vazhdojnë edhe në qoftë se viktimat i ka tërhequr deklaratat e tij ose të saj"*⁵⁴³. Ndërsa ligji nr.104/2012 për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", në nenin 55/1 nënvizon se: *"Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente nuk do të jenë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktimat e tërheq deklaratën ose ankesën e tij ose të saj."*

Në kundërshtim me Konventën, veprat penale të parashikuara në nenet 89, 102/1⁵⁴⁴, 105⁵⁴⁵ dhe 130⁵⁴⁶ të Kodit Penal (që gjejnë shprehimisht parashikim në nenet 35, 36 dhe 37 të Konventës) përfshihen në veprat që ndiqen me ankim sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale dhe për të cilat procedimi nuk mund të vazhdojë nëse viktimat e tërheq ankesën e tij. Nga ana tjetër, ngacmimi seksual (neni 40) që nuk përfshihet në nenin 55 të Konventës për detyrimin e ndjekjes penale ex officio, nuk përfshihet në veprat që ndiqen me ankim sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Një garanci e tillë për fillimin dhe vazhdimin e procedimit penal pavarësisht nga akuza e bërë nga viktimat apo tërheqja e ankimit parashikohet edhe në Konventën e Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore" dhe Konventën e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual", të ratifikuar, por në këtë rast nuk vërehet pajtueshmëri me dispozitat e K.Pr.Penale.

Ndërkohë me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr.35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe që hyn në fuqi në datë 1 gusht 2017, legjitimohet e drejta e ankimit të viktimës ose trashëgimtarëve të saj ndaj vendimit të mosfillimit ose pushimit të çështjes⁵⁴⁷, duke garantuar në këtë

⁵⁴³Shih nenin 32 të Konventës Lanzarote.

⁵⁴⁴"Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve.

⁵⁴⁵Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.

⁵⁴⁶Shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë".

⁵⁴⁷Neni 152, 183, 184 i ligjit nr.35/2017.

mënyrë një të drejtë thelbësore për viktimën, veçanërisht kur kemi të bëjmë me të mitur-viktimë.

4.5.2.4 E drejta për siguri dhe mbrojtje e të miturit viktimë

Identifikimi dhe referimi i viktimave do të humbiste rëndësinë e tij, nëse viktimës nuk do t'i garantohej sigurimi dhe mbrojtja, e cila duhet të jetë e pakushtëzuar nga pëlqimi i tyre për të bashkëpunuar me organet e zbatimit të ligjit. Kjo ndihmë duhet të konsiderohet nga ana e organeve zbatuese të ligjit më shumë si një e drejtë se sa një detyrim për të miturin viktimë, pavarësisht se fakti nëse është kryer ose jo një veper penale do të përcaktohet nga gjykata. Procedurat e hetimeve penale mund të zgjasin me vite, megjithatë viktimat kanë nevojë për ndihmë të menjëherëshme, ku në shumicën e rasteve ato janë në gjendje të keqe fizike dhe psikologjike.

E drejta për sigurinë e viktimës është afirmuar nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare në këtë drejtim, si Protokollin “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të Organizuar Ndërkombëtar”⁵⁴⁸, i cili thekson se: “*Shtetet Pale duhet të përpiqen që të garantojnë sigurinë fizike të viktimave të trafikut nëse ato janë brenda territoreve të tyre*”.

Gjithashtu, Konventa Evropiane “Për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”⁵⁴⁹ i detyron shtetet palë që të garantojnë të drejtën e viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore për siguri dhe mbrojtje. Mungesa e këtyre garancive do të sillte dekurajimin e tyre në kërkimin e të drejtave që u takojnë, duke përfshirë të drejtën për kompensim dhe për pasojë rezulton në mos gëzimin e të drejtave nga viktimat. Protokollin i Trafikimit të Kombeve të Bashkuara, Neni 6(3)(a)-(d) dhe Konventa Evropiane për Masa kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, Neni 12, kërkojnë nga shtetet palë garantimin e kësaj të drejte.

Kjo e drejtë e viktimave është trajtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të drejtës së jetës dhe së drejtës për liri dhe siguri, duke specifikuar se jeta, liria dhe siguria e dëshmitarëve, nuk duhet vënë në rrezik në mënyrë që nuk arsyetohet.⁵⁵⁰

Kështu që, autoritetet publike kanë për detyrë t'i mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmit e tyre të ngushtë ndaj ndërhyrjeve, kërcënimeve dhe rrezikut, para, gjatë dhe pas gjykimit.⁵⁵¹ Mbrojtja efektive e dëshmitarëve është vendimtare që një sistem ligjor të funksionojë siç duhet. Kjo ka rëndësi të veçantë në rastet e trafikimit, ku të pandehurit mund të jenë pjesëtarë të krimit të organizuar dhe viktima mundet që në të

⁵⁴⁸ Shih nenin 6/5 të Protokollin “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të Organizuar Ndërkombëtar”⁵⁴⁸, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

⁵⁴⁹ Shih nenin 30/b të Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve”, ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.

⁵⁵⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Van Mechelen e të tjerë v. Holanda, 21363/93, 21364/93, 21427/93, e datës 23 prill 1997, par. 53. Gjithashtu shih Doorson v.Holanda, 20524/92, e datës 26 mars 1996, par. 70 dhe P.S. v. Gjermania, 33900/96, e datës 20 dhjetor 2001, par. 22.

⁵⁵¹ “Duke respektuar të drejtat e mbrojtjes, mbrojtja e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe personave të afërt me ta duhet organizuar, kudo që është e nevojshme, para, gjatë dhe pas gjykimit.” Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, Rekomandimi (2005)9 mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, e datës 20 prill 2005, neni II(2). Për një pasqyrë të çështjeve të përgjithshme në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, ju lusim të shihni grupin punues mbi mbrojtjen e dëshmitarëve brenda sistemit gjyqësor, pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogë dhe krim, Vjenë 22 – 24 shtator 2005.

njëjtën kohë të jetë dhe dëshmitare kyçe, gjë që e bën atë të ndjeshme ndaj kërcënimeve dhe frikësimit. Në mungesë të mbrojtjes adekuate të viktimës dhe të dëshmitarëve, prokurorët nuk do të mbledhin të gjitha provat e nevojshme që çojnë drejt dënimit të trafikantëve, ndërsa viktimat dhe dëshmitarët mund të dëmtohen edhe më tutje⁵⁵².

Konventa Lanzarote kërkon që shtetet anëtare të bashkëpunojnë për zbatimin e video-regjistrimit, e cila konsiderohet teknikë efikase dhe funksionale e mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave, duke dokumentuar në mënyrë integrale për një vlerësim të duhur *ex post* të vërtetësisë së provës. Gjithashtu, ajo lejon që të vëzhgohen dhe të vlerësohen të gjitha sjelljet e kryera nga i mituri gjatë seancave dëgjimore.⁵⁵³

Një tjetër garanci që kjo konventë parashikon është vënia e theksit tek komunikimi i përdorur me të miturin, duke e konsideruar praktikën e mëparshme të gabuar, e cila mund të çonte deri në shtrëmbërim të vërtetësisë së dëshmisë së tij. Ajo sanksiononte domosdoshmërinë e pranisë së një eksperti psikolog apo psikiatri gjatë marrjes në pyetje të të miturit.

Konventa Lanzarote kërkon efektivitet në marrjen e masave që ajo sugjeron, sepse mundëson sipas standardit më të lartë mbrojtjen e viktimës, e cila gjen shfaqjen e saj më domethënëse tek dëshmitari i mitur, si një subjekt veçanërisht i “dobët”. Statusi i veçantë i të miturit është i lidhur me brishtësinë mendore dhe fizike të tij, sepse është një dëshmitar i ndikueshëm, me aftësi njohëse të ndryshme nga të rriturit dhe, shpesh, nuk është në gjendje të riprodhojë një kujtim kur rezultojnë të jetë i dhimbshëm, ose për shkak se tenton të përziejë elementët e vërtetë me fantazinë.⁵⁵⁴ Procesi i rikujtesës për fëmijën është një “rrugë me pengesa”, për të gjitha arsyet e sipërcituara, por edhe për shkak se kujtesa e fëmijës është një memorie e ashtuquajtur në progres. Kështu, sigurimi i provës në këtë rast sjell dokumentimin e njoftimeve përpara se ato të harrohen sipas një progresioni deklarativ.⁵⁵⁵

Nga studimet e shkencës psikologjike kanë rezultuar se mekanizmat e rikujtesës janë të ndikuar në masë të madhe nga kushtet dhe mënyrat, në të cilat zhvillohet. Prandaj seanca gjyqësore e marrjes dhe verifikimit të provës (dëshmisë së miturit) duhet të jetë sa më pak traumatike për viktimën dhe të shmangë rrezikun e viktimizimit sekondar.⁵⁵⁶

Trafikimi i qënieve njerëzore është një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i personave të trafikuar nuk duhet të ndikohen negativisht nga masat e anti-trafikimit. Kjo është e rëndësishme sepse shpesh personat e trafikuar trajtohen si kriminelë.⁵⁵⁷ Viktimizimi i dytë mund të ndodhë në qoftë se viktimat nuk janë trajtuar me ndjeshmërinë e duhur. Të drejtat e njeriut kërkojnë identifikimin e hershëm dhe ndihmë për personat e trafikuar.⁵⁵⁸ Procesi i bërjes së një identifikimi zyrtar/bindës mund të jetë i gjatë. Për këtë arsye, identifikimi paraprak në kohë dhe efektiv i viktimave është vendimtare për mirëqënien e tyre.

⁵⁵² Shih “Udhërrëfyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimat të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007, fq.56.

⁵⁵³ RECCHIONE, L’esame del minore persona offesa in reati sessuali, cit., pag. 84

⁵⁵⁴ Shih TONINI, *Manuale di procedura penale*, edizione XIII, Milano, 2012, fq. 1007.

⁵⁵⁵ Shih RECCHIONE, *L’esame del minore persona offesa in reati sessuali*, in *Esame incrociato (Officina del diritto)*, 2011, fq. 78.

⁵⁵⁶ Shih MOFFETTI, *La testimonianza fragile nel processo penale: verso la policromatica valutazione delle dichiarazioni del minore*, in *La giustizia penale*, 2013, fasc. 5, fq. 300.

⁵⁵⁷ Shih UNODC, “Toolkit to Combat Trafficking in Persons”, 1st ed., Vienna/New York, 2006, Tool 6.1, p. 103.

⁵⁵⁸ Shih OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, Vienna, 2011, p. 26.

4.5.2.5 Rehabilitimi i të miturit.

Të miturit viktima të trafikimit, ose shfrytëzimit seksual, ose abuzimit seksual pësojnë një dëm të paretërueshem në mënyrë absolute, format e të cilit janë të ndryshme. Ndërkohë, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për garantimin e një standardi sa më të lartë në rikuperimin e dëmit dhe rehabilitimin e viktimave.

Pavarësisht qasjes që Republika e Shqipërisë ka treguar lidhur me përafrimin e legjislacionit të saj me atë ndërkombëtar, sistemi ynë ligjor nuk ka një ligj të veçantë të kompensimit dhe të dëmshpërblimit të viktimave. Legjislacioni ynë procedural penal ka parashikuar vetëm një mjet procedural për të siguruar dëmshpërblimin e viktimës për shkak të dëmit të shkaktuar, nëpërmjet padisë civile në procesin penal⁵⁵⁹. Kështu Kodi i Procedurës Penale⁵⁶⁰ parashikon se: “*Ai që ka pësuar një dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.*” Pra, sipas këtij parashikimi i jepet e drejtë personit që ka pësuar një dëm material nga vepra penale, ose edhe trashëgimtarëve të tij, që të kërkojnë, me anë të një padie civile në procesin penal, kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

Viktimat e veprave penale përfshirë edhe të miturit- viktimë legjitimohen në cilësinë e paditësit civil për të paraqitur padi civile në procesin penal kundër trafikateve, abuzuesve, shfrytëzuesve, apo çdo subjekti aktiv të veprës penale të kryer ndaj tyre, por ata mund të paraqesin një padi të veçantë civile, në gjykatën civile me bazë referencë ligjore nenin 625 të Kodi Civil, mbi shpërblimin e dëmit jopasuror.⁵⁶¹ Siç konstatohet, parashikimet e mësipërme kanë karakter të përgjithshëm duke përfshirë të gjitha viktimat.

Rëndësia që paraqet ky aspekt procedural pasqyrohet me faktin se organizmat ndërkombëtar i kanë kushtuar vëmendje specifike të drejtave të viktimave dhe procedurës së kompensimit të dëmit ndaj tyre, duke shprehur vullnetin e tyre në krijimin e akteve juridike ndërkombëtare. Si të tilla, përmendim Deklaratën e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit e adoptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara⁵⁶². Ky dokument promovon restituimin (*rikthimi i pronës, kompensimi i dëmit, restorimi i drejtave* etj.) dhe kompensimin e viktimës (*i siguruar nga shteti kur mjetet financiare të kryerësit janë të pamjaftueshme për këtë gjë*), si një nga të drejtat themelore të saj. Këto të drejta janë afirmuar dhe trajtuar në mënyrë të plotë nga Konventa e Palermos⁵⁶³ dhe Protokollin i saj shtesë “Mbi parandalimin e trafikut të grave e të fëmijëve”.

⁵⁵⁹ Konventa Evropiane “Mbi kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme” parashikon që shteti mund të ndihmojë në kompensimin e atyre që kanë pësuar një dëmtim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit që ka rrjedhur nga një krim i dhunshëm dhe të personave të varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë, nëse kompensimi nuk mund të jepet nga burime të tjera. Kompensimi jepet edhe nëse personi që ka kryer krimin nuk mund të ndiqet penalisht ose të dënohet.

⁵⁶⁰ Shih nenin 61 të Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁶¹ Shih Sander Simoni “Trajtimi i Viktimave të trafikimit si deshmitarë gjatë procesit gjyqësor, mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore”, shkrim në botimin e Shkollës së Magjistraturës “Kudri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore”, shkurt 2013, fq. 77.

⁵⁶²The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985). URL: <http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/h>.

⁵⁶³ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollin II i saj “Mbi parandalimin, pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”⁵⁶⁴ ishte një hap përpara që bënë shtetet lidhur me burimet e kompensimit, procedurën e realizimit dhe subjektet përfitues. Ajo synon në nxitjen e shteteve për përcaktimin e skemave që garantojnë kompensimin e viktimave, në ndihmën e viktimave në rastet kur ato nuk mund të kompensohen në një mënyrë tjetër. Qëllimi është kompensimi i atyre që kanë pësuar një dëm trupor ose dëmtim të shëndetit. Konventa parashikon se kompensimi mbulon shpenzimet mjekësore, të ardhurat e humbura, shpenzimet për mbajtjen e personave të varur.

Këto aspekte u përcaktuan edhe në Konventën e Këshillit të Evropës “Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”⁵⁶⁵, e cila është akti më i plotë juridik ndërkombëtar, lidhur me trajtimin e viktimave të trafikimit⁵⁶⁶.

Si akte Rekomanduese janë: Korniza e vendimit të dt.15.03.2001 të Këshillit të BE për pozitën e viktimave në procedimet penale parashikon që “Shtetet duhet të shqyrtojnë në rast se ligjet dhe procedurat vendase janë të përshtatshme dhe përgjegjëse për viktimat e trafikut, e të inkurajojnë kompensimin e tyre”.

Rekomandimi nr.8511 i Komitetit të Ministrave të KE-së “Për pozicionin e të dëmtuarit në kuadrin e procedurës penale” parashikon se “një gjykatë penale duhet të urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit nga vepra penale. Duhet të hiqen kufizimet ekzistuese dhe pengesat teknike që çojnë në mosrealizimin e një të drejte të tillë, kompensimi duhet të jetë përparësi në rastin e një dënimi alternativ e se gjykata duhet t’i kushtojë vëmendje nevojës për kompensim të dëmit.”

Rekomandimi nr.8721 i Komitetit të Ministrave të KE-së “Mbi ndihmën e viktimave dhe parandalimin e diskriminimit” shton se “Shtetet duhet të vlerësojnë masën e mbulimit të siguracioneve nga skemat private ose publike të sigurimit për sigurimin efikas të viktimave sipas nevojave të tyre” Rekomandimi nr.9713 i KE-së, “në lidhje me kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes” parashikon gjithashtu se “...masat që duhet të merren për trajtimin e dëshmitarëve veçanërisht në rastet e krimit në familje”.

Standardet ndërkombëtare kërkojnë kompensimin e viktimave të trafikimit, rehabilitimin e tyre moral e material. Manuali Praktik i ODIHR-it mbi *Mekanizmat Kombëtarë të Referimit* përfshin udhëzime mbi rëndësinë e dëmshpërblimit si një mënyrë për rivendosjen e të drejtave të shkelura të personave të trafikuar me efektin e rëndësishëm riparues dhe parandalues⁵⁶⁷. Ata kanë vendosur parimin se përfitimet e trafikantëve nga veprimtaritë e tyre shfrytëzuese duhet të përdoren në dobi të personave, të trafikuar në mënyrë individuale ose kolektive. Në lidhje me këtë, Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i OSBE-së rekomandon se: “Shtetet duhet të shqyrtojnë dispozita ligjore për konfiskimin e mjeteve dhe

⁵⁶⁴E hartuar në Strasburg me 24.11.1983 dhe e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9265 datë 29.07.2004.

⁵⁶⁵Kjo Konventë është miratuar në Strasburg.

⁵⁶⁶Kjo Konventë e Këshillit të Evropës ka veçoritë e saj në krahasim me instrumentet e tjerë ndërkombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Përsa i përket fushës së zbatimit të kësaj Konvente ajo mbulon të gjitha llojet e trafikimit cilitdo qofshin viktimat: burra, gra, fëmijë duke siguruar në këtë mënyrë barazinë gjinore. Kjo Konventë është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar që përkufizon termin “viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore” në ndryshim nga instrumentet e tjerë ndërkombëtarë të cilët limitohen duke i lënë secilit Shtet të çmojë se kush do të quhet viktimë dhe për rrjedhojë të përfitojë mbrojtjen e nevojshme.

⁵⁶⁷National Referral Mechanisms Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons, A Practical Handbook (Mekanizmat kombëtarë të referimit bashkojnë përpjekjet në mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar, Manual praktik) (OSBE/ODIHR, 2004), f. 83-87.

produkteve të trafikimit dhe veprave penale të lidhura me të dhe se pasuritë e konfiskuara do të përdoren në dobi të viktimave të trafikimit”⁵⁶⁸

Raporte të shumta kërkimore dhe raporte të konferencave u janë kushtuar çështjeve të lidhura me dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Janë identifikuar disa probleme në lidhje me mundësinë e përfitimit të dëmshpërblimit. Rekomandimet përfshijnë: përmirësimin e ndërgjegjësimit mbi të drejtat; sigurimin e legjitimitetit të viktimës si palë në proces, p.sh. si “palë e dëmtuar”; përdorimin e pasurive të trafikantëve; heqjen e kufizimeve për përfitimin nga fonde shtetërore të kompensimit; dhe përmirësimin e mundësive për të qëndruar në vendin ku ngrihet padia civile (ose mundësitë për të siguruar përfaqësim nga një palë e tretë).

4.5.2.5.1 Dëmshpërblimi

Termet “dëmshpërblim,” “kthim i dëmit,” “kthim” dhe “zhdëmtim” shpesh përdoren për konceptet, të cilat janë të njëjta ose shumë të afërta, d.m.th., “të ndreqësh diçka për dikë për humbjen, dëmtimin, veprimin e padrejtë, veçanërisht nëpërmjet pagesës së përshtatshme.”⁵⁶⁹ Në këtë punim termi “dëmshpërblim” i referohet konceptit të përgjithshëm të pagesës e personit, pavarësisht nga burimi i pagesës apo mekanizmi i përdorur, apo nga llojet e humbjeve që dëmshpërblehen⁵⁷⁰. Pra, dëmshpërblimi përfshin shpërblimin nga skemat me fond shtetëror si dhe shpërblimet e dhëna në proceset ligjore penale, civile ose të së drejtës së punës.

Shpërblim i dëmit përdoret në një kuptim më të ngushtë, sepse i referohet shumës së parave që i takon atij që preket nga vepra penale, marrë si dëmshpërblim nga autori i veprës penale⁵⁷¹. Dëmshpërblimi e përjashton kompensimin në rastet kur burimi i financimit është skema shtetërore dhe për këtë arsye, termi “shpërblim i dëmit (dëmshpërblim)” përdoret në kontekstin e procedurës civile dhe në atë të punës.

Kërkesat për dëmshpërblimin mund të përmbajnë disa elementë të ndryshëm (p.sh., dhimbje dhe vuajtje, shpenzimet mjekësore, dhe paga të papaguara) ose një element të vetëm (p.sh., paga të papaguara). Këta elementë mund të klasifikohen në kategori më të gjera si dëme “morale” dhe “materiale” (që përkufizohen më poshtë)⁵⁷².

Përdorimi dhe përkufizimi i termave “ndreqje” (*redress*) “kthim” (*restitution*) ose “rivendosija e së drejtës” (*reparation*) në kontekstin ligjor ndërkombëtar ose kombëtar, do të thotë përdorimi i përshtatshëm në atë situatë të veçantë, por përndryshe nuk i atribuohet asnjë kuptim tjetër⁵⁷³.

Shtete të ndryshme përdorin terma të ndryshëm për elementët e humbjes që përfshihen në kërkesën për dëmshpërblim. Megjithatë, në një kuptim të përgjithshëm,

⁵⁶⁸ Kapitulli III, Seksioni 1.5.

⁵⁶⁹ Përkufizimi i dëmshpërblimit (*compensation*) në *Chambers 21st Century Dictionary* (Fjalori Chambers i Shekullit të 21-të), 2004.

⁵⁷⁰ Shih “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-es. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Al.Ujazdowski 19 00-557 Varshavë Poloni www.osce.org/odihr fq 16

⁵⁷¹ Black’s Law Dictionary (Fjalori Juridik Black) (botimi i 8-të, 2004).

⁵⁷² Shih “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-es. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Al.Ujazdowski 19 00-557 Varshavë Poloni www.osce.org/odihr fq. 16.

⁵⁷³ Ka raste kur ndonjëri prej këtyre termave ka një kuptim në legjislacionin e një vendi dhe kuptim tjetër në vende të tjera, p.sh. termi “*restitution*” (kthim i dëmit) në ShBA do të thotë pagesa që i bëhet viktimës nga i pandehuri në zbatim të vendimit të gjykatës, por në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë “*restitution*” do të thotë kthim i mallrave dhe pronës tek pronari i ligjshëm.

kërkesat për dëmshpërblim përmbajnë kryesisht elementë që përfshihen në dy kategori të veçanta: dëmshpërblimi për dëmin material dhe dëmshpërblimi për dëmin moral.

Dëmi material i referohet humbjes financiare ose monetare, p.sh., shpenzimet mjekësore, të shtrimit në spital ose të varrimit, humbja e të ardhurave të pritshme dhe përfitimeve që rrjedhin nga punësimi, pagat e papaguara, dhe kostot e dëmtimeve ndaj pronës. Përkufizimi dhe fusha e zbatimit të dëmeve materiale në kontekstin kombëtar përcaktohet në legjislacion (ose nëpërmjet precedentëve në vendet *common law* traditës anglo-saksone) dhe ndryshon nga vendi në vend. Disa mekanizma dëmshpërblimi mundësojnë që të jepet pagesa e të gjitha formave të dëmit material, ndërsa të tjera mundësojnë vetëm kategoritë e kufizuara.

“Dëmi moral” u referohet humbjeve të tjera jofinanciare ose jo-monetare, për shembull, vuajtjeve emocionale, cënimit të nderit ose emrit të mirë, “dhimbjes dhe vuajtjes”, shqetësimit, humbjes së kënaqësisë së jetës, humbjes së shoqërisë dhe të miqësisë. Sërish, përkufizimi dhe fusha e zbatimit të dëmit moral në kontekstin kombëtar përcaktohet në ligj (ose nëpërmjet precedentëve në vendet *common law*) dhe ndryshon nga vendi në vend⁵⁷⁴.

Disa mekanizma dëmshpërblimi lejojnë që të kërkohen të gjitha format e dëmit moral, disa të tjerë lejojnë vetëm lloje të caktuara të dëmit moral dhe disa të tjerë nuk e lejojnë fare paraqitjen e kërkesës në lidhje me dëmin moral.

Parashikohen disa lloje kompensimesh për viktimën në legjislacione të ndryshme, sisteme të ndryshme ligjore kanë gjetur mënyra të ndryshme për të bërë kompensimin e viktimave. Kompensimi mund të bëhet nga autori i veprës penale ose nga shteti. Kompensimi nga autori i veprës penale mund të realizohet duke shfrytëzuar instrumentet procedurale civile dhe penale. Instrumentet civile mund të përdoren duke inkurajuar ngritjen e padive civile të dëmshpërblimit të dëmit nga ana e viktimës. Ky instrument nuk është i favorshëm për situatën në të cilën vihet viktimja dhe kohëzgjatja e proceseve civile. Mënyra e bashkëveprimit të së drejtës civile në procesin penal ndaj autorit është një mënyrë tjetër që siguron gjykimin e njëkohshëm të autorit dhe të padisë së kërimit të kompensimit dhe lehtëson psikologjikisht viktimën e redukon procedurën e shpenzimet⁵⁷⁵.

Kompensimi mund të bëhet ndaj viktimës edhe nëpërmjet caktimit të masës së kompensimit si pjesë e dënimit kryesor siç parashikojnë disa legjislacione. Disa legjislacione parashikojnë dhe mundësinë e kërimit nga ana e viktimës së fitimit të munguar p.sh nga mosmarrja e pagës. Kompensimi nga autori i veprës penale, i cili e ka shkaktuar dëmin dhe vuajtjen duhet të jetë qëllimi kryesor. Kjo mund të bëhet në disa mënyra: kompensimi nëpërmjet proceseve civile e penale.

Ekziston e drejta e dëmshpërblimit në rastet e trafikimit, krimeve të dhunshme, dhunës ndaj grave, shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe kur shkelen standardet ndërkombëtare të punës. Megjithatë, kjo e drejtë kufizohet në dëmshpërblimin nga trafikanti, shfrytëzuesi, abuzuesi. Dëmshpërblimi nga shteti ndodh vetëm në rrethana të kufizuara të krimeve të dhunshme që shkaktojnë dëme fizike dhe mendore⁵⁷⁶.

⁵⁷⁴Shih “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-es. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Al.Ujazdowski 19 00-557 Varshavë Poloni www.osce.org/odihr fq. 16.

⁵⁷⁵Mekanizmat kombëtare të referimit, Manual praktik, OSBE/ODIHR.

⁵⁷⁶Shih “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-es. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Al.Ujazdoëskie 19 00-557 Varshavë Poloni www.osce.org/odihr fq. 17.

Standardet ndërkombëtare kanë zhvilluar parimin sipas të cilit përfitimet e trafikantëve nëpërmjet aktivitetëve të tyre shfrytëzuese duhet të përdoren në dobi të personave të trafikuar në mënyrë individuale ose kolektive. Udhëzimet ndërkombëtare me natyrë politikisht detyruese përcaktojnë detyrimin e mbledhjes së pasurive të krimit dhe përdorimin e kësaj pasurie për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Theksi vihet gjithashtu tek interesat e veçanta të grave dhe fëmijëve. Kur rasti përmban shkelje shumë të rënda të të drejtave të njeriut, shkelje e rëndë e ligjeve humanitare apo krim ndërkombëtar (siç përcaktohet nga Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale), atëherë ekziston një theksim akoma më i madh mbi të drejtën për dëmshpërblim.

4.5.2.5.2 Mekanizmat e shpërblimit

Legjitimiteti aktiv, ligjor (shkaku i ngritjes së padisë) për të kërkuar dëmshpërblim ndryshon sipas rrethanave rregulluese (p.sh., në legjislacionin civil ose atë të punës), llojeve të humbjeve që kompensohen, si dhe mund të ndryshojnë dhe metodat që përdoren për të llogaritur masën e shpërblimit. Gjithashtu, janë të ndryshme dhe procedurat dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e përfitimit nga shpërblimi në varësi të mekanizmit që përdoret. Çdo ndryshim në procedurë apo në standardin ligjor mund të ndikojë në mundësinë e individit për të paraqitur me sukses kërkesën, dhe për këtë arsye secili mekanizëm ka sfidat ose përparësitë e veta⁵⁷⁷.

E drejta për të përfituar dëmshpërblim ekziston pavarësisht nëse vepra penale e trafikimit, shfrytëzimit, ose abuzimit seksual klasifikohet si krim i dhunshëm.

Disa karakteristika të mekanizmave të dëmshpërblimit janë të përbashkëta për të gjitha shtetet. Të gjitha strukturat e tilla ligjore dhe administrative paraqesin sfida për cilindo që kërkon zhdëmtim, përfshi dëmshpërblimin. Njohja e këtyre sfidave dhe karakteristikave të përgjithshme duhet të ndihmojë në kuptimin e përparësive dhe dobësive të secilit lloj mekanizmi për personat e trafikuar. Pavarësisht specifikave që kanë vendet e ndryshme theksojme se ekzistojnë tre mekanizma për dëmshpërblimin, si më poshtë:⁵⁷⁸

A. Dëmshpërblimi nga trafikanti/shfrytëzuesi/abuzuesi

Si mekanizëm të parë për të realizuar dëmshpërblimin e viktimave standardet ndërkombëtare parashikojnë të drejtën e dëmshpërblimit nga trafikanti, ose shfrytëzuesi, ose abuzuesi, i cili arrihet në mënyrë vullnetare ose në mënyrë shtrënguese.

Marrëveshjet vullnetare mund të arrihen si pjesë e një marrëveshjeje me ndërmjetësim në një veprim kolektiv ose individual që kryhet jashtë procesit gjyqësor (p.sh., përpara ngritjes së padisë por duke e parashikuar atë); nëpërmjet negociatave brenda procesit penal për marrëveshje që pranon përgjegjësinë (p.sh., në SHBA, ku njihet si *'plea agreement'*), ose një marrëveshje pajtimi të ndërmjetësuar nga të tjerët në çështjen penale (p.sh., në Francë); apo si një marrëveshje pajtimi e negociuar në çështjen civile apo e bazuar në legjislacionin e punës (në të gjitha vendet – shiko shembujt në profilet e vendeve për SHBA-në dhe për Federatën Ruse)⁵⁷⁹.

⁵⁷⁷ Po aty.

⁵⁷⁸ Sistemi ynë parashikon tre mekanizma.

⁵⁷⁹ Shih "Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-es. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Al.Ujazdowski 19 00-557 Varshavë Poloni www.osce.org/odihr fq.17.

Urdhrat shtrënguese lëshohen me vendim gjykate në proceset penale, civile apo të punës. Në raste të tilla, gjykata duhet detyrimisht të shqyrtojë të gjitha provat në lidhje me përgjegjësinë (fajin) për humbjen dhe në lidhje me natyrën dhe masën e dëmit. Urdhri i lëshuar nga gjykata mund të paguhet ose jo në mënyrë vullnetare. Mospagesa mund të detyrojë viktimën ose shtetin të ndjekë procedurat përbarimore. Këto mund të jenë jo të suksesshme, që do të thotë se, pavarësisht nga ekzistenca e disa mekanizmave dëmshpërblimi, marrja e masës së dëmshpërblimit nga personi i trafikuar, në praktikë ndodh shumë rrallë.

Procedimi për dëmshpërblimi mund të kryhet i veçuar (në çështjen penale) ose bashkë me një padi tjetër ndaj subjektit aktiv të veprës penale (p.sh. çështja penale së bashku me një çështje të bazuar në legjislacionin e punës).

Si alternativë, një padi për dëmshpërblim nëpërmjet procesit penal, civil dhe legjislacionit të punës mund të ndiqet bashkë me një kërkesë për të përfituar nga fondi shtetëror, në qoftë se plotësohen kriteret e pranueshmërisë për fondin. Mundësia e paraqitjes së padisë për dëmshpërblim ndaj trafikantit/shfrytëzuesit ka disa forma dhe mund të shpjerë në shpërblime të konsiderueshme që mbulojnë të paktën një pjesë të humbjeve që ka pësuar i mituri viktimë.

B. Dëmshpërblimi nga shteti

Dëmshpërblimi mund të paguhet dhe nga shteti nëpërmjet skemave të administruara dhe financuara prej tij. Këto skema janë krijuar në disa vende, zakonisht për viktimat e krimeve të dhunshme, si në Francë, Rumani dhe në Mbretërinë e Bashkuar; si dhe është propozuar në Ukrainë.

Skema të financuara ose të subvencionuara nga shteti kanë përparësinë që i sigurojnë viktimës pagesë të garantuar të dëmshpërblimit. Shpesh këtu përfshihet dhe mundësia e pagesës së menjëhershme ose të ndërmjetme. Disa skema mundësojnë në mënyrë të shprehur që shtetit i kalon (nga viktimat) e drejta për të paditur të pandehurin për dëmet e shkaktuara viktimës, siç është rasti në Francë dhe Ukrainë. Kjo ruan elementin “moral” dhe ndëshkues të skemës së kompensimit. Një përparësi tjetër e skemave të tilla është se nuk ka nevojë që të identifikohet ose të përcaktohet vendndodhja specifike e keqbërësit. Zakonisht mjafton raporti i policisë së bashku me gadishmërinë për të ndihmuar policinë gjatë hetimit.

Skemat shtetërore mund të jenë relativisht të thjeshta, joburokratike dhe më të shpejta se sa procesi civil. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë, ka agjenci që ndihmojnë viktimat në plotësimin e kërkesave dhe procedurat janë pa ndërlikime të panevojshme, të lehta për t’u përdorur. Megjithatë, shpesh përmbajnë kriteret kufizuese për pranimin, të bazuar në kombësinë ose statusin e viktimës, të cilat mund të mos plotësohen nga një person i trafikuar (shih Rumaninë, ku kërkesa e kombësisë ua jep këtë të drejtë vetëm rumunëve, atyre që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin rumun si dhe shtetasve të atyre vendeve me të cilat Rumania është e lidhur me anë të konventave). Ato mund të jenë gjithashtu të disponueshme vetëm për viktimat e disa kategorive krimesh, si vepra penale të përcaktuara ose krime të dhunshme (në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë). Këto kriteret mund të paraqesin pengesa të paarsyeshme në paraqitjen e kërkesave nga viktimat.

Pavarësisht nga pësimi i traumës, shfrytëzimit dhe dëmit ekonomik, viktimat mund të mos ketë pësuar dhunë gjatë historisë së trafikimit, gjë që nuk do t’i jepte të drejtë të përfitonte nga shumica e skemave shtetërore të dëmshpërblimit për viktimat e

krimit. Zgjerimi i mundësisë për të përfitur nga skema të tilla, duke u bazuar në klasifikimin e përvojës së viktimës si i trafikuar dhe jo në provat e dhunës, duhet të bërë të mundur automatikisht që viktima legjitimohet të paraqesë padinë.

Kështu veprohet në Francë, ndonëse në praktikë është identifikuar dhe hetuar vetëm një rast trafikimi. Natyra e përvojës së trafikimit të personit dhe humbjet e pësuarra do të përcaktonin pastaj masën e dëmit. Së fundi, ka shumë mundësi, që shpërblimi që jepet nga shteti nuk do të mbulojë të gjitha dëmet që mund të jepen në padinë civile, p.sh., mund të mos paguhet dëmi moral, siç ndodh në Ukrainë dhe Rumani. Shuma e disponueshme mund të jetë e kufizuar sipas një tarife të përcaktuar, si në rastin e Mbretërisë së Bashkuar, duke i lënë kështu viktimës zgjedhjen të pranojë një shpërblim të ulët ose të padisë të pandehurin në gjykatë civile për pjesën tjetër të dëmeve.

Në disa vende janë krijuar skema të posaçme ose fonde për viktima të llojeve të caktuara të krimeve. Kjo ka ndodhur kryesisht për viktimat e veprimeve terroriste^{580,581} në Francë ose Programin e Rimbursimit të Viktimave të Terrorizmit Ndërkombëtar dhe Fondin e Dëmshpërblimit të Viktimave të 11 shtatorit⁵⁸² në SHBA. Motivimi i tyre është që të sigurohet se vdekja dhe plagosjet e rënda kompensohen kur nuk ka shpresa reale për padi civile.

Skemat shtetërore janë gjithashtu të kushtueshme, si në lidhje me kostot administrative dhe me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit⁵⁸³. Qeveritë mund të parapëlqejnë të investojnë në veprimtari të tjera që synojnë forcimin e shtetit të së drejtës apo ndihmën e përgjithshme ndaj viktimave të trafikimit. Për sa u përket detyrimeve ligjore ndërkombëtare, gjendja është e ndryshme në secilin shtet dhe përparësitë për reforma nuk do të jenë të njëjta. Megjithatë, propozuesit e dëmshpërblimit për personat e trafikuar duhet pa tjetër të kenë parasysh çështjet buxhetore të këtyre skemave, kur vendosin se cilat skema ose reforma do të përkrahin.

Pavarësisht nga ratifikimi i Konventës Evropiane “Për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme” (KEDVKDH-së), Republika e Shqipërisë akoma nuk ka ndërmarrë një nismë për krijimin e ndonjë skeme shtetërore për dëmshpërblimin. Megjithatë, legjislacioni shqiptar krijon mundësinë e dëmshpërblimit nëpërmjet padisë civile në procesin penal ose padisë civile të pavarur sipas procedurave civile. Ndryshimi kryesor midis të dyjave është se nuk mund të kërkohet dëmi moral me anë të padisë në çështjen penale. Kjo mund të dekurajojë viktimat në bërjen e kërkesave, duke qenë se në shumicën e rasteve padia e tyre është për dëme morale dhe në këtë rast ajo duhet ngritur në gjykatën civile ku ka probleme të shpenzimeve, kohës dhe rezultateve. Ka shumë mundësi që kjo në vetvete do të ulë numrin e kërkesave për shpërblim të dëmit në Shqipëri⁵⁸⁴.

⁵⁸⁰Ligji i 9 shtator 1986.

⁵⁸¹ Shih *Fonds de Garantie* (Fondi i Garancisë).

⁵⁸²“Fondi i 11 shtatorit u miratua ...me qëllimin e shprehur për të siguruar dëmshpërblim dhe një alternativë për kthimin e dëmit jashtëkontraktor individëve dhe familjeve të tyre që u vranë apo u plagosën si rezultat i sulmeve, pa nevojë që të provohet faji. Në shkëmbim të heqjes dorë nga e drejta për të paditur, familjaret e atyre që humbën jetën ose u lënduan gjatë sulmeve, iu premtua zgjidhje e shpejtë, jo e kushtueshme dhe e parashikueshme. Viktimat do të merrnin dëmshpërblim të plotë. Shpërblimi do të financohej nga Thesari i shtetit amerikan, pa i kufizuar buxheti i përgjithshëm të programit. Kështu, Fondi i 11 shtatorit ishte një shpenzim i fondeve publike i pashembullt për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale.”⁷⁹ Tulane Laë Revieë, 167, 197 (nëntor 2004).

⁵⁸³ Për një pasqyrim të përgjithshëm i buxhetit, shih profilin e Mbretërisë së Bashkuar

⁵⁸⁴Shih “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-es. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Al.Ujazdowski 19 00-557 Varshavë Poloni www.osce.org/odihr fq. 63.

Ratifikimi i KEDVKDH-së ka patur ndikim në praktikën gjyqësore të vendit tonë, sepse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar padinë civile në procesin penal gjatë gjykimit të procedimit penal lidhur me veprën penale të “Shfrytëzimi i prostitucionit”⁵⁸⁵.

Megjithatë, nëse padia civile rrëzohet në procesin penal, ajo nuk mund të ngrihet përsëri në gjykatën civile. E vetmja mënyrë e riparimit të dëmit moral nga gjykata penale, me kërkesë të paditësit civil, është botimi në gazetë i dënimit të autorit të veprës penale në gazetë⁵⁸⁶. Këtu krijohet paqartësi për shkak se dëmit i referohet vetëm neni 58, ndërsa dëmit material neni 61 i Kodit të Procedurës Penale.

Legjislacioni procedural penal nuk i atribuon të drejta të qarta viktimës. Vetëm nëse merr statusin e paditësit civil në procesin penal, ajo ka të drejtë të përfaqësohet. Si rrjedhojë, njohja e përgjithshme dhe roli i viktimës në procesin penal është i mangët (p.sh., nuk ka të drejtë t’u drejtojë pyetje dëshmitarëve), dhe kjo mund të sjellë pasoja në praktikë ku të drejtat e viktimës nuk merren seriozisht nga policia, nga prokuroria ose nga vetë gjykata⁵⁸⁷.

Instrumentet proceduralë civilë e penale nuk rezultojnë efikase. Sigurimi i fondeve publike jo gjithmonë është i mundur – mund të jetë e mundur vetëm krijimi i skemave të sigurimeve shëndetsore ose rrjeteve sociale të financuara nga shteti. Më i volitshëm mund të ishte miratimi i një ligji të veçantë për kompensimin e viktimave të trafikut apo të dhunës në përgjithësi. Ky ligj do jetë në ndihmë të personave të dhunuar që kanë pësuar dëmtim të shëndetit si rezultat i krimit dhe kanë nevojë për trajtim shëruar, pension apo pagesë tjetër për mirëqenie. Mënyrë tjetër është sigurimi i fondeve për kompensimin e viktimave nëpërmjet pasurive të sekuestruara e të konfiskuara trafikantëve, pasuri të vëna në mënyrë të paligjshme nëpërmjet kryerjes së veprës.

Çështja e kompensimit të viktimave ka nevojë për përmirësime ligjore. Krahas krijimit të një skeme shtetërore për kompensimin e viktimave të trafikimit duhen ndryshuar dhe plotësuar edhe dispozitat e K.Pr.P për ngritjen e padisë civile në procesin penal dhe gjykimin e saj brenda këtij procesi. Ky është edhe rasti i vetëm ku, sipas K.Pr.P nenet 58-68, viktima e trafikimit mund të marrë pjesë si palë në proces, nëpërmjet padisë civile në procesin penal, për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit. Për çështjen e kompensimit të viktimave të trafikimit duhen pasur parasysh rekomandimet e dhëna nga misionet vëzhguese⁵⁸⁸ dhe direktivat e rekomandimet ndërkombëtare⁵⁸⁹. Mungesa e parashikimeve të qarta në K.Pr.P për dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit, ose abuzimit në mënyrë të pakushtëzuar. Në këto kushte, organet e

⁵⁸⁵ Me sa duket në këtë çështje gjykata vendosi që paditësit (viktimës) t’i jepej shuma prej 2 milion ALL (rreth 16 000 EUR) si shpërblim i dëmit material për fitimin e munguar, ndonëse shfrytëzimi seksual normalisht do të konsiderohej si “punë e paligjshme.” Vendimi u ankimua, por u la në fuqi nga Gjykata e Apelit. Megjithatë, vendimi nuk është zbatuar ende. Informacion i dhënë nga QNLQ në seminarin e ODIHR-it në Barcelonë, dhjetor 2007, shih shënimin 43.

⁵⁸⁶ Neni 399 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁸⁷ Shih Sander Simoni “Trajtimi i Viktimave të trafikimit si dëshmitarë gjatë procesit gjyqësor, mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore”, shkrim në botimin e Shkollës së Magjistraturës “Kuadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore”, shkurt 2013, fq.85.

⁵⁸⁸ Raporti i GRETA-s përmend edhe problemet e hasura në zbatimin e ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (raporti i GRETA-s paragrafët 171, 172, 174, 128 dhe rekomandimi nr.17).

⁵⁸⁹ Direktivat e BE-së të datës 5 prill 2011 (paragrafi 13 dhe neni 17) rekomandojnë dhe inkurajojnë përdorimin e aseteve të konfiskuara për mbështetjen e viktimës së trafikimit për mbrojtje përfshirë edhe kompensimin.

drejtësisë duhet të orientohen drejt referimit direkt të akteve ndërkombëtare ose instrumentave të tjera.

Duhet të ndryshohet K.Pr.P, përkatësisht neni 158 të K.Pr.P. Nga praktika gjyqësore është konstatuar se, në kushtet kur viktimat e trafikimit janë konsideruar si të dëmtuara nga vepra penale, organet e zbatimit të ligjit, në përgjithësi, nuk kanë aplikuar të drejtën e tyre sipas nenit 158 të K.Pr.P. Por, në mënyrën se si është aktualisht e formuluar dispozita e mësipërme, krijon paqartësi lidhur me *të drejtën e të dëmtuarve për të mos dhënë deklaramë* në fazën e hetimeve paraprake apo dëshmi gjatë gjyqimit, në rastet kur deklarojnë se kanë bashkëjetuar apo kanë lidhur martesë me tutorët e tyre⁵⁹⁰.

Nisur nga nevoja për të pasur një kuadër ligjor sa më të plotë për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, i cili të jetë edhe në përputhje me standardet dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, mund të shikohet mundësia e hartimit të një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Reformat ligjore dhe institucionale gjatë këtyre 10 viteve të fundit në luftën kundër trafikimit duhen vijuar dhe me trajtimin e viktimave të trafikimit e kompensimin e tyre; përvoja e deritanishme e Gjykatës së Krimeve të Rënda e strukturave të tjera pararendëse anti-trafikim janë një garanci për përmbushjen e këtij standardi të ri. Shteti dhe shoqëria duhet të bëjnë ç'është e mundur për të ndihmuar viktimat ta tejkalojnë stigmën me të cilën ballafaqohen dhe të çlirohen prej saj dhe në këtë mënyrë, duke dekurajuar autorët e mundshëm të trafikimeve. Kompensimi ose dëmshpërblimi moral për veprimin e trafikimit do t'i jepte viktimës së trafikimit mundësinë për t'u rehabilituar moralisht e integruar objektivisht dhe njëherë në jetën social – ekonomike duke rivendosur në vend të drejtën. Kjo duke e bërë Shqipërinë që të plotësojë standardet e nevojshme në këtë fushë të drejtësisë penale.

4.6. Të dhëna statistikore

Në këtë aneks po paraqesim shkurtimisht disa të dhëna staisikore lidhur me krimet seksuale me subjekt pasiv të miturin, mbështetur në të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme⁵⁹¹. Vëmendja do të përqëndrohet në drejtimet e mëposhtme:


4.6.1. Tendencat sipas veprave penale

- **Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur**

Ecuria e kësaj vepre penale gjatë viteve 2000-2016 paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

⁵⁹⁰Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr.555, datë 03.12.2008.

⁵⁹¹ Shih Raportet Vjetore për Gjendjen e Kriminalitetit për periudhën 2000-2016.




Sic vërehet nga të dhënat statistikore, procedimet e regjistruara për nenin 100 të Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, në vitin 2001 rezultojnë me ulje 8 % krahasuar me të dhënat e vitit 2000, ndërkohë që në vitin 2002 ka një rritje prej 100 % të numrit të procedimeve të regjistruara në prokurori krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2003 procedimet penale të regjistruara rezultojnë me një ulje prej 9 % krahasuar me vitin 2002, në vitin 2004 rezulton një rritje prej 10 %, në vitin 2005 numri i procedimeve të regjistruara për këtë vepër është ulur me 41 %. Në vitin 2006 shënohet rritje e numrit të procedimeve të regjistruara me 46 % krahasuar me vitin 2005, në vitet 2007 e 2008 është regjistruar i njëjti numër procedimesh që krahasuar me vitin 2006 përbën një ulje prej 10,5 % e në vitin 2009 është regjistruar sërish një rritje 11,8 % që në shifra rezulton i njëjti tregues si në vitin 2006 e konkretisht 19 procedime penale. Në vitin 2010 është regjistruar ulje e numrit të procedimeve penale prej 15,8 %, në vitin 2011 procedimet rezultojnë me ulje 12,5 % krahasuar me të dhënat e vitit 2010, ndërkohë që në vitin 2012 ka një rritje prej 6,2 % të numrit të procedimeve të regjistruara në prokurori krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2013 procedimet penale të regjistruara rezultojnë me një rritje prej 52,9 % krahasuar me vitin 2012, në vitin 2014 rezulton një ulje prej 23 %, në vitin 2015 numri i procedimeve të regjistruara për këtë vepër është ulur me 5 % dhe pothuajse me të njëjtën përqindje është ulur edhe në vitin 2016.

Duke vërejtur trendin e procedimeve të regjistruara konkuldohet se tendenca është në rritje, ku në vitin 2001 është regjistruar numri më i ulët i procedimeve dhe në vitin 2013 është regjistruar numri më i lartë i tyre.

- **Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç**

Ecuria e kësaj vepre penale gjatë viteve 2000-2016 paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Siç vërehet nga të dhënat statistikore, procedimet e regjistruara për nenin 101 të Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”, në vitin 2001 rezultojnë me rritje 81 % krahasuar me të dhënat e vitit 2000, ndërkohë që në vitin 2002 ka një ulje prej 34,5 % të numrit të procedimeve të regjistruara në prokurori krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2003 procedimet penale të regjistruara rezultojnë me një rritje prej 15,8 % krahasuar me vitin 2002, në vitin 2004 rezulton një ulje prej 4,5 %, në vitin 2005 numri i procedimeve të regjistruara për këtë veprë është rritur me 19 %. Në vitin 2006 shënohet ulje e numrit të procedimeve të regjistruara me 12 % krahasuar me vitin 2005, ndërsa në vitin 2007 numri i procedimeve të regjistruara është rritur me 45,5 %. Në vitin 2008 ka sërish ulje në masën 28 % krahasuar me një vit më parë. Tendenca në ulje vazhdon edhe në vitet 2009 e 2010 përkatësisht 30,4 % dhe 43,7 %. Në vitin 2011 rezultojnë me rritje 33 % krahasuar me të dhënat e vitit 2010, në vitin 2012 ky tregues rezulton sërish me ulje prej 41,6 %, në vitin 2013 procedimet penale të regjistruara rezultojnë me një rritje prej 114 % krahasuar me vitin 2012, në vitin 2014 rezulton një rritje prej 26,6 %, e ruajtur konstante edhe në vitin 2015, dhe në vitin 2016 numri i procedimeve të regjistruara për këtë veprë është ulur në masën 79 %, njëkohësisht treguesi më i ulët ndër vite.

Duke vërejtur trendin e procedimeve të regjistruara konkuldohet se tendenca është në ulje, ku në vitin 2007 është regjistruar numri më i lartë i procedimeve dhe në vitin 2016 është regjistruar numri më i ulët i tyre.


- *Dhuna seksuale*

Vepra penale e parashikuar nga neni 107/a i Kodit Penal “Dhuna seksuale”, në paragrafin e saj të tretë penalizon kryerjen e veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç seksuale apo pjekurinë seksuale.

Rezulton se nuk ka patur procedime penale të regjistruara në prokurori për këtë veprë, në vitet 2013⁵⁹²-2016.

- **Vepra të turpshme**

Ecuria e kësaj vepre penale gjatë viteve 2000-2016 paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Siç vërehet nga të dhënat statistikore, procedimet e regjistruara për nenin 108 të Kodit Penal “Vepra të turpshme”, në vitin 2001 rezultojnë me rritje 75 % krahasuar me të dhënat e vitit 2000, në vitin 2002 ka një rritje prej 71 % të numrit të procedimeve të regjistruara në prokurori krahasuar me një vit më parë, rritje që vijon edhe në vitin 2003 ku procedimet penale të regjistruara rezultojnë me një rritje prej 66,7 % krahasuar me vitin 2002. Në vitin 2004 rezulton një ulje prej 15 %, në vitin 2005 numri i procedimeve të regjistruara për këtë veprë është ulur me 29,4 %, ndërkohë që në vitin 2006 shënohet rritje e numrit të procedimeve të regjistruara me 16,7 % krahasuar me vitin 2005. Në vitin 2007 numri i procedimeve të regjistruara është ulët sërish me 42,9 %, ndërsa në vitin 2008 ulja është 12,5%, që i korrespondon numrit të procedimeve të vitit 2001 dhe ruan këtë tregues konstant edhe në vitin 2009. Në vitin 2010 ka një tendencë në rritje prej 57 %, por që ulët sërish në vitin 2011 me 54 % krahasuar me të dhënat e vitit 2010. Në vitin 2012 ky tregues rezulton me rritje prej 40 %, në vitin 2013 procedimet penale të regjistruara për këtë veprë rezultojnë me një rritje prej 3,4 herë krahasuar me vitin 2012, në vitin 2014 rezulton një ulje prej 12,5 %, në vitin 2015 numri i procedimeve të regjistruara për këtë veprë është rritur me 47,6 % dhe në vitin 2016 numri i procedimeve ka shënuar ulje prej 16 % krahasuar me një vit më parë.

Duke vërejtur trendin e procedimeve të regjistruara konkuldohet se tendenca është në rritje, ku në vitin 2000 është regjistruar numri më i ulët i procedimeve dhe në vitin 2015 është regjistruar numri më i lartë i tyre.

⁵⁹² Shtuar me ligjin 144/2013.

- *Pornografia*

Ecuria e kësaj vepre penale gjatë viteve 2000-2016 paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Siç vërehet nga të dhënat statistikore, nga viti 2000 deri në vitin 2004 nuk rezultojnë procedime penale të regjistruara në organin e prokurorisë për nenin 117 të Kodit Penal “Pornografia”. Në vitin 2004 është regjistruar 1 procedim penal, në vitet 2005 e 2006 sërish nuk rezultojnë procedime penale të regjistruara. Në vitin 2007 janë regjistruar 2 procedime penale, në vitet 2008 e 2009 është regjistruar respektivisht nga 1 procedim penal dhe në vitet 2010 deri 2014 nuk rezultojnë procedime penale të regjistruara. Në vitin 2014⁵⁹³ janë regjistruar 28 procedime penale për këtë vepër, në vitin 2015 janë regjistruar 30 procedime penale që përbëjnë rritje prej 7 % krahasuar me vitin 2014 dhe në vitin 2016 shënohet një ulje e ndjeshme e numrit të procedimeve penale të regjistruara prej 86,7 % krahasuar me një vit më parë.

Duke vërejtur trendin e procedimeve të regjistruara konkuldohet se tendenca në vite është në rritje, ku në vitin 2015 është regjistruar numri më i lartë i tyre.

⁵⁹³ Ndryshuar dispozita me ligjin 144/2013

Të dhëna statistikore 2002-2016

		Neni 100	Neni 101	Neni 108	Neni 117	Neni 128/b
Viti 2002	Procedime te regjistruara	22	19	12	0	5
	Persona te pandehur	22	20	13	0	2
	Persona denuar	13	10	8	0	3
Viti 2003	Procedime te regjistruara	20	22	20	0	9
	Persona te pandehur	20	21	17	0	12
	Persona denuar	16	7	12	0	6
Viti 2004	Procedime te regjistruara	19	20	17	1	8
	Persona te pandehur	17	21	13	1	5
	Persona denuar	10	10	11	0	5
Viti 2005	Procedime te regjistruara	13	25	12	0	3
	Persona te pandehur	11	11	10	0	0
	Persona denuar	9	8	12	0	0
Viti 2006	Procedime te regjistruara	19	22	14	0	1
	Persona te pandehur	14	11	10	0	0
	Persona denuar	5	6	8	0	0
Viti 2007	Procedime te regjistruara	17	32	8	2	3
	Persona te pandehur	13	19	6	1	2
	Persona denuar	6	1	12	0	3
Viti 2008	Procedime te regjistruara	17	23	7	1	5
	Persona te pandehur	10	18	5	1	3
	Persona denuar	6	7	5	0	4
Viti 2009	Procedime te regjistruara	19	16	7	1	1
	Persona te pandehur	11	11	4	0	0
	Persona denuar	11	8	5	0	1
Viti 2010	Procedime te regjistruara	16	9	11	0	6
	Persona te pandehur	15	10	11	0	5

	Persona denuar	9	3	5	0	1
Viti 2011	Procedime te regjistruara	14	12	5	0	2
	Persona te pandehur	13	9	5	0	0
	Persona denuar	7	5	3	0	6
Viti 2012	Procedime te regjistruara	23	7	7	0	0
	Persona te pandehur	17	1	7	0	0
	Persona denuar	12	1	4	0	0
Viti 2013	Procedime te regjistruara	26	15	24	0	7
	Persona te pandehur	20	17	18	0	3
	Persona denuar	17	0	9	0	0
Viti 2014	Procedime te regjistruara	20	19	19	26	4
	Persona te pandehur	19	19	14	1	1
	Persona denuar	21	3	9	0	0
Viti 2015	Procedime te regjistruara	19	19	3	30	11
	Persona te pandehur	17	21	2	1	3
	Persona denuar	15	3	3	0	1
Viti 2016	Procedime te regjistruara	17	5	26	4	6
	Persona te pandehur	13	2	22	0	1
	Persona denuar	10	7	11	1	2

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. Sipas standardeve ndërkombëtare të sëmundjeve, ku klasifikohen edhe çrregullimet mendore, një adoleshent që është 16 vjeç ose më i madh, i cili është të paktën pesë vite më i madh se fëmija ndaj të cilit ka tërheqje seksuale, mund të diagnostikohet si rast pedofilie. Pra, personi, kryesisht madhor në moshë, karakterizohet nga një tërheqje dhe interes seksual i tillë, që është i vazhdueshëm e qëndrueshëm në kohë, për të paktën gjashtë muaj. Puna kërkimore tregon që pedofilia mund të haset si te meshkujt, ashtu edhe tek femrat, por është më e theksuar tek meshkujt. Raste mund të gjenden edhe mes personave të afërt e familjarë të të miturit.
2. Pedofilia është e lidhur me konceptin e dhunës seksuale dhe abuzimit seksual. Kuptimi i kësaj të fundit, tashmë me karakter ndërkombëtar dikton domosdoshmërinë e përcaktimit të definicionit se çfarë nënkuptohet me “dhunë”. Dhuna konsiderohet si një dhunim (shkelje) i përgjithshëm i të drejtave të çdo qenieje njerëzore: i së drejtës së jetës, sigurisë, dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik e mendor dhe mund të marrë forma të ndryshme ose, më saktë, materializohet në forma të ndryshme, si agresion ose sulm fizik, abuzim seksual e përdhunim, kanosje dhe tronditje e thellë ose frikësim dhe duhet të konsiderohet nga e drejta penale, si vepër penale.
3. Lidhur me abuzimin seksual brenda rrethit të besimit, Kodi jonë Penal parashikon dënime penale në rastet e abuzimit seksual *duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës* apo me *persona në gjini ose nën kujdestari*. Megjithatë, vihet re se legjislacioni penal ende nuk merr parasysh të gjithë dimensionin e marrëdhënies së besimit siç përcaktohet nga Konventa Lanzarote. Një gjë e tillë është theksuar edhe në raportin e parë të Monitorimit të Zbatimit të Konventës së Lanzarotës (Lanzarote Committe), “*një pjesë e shteteve anëtare kanë futur në legjislacionin e tyre dënimin penal për abuzimin seksual të fëmijëve në kontekstin e abuzimit me pozitën, statusin ose marrëdhënien, por vetëm një prej tyre ka përdorur terminologjinë e përcaktuar në Konventën e Lanzarotës për përcaktimin e krimin si abuzim në një pozitë besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes*”.
4. Ndryshimet e bëra në Kodin Penal me ligjin nr.144/2013, datë 20.5.2013, ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale. Këto ndryshime e sjellin legjislacionin penal shqiptar në standardin e legjislacionit ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e Këshillit të Evropës (Lanzarote) “*Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual*”. Në këtë frymë është miratuar ngritja e Seksionit për të Miturit pranë institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet ligjit nr.155/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i cili pritet të ndikojë pozitivisht në garantimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.
5. Edhe pse Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Lanzarotës, si dhe atë të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, legjislacioni shqiptar ka ende sfida sa i përket çështjes së mbrojtjes së fëmijës dhe në veçanti mbrojtjes së fëmijës nga abuzimi seksual. Pa dyshim, njohuria për fenomenin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve vjen në rritje dhe bashkë me rritjen e të kuptuarit të përbashkët

mbi karakteristikat dhe tipologjinë e fenomenit, lind edhe nevoja për rishikime të vazhdueshme të legjislacionit.

6. Nga raportet dhe analizat e bëra deri tani, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri ka shumë mangësi, sidomos sa i përket nivelit të kapaciteteve të profesionistëve për t'iu përgjigjur nevojave komplekse të fëmijëve të abuzuar dhe familjeve të tyre, mungesës së buxhetit dhe mungesës së shërbimeve mbështetëse rehabilituese dhe ri-integruese për fëmijën dhe familjen. Një situatë e tillë nuk është e justifikueshme, qoftë edhe formalisht për shkak të angazhimeve të marra përsipër në kuadër të parashikimeve të bëra nga neni 14/1 i Konventës së Lanzarotes, i cili përcakton se: *“Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të ndihmuar viktimat, në kuadrin afatshkurtër dhe afatgjatë, për rimëkëmbjen e tyre fizike dhe psikosociale. Masat e marra në përputhje me këtë paragraf duhet të marrin parasysh pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijëve”*.
7. Numri i kufizuar i burimeve njerëzore që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, konkretisht mungesa e NJMF-ve në çdo njësi administrative në Shqipëri si dhe prania e vetëm e një punonjësi në NJMF-të ekzistuese, e vështirëson shumë punën në identifikimin, referimin, vlerësimin dhe ndjekjen e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Megjithatë kohët e fundit janë bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, pothuajse në të gjitha shkollat është i pranishëm psikologu.
8. Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri i mungojnë shërbimet e emergjencës 24 orë (përveç një qendre në Tiranë), si edhe shërbimet e specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht dhe autorët e krimit, të cilat do mundësonin ofrimin e ndërhyrjes së menjëhershme dhe trajtimit afatgjatë të fëmijës dhe familjes sipas një modeli specifik.
9. Jeta seksuale e një personi është pjesë e jetës së tij private, e cila përbën një aspekt të rëndësishëm të të drejtave themelore të njeriut. Jeta private garanton një sferë brenda së cilës një person mund të krijojë marrëdhënie të llojeve të ndryshme duke përfshirë edhe ato seksuale dhe si rrjedhojë jep zgjedhjen për të afirmuar e nënkuptuar se identiteti i jetës seksuale të një personi i përket mbrojtjes së dhënë nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.
10. Në Shqipëri konstatohet mungesë e njohurive dhe aftësive profesionale në fushën e abuzimit seksual të fëmijëve. Nëpunës nga sektorë të ndryshëm që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve kanë mangësi në njohuri dhe në aftësi profesionale lidhur me trajtimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë përfshirë në programe trajnimit që lidhen me çështje të abuzimit seksual të fëmijëve brenda rrethit të besimit. Nga ana tjetër, një pjesë e tyre nuk njohin plotësisht kuadrin e përgjithshëm rregullator mbi menaxhimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar, specifikat e vlerësimit dhe ndjekjes së rasteve të abuzimit seksual brenda rrethit të besimit. Kodi i sjelljes së profesionistëve me fëmijët është në mjaft raste i papërshtatshëm.
11. Së fundmi, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”. Ky është një hap i rëndësishëm me fokus përmirësimin e kuadrit ligjor. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin,

ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

12. Marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale me të mitur janë një nga krimet që kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore. Ato përfaqësojnë një nga format kryesore të abuzimit seksual ndaj të miturit. Mbrojtja e lirisë seksuale dhe zhvillimit seksual normal të personit të mitur përbën një nga aspektet kryesore të integritetit fizik dhe psikik të tij, si dhe një nga të drejtat dhe liritë themelore të të miturit. Prandaj kjo figurë e veprës penale paraqet rëndësi të madhe në mbrojtjen e këtyre të drejtave.
13. Gjatë aplikimit në praktikë të kësaj figure të veprës penale u konstatua se ajo nuk mund të zbatohet në rastin e marrëdhënieve homoseksuale me të mitur. Kështu, me qëllim që të sigurohet mbrojtja juridike penale e njëjtë ishte e nevojshme ndërhyrja legislative. Një boshllëk i tillë ligjor u plotësua me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001, i cili ndryshoi përmbajtjen e mësipërme, duke i dhënë trajtën që kjo dispozitë ka aktualisht. Kështu që edhe në rastin e marrëdhënieve homoseksuale me të mitur kualifikimi ligjor duhet të bëhet sipas këtij neni. Ky qëndrim është i konsoliduar edhe nga praktika gjyqësore.
14. Marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale më një fëmijë të mitur që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç formojnë krim sepse është çmuar se fëmija i mitur, në këtë moshë, nuk e ka arritur atë zhvillim të përgjithshëm, në të cilin të kuptojë karakterin e veprës dhe pasojat e saj, si dhe mund të kryejë normalisht marrëdhënie seksuale pa pasojë të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin normal seksual. Përcaktimi i saktë i moshës ka rëndësi ekzistenciale për kualifikimit e saktë ligjor.
15. Edhe pse përcaktimi me ligj i moshës 14 vjeç për konsensusin për marrëdhënie seksuale është një hap pozitiv në mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi seksual, kjo moshë bie në kundërshtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, e cila përcakton se “fëmijë është çdo person deri në moshën 18 vjeç”. Gjithashtu këto nene kriminalizojnë aktin e penetrimit seksual, por nuk përcaktojnë qartë veprime të tjera me natyrë seksuale që mund të ndërmerren kundrejt fëmijës. Neni 108 i Kodit tonë Penal dënon kryerjen e akteve të turpshme në prezencë të fëmijës nën moshën 14 vjeç, por nuk jep një përkufizim të akteve të turpshme. Për më tepër fëmijët mbi moshën 14 vjeç nuk janë të mbrojtur nga ky nen.
Kjo mangësi në legjislacionin shqiptar është evidentuar edhe nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës sipas të cilit “*Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës është thellësisht i shqetësuar për gjendjen e legjislacionit shqiptar, i cili nuk mbron të gjithë fëmijët deri në moshën 18-vjeçare nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, për mungesën emasave efektive për parandalimin dhe luftimin e tij, si dhe mungesën e shërbimeve për t’i ofruar fëmijëve mbështetje psiko-sociale, rehabilitim dhe ri-integrim*”.
16. Kodi ynë Penal nuk parashikon në mënyrë eksplicite momentin e konsumimit të kësaj figure të veprës penale. Ndërsa, në kodet e disa vendeve të tjera, psh ai i Kosovës, moment i konsumimit rezulton nga përkufizimi që bëjnë për termin “marrëdhënie seksuale. Siç theksuam më

sipër, Kodi Penal i Kosovës e përcakton marrëdhënien seksuale penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit. Si përfundim themi se vepra konsiderohet e konsumuar në momentin që ndodh një penetrim sado i vogël, ose një fillesë e aktit seksual.

17. Termi “pëlqim” nënkupton pajtim i vullnetshëm i personit, i cili ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, ose pjekurinë seksuale për të kryer aktin seksual. Nuk ekziston pëlqimi nëse personi me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë; pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës; pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin; ose personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera; personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera.
18. Figura e veprës penale e marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale me të mitur me pasojë vdekjen është vepër penale e përbërë e drejtë, sepse kryerja e marrëdhënieve me të mitur përbën vepër penale edhe nëse nuk shoqërohet me vdekjen e viktimës, ndërsa vdekja përbën vepër penale edhe nëse kryhet më vetë. Lidhur me këtë rrethanë cilësuese rëndësi të veçantë merr qëndrimi psikik i subjektit aktiv lidhur me vdekjen e të miturit. Disa autorë mbajnë qëndrimin se pasojat si vdekja, apo vetëvrasja e të miturit në çdo rast vijnë nga pakujdesia, duke e trajtuar si vepër me dy forma faji. Megjithatë një qëndrim i tillë nuk është konsistent, sepse në këtë figurë të veprës penale dallojmë qëndrimin psikik që subjekti aktiv ka ndaj aktit seksual dhe ndaj pasojës së ardhur, vdekja, vetëvrasja, apo dëmtimi i rëndë i shëndetit. Një formë e tillë e qëndrimit psikik në doktrinën e së drejtës konsiderohet si forma e ndërlikuar e fajit.
19. Konsiderohet marrëdhënie seksuale edhe rasti kur persona të tjerë detyrohen për të kryer marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin. Një përcaktim i tillë është i saktë dhe në këtë optikë duhet të përqasin interpretimin e tyre edhe organet e drejtësisë shqiptare. Ndërsa, lidhur me përgjegjësinë penale të personit që i ka shtyrë të miturit të kryejnë marrëdhënie seksuale, theksojmë se subjekti aktiv e ka konsumuar figurën e veprës penale dy herë, sepse në marrëdhënie janë përfshirë dy të mitur, dhe për secilin prej tyre plotësohen elementet e figurës së veprës penale. Në këtë rast nuk plotësohen kriteret e rrethanës “kryerje e veprës më shumë se një herë”. Kjo e fundit nënkupton kryerjen disa herë të figurës së përgjithshme, përfshirë format e cilësuar të saj dhe është qartësisht e dallueshme nga rrethana “në dëm të disa personave”. Elementi kohë është kriteri dallues i këtyre rrethanave. Nëse vepra kryhet ndaj disa personave në një kohë relativisht të afërt, si dhe në koneksitet me njëra tjetrën në anën objektive, atëherë ndodhemi përpara rrethanës “në dëm të disa personave”.
20. Lidhur me dijeninë e moshës të të miturit, shtetet në kodet penale të tyre kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Kështu, Kodi Penal italian në nenin

609 përcakton se: “Kur veprat e parashikuara nga nenet 609 bis, 609 ter, 609 quater dhe 609 octies kryhen kundër personit nën moshën katërbëdhjetë vjeç, si dhe në rastin e krimit të përmendur në nenin 609 quinquies, fajtori nuk mund të pretendojë, si justifikim për veten, mosdijeninë e moshës së viktimës”. Pra, ligjvënësi italian përjashtoi aplikimin e rregullave të gabimit në fakt për këtë figurë të veprës penale. Ndërsa Kodi Penal i Kosovës në nenin 229 të tij përcakton se: “1. Për qëllime të këtij Kapitulli, lajthimi lidhur me moshën e viktimës e cila është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet nuk është lajthim në fakt sipas nenit 25 të këtij Kodi, nëse kryesi me vetëdije ka qenë i pakujdesshëm në vënien e vetës në lajthim të tillë. 2. Kryesi nuk është penalisht përgjegjës për shkak të lajthimit në fakt nga neni 25 i këtij Kodi nëse për arsye të justifikueshme nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se viktima ka qenë nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet”. Nga njëra anë Kodi Penal i Kosovës për efekt të aplikimit të përgjegjësisë penale e detyron autorin që të tregohet i kujdesshëm që me vetëdije të mos bjerë në një lajthim në fakt. Nga ana tjetër në mënyrë eksplicite, ky kod parashikon përjashtimin e përgjegjësisë penale në rastin e gabimit në fakt. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, duhet të përmirësohet në këtë drejtim, duke bërë parashikime strikte lidhur me gabimin në fakt për këtë figurë të veprës penale.

21. Duke marrë në konsideratë konceptin e konkurimit fiktiv në formën e përthithjes, në të cilin njëra vepër shërben si mjet, ndërsa tjetra si qëllim theksojmë se, në rastin kur heqja e paligjshme e lirisë shërben si mjet për realizimin e veprës qëllim, kryerjes së marrëdhënies seksuale, nuk kemi konkurim ndërmjet këtyre veprave. Kështu, heqja e paligjshme e lirisë dënohet me lehtë se marrëdhënia seksuale, homoseksuale me të mitur. Të dy këto vepra kryhen ndaj të njëjtit subjekt pasiv. Heqja e paligjshme e lirisë është mjeti i vetëm për realizimin e veprës qëllim.
22. Kur heqja e paligjshme e lirisë shoqëron marrëdhënien seksuale, ose homoseksuale. Për shembull, personi A takon të mitur në rrugë, e terheq me forcë nga krahu dhe pas një shkurrije kryen marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të. Më pas e lë të lirë të largohet. Duke patur në vëmendje analizën e bërë lidhur me konceptin e konkurimit fiktiv të përthithjes, një tjetër rast i tij është konkurimi ndërmjet veprës kryesore dhe veprës së padënuar shoqëruese dytësore (inkluzioni), e cila ekziston gjatë realizimit në të njëjtën kohë të figurave të veprës kryesore dhe asaj ndihmëse. Këto figura mund të realizohen me një, apo më shumë veprime në lidhshmëri natyrore, kohore dhe hapësinore. Kështu që, në shembullin e mësipërm nuk kemi konkurim ndërmjet heqjes së paligjshme të lirisë dhe marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale me të mitur. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga praktika gjyqësore.
23. Kur heqja e paligjshme e lirisë pason marrëdhënien seksuale, ose homoseksuale. Për shembull, personi A pasi kryen marrëdhënie seksuale me të miturin, e fut atë në garazhin e makinës dhe e mban aty për disa ditë. Sipas doktrinës juridike, një tjetër rast i konkurimit fiktiv të përthithjes është konsumcioni i veprës plotësuese të padënuar, e cila ekziston vetëm si vazhdimësi natyrore e veprës kryesore, si formë për realizimin e qëllimit për çka është kryer edhe vepra kryesore. Vepra e mëvonshme mbulohet nga vepra e më përparshme nëse e mira juridike që mbrohet është e njëjta, në të kundërt kur të mirat juridike të cenuara janë të ndryshme atëherë

kemi të bëjmë me konkurim ndërmjet veprave penale. Duke u bazuar tek ky rregull kualifikimi ligjor i faktit tipik të trajtuar në shëmbullin e mësipërm bëhet duke konkuruar veprat me njëra tjetrën. Ky qëndrim është reflektuar edhe në praktikën gjyqësore.

24. Duke konstatuar ngjashmërinë që ka rrëmbimi, ose mbajtja peng e personit me qëllim përfitimin, me heqjen e paligjshme të lirisë me qëllim për të kryer marrëdhënie seksuale me të mitur, është e rëndësishme të analizohen diferencat thelbësore ndërmjet këtyre figurave të veprës penale. Kjo analizë merr vlerë të shtuar për shkak të problematikave të shfaqura në praktikën gjyqësore dhe kualifikimit të gabuar ligjor që bëhet në këto raste të ngjashme.
25. Krimi “Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me të mitur”, siç e theksuam më lart ka objekt juridik mbrojtjeje lirinë seksuale, por akti seksual dhe veprimet që e përbëjnë, apo shoqërojnë atë çënojnë edhe ndjenjën e dinjitetin personal. Kjo e fundit përbën objektin juridik të mbrojtjes të figurës së veprës penale të “Fyerja”. Pavarësisht koneksitetit natyror të tyre, ndërmjet krimit “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe kundërvajtjes penale të “Fyerja” ekzistojnë dallime thelbësore si nga objekti që ato prekin ashtu edhe nga ana subjektive. Duke marrë në konsideratë dallimin ndërmjet figurave të veprës penale të “Fyerja” dhe “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”, theksojmë se për të bërë kualifikimin e duhur ligjor, duhet të përcaktohet qëllimi që ka subjekti aktiv në kryerjen e veprimeve të tilla. Kështu, nëse këto veprime janë kryer në funksion të arritjes së kënaqësisë seksuale, atëherë kualifikimi do të bëhet sipas nenit 100 të Kodit Penal, sepse ato konsiderohen pjesë përbërëse e aktit seksual. Ndërsa, nëse ato kryhen me qëllim për të cenuar nderin dhe dinjitetin personal të të dëmtuarit, kualifikimi do të bëhet sipas konkurimit real ndërmjet figurave të veprës penale të “Fyerja” dhe “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”.
26. Në doktrinën e së drejtës penale në Shqipëri është mbajtur qëndrimi se për sa kohë që objekti i drejtpërdrejtë “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari” si dhe krimeve të tjera seksuale është i ndryshëm, atëherë duhet të pranojmë edhe konkurimin ndërmjet tyre. Sipas tyre, krimi i marrëdhënieve seksuale në gjini konkuron në çdo rast me krimet e tjera seksuale. Qëndrimi që ka mbajtur praktika gjyqësore ndër vite është i njëjtë me qëndrimin e teorisë. Si konkluzion theksojmë se, figurat që kanë të njëjtin objekt grupor nuk konkurrojnë me njëra tjetrën. Këtë qëndrim kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.1, datë 12.03.2002. Duke marrë në konsideratë qëllimin e ligjit penal, të dënimit penal, parimin e drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe dënimit, si dhe faktin që legjislatori e përcakton masën dhe llojin e dënimit për veprat konkrete në varësi të rrezikshmërisë shoqërore që ato paraqesin, qëndrimi që kualifikimi ligjor të bëhet sipas dispozitës që parashikon dënimin me të rëndë është më i bazuar në shkencën e së drejtës penale. Si përfundim theksojmë se, për të shmangur të gjitha problematikat lidhur me konkurimin ndërmjet figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” dhe figurës së veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini ose nën

- kujdestari”, është e nevojshme ndërhyrja legjislative duke e parashikuar si rrethanë cilësuese në një rën nga figurat e veprës penale, atë të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në gjini ose nën kujdestari me të miturit.
27. Legjislacioni penal nuk ka dhënë përkufizimin e termit “vepra të turpshme”. Ndërsa, doktrina e së drejtës penale është përpjekur në këtë drejtim duke i përkufizuar veprat e turpshme (luxuri) si ato forma të kënaqjes së epshit seksual që nuk përmbajnë elementët e ndonjë krimi tjetër seksual (të marrëdhënies seksuale, ose homoseksuale, ngacmimit seksual, dhunës seksuale, pornografisë, prostitucionit, apo trafikimit). Lidhur me termin “vepra të turpshme” edhe jurisprudenca ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Sipas saj, në nocionin “Vepra të turpshme apo akte seksuale” përfshihen të gjitha ato akte të adresuara drejt zonave erogjene dhe që janë të përshtatshme për të cënuar apo kompromentuar vendosmërinë e lirë të seksualitetit të viktimës dhe që rezultojnë të afta për të hyrë në sferën seksuale të viktimës, me mjete që lidhen me shtrëngim, presion apo abuzim të kushteve të inferioritetit fizik apo psikik. Në të gjitha këto raste do të përfshihen çdo lloj prekje, kapje, shtypje mbi zonat intime të viktimës, të ndjeshme dhe të afta për të shkaktuar ndjesi seksuale qoftë edhe në mënyrë jo të plotë dhe/ose për një periudhë kohore të shkurtër, duke qenë i parëndësishëm fakti nëse viktimja e ka arritur këtë kënaqësi erotike. Shprehja “pjesë intime” nënkupton gjinj të një femre, penis, vagina dhe/apo anusi. Ndërsa shprehja “prekje” nënkupton kontakt direkt ose indirekt, pa penetrim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë send.
28. Praktika gjyqësore ka treguar që subjekti aktiv në periudha të ndara kohore ka kryer veprime të ndryshme si prekja në pjesë të ndryshme të trupit dhe më pas ka ndodhur kryerja e marrëdhënies seksuale. Në këtë rast kualifikimi ligjor duhet të bëhet sipas figurës së veprës penale të “Marrëdhënia seksuale, ose homoseksuale me të mitur”. Është ana subjektive e krimit kryesor për të dalluar këtë figurë të veprës penale nga veprat e tjera seksuale, pra, qëllimi i subjektit aktiv për të kryer vepra të turpshme apo marrëdhënie seksuale. Një element i rëndësishëm për të përcaktuar nëse subjekti aktiv ka patur si qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale apo vetëm vepra të turpshme, është fakti nëse akti seksual është realizuar apo jo, pavarësisht mundësisë së realizimit të tij.
29. Parashikimi i rrethanës cilësuese: “Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale” është zbatim i detyrimeve, ose angazhimeve të marra përsipër nga Republika e Shqipërisë me ratifikimin e Konventës Lanzarote, për të marrë masa legjislative për kriminalizimin ose për të parashikuar si vepër penale shkaktimin me qëllim, për qëllime seksuale, të një fëmije i cili nuk e ka arritur moshën e përcaktuar, për të qenë dëshmitar i abuzimit seksual ose i aktiviteteve seksuale, edhe pa iu dashur të marrë pjesë në to. Konventa Lanzarote veprimet e tilla i përcakton me termin “Korrupsioni i fëmijëve”.
30. Konstatohet se parashikimi i bërë nga Kodi Penal, nuk është tërësisht në përputhje me parashikimin e Konventës Lanzarote. Kodi Penal nuk ka parashikuar edhe togefjalëshin “edhe pa iu dashur të marrë pjesë në to”.

Një zgjedhje e tillë është në përputhje me parimet shkencore penale mbi bazën e të cilave është ndërtuar seksioni i krimeve seksuale, sepse nëse do të bënim një parashikim të tillë atëherë do të kishim konvergencë ndërmjet anës objektive të kësaj figure të veprës penale e kryer sipas rrethanës cilësuese dhe anës objektive të figurës së veprës penale që konsumohet nga kryeja e sjelljes seksuale. Kështu, do të ndërlikohej kualifikimi ligjor nëse i mituri do të bëhej pjesë e veprimeve seksuale si psh pjesë e marrëdhënies seksuale. Në këtë rast do të konsumoheshin figurat e veprës penale të “Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me të mitur” dhe “Vepra të turpshme”, sipas rrethanës cilësuese. Pra, një parashikim i tillë do të çenonte parimet e ligjshmërisë dhe *ne bis in idem*.

31. Nga studimi i praktikës gjyqësore rezulton se kryerja e veprave të turpshme ndaj të miturve sjell pasoja të rënda psikologjike për ta, saqë në disa raste ka shkaktuar tentativën për vetëvrasje, apo realizimin e saj. Gjithashtu, është konstatuar se në disa raste veprat e turpshme kryhen ndaj disa të miturve njëkohësisht. Në disa prej këtyre rasteve kualifikimi ligjor i bërë nuk është sipas rregullave juridiko-penale të konkurimit, apo të ekzistencës së figurave të veprës penale.

Meqënëse figura e veprës penale “Vepra të turpshme” nuk parashikon si rrethanë cilësuese shkaktimin e vetëvrasjes, atëherë duhet të analizohet ekzistenca e figurës së veprës penale “Shkaktimi i vetëvrasjes” parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal. Nga përmbajtja e kësaj dispozitë rezulton se dy nga elementet determinant më vlerë kualifikuese janë:

- Ekzistenca e varësisë apo marrëdhënieve familjare ose bashkëjetesës ndërmjet subjektit aktiv dhe pasiv;
- Trajtimi i keq sistematik ose sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin.

Nëse pas kryerjes së veprës së turpshme plotësohen kushtet e sipërcituara atëherë plotësohen elementet e secilës figurë të veprës penale dhe në këto kushte do të kishim konkurim ndërmjet tyre. Ndërsa, nëse nuk plotësohen kushtet e sipërpërmendura atëherë kualifikimi duhet të bëhet vetëm sipas figurës së veprës penale të “Vepra të turpshme”. Lidhur me këto situata, në praktikën gjyqësore nuk janë mbajtur qëndrime të njëjta.

32. Duhet të theksojmë se legjislacioni penal ka pasqyruar në përmbajtjen e tij të gjitha zhvillimet në kuadrin juridik ndërkombëtar. Kështu, ajo ka reflektuar edhe parashikimet e bëra nga Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, (Lanzarote) 25.10.2007, e cila është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Me anë të kësaj konvente shtetet anëtare ranë në marrëveshje lidhur me format e inkriminimit. Risi e kësaj konvente ishte parashikimi dhe inkriminimi i veprimeve, që lidhen me pjesëmarrjen e një fëmije në performanca pornografike.

33. Legjislacioni ynë penal nuk ka dhënë përkufizimin e termi “Pornografi e fëmijëve”. Megjithatë, përpjekje janë bërë nga doktrina e së drejtës penale, por dhënia e një përkufizimi për pornografinë e fëmijëve është i vështirë për shkak të trajtimit të pakët të këtij koncepti, si dhe koneksitetit dhe nënkuptimit si një pornografi e zakonshme. Termi “pornografi e fëmijëve” nënkupton pornografinë konvencionale me subjekt fëmijët, me përmbajtje të imazheve me natyrë seksuale shfrytëzuese të fëmijëve viktima, pavarësisht pëlqimit të fëmijës për çdo akt seksual të përshkruar në çdo

- imazh. Termi “pornografi e fëmijëve” përfshin, por nuk kufizohet në, “çdo paraqitje, në çfarëdo mënyrë, të një fëmije të përfshirë në aktivitete të vërteta ose të simuluar eksplicite seksuale ose çdo paraqitje e pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale”, si dhe përdorimin e një fëmije për të krijuar një shfaqje të tillë.
34. Pavarësisht se Kodi Penal nuk ka dhënë një përkufizim për pornografinë e fëmijëve, meqë Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual” Lanzarote, mund t’i referohemi drejtpërdrejt përkufizimit të dhënë nga ajo. Kështu, në nenin 20/2 të saj theksohet se: *“Termi “pornografi fëmije” do të thotë çdo material që vizualisht pasqyron një fëmijë të angazhuar në një sjellje eksplicite reale ose të simuluar seksuale ose ndonjë pasqyrim i organeve seksuale të fëmijës për qëllimet seksuale parësore.*
35. Përcaktimi i termit “fëmijë”, për qëllimet e pornografisë së fëmijëve, do të konsiderohet “çdo person nën moshën 18 vjeç”, pavarësisht nga mosha e arrijtes së pjekurisë seksuale. Mosha që përcaktohet nga ligji, në të cilën një person mund të konsiderohet i aftë për të dhënë pëlqimin për aktivitetin seksual ndryshon nga vendi në vend, një pengesë e vështirë për mbrojtjen e qëndrueshme dhe të harmonizuar të fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në nivel ndërkombëtar. Ndërsa, një person nën moshën 18 vjeç mund të jetë në gjendje për të dhënë pëlqimin lirisht për marrëdhëniet seksuale, një individ i tillë nuk është ligjërisht në gjendje për të dhënë pëlqimin për çdo formë të shfrytëzimit seksual, duke përfshirë edhe pornografinë e fëmijëve.
36. Paragrafi i dytë i nenit 117 të Kodit Penal parashikon format e inkriminimit të sugjeruara nga Konventa Lanzarote. Për herë të parë u inkriminua pornografia e fëmijës, sepse deri në këtë moment ishte kriminalizuar vetëm “pornografia në mjediset ku ka fëmijë”. Risi e kësaj konvente ishte parashikimi dhe inkriminimi i veprimeve, që lidhen me pjesëmarrjen e një fëmije në performanca pornografike.
37. Një nga teknikat e inkriminimit që përdor Kodi Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Pornografia” është posedimi i pornografisë së fëmijëve. Kjo teknikë inkriminimi u parashikua me ligjin nr.144/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke parashikuar se: *“...Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet...”* Ky parashikim përbënte një risi në krahasim me kodet penale të mëparshme, sepse posedimi e pornografisë nuk kondicionohet me qëllim specifik mbajtjeje për shpërndarje, ose shitje. Për efekt konsumimi mjafton posedimi i pornografisë, duke formalizuar në mënyrë të dukshme këtë figurë të veprës penale.
38. Në Kodin tonë Penal nuk janë reflektuar parashikimet e Konventës Lanzarote lidhur me institutin e tentativës dhe bashkëpunimit për veprën penale të pornografisë. Megjithatë, kjo nuk pengon aplikimin e instituteve të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht instituti i bashkëpunimit, tentativës. Në mënyrë specifike, në Kodin Penal duhet të

reflektohen masat e duhura të kërkuara nga konventa, sepse kjo do të ndikonte në përmirësimin e politikës penale.

39. Praktika gjyqësore ka treguar se si faza paraprake e pornografisë, joshja, tërheqja, paraqet veprimet fillestare të ndërmarra nga një abuzues seksual i fëmijëve për t'u "socializuar" ose "për të përgatitur" fëmijën për një marrëdhënie seksuale. Përgjithësisht janë dy forma të tërheqjes së fëmijëve: joshje online dhe shpërndarjen, ose shfaqje të pornografisë (të rritur ose fëmijë) për një fëmijë. Joshje online e një fëmije për akte seksuale ndodh kur një abuzues përdor internetin për të joshur, për të ftuar, ose bindur fëmijën të takohen për akte seksuale. Abuzuesit seksualë të fëmijëve përdorin një shumëllojshmëri të mjeteve të tilla si e-mail, faqet e rrjeteve sociale, mesazheve të çastit, dhe chat room për të fituar besimin e fëmijës dhe pastaj caktojnë një takim ballë për ballë.
40. Konventa Lanzarote sugjeron kriminalizimin e veprimit të "Joshjes" duke përdorur termin "Tundimi i fëmijëve për qëllime seksuale". Kështu në nenin 23 të Konventës theksohet se: "*Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e propozimit të qëllimshëm, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, të një të rrituri për të takuar një fëmijë, që nuk e ka mbushur moshën e përcaktuar në zbatim të nenit 18, paragrafi 2, për qëllimin e kryerjes së ndonjërisë prej veprave penale të përcaktuara, në përputhje me nenin 18, paragrafi 1.a, ose nenin 20, paragrafi 1.a, kundër tij ose saj, kur ky propozim pasohet nga akte materiale që çojnë në një takim të tillë...*" Një parashikim i tillë, me disa specifika të ndryshme, është pasqyruar në nenin 108/4 të Kodit tonë Penal në të cilin parashikohet se: "*Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjërisë nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.....*". Një zgjedhje e tillë nuk është në kundërshtim me konventën sepse ajo është më gjithëpërfshirëse dhe nuk e përjashton parashikimin e saj.
41. Si konkluzion, theksojmë se nuk duhet të ketë përgjegjësi penale për fëmijët e përfshirë në pornografi dhe një parashikim i tillë duhet të jetë i shprehur në mënyrë të qartë në çdo legjislacion kombëtar. Pavarësisht nëse një fëmijë është viktimë "vullnetare" ose dëshmitar jobashkëpunues, nuk duhet harruar fakti se ai/ajo është fëmijë viktimë.
42. Pozita e të dëmtuarit dhe të drejtat e tij gjatë procesit penal duket se nuk ka patur vëmendje specifike nga legjislatori, sepse ky i fundit përqëndrohet në zbulimin, gjetjen, ndëshkimin e autorit të veprës penale. Një aspekt i tillë ka bërë që në doktrinë të theksohet se tipari diskrecionar karakterizon drejtësinë tonë penale, sepse i gjithë sistemi procedural penal, duke përfshirë edhe atë penal material ka fokus atë të sipërcituar, duke mos i kushtuar rëndësi, në veçanti pasojave të veprës penale dhe pozitës së të dëmtuarit nga ajo.

Vendi ynë ka treguar në permanencë vullnetin që të përqafojë nismat ndërkombëtare duke ratifikuar me shpejtësi konventat ndërkombëtare me objekt pozitën e viktimës në procesin penal. Megjithatë akoma është në fazën embrionale koncepti i "viktimologjisë" dhe nuk janë marrë të gjitha

masat që këto konventa kërkojnë në këtë drejtim. Mangësi të tillë kanë bërë, në veçanti në ato raste ku viktimë është i mitur, që ajo të bëhet subjekt i viktimizimit sekondar.

43. Theksojmë se ka patur një angazhim në rritje të të gjitha strukturave shtetërore, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, përmes masave parandaluese dhe mbrojtëse, si të natyrës ligjore, ashtu edhe të tipit administrativ, social, ekonomik, etj. Shteti Shqiptar është angazhuar në mënyrë të veçantë, me parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i të miturve, duke shprehur vullnetin e tij në luftën kundër këtij fenomeni edhe nëpërmjet ratifikimit të disa konventave, të cilat zënë një vend të veçantë në hierarkinë e akteve ligjore.
44. Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet përkufizimi apo kuptimi i termit të dëmtuar apo viktimë. Në mungesë të një parashikimi të tillë doktrina e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore janë përpjekur që të japin një përkufizim dhe një përcaktim të tillë.
Për të përcaktuar rrethin e personave që mund të konsiderohen viktimë ka patur qëndrime të ndryshme në doktrinë. Mund të themi se viktimë konsiderohet çdo anëtar i familjes së viktimës, që ka pësuar një dëmtim, e shkakuar kjo e fundit drejtpërdrejtë nga vepra penale. Termi “dëmtim” duhet të nënkuptojë marrëdhënien shpirtërore individuale, duke përfshirë atë të varësisë materiale të drejtpërdrejtë ndërmjet viktimës dhe të afërmit të tij.
45. Identifikimi i të miturit, viktimë e abuzimit seksual, ose trafikimit, është një nga aspektet procedurale kryesore, i cili jep kontribut të rëndësishëm për zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e abuzuesit, ose shfrytëzuesit, si dhe bën të mundur mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë një angazhim serioz në arritjen e një procesi identifikimi sa më efektiv, i cili shprehet në miratimin nga Këshilli i Ministrave i vendimit nr.582 datë 27.07.2011 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit”.
46. Organet e pushtetit qendror duhet të ndërmarrin angazhimet bazë për organizimin, bashkërendimin e duhur, financimin dhe sigurimin e një kuadri rregullator efektiv për luftimin e krimit të shfrytëzimit, ose abuzimit seksual të të miturit në përgjithësi dhe për identifikimin e viktimave në veçanti, gjithashtu me një zbatim sa më efektiv të tyre. Mungesa e angazhimit të këtyre organeve mund të shkaktojë lehtësisht rrëzimin e sistemit të krijuar, si dhe mangësi në atë çfarë ofrohet.
47. Autoritetet e emigracionit të kufirit e të zbatimit të ligjit duhet të krijojnë dhe zbatojnë procedura për identifikimin e fëmijëve viktimë në portet e hyrjes apo në vende të tjera. Autoritete të shërbimit social, të shëndetësisë ose të arsimit duhet të vihen në lidhje me autoritetet me rëndësi të zbatimit të ligjit, sa herë që ka informacion ose dyshim se një fëmijë po shfrytëzohet apo po trafikohet ose rrezikon të shfrytëzohet dhe trafikohet, apo abuzohet. Zyrtarët që përgjigjen për politikën, po ashtu si dhe një spektër i gjerë i organizmave të zbatimit të ligjit dhe të mirëqënies së fëmijës, kanë për detyrë të vënë në zbatim procedura që do të mundësonin identifikimin e fëmijëve të trafikuar, ose abuzuar sa më shpejt e sa më me efektshmëri që të jetë e mundur. Në veçanti të miturit e trafikuar mund të

identifikohen në pika të ndryshme gjatë procesit të trafikimit si: ndërsa shoqërohen nga trafikantët në largësi nga vendet e tyre të zakonshme të banimit; ndërkohë që largohen nga vendi i tyre; ndërsa kalojnë kufirin në një vend të huaj; ose në kohën që shfrytëzohen. Institucionet e ndryshme, si qeveritare ashtu dhe joqeveritare, duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e të miturve në këto faza të ndryshme të procesit të trafikimit.

48. Shërbimet sociale, autoritetet shëndetësore dhe arsimore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e fëmijëve që abuzohen, shfrytëzohen ose që eventualisht trafikohen, si në vendin e tyre të prejardhjes ashtu dhe në një vend të huaj. Ato duhet të jenë të vetëdijshëm e të vëmendshëm ndaj shenjave që tregojnë se fëmijët po shfrytëzohen, ose abuzohen, p.sh. nëse ata nuk ndjekin rregullisht shkollën ose kur janë shumë të shpërqendruar e nuk mësojnë. Shërbimet sociale duhet të luajnë një rol të veçantë në kontrollin e mirëqënies së fëmijëve që janë identifikuar në një pike kufitare si viktima të mundshme trafikimi (ose në rrezik të abuzohen për arsye të tjera) e të vënë në dijeni shërbimet e imigrimit ose shërbimet policore.
49. Nëse në përfundim të procesit të identifikimit arrihet që të identifikohet një, ose disa të mitur, të cilët kanë qënë viktima të trafikimit, shfrytëzimit, ose abuzimit seksual, hapi i parë që duhet të ndërmerret është caktimi i një kujdestari për ta shoqëruar të miturin përgjatë gjithë procesit, deri sa të gjendet dhe zbatohet një zgjidhje e qëndrueshme në interesin më të mirë të fëmijës. Ky aspekt procedural paraqet rëndësi substanciale për mbrojtjen e të drejtave të të miturit, aq sa është ngritur në standard me karakter ndërkombëtar, i parashikuar nga aktet ndërkombëtare dhe i detyrueshëm për t'u ndërmarrë nga të gjitha shtetet, të cilat kanë ratifikuar këto akte. Kështu, në mënyrë eksplicite Konventa e Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qënieve" parashikon se: "*Pas identifikimit të një fëmije të parashikuar si viktime, cdo palë: -a) do të parashikojë përfaqësimin e fëmijës nga një kujdestar ligjor, organizatë, ose autoritet ligjor që do të veprojë në emër të interesave më optimale të këtij fëmije...*"
50. Shteti, nëpërmjet ministrive përkatëse, duhet të ndihmojë autoritetet e zbatimit të ligjit, autoritetet e shërbimit social, organizmat me rëndësi administrative, organizmat ndërkombëtare dhe OJF/organizatat e shoqërisë civile për përcaktimin e një mekanizmi efikas referimi për fëmijët viktima. Marrëveshja ku përcaktohen përgjegjësitë e aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore për sa i përket identifikimit, referimit, akomodimit, asistencës dhe rehabilitimit të viktimave të trafikimit në Shqipëri është Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qënieve Njerëzore (MKR) e firmosur më datë 18 Korrik 2005. Në thelb, MKR është një sistem, një rrjet i ngritur mes policisë, shërbimit social, shërbimit diplomatik dhe konsullor, si dhe qendrave pritëse dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit.
51. Ratifikimi i konventave nga Republika e Shqipërisë, duke i bërë pjesë të sistemit juridik të brendshëm dhe të detyrueshëm për zbatim, kërkon që në legjislacionin procedural penal të reflektohen qasjet e tyre, të merren masat e duhura legjislative në funksion të realizimit të qëllimit të ekzistencës së

tyre, në mbrotje të të drejtave dhe interesave të viktimës në përgjithësi dhe asaj të të miturit në veçanti.

52. Të miturit viktimë të trafikimit, shfrytëzohen për kryerjen e shumë veprave të tjera penale të tilla si, vjedhja, vjedhja e xhepave, trafikimi i drogave, kultivimi i kanabisit, mashtrimi etj., duke u shndërruar në strategji e qëllimshme e trafikuesve që t'i ekspozojnë viktimat ndaj rrezikut për t'u ndjekur penalisht dhe t'i manipulojnë dhe shfrytëzojnë për veprimtari kriminale. Kjo veprimtari kriminale kërkon që organet shtetërore të tregohen vigjilentë që të bëjnë diferencat nëse i mituri është subjekt aktiv, apo viktimë e një krimi, duke bërë një identifikim të saktë të viktimës dhe hetim të efektshëm të krimit të trafikimit, si dhe për të siguruar mbrotje të efektshme të të drejtave të viktimës, përfshirë mosdënimin për ato shkelje të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin që ata janë trafikuar.
53. Informimi i të miturit-viktimë është një aspekt procedural shumë i rëndësishëm në trajtimin e tyre, i cili është afirmuar në akte juridike ndërkombëtare. Kështu, Protokollin "Mbi parandalimin, pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar" parashikon se shtetet palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ ose administrativ të përmbajë masa të tilla, që u sigurojnë viktimave të trafikimit në rastet e duhura informacionin e duhur për proceset gjyqësore dhe ato administrative, si dhe mbështesin viktimën në shprehjen e shqetësimeve të tyre gjatë procedurave penale.
54. Viktimës duhet t'i garantohet akses efektiv në informacion. Kontakti i parë është kur viktimë kallëzon veprën penale, njofton nëpërmjet telefonit apo ndodhet në vendin e ngjarjes. Informacioni jepet në mënyra të ndryshme, me gojë, me shkrim, zakonisht duke shpërndarë njoftime e broshura dhe duke krijuar një sistem në të cilin ka një detyrim për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët që të informojnë viktimën për të drejtat e tij. Informacioni duhet të jepet pa vonesë dhe referuar jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, nënkupton kriter si "afat i arsyeshëm", "pa vonesë të pajustificuar" etj. Oficeri i policisë duhet të sigurohet që viktimë të informohet për shërbimet e mbështetjes së viktimave dhe i kërkon atyre nëse dëshirojnë të kontaktohen nga këto shërbime.
55. Në Kodin tonë të Procedurës Penale, deri para ndryshimeve të miratuara me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar në mënyrë eksplicite e drejta e viktimës për interpretim, sqarim, apo përkthim. Në nenin 123 të Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar është parashikuar tashmë që, dispozitat për caktimin e përkthyesit për të pandehurin zbatohen edhe për viktimën.
56. Të gjitha të drejtat e viktimës të sipërpërmendura do të ishin të cinguara nëse viktimës nuk i njihet e drejta për të ankuar vendimin e organit procedural, lidhur me hetimin e veprës penale, subjekt pasiv i së cilës është.
57. Në kundërshtim me Konventën, veprat penale të parashikuara në nenet 89, 102/1, 105 dhe 130 të Kodit Penal (që gjejnë shprehimisht parashikim në nenet 35, 36 dhe 37 të Konventës) përfshihen në veprat që ndiqen me ankim sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale dhe për të cilat procedimi nuk mund të vazhdojë nëse viktimë e tërheq ankesën e tij. Nga ana tjetër, ngacmimi seksual (neni 40) që nuk përfshihet në nenin 55 të Konventës për detyrimin e ndjekjes penale ex officio, nuk përfshihet në veprat që ndiqen me

ankim sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Një garanci e tillë për fillimin dhe vazhdimin e procedimit penal pavarësisht nga akuza e bërë nga viktima apo tërheqja e ankimit, parashikohet edhe në Konventën e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore” dhe Konventën e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, të ratifikuar, por në këtë rast nuk vërehet papajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

58. Identifikimi dhe referimi i viktimave do të humbiste rëndësinë e tij, nëse viktimës nuk do t’i garantohej sigurimi dhe mbrojtja e saj, e cila duhet të jetë e pakushtëzuar nga pëlqimi i tyre për të bashkëpunuar me organet e zbatimit të ligjit. Kjo ndihmë duhet të konsiderohet nga ana e organeve zbatuese të ligjit më shumë si një e drejtë se sa një detyrim për të miturin viktimë, pavarësisht se fakti nëse është kryer ose jo një veper penale do të përcaktohet nga gjykata. Procedurat e hetimeve penale mund të zgjasin me vite, megjithatë viktimat kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme, ku në shumicën e rasteve ato janë në gjendje të keqe fizike dhe psikologjike.
59. Të miturit viktimë të trafikimit, ose shfrytëzimit seksual, ose abuzimit seksual pësojnë një dëm të përkuperueshëm në mënyrë absolute, format e të cilit janë të ndryshme, por janë bërë përpjekje të vazhdueshme për garantimin e një standardi sa më të lartë në rikuperimin e dëmit dhe rehabilitimin e viktimave. Pavarësisht qasjes që Republika e Shqipërisë ka treguar lidhur me përafrimin e legjislacionit të saj me atë ndërkombëtar, sistemi ynë ligjor nuk ka një ligj të veçantë të kompensimit dhe të dëmshpërblimit të viktimave. Legjislacioni ynë procedural penal ka parashikuar vetëm një mjet procedural për të siguruar dëmshpërblimin e viktimës për shkak të dëmit të shkaktuar, nëpërmjet padisë civile në procesin penal.
60. Konkludojmë që është e nevojshme që gjithë përvoja juridike shqiptare të synojë përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, të cilat parashikojnë se viktimat e krimit, në mënyrë të veçantë viktimat e krimeve të dhunshme, duhet të gëzojnë të drejtën e kompensimit të dëmit nga keqbërësi ose shteti, duke e konsideruar ushtrimin e kësaj të drejte me rëndësi të veçantë, jo vetëm për rehabilitimin fizik, psikologjik dhe shoqëror të viktimës, por edhe për vetë forcën e drejtësisë.

BIBLOGRAFIA

Literaturë:

- Kempe CH. Sexual abuse, another hidden pediatric problem: the 1977 C. Anderson Aldrich lecture. *Pediatrics*. 1978;62:382–389
- *Report of the consultation on child abuse prevention*, 29–31 March 1999. Geneva, World Health Organization, 1999 (document WHO/HSC/PVI/99.1).
- Krug EG et al., eds. *World report on violence and health*. Geneva, World Health Organization, 2002.
- Yates A. Differentiating hypererotic states in the evaluation of sexual abuse. *J Am Acad Child Adolesc Psychiatry*. 1991;30:792.
- **Raman, Surekha** (1995). “Violation of Innocence: Child Sexual Abuse and the Law” The Laëyers Collective; (10 & 11), October- November.
- “Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Rrethin e Besimit në Shqipëri” Një Studim Cilësor mbi Perspektivat dhe Perceptimet e Profesionistëve, Prindërve dhe Fëmijëve. Dhjetor 2015, Terre Des Hommes.
- Sethi D., Bellis M. et al. *European report on preventing child maltreatment*. Geneva, Worldhealth Organization, 2013.
- Julia Whealin, Ph.D. (2007-05-22). “*Child Sexual Abuse*”. National Center for Post Traumatic Stress Disorder, US Department of Veterans Affairs.
- Finkelhor D (1994). The International Epidemiology of Child Sexual Abuse. *Child Abuse & Neglect*, 18(5): 409–417.
- World report on violence against children, (2006).
- United Nations Secretary-General’s Study on Violence against Children (2005). Regional Desk Review: South Asia. Available at: www.violencestudy.org/r27.
- Haj-Yahi MM, Tamish S (2001). The Rates of Child Sexual Abuse and Its Psychological Consequences as Revealed by a Study among Palestinian University Students. *Child Abuse & Neglect*, 25(10): 1303–1327.
- Andrews G et al. (2004). Child Sexual Abuse. In: Ezzati M et al. (2004). *Comparative Quantification of Health Risks: Global and Regional Burden of Disease Attributable to Selected Major Risk Factors*, Vol. 2. Geneva, World Health Organization, pp 1851–1940.
- Committee of the Parties to the Council of Europe Convention on the protection of children against sexual exploitation and sexual abuse (T-ES) 1st implementation report PROTECTION OF CHILDREN AGAINST SEXUAL ABUSE IN THE CIRCLE OF TRUST THE FRAMEËORK Adopted by the Lanzarote Committee on 4 December 2015.
- Filippou, F. *Child Protection System Under Construction*. Terre des hommes Mission in Albania, 2015.
- Margo Kaplan by New York Times; http://www.nytimes.com/2014/10/06/opinion/pedophilia-a-disorder-not-a-crime.html?_r=0 ;October 2014.
- Kempe CH. Sexual abuse, another hidden pediatric problem: the 1977 C. Anderson Aldrich lecture. *Pediatrics*. 1978;62:382–389.
- “Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders”

- <http://www.virped.org/index.php/who-we-are>
- <https://it.wikipedia.org/wiki/Pedofilia>
- Protecting children from sexual violence. www.coe.int/children2010
- <https://it.wikipedia.org/wiki/Pedofilia>
- Krugman RD. Recognition of sexual abuse in children. *Pediatr Rev.* 1986;8:25–30
- McCann J, Voris J. Perianal injuries resulting from sexual abuse: a longitudinal study. *Pediatrics.* 1993;91:390–397
- *American Journal of Psychology e il Journal of Psychiatric Practice*
- Sex, Priests and Secret Codes; Thomas Doyle, Richard Sipes and Patrick Wall; 2006
- <http://www.theguardian.com/world/2009/sep/28/sex-abuse-religion-vatican>
- <http://www.theguardian.com/world/2009/sep/28/sex-abuse-religion-vatican>
- Ismet Elezi “E drejta Penale (Pjesa e posaçme)”, Tiranë 2013.
- Vllado Kambovski “E drejta Penale”, Pjesa e Përgjithshme, Botim i dytë, SHB “Furkan ISM” Shkup 2007.
- Ismet Elezi “E drejta Penale (Pjesa e posacme)”, Tiranë 2009.
- Mantovani, Diritto penale, Parte generale, 2001.
- Dorina Hoxha “Ndikimi i elementit kohë në veprës penale”, botimet Jozef 2015.
- Skënder Kaçupi, Fazat e kryerjes së veprës penale, Disertacion, 1990.
- Fiandaca-Musco, Diritto penale, Parte generale.
- Antolisei, Manuale di diritto penale, Parte generale.
- Pagliaro, Principi di diritto penale. Parte generale, Milano, 1998.
- “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i Gjykatës së Lartë të RPSSH dhe Universiteti i Tiranës, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982.
- Shefqet Muçi “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i përditësuar. Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2007.
- Ismet Salihu, E drejta penale. Pjesa e Përgjithshme, 2010.
- Ismet Elezi, dhe të tjerë “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë, 2006.
- Alessandro Amaolo “Il reato complesso di cui all’art. 84 codice penale”, në adresën e internetit <http://www.overlex.com/leggiarticolo.asp?id=1957>, akses në dt. 04 Maj 2013.
- Grigor Gjika “Bashkim krimesh dhe dënimesh”, Drejtësia Popullore, nr. 3, viti 1963.
- Ismet Salihu “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botim i ripunuar, Botimet “Fama 2008”, Prishtinë, 2008.
- Shih vendimin unifikues nr 284 datë 06.10.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- http://www.legifrance.gouv.fr/content/download/1957/13715/.../Code_33.pdf%E2%80%8E, akses në datë 25 Mars 2013.

- Ronco, M, Ardizzone, S., Codice penale ipertestuale, Commentario anca dati di giurisprudenza, Seçonda edizione, Utet giuridica 2007.
- Çela, Elezi, Peza, Gjika, E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme III.
- Nicola Corea “Le Sezioni Unite dicono no alla consunzione”, artikull në adresën e internetit <http://www.altalex.com/index.php?idnot=34106>, akses në datë 16 Prill 2013. Shih gjithashtu, Vllado Kambovski “E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese “Furkan ISM”, Shkup, 2007.
- Luan Pirdeni “Hyrje në Logjikë”, Shtëpia Botuese “Koçi”, Tiranë, 2007, f. 32.
- Ismet Salihu, Hilmi Zhitija dhe Fejzullah Hasani “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës” Botimi 1 I publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, viti 2014.
- “E Drejta Penale e RPSSH, Pjesa e Posaçme”, Botim i “Universitetit të Tiranës”, “Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike”, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1983.
- “Concorso Apparente di Norme”, “Digesto delle Discipline Penalistiche, Volume 2”, Botimet “UTET”, Quarta Edizione”, Rishtypur 1994.
- “Relazione sul tema, il concorso di reati”, Botim i “Fondazione dell’Avvocatura Trevigiana Scuola Forense”. në adresën e internetit: <http://www.ordineavvocatitreviso.it/sito/images/stories/RELAZION E CONCORSO DI REATI Lezione del 29.06.2012.pdf>, akses në datë 25 Shkurt 2012.
- Per Erik Astrom “Beyond all tolerance, A growing problem demanding new counter-measures”, Save the Children Sweden, 2004.
- Janis Wolak et al., Child-Pornography Possessors Arrested in Internet-Related Crimes: Findings from the National Juvenile Online Victimization Study vii, n.1 (Nat’l Ctr. for Missing & Exploited Children ed., 2005) [hereinafter Child-Pornography Possessors].
- Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the Sale of Children, Child Prostitution and Child Pornography, G.A. Res. 54/263, Annex II, U.N. Doc. A/54/49, Vol. III, art.2, para.c, entered into force Jan. 18, 2002 [hereafter Optional Protocol].
- International Centre for Missing & Exploited Children (ICMEC) - Child Pornography- Model legislation & Global Review, 2012, 7th Edition.
- ICMEC - Child Pornography- Model legislation & Global Review, 2012.
- Internet Watch Foundation, 2009 Annual and Charity Report 18, at http://www.iwf.org.uk/assets/media/annual-reports/IWF_2009_Annual_and_Charity_Report.pdf.
- Internet Watch Foundation, 2011 Annual and Charity Report 12, at <http://www.iwf.org.uk/accountability/annual-reports/2011-annual-report>
- Internet Watch Foundation, 2006 Annual and Charity Report 19, at http://www.enough.org/objects/20070412_iwf_annual_report_2006_web.pdf
- Janis Wolak et al., Child-Pornography Possessors Arrested in Internet-Related Crimes: Findings from the National Juvenile Online Victimization Study

- Child Pornography “Model legislation & Global Review” 2012, Seventh Edition. International Centre for Missing & Exploited Children.
- Trent Toone, Kids revealing too much online, study says, Deseret Neës, Feb. 6, 2011, at <http://www.deseretnews.com/article/705366050/Kids-revealing-too-much-online-study-says.html?pg=all>.
- Eva J. Klain, Prostitution of Children and Child-Sex Tourism: An Analysis of Domestic and International Responses 47 (Nat’l Ctr. for Missing & Exploited Children ed., 1999).
- Prostitution of Children and Child-Sex Tourism.
- European Commission, Child Sexual Abuse, Jun. 12, 2012, at http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/child-sexual-abuse/index_en.htm.
- Richard Kerbaj and Dominic Kennedy, Link Between Child Porn and Muslim Terrorists Discovered in Police Raids, TIMES ONLINE, Oct. 7, 2008 (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).
- Sergey Stefanov, Russia Fights Child Porn and Terrorism on the Internet, PRAVDA, Dec. 4, 2002, at <http://english.pravda.ru/hotspots/terror/04-12-2002/1620-porn-0/>.
- Orin Kerr, Applying the Fourth Amendment to the Internet: A General Approach, 62 Stan. L. Rev. 1005, 1030 (2010) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).
- European Commission Directorate General for Home Affairs, Evidence of Potential Impacts of Options for Revising the Data Retention Directive: Current approaches to data preservation in the EU and in third countries 4 (Nov. 2012) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).
- Christopher Parsons, Lawful Access and Data Preservation/Retention: Present Practices, Ongoing Harm, and Future Canadian Policies, 21 (2012) (describing the increasingly blurred distinction between content based and non-content based data) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).
- Department of Justice of Canada, Lawful Access FAQ 4 (2005) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children)
- Jason Weinstein, Data Retention as a Tool for Investigating Internet Child Pornography and other Internet Crimes 3 (Jan. 25, 2011) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).
- EU Directive on the retention of data generated or processed in connection with the provision of publicly available electronic communication services or of public communications networks, Article 1 (Mar.15, 2006), at <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32006L0024:en:html>.
- Report from the European Commission to the Council and the European Parliament: Evaluation report on the Data Retention Directive (Directive 2006/24/EC) 22 (Apr. 18, 2011), at <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0225:FIN:en:PDF>.
- Cecilia Malmström, Member of the European Commission responsible for Home Affairs, Taking on the Data Retention Directive, SPEECH/10/723

- European Commission conference in Brussels (Dec. 3, 2010), at http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-10-723_en.htm.
- Sander Simoni “Trajtimi i Viktimave të trafikimit si deshmitarë gjatë procesit gjyqësor, mundësitë ligjorepër kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore”, shkrim në botimin e Shkollës së Magjistraturës “Kquadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore”, shkurt 2013.
 - “The responsibilities and the rights of victims of crime”. The Modern Law Review 1992, Jul; 55(4).
 - Sebba L. “The victim’s role in the penal process: A theoretical orientation”. The American Journal of Comparative Law 1982; 30(2): 217-240.
 - MOFFETTI, “La testimonianza fragile nel processo penale: verso la policromatica valutazione delle dichiarazioni del minore, in La giustizia penale”, 2013.
 - “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007.
 - Komisioneri i lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatët (UNHCR), “Guidelines on Policies in dealing with Unaccompanied Children Seeking Asylum” (Udhëzues për politikën që trajtojnë fëmijët e pashoqëruar që kërkojnë azil) shkurt 1997.
 - Separated Children in Europe Programme. Statement of Good Practices. (Fëmijët e ndarë në programin europian. Dëshmim i praktikave të mira). Save the children dhe UNHCR, Botim i tretë, 2004.
 - SOSFS Recommendations: Socialstyrelsens foertfattningssamling (Rekomandimet e SOSFS: Përmbledhje e rregullave për bordet sociale), 1986: 26 dhe 1993: 11, Suedia, cituar në Separated Children in Europe Programme (Fëmijët e ndarë në Programin europian). Workshop lidhur me vlerësimin e moshës dhe identifikimin. Bukuresht, 20-22 mars 2003. Raport prej Kate Haltvorsen.
 - The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985).
 - Limanowska, B., “Trafikimi i Qënieve Njerëzore në Europën Jug-Lindore”, UNICEF, OKB OHCHR, OSBE/ ODIHR, 2002.
 - “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europën Juglindore dhe Lindore.
 - OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, supra note 7.
 - UNODC, “Toolkit to Combat Trafficking in Persons”, 1st ed., Vienna/Neë York, 2006, Tool 6.1.
 - OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, Vienna, 2011.
 - ICMPD, “Guidelines for the Development of a Transnational Referral Mechanism for Trafficked Persons: South-Eastern Europe”, Vienna, 2009.
 - Raportit “Për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore” janar -dhjetor 2011.

- “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore.
- OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, *supra* note 7.
- “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktime të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007.
- “Programi për fëmijët e ndarë në Europë, Deklaratë e praktikave të mira”, Save the Children, Botim i tretë 2004.
- “Udhërrefyes referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktime të trafikimit në Europë”. Unicef, Tiranë, 2007.
- “Programi për fëmijët e ndarë në Europë, Deklaratë e praktikave të mira”, Save the Children, Botim i tretë 2004.
- “Doracak i ofruesve të shërbimeve për mbrojtjen e viktimeve të trafikimit”, Tiranë, qershor 2008, Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- “Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimeve të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014.
- ILO, Vlerësimi Global i Punës së Detyruar (Gjenevë, 2012): Në vitin 2012, ONP vlerësoi se 20.9 milionë njerëz janë viktime të punës së detyruar, në shkallë botërore. Ky vlerësim përfshin të gjithë sferën e trafikimit të qenieve njerëzore.
- European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The EU Strategy towards the Eradication of Trafficking in Human Beings 2012-2016.
- OSCE Ministerial Council, Declaration on Trafficking in Human Beings, MC(10). JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para.6 (Këshilli Ministerial i OSBE-së, Deklarata për Trafikimin e Qenieve Njerëzore).
- OSCE Ministerial Council, Decision No. 1 Enhancing the OSCE’s Efforts to Combat Trafficking in Human Beings, MC(8).DEC/1 (Vienna, 28 November 2000), para. 9; OSCE Ministerial Council, Ministerial Declaration On Combating All Forms of Human Trafficking, MC.DOC/1/11/Corr.1 (Vilnius, 7 December 2011). Vendime të Këshillit Ministerial të OSBE-së.
- “Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimeve të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave, OSCE 2014.
- Qendra për Shanse të Barabarta dhe Luftë kundër Racizmit, Trafikimit dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore (Belgjikë) në lidhje me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit të Gent (Belgjikë), 31 maj 2007.

- Kombet e Bashkuara, Op. Cit.,
http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVII I-12 a&chapter=18&lang=en.
- Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 14 dhe 15 prill 2009, CTOC/COP/WG.4/2009/2 (21 prill 2009), vizituar më 10 prill 2013.
- Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 27-29 janar 2010, CTOC/COP/WG.4/2010/6 (17 shkurt 2010),
http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/CTOC_COP_WG4_2010_final_report_E.pdf.
- Qendra Studimore Innocenti e UNICEF, Child Trafficking in the Nordic Countries: Rethinking strategies and national responses. Technical report (May 2012).
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Udhëzime për Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit (shtator 2006).
- UNICEF, Udhëzues referencë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropë (Gjenevë, 2006).
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja V kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit” Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në konsultim me Ekipin e Ekspertëve të Aleancës kundër Trafikimit të Personave. OSCE 2014.
- Council of Europe, Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice (17 November 2010).
- UNODC, Udhëzime legjislative për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollit në zbatim të tij (New York, 2004).
- Raport Titulli “Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar, në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Analizë e legjislacionit dhe praktikës shqiptare mbi trafikimin e qenieve njerëzore, duke përfshirë asistencën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe monitorimin e gjykatave”. Tiranë, 2009.
- Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, Rekomandimi (2005)9 mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, e datës 20 prill 2005, neni II(2). Për një pasqyrë të çështjeve të përgjithshme në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, ju lusim të shihni grupin punues mbi mbrojtjen e dëshmitarëve brenda sistemit gjyqësor, pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogë dhe krim, Vjenë 22 – 24 shtator 2005.
- TONINI, *Manuale di procedura penale*, edizione XIII, Milano, 2012, fq 1007
- RECCHIONE, *L’esame del minore persona offesa in reati sessuali*, in *Esame incrociato (Officina del diritto)*, 2011.

- MOFFETTI, *La testimonianza fragile nel processo penale: verso la policromatica valutazione delle dichiarazioni del minore*, in *La giustizia penale*, 2013, fasc. 5.
- UNODC, “Toolkit to Combat Trafficking in Persons”, 1st ed., Vienna/New York, 2006, Tool 6.1.
- OSCE, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims. A Community Policing Approach”, Vienna, 2011.
- “Dëshmshpërblimi për përsone dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-es. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Al.Ujazdowskie 19 00-557 Varshavë Poloni www.osce.org/odihr.
- *Black’s Law Dictionary* (Fjalori Juridik Black) (botimi i 8-të, 2004).
- Raporti i GRETA-s përmend edhe problemet e hasura në zbatimin e ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (raporti i GRETA-s paragrafët 171, 172, 174, 128 dhe rekomandimi nr. 17).
- Drejtësia Popullore, nr.1, viti 1968,

Legjislacion:

- Kushtetura e RSH, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998
- Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003
- Kodi Penal i RSH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995
- Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.03.1995
- Kodi Civil i RSH, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.07.1994
- Kodi i Punës i RSH, miratuar me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995
- Ligji nr.10347 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i miratuar në 4.11.2010
- Ligji nr.8454, datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” është plotësuar me Ligjin nr.8600, datë 10.04.2000, si dhe është ndryshuar edhe me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005.
- Kodi Penal miratuar nga Kuvendi Popullor më 15.06.1977 dhe hyrë në fuqi më 01.10.1977.
- Kodi Penal i Kosovës nr.04/L-082 të vitit 2012, botuar në fletoren zyrtare nr.19 datë 13.07.2012.
- Ligj nr.8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e “Konventës për Krimin në Fushën e Kibernetikës”.
- Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimin dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, e vitit 1985.
- Konventa “Mbi të drejtat e fëmijës” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me datë 20.11.1989
- Konventa e miratuar në Strasburg me 24.11.1983, ratifikuar me ligjin nr.9265 dt.29.07.2004.
- Ligji nr.10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”,

- Konventa Lanzarote ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
- Protokolli Opsional “Mbi shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijë dhe Pornografinë”, miratuar me ligjin nr.9834, datë 22.11.2007.
- Protokolli Opsional “Mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura, miratuar me ligjin nr.9833, datë 21.12.2007.
- Konventa e Hagës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin për Birësimet jashtë vendit” ratifikuar me ligjin nr. 8624, datë 15/06/2000.
- Konventa nr.182 “Për Format më të këqija të punës së fëmijëve” dhe Rekomandimi nr.190, “Format më të këqija të punës së fëmijëve”, ratifikuar me ligjin nr. 8774, datë 23.4.2001.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, ratifikuar me ligjin nr. 9265, datë 29.7.2004.
- Konventa Evropiane “Mbi marrëdhëniet me fëmijët”, ratifikuar me ligjin nr.9359, datë 24.3.2005.
- Konventa Evropiane “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, aderuar me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimave të trafikimit”, ratifikuar me ligjin nr. 9544, datë 29.05.2006.
- Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijët”, aderuar me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007.
- Protokolli Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi implikimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura”, aderuar me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007.
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”, ratifikuar me ligjin nr.10 015, datë 6.11.2008.
- Konventa e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, aderuar me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”, ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 9.02.2009.
- Konventa Evropiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore”, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.
- Ligji nr.10 425, datë 2.6.2011 për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.
- Ligji nr.104/2012 për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

- Ligji nr.10 424, datë 2.6.2011, për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”.
- Ligji nr.63/2012, për ratifikimin e Konventës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”.
- Ligji 86/2013 për ratifikimin e Protokollit Opsional mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Procedurat e Komunikimit.
- Direktiva nr.29 të vitit 2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25.10.2012 e Bashkimit Evropian.
- Ligji nr.10071, datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.
- Vendimit nr.582, datë 27.07.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit”.
- Convention for the Protection of Individuals with regard to Automatic Processing of Personal Data (1981, as amended in 1999), CETS No. 108; European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms (1950), CETS No.005, Article 8 (Right to respect for private and family life).
- “Udhëzues Rajonal Për Identifikimin e Personave të Trafikuar” Manual për Europen Juglindore dhe Lindore.
- “Strategjia Kombëtare për luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore , Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2005- 2007 PERFSHIRE: Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktimë të trafikimit – Marreveshje bashkëpunimi për krijimin e një mekanizmi kombëtar referues për identifikim dhe asistencë të përmirsuar për viktimat e trafikut të qënieve njerëzore”, Tiranë, Shqiperi- Korrik 2005 (Ribotuar në korrik 2006)
- Bashkimi Evropian, Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA (5 prill 2011):
- “Plani i BE-së për praktikën më të mira, standartet dhe procedurat për luftimin dhe parandalimin e Trafikimit të Qënieve Njerëzore”. Fletore Zyrtare C 311, 09/12/2005.
- Bashkimi Evropian, Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qënieve njerëzore dhe për mbrojtjen e viktimave, e cila zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA (5 prill 2011), Preambula, Kapitulli 11.
- Kombet e Bashkuara, Konventa për Statusin e Refugjatëve, 189 UNTS 150 (Gjenevë, 28 korrik 1951).
- Vendimi Kuadër të Këshillit 15.03.2001/220/JHA “Për pozitën e viktimave në procedimet penale”.
- Direktivat e BE-së të datës 5 prill 2011 (paragrafi 13 dhe neni 17) rekomandojnë dhe inkurajojnë përdorimin e aseteve të konfiskuara për mbështetjen e viktimës së trafikimit për mbrojtje përfshirë edhe kompensimin.

- Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr.557, PC.DEC/557, 24 Korrik 2003, shtojca e Planit - Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 685, PC.DEC/685, 7 Korrik 2005.
- OKB ECOSOC, “Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Raporti i Kombeve të Bashkuara nga Komisioneri I Lartë për të Drejtat e Njeriut në Këshillin Ekonomik dhe Social”, E/2002/68/Add.1, 2002.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore¹ e nënshkruar korrik 2005.
- Strategjia e mbrojtjes sociale dhe plani i saj i veprimit (2008-2013), miratuar me VKM nr.80, datë 28.01.2008.
- Strategjia Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara dhe Plani i saj i Veprimit, miratuar me VKM nr.8, datë 7.01.2005.
- Strategjia për Shërbimin e Kujdestarisë, miratuar me VKM nr.1104, datë 30.7.2008.
- Strategjia e Trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2010, miratuar me VKM nr. 1083, datë 23.07. 2008.
- Plani i veprimit për fëmijë 2012-2015 – Organizata Botërore për mbrojtjen e fëmijëve.
- Komiteti Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve, ngritur me Urdhër të Kryeministrit, Nr. 24 datë 21.03.2007.
- Raportet Vjetore për Gjendjen e Kriminalitetit për periudhën 2000-2016 të Prokurorisë së Përgjithshme.

Jurisprudenca e GjEDNJ:

- Çështja Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 22.10.1981, A. 7525/76.
- Çështja Rantsev kundër Qipros dhe Ruisë, kërkesa nr. 25965/04 (Strasburg, 7 janar 2010), vizituar më 31 janar 2013.
- Çështja, Van Mechelen e të tjerë v. Holanda, 21363/93, 21364/93, 21427/93, e datës 23 prill 1997.

Jurisprudenca Kushtetuese

- Vendimi nr.14, datë. 17 04. 2007. Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr.8 datë 05.03. 2005 të Gjykatës Kushtetuese.

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë

- Vendimi nr.2, datë 20.06.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendimin nr.245, datë 26.09.2012 i Kolegjit Penale të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr.537, datë 28.10.2009 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.15, datë 04.02. 2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr.537, datë 28.10.2009 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.122, datë 23.08.1966 i Kolegjit Penal I Gjykatës së Lartë
- Vendimi i datës 13.12.1980 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Vendimi nr.555, datë 03.12.2008 i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendimi i datës 24.04.1974 i Gjykatës së Lartë.
- Udhëzimi nr.1, datë 14.03.1979 i Plenumit të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.249, datë 03.10.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi e datës 04.10.1980 i Kolegjit të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.148, datë 30.05.2012 i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.12, datë 31.03.1959 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.15, datë 04.02. 2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Udhëzimi nr.183, datë 20.09.1966 i Plenumit i Gjykatës së Lartë, Kolegji Penal
- Vendimi nr.170, datë 08.10.1966 i Kolegji Penal I Gjykatës së Lartë
- Vendimii e datës 30.05.1975 të Kolegjit Penal të Gjykata e Lartë.
- Vendimi unifikues nr.6, datë 30.09.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.8, datë. 5.03 2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Udhëzime të Plenumit të Gjykatës së Lartë, vitet 1965-1970
- Vendimi unifikues nr.284, datë 06.10. 2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.289, datë 07.11. 2012, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi unifikues nr.1, datë 25.03.2005 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.715, datë 30.06.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.49, datë 18.02.2009 i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.245, datë 26.09.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr.365, datë 04.04.2007 i Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.128, datë 01.03.2006 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi i datës 14.07.1980 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr.75, datë 19.02.2003 i Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.19, datë 18.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.68, datë29 Shkurt 2012 të Gjykatës së Lartë
- Vendimi unifikues nr.1 datë 01.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.151, datë 30.05.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.62, datë27.02.2013 i Kolegjit penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi i datës 26.05.1979 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Udhëzimi nr.1,datë 14.03.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë.

Jurisprudenca e gjykatave të faktit

- Vendimi nr.1581 datë 18.11.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.337 datë 11.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.1175 datë18.07.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- Vendimi nr.594 datë 24.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.296 datë 26.02.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.14 datë 24.01.1961 i Kolëgjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr.1099 datë 17.07.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.176 datë 27.01.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
- Vendimi nr.1048 datë 05.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.2301 datë 24.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.1524 datë 07.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.2301 datë 24.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.934 datë 17.04.2014 i Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.1224 datë 14.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr.582 datë 25.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.821 datë 25.04.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Jurisprudenca Italiane

- Vendimi nr.5478/2014 i Gjykatës Italiane të Kasacionit
- Vendimi nr.15676 të vitit 2010 i Gjykatës Italiane të Kasacionit
- Vendimi nr.366 të vitit 2000 i Gjykatës Italiane të Kasacionit
- Vendimi nr.7234 të vitit 1998 i Gjykatës Italiane të Kasacionit
- Vendimi nr.1702 të vitit 1972 i Gjykatës Italiane të Kasacionit
- Vendimi nr.314 të vitit 1971 i Gjykatës Italiane të Kasacionit

Jurisprudenca e SHBA-së

- Vendimi Roth v. United States (1957) i Gjykatës Supreme të SHBA-ve
- Vendimi Ginsberg v. Neë York (1968) i Gjykatës Supreme të SHBA-ve
- Vendimi Ginzburg v. United States (1965) i Gjykatës Supreme të SHBA-ve
- Vendimi Miller v. California (1973) i Gjykatës Supreme të SHBA-ve
- Vendimi New York v. Ferber (1982) i Gjykatës Supreme të SHBA-ve

ABSTRAKT

Ky punim doctoral synon të formësojë një trajtesë juridike në përfaqje të plotë të dimensioneve reale fenomenologjike e juridiko-penale të pedofilisë, një moment me ndjeshmëri të lartë dhe vëmendjen e çdo legjislatori. Problematika që shtron kjo lloj fenomenologjie në praktikën gjyqësore, është e shumëllojshme, në kuptim të interpretimit të ligjit material dhe aspektet procedurale. Mungesa e punimeve kushtuar posaçërisht pedofilisë është arsyeja kryesore që orientoi bindjen time profesionale për të mundësuar një trajtesë në këtë fushë, me gjithë vështirësitë jo të vogla në planin e literaturës vendase e të huaj. Punimi vendos në qendër të trajtimit regjimin juridik të mbrojtjes së fëmijëve, duke analizuar specifikisht në formë të thelluar refleksionin juridik penal dhe inkriminimin e formave të shfaqjes së pedofilisë. Pedofilia është këndvështruar në kuptimin e profilit juridik, psikologjik dhe në marrëdhënie të veçantë juridike me disa vepra të tjera penale, si: heqja e paligjshme e lirisë dhe fyerja. Nëse e shohim në një kontekst paraprak, pedofilia nuk ka një marrëdhënie të ngushtë etimologjike me të drejtën penale, nisur nga fakti se termi në fjalë, ka më shumë domethënie sociologjike sesa juridiko-penale. Por, në një kontekst të gjerë juridik, ky nocion formësohet në një sërë figurash veprash penale, të cilat janë analizuar në punim si forma të tjera të inkriminimit të pedofilisë, si: marrëdhëniet seksuale në gjini, vepra të turpshme, pornografia etj. Një aspekt tjetër juridik, që përbën një stacion reflektimi dhe interesi teorik e praktik për autorin, është edhe mbrojtja e subjektit të posaçëm, fëmijës, në cilësinë e subjektit juridik. Për këtë qëllim janë konsideruar si me rëndësi të veçantë dhe janë trajtuar gjithashtu momente, si: aktet juridike ndërkombëtare me fokus garantimin e të miturve si viktimë në vepra penale të ndryshme, kryesisht në ato me natyrë seksuale. Besojmë se një përmbledhje e tillë juridike do të shërbejë si bazë për të pasuruar doktrinën dhe praktikën gjyqësore, përkundrejt interesit të përdorimit nga studentët dhe mjediset universitare, si edhe do të shërbejë në të ardhmen si një argument konsultimi për të realizuar përmirësime të këtij kuadri.

Fusha: *E drejtë penale*

Fjalë kyç: *pedofili, liri seksuale, profil psikologjik, marrëdhënie seksuale, teknikat e inkriminimit, viktimë e abuzimit seksual, kujdestari.*

ABSTRACT

This doctoral dissertation aims at creating a legal approach in conformity with real phenomenological and juridical-criminal dimensions of pedophilia, a issue of high sensitivity to the attention of any legislator. In the judicial practice, the problem of this type of phenomenology is diverse, in terms of the interpretation of the substantive law and procedural aspects. The lack of materials dedicated specifically to pedophilia is the main reason guiding my professional conviction to conduct a study in this field, despite the many difficulties related to domestic and foreign data. The thesis is mainly focused on the legal regime for the children protection, analyzing in detail the criminal legal reflection and the incrimination of forms of pedophilia. Pedophilia is viewed from a juridical, psychological and juridical standpoint and a specific judicial relationship with some other criminal offenses such as deprivation of liberty and insult. If we look at it in a prior context pedophilia does not have a close etymological relationship with criminal law, given that the term in question has a more sociological meaning than a criminal-judicial one. But, in a broad legal context, this notion is shaped by a series of criminal acts that have been analyzed in the thesis as other forms of pedophilia incrimination: homosexuality, obscene acts, pornography, and so on. Another legal aspect which is a reflection point and theoretical and practical interest for the author, is also the protection of the special subject, the child, in the capacity of the judicial subject. For this purpose, special aspects with high priority have also been considered: international legal acts focused on guaranteeing the juveniles as victims of various criminal offenses, especially those of a sexual nature. Such a legal summery, we believe, will serve as a basis for enriching judicial doctrine and practice, concerning the interest of students and university circles, and will serve in the future as a consultation reference for achieving improvements to this framework.

Areas: *Criminal Law*

Key Words: *Pedophilia, sexual freedom, psychological profile, sexual relations, incrimination techniques, victim of sexual abuse, custody.*